



PROF.DR.HFZ.
HAJREDIN HOXHA

RRUGA E DA'VETIT
NË ALLAHUN XH.SH.
NËN HIJEN E SURES
EL EN'AM



Direktiva të arta për hoxhallarë dhe studentë
Sipas Tefsirit të prof.Sejid Kutub



Asoc.Prof.Dr.Hfz.Hajredin Hoxha

Rruga e Da'wetit në Allahun xh.sh. nën hijen e Sures El En'am

(Direktiva te arta për hoxhallarë dhe studentë sipas Tefsirit të prof.Sejid Kutub)

Përktheu nga arabishtja:

Doc.Dr. Muhamed Mustafa

Lektoroi: Ahmed Ramadani

Korrekttoi: Ismet Kroshi

Tetovë 2009 - 1430 h.

Autor: **Dr.Hfz.Hajredin Hoxha**

Metoda e Sejjid Kutubit në të kuptuarit e ajeteve kur'anore mbi da'vetin përmes tefsirit të tij **“Fi dhilâlil-Kur'an”** (**“Nën hijen e Kur'anit”**)

(sureja **“el En'amë”** si shembull)

Disertacion për mbrojtjen e magistraturës nga lëmia e Kur'anit dhe Sunnetit.

Universiteti Ndërkombëtar Islamik në Kuala Lumpur - Malajzi

Fakulteti i Njohurive të Shpalljes dhe Shkencave Humane

Janar, 2000

E përktheu nga arabishtja:

Muhamed Mustafa

Redaktor gjuhësor:

Ahmed R. Ramadani

Korektor gjuhësor:

Ismet Krosi

PËRMBAJTJA

REZIME	7
Falënderim dhe mirënjohje:	9
PËRKUSHTIM!	12
HYRJE	13
Forma e hulumtimit	17
KAPITULLI I PARË	19
I. Rëndësia e kësaj tematike	Error! Bookmark not defined.
HYRJE	20
I. Rëndësia e kësaj tematike	24
1. Arsyet e zgjedhjes së kësaj teme	25
2. Problematika dhe pyetje që kanë të bëjnë me këtë hulumtim	25
3. Studimet e mëhershme	26
4. Metoda e hulumtimit	29
II. Sejjid Kutubi: Lindja, rritja, mendimet, vepra dhe rënia shehid	31
Lindja	31
Rritja dhe zhvillimi i tij	32
Karakteristikat e fëmijërisë së tij	33
Bashkangjitja e Sejjid Kutubit me Vëllezërit Muslimanë	37
Veprimtaria dhe literatura e tij	39
Rënia e tij shehid (mbytja e tij)	46

KAPITULLI I DYTË	31
I. Parimet, rregullat dhe mendimit e Sejjid Kutubit	51
II. Cilësitë e thirrësit në metodën kur'anore Error! Bookmark not defined.	
III. Thirrja e jobesimtarëve në Islam Error! Bookmark not defined.	
Hyrje Error! Bookmark not defined.	
I. Parimet, rregullat dhe mendimit e Sejjid Kutubit	53
II. Cilësitë e thirrësit në metodën kur'anore	161
1. Formimi intelektual i thirrësit Error! Bookmark not defined.	
A). Përbërja shpirtërore e thirrësit	161
1). Aspekti shpirtëror	Error! Bookmark not defined.
2. Aspekti i sjelljes Error! Bookmark not defined.	
A). Durimi	169
B). Butësia dhe mëshira	172
C). Toleranca dhe zemërgjerësia	175
Ç). Respektimi i urdhërave të fesë dhe largimi nga ndalesat e saj	176
2. Të dijë atë në të cilën thirret dhe ta kuptojë në mënyrë të drejtë	177
3. Thirrësi duhet ta njohë kulturën e kohës në të cilën jeton	183
III. Thirrja e jobesimtarëve në Islam	124
1. Thirrja (da'veti) në bazë të rrugës së shikimit dhe persiatjes rreth ajeteve të Universit	124
Hyrje Error! Bookmark not defined.	

2. Thirrja e jobesimtarëve në bazë të dialogut të qëlluar dhe diskutimit më të mirë	132
KAPITULLI I TRETË	66
I. Metoda e profesor Sejjid Kutubit në tefsirin e tij	66
II. Metoda e Kur’anit në eliminimin e koncepteve xhahilite	Error!
	Bookmark not defined.
Hyrie	Error! Bookmark not defined.
I. Metoda e profesor Sejjid Kutubit në tefsirin e tij	70
II. Metoda e Kur’anit në eliminimin e koncepteve xhahilite	136
1. Gradualiteti	136
2. Kujdesi ndaj gjendjes së atyre që u flitet (dëgjuesëve)	149
Kritikë, epilog dhe sugjerime	194
1. Disa vështrime mbi metodën e profesor Sejjid Kutubit	194
A). Vështrimet e posaçme	195
a). Kuptimi i përgjithshëm:	195
b). Kuptimi i posaçëm	196
B). Vështrimet e përgjithshme	197
1. Mos akuzimi i muslimanit për kufër me gjëra të dyshimta e të pastra:	199
2. Mbështetja në Kur’an dhe Sunnet:	199
3. Dallimi në mes gjykatësve dhe thirrësve:	200
KAPITULLI I KATËRT	Error! Bookmark not defined.
I. Thirrja (da’veti) dhe metoda e saj nëpërmes sures “El En’amë”	Error! Bookmark not defined.

II. Karakteristikat dhe specifikat e metodës së Sejjid Kutubit në të kuptuarit e ajeteve të da’vetit.	Error! Bookmark not defined.
III. Thirrja e muslimanëve në përmirësim	Error! Bookmark not defined.
Hyrje	Error! Bookmark not defined.
Kur’ani i flet instiktin njerëzor	Error! Bookmark not defined.
I. Thirrja (da’veti) dhe metoda e saj nëpërmes sures “El En’amë” ...	75
1. Arsyet e zgjedhjes së sures “El En’amë”	76
2. Tematikat e sures	Error! Bookmark not defined.
3. Emri dhe arsyeja	82
4. Rreth vlerës së sures dhe zbritjes së saj	84
5. Mënyrat e da’vetit (thirrjes) në Kur’anin Fisnik në përgjithësi:	87
II. Karakteristikat dhe specifikat e metodës së Sejjid Kutubit në të kuptuarit e ajeteve të da’vetit.	90
Hyrje	Error! Bookmark not defined.
III. Thirrja e muslimanëve në përmirësim	92
1. Thirrje në përmirësimin e besimit në bazë të të vërtetës hyjnore dhe adhurimit:	92
2. Përmirësimi i shoqërisë sipas metodës kur’anore	106
A). Çështja e mbështetjes së thirrësve në dhunë dhe në përdorimin e forcës:	107
B). Natyra dhe universalizmi i kësaj feje	109
C). Pikënisja - përcaktimi i rrugës së besimtarëve ndaj rrugës së kriminelëve	110

Ç). Historia islame argument për distancim nga mëkatarët	116
D). Çmimi i këtij distancimi dhe largimi	118
Përfundim dhe sugjerime	203

REZIME

Qëllimi i këtij hulumtimi është të studiohet metoda e profesor Sejjid Kutubit në të kuptuarit e tij të ajeteve të da'ves, përmes tefsirit të tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”** (**“Nën hijen e Kur’anit”**), duke e marrë si shembull suren **“el En’amë”**, pasi u vërejt se kishte devijim nga metoda e Kur’anit në da've, për këtë shkak ishte një imperativ që të sqarohen hapat e metodës së Kur’anit në thirrjen në Zot. Meqë në lëmë të da'vetit dolën shumë thirrës, disa prej tyre e kuptuan filosofinë e da'vetit dhe parimeve të tij, ndërsa disa të tjerë jo! Në mesin e atyre, të cilët i llogarisim se e kanë kuptuar da'ven në bazë të metodës së shëndoshë kur'anore është profesori i çmuar dhe shehidi Sejjid Kutub (Zoti e mëshiroftë!).

Hulumtuesi e ka aplikuar metodën induktive, objektive dhe analitike në hulumtimin e tij për t'i nxjerrë mendimet e profesor Sejjid Kutubit rreth kësaj tematike në bazë të shkrimeve të tij të shumta, posaçërisht në komentimin e tij që ia bën sures **“el En’amë”**.

Përmes këtij studimi hulumtuesi e ka paraqitur metodën e profesor Sejjid Kutubit në të kuptuarit e tij të da'ves. Metoda e tij mbështetet në parimin e përqendrimit në metodat e ndryshimeve të da'ves në Kur'anin Fisnik, pastaj në da'ven apo thirrjen e muslimanëve për përmirësimin e adhuruesve, më pas në thirrjen e tyre që të përmirësojnë jetën e tyre sipas metodës kur'anore, si dhe sqarimin e metodës së Kur’anit mbi eliminimin e koncepteve injorante të xhahilijetit dhe korrektimin e metodave të tyre intelektuale e teorike si dhe thirrjen e tyre në metodën gnostike dhe edukative.

Përveç kësaj që u theksua, kjo metodë nënkupton edhe thirrjen e jobesimtarëve në Islam, në mënyra të ndryshme si p.sh.: mënyra e shikimit dhe persiatjes rreth argumenteve të Universit, dialogu në formë më të bukur dhe kujdesi ndaj rrethanave dhe realitetit të tyre.

Kjo metodë e obligon thirrësin që pikësëpari të mbështetet në thirrjen në Zotin e Madhërishëm e jo në thirrjen nacionale, morale, shoqërore etj. Kjo metodë zbulon cilësi dhe përbërje shpirtërore, intelektuale e bihevioriste, me të cilat duhet të jetë i pajisur një thirrës.

Universiteti Ndërkombëtar Islamik në Kuala Lumpur - Malajzi.

Deklaratë mbi të drejtat e botimit dhe shërbimit të hulumtimeve të pabotuara:

© *Të drejtat e botimit të vitit 2000 i takojnë Hajredin Hoxhës dhe vepra titullohet:*

“Metoda e Sejjid Kutubit në të kuptuarit e ajeteve kur’anore mbi da’vetin përmes tefsirit të tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”** (“Nën hijen e Kur’anit”), sureja **“el En’amë”** si shembull”

© Nuk lejohet ribotimi apo përdorimi i këtij hulumtimi të pabotuar në asnjë mënyrë, qoftë grafike apo elektronike, fotokopjim apo regjistrim pa autorizim paraprak me shkrim nga hulumtuesi, përveç në rastet vijuese:

Falënderim dhe mirënjohje:

Këtu nuk mund të ri pa shprehur një falënderim të sinqertë dhe të posaçëm për Zotin e Madhërishtëm, në fillim e mbarim, i Cili më dhuroi të mira dhe begati të shumta e të panumërta, në mesin e të cilave është edhe realizimi i këtij hulumtimi dhe përfundimi i tij në një kohë të shkurtë e të caktuar.

Më pas, me falënderimet e mia i drejtohem profesorit dhe mentorit tim të njohur prof.dr. Su'ad Jëlldërëm (Zoti e ruajtë!), i cili nuk nguronte në ndihmat udhëzuese dhe në rrëfimet e vlefshme që m'i ofronte, si dhe nuk ngushtohej fare nga kontrollimet e shpeshta të këtij punimi dhe nga sqarimet e vazhdueshme, derisa e përfundova disertacionin në këtë formë që është para duarve tuaja.

Poashtu falënderoj dhe i drejtohem me mirënjohje anëtarit të dytë të komisionit, prof. dr. Xhemal Ahmed Beshir Badi (Zoti e shpërbleftë me të mira!), i cili pati një rol të madh në zhvillimin e idesë së këtij disertacioni dhe në rregullimin metodologjik deri në fund, ndaj dhe për këtë i falënderohem Zotit të Madhërishtëm!

E falënderoj dhe mjaft i jam mirënjohës prof. dr. Abdul-Kahhar Davud El-Ani (Allahu e mëshiroftë) i cili me vëmendje dhe vullnetarisht e lexoi këtë disertacion dhe shprehi vështrime të vyera të cilat e lartësuan vlerën shkencore të magjistraturës!

Gjithashtu i jam falënderues dhe mirënjohës vëllait tim të sinqertë Azad Ali, i cili luajti rol të madh në rregullimin formal dhe përmbajtësor të disertacionit!

Gjithashtu iu falënderohem edhe profesorëve të mi të çmuar që punojnë në Universitetin Ndërkombëtar Islamik në Malajzi, posaçërisht anëtarët e këshillit mësimor-shkencor të drejtimit të Kur'anit dhe Sunnetit!

Fare në fund nuk mund të ri pa e falënderuar përzemërsisht këshilltarin Islam pranë Ambasadës së Arabisë Saudite ne Kuala Lumpur Shejh Abdurrahman ibn Sa'd Ez-Zejr (Zoti e ruajtë!), i cili më ofroi mundësi të shkëlqyera për t'u shërbyer në bibliotekën e tij të vyer!

Pra, këtë punim timin të parë, ua kushtoj të gjithë këtyre që i përmenda më sipër, si dhe secilit që më këshilloi rreth këtij disertacioni shkencor, edhe njëherë duke i falënderuar sinqerisht dhe duke e lutur Zotin e Madhërishëm që t'i shpërblejë me të gjitha të mirat e Tij të pakufishme, për hir të Islamit dhe muslimanëve, për ndihmën që ma ofruan!

Vërtet Zoti i Madhërishëm është i Luturi më i Mirë dhe Dhënësi më Fisnik

PËRKUSHTIM!

- Këtë punim ua përkushtoj prindërve dhe vëllezërve të mi të dashur që dhanë çdo gjë të çmueshme për të mësuar fenë dhe Kur'anin!

- Bashkëshortes time të çmuar e cila më shoqëron në jetë dhe që më përkushtoi kujdes të madh deri në përgatitjen e këtij disertacioni!

- Dëshmorëve (shëhidëve) të rënë në tokën e Kosovës nga duart e kriminelëve serbë.

-Hoxhallarëve,studentëve, thirrësve ne Islam kudo që të jenë.

- Të gjithë këtyre ua përkushtoj këtë hulumtim modest duke e lutur Zotin e Madhërishëm që ta vendojë në peshoren e veprave të mira të mia në Ditën kur nuk ka kurrfarë dobie as prej pasurisë e as prej fëmijëve! Amin!

Parathenje

Të gjitha falënderimet i takojnë Allahut xh.sh. Përshëndetjet, salavatët, lutjet tona qofshin për Muhamedin a.s, familjen e tij, shokëve të tij dhe mbi ata të cilët e ndjekin rrugën e tij deri në momentin e fundit të kësaj jete. Amin

Lexues të nderuar!

Shkenca e interpretimit të Kur'anit-Tefsiri duke filluar që nga periudha e sahabëve – *Allahu qoftë i kënaqur me ta* – e deri në ditët tona, ka kaluar në periudha të ndryshe, qështje kjo, e cila kishte çuar në transformimin e rrugës së interpretimit dhe daljen në skenë të metodologjive dhe lëvizjeve të ndryshme, lexime bashkëkohore në tefsirin e kur'anit famëmadh, të cilat përputheshin me pronarët e këtyre ideologjive devijuese dhe shkencave të larmishme tek disa bashkëkohas tanë. Këto lexime të reja dhe bashkëkohore, nënkuptojnë përdorimin e teorive të reja në te'vilin dhe interpretimin e kur'anit famëmadh, të cilat çuan në shtrembërimin e kuptimeve kur'anore si dhe janë në kundërshtim më te vërtetat e jursiprudencës islame, ndaj dhe bien ndesh me objektivat e larta islame.

Arsyeja e paraqitjes së këtyre ideve dhe doktrinave - sa shkatrrimtare aq edhe të dëmshme- ishte ndotja e mendimeve të pasuesve të saj me metodologjitë ideologjike të perëndimit dhe mungesës së rrespektit të tyre ndaj shenjtërisë së kur'anit famëlartë; karakteristikave tipike të tij të elokuencës, rrjedhshmërisë, retorikës dhe linguistikës, ç'është e vërteta, ajetet kur'anore ata i konsideronin si tekste me karakter njerëzor, gjë që –sipas tyre- jep me kuptue se ato nuk qenë ajete hyjnore. Pasuesit e këtij leximi të ri

bashkëkohorë thirrnin në atë se kinse “kur’ani është produkt njerëzor, produkt i arsyes dhe intelektit, si dhe produkt historik i së kaluares.

Më këtë ata synonin që ajetet kur’anore t’i lidhnin, e pastaj t’i bashkonin me gjendjen kohore dhe sikur ato të ishin tekste të historisë njerëzore! Me pastaj, termet apo nocionet e reja i përdoren në kundërshtim me termet shariatike, si fjala vjen; Epistemologjike, Empiriko shkencore, islamiste, selefizëm, primitive, antologjike, bolshevike, dialektike, kohore, mekanizmatike, hermeneutike, demagogjike...etj.

Kur’anin filluan ta emërtonin si një **Përmbledhje e madhe vargjesh** (El Mudev-venetu el Kur’anije), kurse ajetet kur’anore i ashtuquajten si një grup fjalësh apo thënë më mirë **grup frazash**(el ‘ibaretu- el’ibarat), ndersa zbritjen e kur’anit e emërtuan si **ndodhia kur’anore**(el Vakiatu el Kur’anijetu)!! këto qenë errësira që pasonin njëra tjetrën, prandaj nuk ka pikë dyshimi se kjo shkollë nuk qe tjetër vetëm se shtrirje dhe zgjerim i shkollave të profesorëve të tyre orientalistë, të cilët për përgambërlukun e Muhammedit alejhi selam, thanë se nuk është asgjë tjetër, vetëm se vazhdim i judaizmit dhe krishterizmit. Si rrjedhojë, metodologjia e kësaj shkolle është despotizmi ne tekstet kur’anore dhe komentimi i tyre në përshtatshmëri me veglat metodologjike dhe gjuhën përendimore, i ndryshëm dhe krejtësisht tjetër për rregullat dhe llojet arabe.

Është shumë më rëndësi për t’u njohur me ata të cilët në këtë kohë më vete bartën flamurin e këtij lloji të leximit bashkëkohor të kur’ani kerimit, ata qenë nga mesi i muslimanëve, andaj për t’u preventuar nga ky grup dhe për të marrë mësim, do përmendim emrat në vazhdim; sekularisti Algerian Muhammed Erkun, marksistit nga Siria Muhammed Shahrur, Socialisti Muhammed Abid El-Xhabirij, Egjiptasi Hassen Hanefij, professor i Filozofisë mbi mendimin

mu'tezilit, Egjiptasi dhe profesor i gjuhë arabe dhe mendimit mu'tezilit Nasr Hamid Ebu Zejd Tunisiani Abdurmexhid Esh-sherefij, komunisti bashkëkohor sirian me prejardhje turke Xhelal Sadik El-Adhm.

Në këtë kohë Umeti Islam ka nevojë jashtzakonisht të madhe për një tefsirë, të cilit doemos duhet t'i rikthehet formulimi mendor dhe intelektual prej fillimit; të nxirret nga vetëshpërbërja e tij, të lirohet dhe të shpërthej fuqia e këtij formulimi nga ngurtësia dhe prapambeturia; të ripërtërihet në të shpirti i kësaj Gjithësie dhe ndertimi i saj. Tefsiri i kërkuar dhe i nevojshëm është ai interpretim, i cili këtë ymet e nxjerr nga realiteti i prapambeturesë dhe pas tij të pasoj rritja dhe zhvillimi urbanistik, industrial dhe krijimitaria.

Nuk ka fare dyshim se ato lexime bashkëkohore tendencioze të sipërshënuara; do të përfundojnë duke dështuar dhe atë për shkak të rënies dhe injorancës se tyre rreth kur'anit famëlartë, veçorive të tij gjuhësore, mënyrave, pasojave të retorikës si dhe metodologjive të sakta interpretuese.

Vërtet metodologjia aplikative në tefsirin e Kur'anit për të cilin thirremi, është më se e nevojshme për këtë periudhë dhe të sendërtohet në interpretimin, kuptimin, meditimin dhe leximin e kur'anit famëlartë, derisa që umeti islam të lirohet nga krizat e saja intelektuale, psikologjike, edukative, morale, ekonomike dhe fetare, te cilin profesor i nderuar Sejjid Kutbi e kishte emërtuar me nofken; Metodologji e gjallë aplikative në interpretimin dhe komentimin e Kur'anit, apo Metodologji dinamike-El Menhexh el Harekij fi Tefsiril Kur'an.

Kur është fjala për zakonin dhe të kuptuarit e kësaj metodologjie të gjallë aplikative, një gjë të tillë e shohim ta këtë shkjaruar profesori i nderuar –Allahu e mëshiroftë- në shumë vende në tefsirin dhe punimet e tij, ku lexuesi dhe

intelektuali shqiptar, hoxhallarët dhe studentët-talebet shqiptar dhe të tjerë do ta gjejnë këtë metodologji të re në kuptimin e Islamit dhe të ajeteve kur'anore ta gjejnë ne faqet e këtij libri.

Ky libër-disertacion Masteri u shkrua në vitin 2000, por e pati fatin e botimit dhe të perthimit gadi pas nje dekade për shume shkaqe, ma kryesorja është ishte që unë desha ti rianalizojë, ri shqyrtojë dhe të shtoj diçka të re në kapitujt e tij në verzionin origjinal arabisht dhe të shënoj dicka të re nga eksperiencia ime fetare, globale dhe akademike pas dhjetë vitesh, e pastaj edhe të rikorigjohet esenca e përthimin në gjuhën shqipe. Ky ishte ai shkaku kryesor që vonë po paraqitem para publikut me këte monografi shkencore me dimensione fetare, sociale, ideologjike, politike dhe morale. Normal se edhe ngarkesat akademike dhe fluksi i angazhimeve nëpër univerzitetet të ndryshme që kam ligjëruar; kanë ndikuar që kjo vepër të vonohet. Elhamdulillah, kjo monografi është perkthyer edhe në anglishte në SHBA, dhe së shpejti do të publikohet.

Lus Allahun xh.sh. për ndihmën e Tij, dhe që kët vepër ta pranojë nga unë. Mbes me shpresë që lexuesit, hoxhallarët, studentët, thirrësat në Islam dhe intelektualët shqiptarë dhe të tjerë të përfitojnë nga kjo monografi. Amin

Autori

Dr.Hfz. Hajredin Hoxha

Fakulteti i Sheriatit dhe Studimeve Islame-Universiteti i Katarit

Doha-Katar

17.06.2013

HYRJE

Forma e hulumtimit

Ky hulumtim, përkatësisht disertacion shkencor përmban katër kapituj dhe epilogun.

Në kapitullin e parë hyrës kam theksuar rëndësinë e kësaj teme, arsyet e zgjedhjes së këtij hulumtimi, problematikën e hulumtimit, studimet e mëhershme, metodën e hulumtimit dhe formën. Në këtë kapitull kam shqyrtuar edhe jetën, veprimtarinë dhe mendimet e Sejjid Kutubit duke u përqendruar në lindjen, rritjen, karakteristikat e fëmijërisë, udhëtimet dhe aktivitetet e tij, si dhe bashkangjitjen e profesor Sejjid Kutubit lëvizjes së **Vëllezërve Muslimanë**, pastaj veprat e tij, dhe në fund, rënien e tij shehid.

Në kapitullin e dytë kam studiuar dhe theksuar parimet, rregullat dhe themelet e mendimeve të Sejjid Kutubit në mënyrë më të detajuar. Më pas kam studiuar cilësitë e thirrësit në metodën kur'anore, formimin intelektual të thirrësit, pastaj kam shqyrtuar edhe parimet psikike të thirrësit, duke filluar nga aspekti shpirtëror dhe ai biheviortist. Pastaj kam hulumtuar aspektin e sjelljes së thirrësit dhe disa cilësi të saj, si p.sh.: durimin, butësinë, mëshirën, tolerancën, zemërgjerësinë, pastaj njohjen e asaj në të cilën thirret dhe kuptimin e saj në mënyrë të drejtë, njohjen e kulturës së kohës në të cilën vepron dhe jeton. Këtu gjithashtu kam studiuar dhe hulumtuar mënyrën e thirrjes së jobesimtarëve në Islam, në bazë të dialogut të qetë dhe të mirë, si dhe thirrjen në bazë rrugës së persiatjes së argumenteve të Universit.

Në kapitullin e tretë kam theksuar metodën e profesor Sejjid Kutubit në tefsirin e tij në përgjithësi, më pas disa fjalë miradije nga dijetarët për tefsirin e tij dhe pastaj i kam theksuar disa karakteristika dhe cilësi të **“Dhilâl-it”** të tij. Më pas, në këtë kapitull kam shqyrtuar metodën e Kur'anit Fisnik në eliminimin e koncepteve dhe besimeve të xhahilijetit duke filluar gradualisht dhe në mënyrë sukcesive. Pastaj kam hulumtuar kujdesin ndaj situatës së njerëzve, gjegjësisht kujdesin që duhet kushtuar atyre që dëgjojnë thirrjen (da'vetin). Në fund, e kam përmbyllur me disa vështrime mbi metodën e profesor Sejjid Kutubit, si dhe kam theksuar kritikën kundër tij. Këtë kapitull e kam përfunduar me një epilog dhe me disa sugjerime.

Në kapitullin e katërt në hyrje me ca fjalë të shkurtëra i jam qasur thirrjes që Kur'ani Fisnik i bën instiktit njerëzor. Më pas kam shtjelluar çështjen e thirrjes (da'vetit) dhe mënyrën e kësaj nëpërmes sures “**el En'amë.**” Në fillim i kam theksuar arsyet e zgjedhjes së kësaj sureje, temat e kësaj sureje, emrin, vlerën dhe rëndësinë e kësaj sureje, shkaqet e shpalljes së saj, metodat e da'vetit në Kur'anin Fisnik në përgjithësi si dhe karakteristikat dhe specifikat e metodës së Sejjid Kutubit në të kuptuarit e ajeteve të da'vetit në veçanti. Më pas në këtë kapitull të disertacionit tim kam hulumtuar thirrjen e muslimanëve në përmirësim, gjegjësisht përmirësimin e shoqërisë sipas metodës kur'anore. Gjithashtu këtu kam bërë edhe një vështrim ndaj korrektimit të metodës së mendimit, hulumtimit dhe da'vetit sipas metodës gnostike dhe edukative dhe në fund kam dhënë një përfundim dhe ca sugjerime.

Vështrimet e profesor Sejjid Kutubit i kam ndarë në dy grupe: Grupi i posaçëm që ka të bëjë me vështrimet që i kam vërejtur gjatë studimit tim të tefsirit dhe metodës së tij, si dhe grupi i përgjithshëm që ka të bëjë me vështrimet e hulumtuesve të tjerë në formë më të rëndësishme që i përfitova si dhe disa porosi.

Lus Zotin e Madhërishtëm që ta pranojë këtë mund timin modest dhe shpresoj se do ta llogaris në mesin e veprave të mia të mira në Ditën kur nuk ka dobi as prej pasurisë e as prej fëmijëve, përpos atij që i ka ardhur Zotit me zemër të shëndoshë!

Nëse ia kam qëlluar atëherë kjo është prej Zotit dhe njëherit është begati për mua, ndërsa nëse ka ndonjë mangësi, atëherë ajo është prej djallit dhe prej meje!

Lus Zotin e Madhërishtëm që të më falë, të më Mëshirojë dhe të më drejtoj në Rrugën e Vërtetë!

Gjithashtu kërkoj nga lexuesit e sinqertë që fare të mos hezitojnë me këshillat e tyre për mua, në udhëzime dhe në vështrime metodologjike të cilat lirisht mund të mi shprehin gojarisht nëse ka mundësi, dhe për një gjë të tillë, gjithsesi do t'iu jem falënderues.

U mundova që të jap maksimumin në këtë hulumtim, duke qenë plotësisht i vetëdijshëm se nuk jam i përkryer, përkundrazi... kurse lutja ime e fundit është: **Falënderimi i takon vetëm Allahut Zotit të botëve!**

KAPITULLI I PARË

HYRJE

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, ndërsa salavatet dhe selami Pejgamberit dhe të Dërguarit më të respektuar, zotëriut tonë Muhammedit, Familjes së tij të Pastër, të gjithë sahabëve si dhe atyre që ecin në rrugën e tij dhe që ndjekin Sunnetin e tij deri në Ditën e Gjykimit!

O Zoti ynë! Na nxirr nga errësira e iluzionit, na furnizo me dritën e të kuptuarit dhe na bëj prej atyre që e dëgjojnë me vëmendje fjalën dhe që e ndjekin të mirën! Amin!

Nuk ka dyshim se rruga e da'vetit (thirrjes) në Zotin e Madhërishtëm është një nga rrugët më të ndershme në përgjithësi, gjithnjë duke u bazuar në ajetin kur'anor:

“E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e Allahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: “Unë jam prej muslimanëve?” (Fussilet, 33).

S'do mend që sot, kur ka pak thirrës dhe kur ka shumë vepra të këqija dhe dominon injoranca, sikur që aktualisht është gjendja jonë, e që megjithatë çdo gjë ndodh sipas Fuqisë së Tij, thirrja islame është obligim dhe farz individual...!¹

Kjo rrugë është rruga e vetë Pejgamberit dhe të Dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), si dhe të atyre që e ndoqën pas, që nga Ademi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e deri te vula e pejgamberëve dhe të dërguarve, Muhammedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Në këtë kontekst Zoti i Madhërishtëm thotë:

“Ai u përcaktoi juve për fë atë që i pat përcaktuar Nuhit dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe

¹ *Min ekvali semahat el Sheikh Abdulaziz Abdullah bin Baz fi el Da'we*, Darul-vatan lin-neshri vet-teuzi'ë; bot. l. 1413 hixhri. fq. 16.

Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të! (Esh Shura, 13).

Natyra e kësaj rruge nuk është e shtruar me lule e trëndafila, e as që është e lehtë dhe e rrafshhtë që çdokush të eci kollaj mbi të, përkundrazi... Sipas caktimit të Urtësisë së Zotit të Madhërishëm, kjo rrugë është përplotë gjemba, thumbuj e pengesa dhe është shumë e vështirë për t'u ecur, ndaj dhe për këtë shkak, thirrësi ka nevojë për përpjekje, durim të madh (sabër) dhe mbështetje të vazhdueshme në Zotin e Madhërishëm, përkatësisht Atij t'i lutet gjithnjë, në çdo kohë dhe çdo çast, qoftë në të mirë apo në të keqe, derisa të realizojë qëllimin e synuar dhe ta predikojë thirrjen në mesin e njerëzve. Në këtë kontekst, Zoti i Madhërishëm i drejtohet Pejgamberit të Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) duke i thënë:

“Ti (Muhammed) duro ashtu sikurse duruan të dërguarit e vendosur dhe mos kërko ngutjen e dënimit për ta! “ (El Ehkafë, 35). Me këto Fjalë, Zoti njëherit iu drejtohet gjithashtu edhe të gjithë besimtarëve!

Kjo rrugë, ashtu siç theksuam më sipër, kërkon prej thirrësit urtësi, logjikë të shëndoshë, fjalë të bukura dhe diskutim të butë, premisa këto për të qenë i suksesshëm në da'vetin (thirrjen) e tij. Për shkak të rëndësisë së kësaj çështje, Zoti i Madhërishëm thotë:

“Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri ai që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai më së miri për të udhëzuarit.” (En-Nahl, 125).

Thirrësi për në rrugën e Zotit të Madhërishëm, për të qenë aktiv dhe i suksesshëm në punën e tij, duhet të pajiset me moral të pejgamberëve dhe të Kur'anit, si dhe të ketë cilësi të lavdëruara në fjalë e vepra. Për ta arritur këtë sukses të rëndësishëm, Zoti i Madhërishëm thotë:

“O ju që besuat pse po thoni atë që nuk e punoni. Tek Allahu është shumë e urrejtur ta thoni atë që nuk e punoni!” (Es Saff, 2-3).

Zoti i Madhërishëm poashtu thotë:

“Vërtetë ti je në një shkallë të lartë të moralit.” (El-Kalem, 4).

“A po i urdhëroni (thirrni) njerëzit për punë të mira, e veten tuaj po e harroni? Ndërsa ju e lexoni Librin (Teuratin). A nuk po mendoni?” (El-Bekare, 44).

Ashpërsia dhe vrazhdësia në fjalë nuk janë cilësi të thirrësve të suksesshëm dhe këtë parim e konfirmon edhe vetë Kur’ani Fisnik:

“Ti ishe i butë ndaj tyre ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin andaj ti falu atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohen me ta në të gjitha çështjet!” (Ali-Imran, 159).

Meqë ditëve të sotme, veçmë ka ndodhur devijimi i një numri të madh të thirrësve nga metoda e Kur’anit në thirrjen në Zot dhe largimi nga instruksionet thirrëse, më shumë se kurrë më parë, ndjehet nevoja për ekzistimin e dijetarëve të mëdhenj, të cilët i përcaktojnë hapat e metodës kur’anore në thirrje (da’vet), vënë rregulla, parime dhe baza që janë më se të domosdoshme për të ecur përpara thirrësit.

Shkaqet e këtij devijimi kanë ardhur si rrjedhojë e disa rrethanave dhe faktorëve:

* *Koncepteve të ndryshme të njerëzve rreth filozofisë së thirrjes (da’vetit) dhe dimensioneve të saja fetare dhe edukative;*

* *Qëndrimeve të ndryshme dhe vizioneve të llojllojshme të specialistëve të lëmive të ndryshme;*

* *Mosmarrjes parasysh të situatës së njerëzve dhe realitetit të tyre; dhe:*

* *Njohurive të kufizuara rreth parimeve të Sheriatit.*

Nga thirrësit që dolën në skenë në territorin islam në gjysmën e parë të këtij shekulli (*shekullit XX, vërejtje e përkth.*), dhe që e kuptuan tamam ashtu siç duhet dhe në mënyrë korrekte metodën kur’anore të da’ves (thirrjes), është

profesori i nderuar, shehidi i Islamit, Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë me Mëshirën e Tij të pakufijshme!)

Profesori martir Sejjid Kutub, në krahasim me metodat e thirrësve të tjerë anembanë territorit islam, dallon pikërisht me metodën e tij unike dhe precize, metodë kjo e cila karakterizohet me dimensione edukative, fetare e aplikative, dhe kjo vërehet qartë në të gjitha veprat e tij, e posaçërsht në kryeveprën e tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”** (**“Nën hijen e Kur’anit”**). Ishte Dëshira e Zotit të Madhërishëm që si rezultat i këtij koncepti unik të jetë edhe rënia e tij shehid në këtë rrugë dhe kësisoji të jetë shembull i mirë për të gjithë muslimanët, e veçanërisht për thirrësit islam, deri në Ditën e Gjykimit.

Këtu e shoh të udhës që patjetër të flitet hapur për të vërtetën në të cilën është i bindur hulumtuesi (*autori H.Hoxha, shen. i perkth.*), gjegjësisht rreth vlerës dhe pozitës së tefsirit **“Fi dhilâlil-Kur’an”** (**“Nën hijen e Kur’anit”**). Ky libër, vërtetë është tejet i rëndësishëm në çdo aspekt, ndaj dhe thirrësi apo intelektual që merret me çështjet e Islamit nëse privohet prej tij, ai në të të njëjtën kohë është privuar nga një e mirë shumë e madhe, ngase autori i këtij tefsiri (*Sejjid Kutubi, vërej. e perkth.*) ka shqyrtuar çdo tematikë thirrëse bashkëkohore në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Ky tefsir gjithashtu shërben edhe si libër paraprak apo preliminar i shqyrtimit të shumë çështjeve të da’vetit që zhvillohen në territorin islam, rreth mënyrës ideale të zbërthimit islamik që mund të na nxjerrë nga atmosfera e tillë negative ku jemi katandisur, si dhe na ofron alternativë.

Profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) na ofron kulmin e mendimit dhe të përvojës së tij të madhe pikërisht në këtë vepër. Kjo vepër, thënë ndryshe, ka qenë si të thuash një bombë intelektuale dhe revolucion i da’vetit botëror, kundër sistemit politik socialist egjiptian, botës nacionaliste arabe dhe asaj islame të rënë në letargji. Qeveria e Abdul-Naserit, në atë kohë, ka dënuar çdo bibliotekë ose institucion që është përpjekur ta botojë këtë libër,² ngase sipas tyre ky libër thërret në ekstremizëm fetar dhe konsiderohet çerdhe e problemeve në botë!!!³

² Një situatë e tillë ishte edhe në Siri në vitet e tetëdhjeta, ndaj dhe ishte mjaft vështirë të gjendej ndonjë kopje e librit **“Fi dhilâlil-Kur’an”** për arsyet që i theksuam më parë.

³ Vizito disa website elektronike në internet dhe do të gjesh dhjetëra hulumtime e artikuj që janë përplotë me akuza, shpifje dhe gënjeshtër të pabaza kundër shehid Sejjid Kutubit.

Mirëpo, në fakt e vërtetë është e kundërta e kësaj, dhe këtë, dhashtë Zoti - do ta vërejmë gjatë këtij studimi! Për hirë të Zotit të Madhërishëm dhe për hirë të sinqeritetit të autorit, ky libër përfitoi autoritet të madh dhe pozitë shumë të lartë në mesin e Ummetit dhe në mesin e thirrësve të botës islame dhe asaj joislame, dhe kështu, përfitoi ithtarë dhe përkrahës, dhe mbase kjo ishte edhe arsyeja që e shtyu orientalistin Olivije Karije të shprehet në hyrjen e librit të tij **“Fi dhilâlil-Kur’an - nga aspekti orientalistik”**: **“Vëllezërit Muslimanë ose Kutubi dhe kutubistët...”**⁴, tërë kjo, kuptohet, për shkak të numrit të madh të ithtarëve të profesorit martir.

Libri **“Fi dhilâlil-Kur’an”** dhe autori i tij vlejné të studiohen nga studiues e hulumtues, dhe me plotë të drejtë mund të thuhet ajo që e thotë prof. dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidi: **“Ekzistojnë shumë pak raste kur emrat në tërësi përputhen me bartësit e tyre. Sejjid Kutubi është njëri prej atyre që ka përputhshmëri në mes të emrit dhe bartësit të emrit, pra, ai ishte zotëri dhe simbol.”**⁵

1. Rëndësia e kësaj tematike

Kjo tematikë është mjaft e rëndësishme, ngase konsiderohet një ndër studimet e para të këtij lloji të studimeve dhe është i pari i llojit të vet. Ekzistojnë disa studime rreth shehid Sejjid Kutubit, përkatësisht rreth jetës, mendimeve dhe veprave të tij të përgjithshme, dhe në bazë të mendimit tim (Zoti e di më së miri!), autori është fyer në forma të ndryshme dhe nuk është punuar aq sa duhet nga ana e shkrimtarëve dhe hulumtuesve për të sqaruar mendimet dhe metodën e tij të da’vetit nëpërmes tefsirit të tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”**, posaçërisht metodën e tij në të kuptuarit e ajeteve kur’anore që flasin rreth da’vetit (thirrjes), metodave, mënyrave e qëllimeve!

⁴ Olivije Karije, **“Fi dhilâlil-Kur’an - rujetun istishrakijje”**; përktheu Muhamed Riza Axxh-xhaxh, Ez-Zehra lil-ilamil-Arabij, bot. 1, 1993, fq. 7.

⁵ Salah Abdul-Fetah El-Halidi, **“Sejjid Kutub-Esh-shehid el-hajj”**; Amman, Jordani, Mektebetul-Aksa, pa vit botimi, fq. 11.

2. Arsyet e zgjedhjes së kësaj teme

Arsyet të cilat më shtynë që ta zgjedh këtë temë janë siç vijon:

** Autori i kësaj metode, të cilin unë do ta studioj është nga thirrësit bashkëkohorë dhe gëzon autoritet të madh dhe respekt të famshëm në mesin e mbarë dijetarëve;*

** Dallimi i tij me një metodë të posaçme në të kuptuarit e ajeteve që flasin mbi da'vetin (thirrjen);*

** Pranimi me të madhe nga populli librin e tij “**Fi dhilâlil-Kur'an**”;*
dhe:

** Metoda atraktive-letrare në shkrimet e tij dhe njohuritë e mëdha mbi kulturën perëndimore dhe mbi rregullat e tyre pozitive, si dhe mbi gjendjen e tyre sociale.*

3. Problematika dhe pyetje që kanë të bëjnë me këtë hulumtim

Çështjen, të cilën hulumtuesi orvatet ta shqyrtojë dhe sqarojë përmes metodës së Sejjid Kutubit rreth të kuptuarit të tij të ajeteve të da'ves (thirrjes) nëpërmjet komentimit të veprës “**Fi dhilâlil-Kur'an**” (“**Nën hijen e Kur'anit**”) dhe nëpërmjet sures “**El En'amë**” si shembull konkret.

Është vërejtur devijimi i dukshëm në metodën e thirrjes në Zotin e Madhërishëm dhe se thirrësit në veçanti, e njerëzit në përgjithësi nuk kanë aplikuar metodën kur'anore në ftesën e tyre në Zot...

Pyetjet e këtij hulumtimi,⁶ të cilat do të përpiqem t'i sqaroj në këtë studim, janë:

- 1. Çka përmban thirrja në Zotin e Madhërishëm në Kur'anin Fisnik?;*
- 2. Cilat janë metodat e thirrjes, të cilat obligohet që thirrësi t'i aplikojë?; dhe:*

⁶ Pasi e tubova këtë hulumtim dhe pasi që e lexova me vëmendje, atëherë kuptova se i përgjigjet pyetjeve që i theksova më parë.

3. Ç'ka duhet të merret parasyshë kur thirren njerëzit?

4. Studimet e mëhershme

Nuk kam gjetur ndonjë studim të mëhershëm rreth kësaj teme, gjegjësisht rreth metodës së Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!) në tefsirin e ajeteve të da'vetit (thirrjes) në Kur'anin Fisnik, ndaj dhe për këtë shkak ky disertacion mund të konsiderohet si punimi i parë në këtë aspekt.

Ndërsa sa i përket punimeve tjera të përgjithshme mbi jetën e shehidit (Zoti e mëshiroftë!), mbi moralin e tij, apo mbi tefsirin e veprës së tij **“Fi dhilâlil-Kur'an”**, ato ekzistojnë, ndaj dhe më poshtë do t'i theksoj titujt vijues:

Veprat e prof. dr. Abdul-Fetah Salah El-Halidit, që gëzojnë autoritet të lartë në krahasim me veprat tjera që janë shkruar rreth shehid Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!) dhe rreth punimeve të tij shkencore. Ai ofroi shumë gjëra të dobishme për gjeneratën e sotshme dhe për gjeneratat e ardhshme rreth këtij mendimtari të madh musliman. Ai madje e ka përpiluar edhe një libër të posaçëm mbi jetën e prof. Sejjid Kutubit që e ka titulluar: **“Sejjid Kutub, minel-milâd ila el-istish-had”**. (**“Sejjid Kutubi-nga lindja e deri në martiritet”**).

Ai poashtu e ka përpiluar edhe një vepër tjetër me titull: **“Sejjid Kutub, Esh-shehid el-hajj”** (**“Sejid Kutubi, Martiri i gjallë”**). Prof. Halidi gjithashtu ka shkruar një libër rreth tefsirit të tij **“Fi dhilâlil-Kur'an”**, të cilin e ka titulluar: **“Fi dhilâlil-Kur'an fil-mizan – dirase ve tekvim.”** (**“Nën hijen e Kur'anit në peshojë-studim kritik”**

Siç vërejmë, titujt e librave qartë tregojnë përmbajtjen e tyre dhe faktin që studiuesi i Sejjid Kutubit ka nevojë obligative për veprat dhe punimet e vlefshme të prof. Halidit. Prof. Abdul-Fetah Salah El-Halidi (Zoti e ruajtë!) ka edhe një libër tjetër që titullohet: **“El-Menhexhul-harekij fidh-dhilâl”** (**“Metoda lëvizëse-dinamike në “Edh-dhilâl”**).

Ekziston një studim i Shejh Muhamed ibn Dulejjim Al-Dulejjim El-Kahtanit që quhet **“Sejjid Kutub, el-muftera alejhi”**⁷ dhe ky studim është pjesë e studimeve që mbrojnë personalitetin e profesorit dhe shehidit Sejjid Kutub dhe diturinë e tij. Ai flet në mënyrë të thuktë mbi jetën e tij (Zoti e mëshiroftë!) si dhe thekson vështrime të rëndësishme rreth kritikës dhe parimeve kritike. Ai poashtu i thekson arsyet që e shtynë të fillojë këtë vepër. Autori gjithashtu shqyrton aty disa çështje nga akaidi, si panteizmi, istivaja, emrat dhe cilësitë, për të cilat edhe akuzohej profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) duke sqaruar se të gjitha akuzimet e tilla, janë si pasojë e leximit të pjesërishëm të tefsirit të tij e jo si rezultat i leximit të përqendruar dhe preciz.

Prof. Abdul-Fetah Ali ka shkruar një vepër që titullohet: **“Sejjid Kutub, sire dhâtije”**⁸ në të cilën flet për jetën e Sejjid Kutubit në formë të përmbledhur dhe për ambientin social e politik në të cilin jetoi profesor Sejjid Kutubi, si dhe për disa sinjale e shenja që argumentonin se profesor Sejjid Kutubi do të luaj rol të rëndësishëm në të ardhmen...

Autori thekson në këtë vepër se profesor Sejjid Kutubi ka qenë letrar e poet, dhe se poezia i buronte nga thellësia e shpirtit të tij dhe inspirohej nga rrethanat në të cilat jetonin muslimanët, përkatësisht vendet arabe dhe ato islame, pra nën okupimin dhe kolonializmin anglez.⁹

Ndoshta studimi i prof. Muhamed Teufik Berekatit: **“Sejjid Kutub-hulasati hajatihi”**¹⁰ me metodën e tij dinamike dhe kritike është një ndër studimet më të afërta me temën time. Autori flet për jetën e tij dhe për metodën e tij në lëvizje, duke u mbështetur pjesërisht në **“Edh-dhilâl”** ashtu siç deklaron edhe vetë autori. Ky studim i ka përmbledhur të trembëdhjetë pjeset e komentuara nga profesor Sejjid Kutubi në: **Dhilâlin e tij**. Ky studim i pjesshëm tregon për metodën e profesorit dhe dëshmorit Sejjid Kutub (Zoti e mëshiroftë!), dhe lirisht mund të thuhet se është i saktë.

⁷ Muhammed ibn Dulejjim Al-Dulejjim El-Kahtani, **“Sejjid Kutub-El-Muftera alejhi”**; Rijad, Darut-tajjibe, bot. I, 1413 hixhri.

⁸ Abdul-Fetah Ali, **“Sejjid Kutub-sire dhatije”**; Kuvajt, Sheriketu Er-Rebi’a linneshri vet-tevzi’, b.1. 1996.

⁹ Shih më gjerësisht: Imam Hasan El-Benna, **“Fehmul-Islam fi dhilâil-usulil-ishrin”**; Xhum’atu Emin Abdulaziz, Aleksandri, Darul-da’veti lin-neshri vet-tevzi’ë, bot. 2, 1991, fq. 10.

¹⁰ Muhammed Teufik Berekat, **“Sejjid Kutub hulasatu hajatihi”**; Meuhexhu’hu fil-hareketi venek’du el-muvexh- xheh ilejhi; pa vit botimi.

Ekziston studimi i doktrinae të tefsirit në shekullin e katërmbëdhjetë nga dr. Fehd Er-Rumi¹¹, i cili flet për doktrinën akaidologjike në tefsir, pastaj sqaron metodën e Ehli-Sunnetit dhe Xhematit, metodën e shi'itëve në tefsir, metodën e ibadijve dhe atë të sufinjve. Më pas, autori i thekson doktrinën shkencore të tefsirit, metodën shkencore-eksperimentale si dhe qëndrimin e shkollës racionale sociale me tefsir.

Pastaj ai thekson doktrinën dhe metodat letrare në tefsir, e posaçërisht në tefsirin **“Fi dhilâlil-Kur’an”** (**“Nën hijen e Kur’anit”**) të profesor Sejjid Kutubit, duke theksuar se metoda e tij dallohet për nga stili, pikërisht në saje të metodës letrare. Ai poashtu i thekson parimet në të cilat mbështetet tefsiri i tij.

Autorin, (Zoti e shpërbleftë për këtë punim voluminoz që e përgatiti për thirrësit e mbarë trojeve islame!) edhe pse duhet thënë që mendimi i tij (*i dr. Fehd Er-Rumit, vërej. e përkth.*) rreth tefsirit të profesor Sejjid Kutubit dhe këtij drejtimi: *si metode letrare ne tefsir!* është diskutabil!¹²

Me pak fjalë, këto ishin disa studime të mëhershme që kishin të bënin me këtë lëmi e të cilat tërësisht dallojnë nga ajo që unë kam ndërmend ta hulumtoj në vijim.

Dhe në fund, hyrja ime në këtë sure është hyrje e një thirrësi, hoxhe që mbështetet në metodat, mënyrat, mjetet dhe udhëzimet e da'vetit, të cilat theksohen në Kur'anin Fisnik.

¹¹ Fehd ibn Abdurrahman ibn Sulejman Er-Rumi, **“It-tixhahatut-tefsiri fil-karnir-rabi’ asher”**; (disertacion doktore), Rijad, bot.1, 1986.

¹² Mua më duket se prof. dr. Fehd ibn Abdurrahman ibn Sulejman Er-Rumi është larg saktësive në këtë aspekt kur thotë se metoda e Sejjid Kutubit karakterizohet me nuanca letrare...!! Metoda e Sejjid Kutubit është metodë revolucionare dhe dinamike e da'vetit, madje këtë edhe ai vetë e ka theksuar në shumë vende në tefsirin e tij: **“Metoda e mbështetur në Librin e Zotit”**; **“Shenjat në rrugë”** ku fton **“...për të nisur nga fillimi dhe për ngritjen e flamurit “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!” lartë duke thirrur që të merret pushteti nga duart e tiranëve për ta rikthyer te Zoti që është Një dhe i Plotfuqishëm, Atij të Vetmit, të Cilin i takon Pushteti i qiejve dhe i tokës...”** Edhe pse vërehet qartë aspekti letrar, gjuhësor dhe retorik në metodën e tij, kjo nënkupton se ai ka pasur aftësi të mëdha gjuhësore dhe retorike!

5. Metoda e hulumtimit

Në këtë punim disertacioni, unë e kam aplikuar metodën induktive tematike, dhe atë në bazë të ndjekjes së fjalëve të profesor Sejjid Kutubit rreth çështjeve që kanë të bëjnë me këtë hulumtim.

Metoda analitike¹³ e teksteve të marra nga tefsiri i tij rreth ajeteve që flasin për da'vetin (thirrjen) me përqendrim të plotë në tefsirin e sures “**El En'amë**” dhe në tefsirin e tij në përgjithësi, përforcon atë që ka të bëjë me çështjet e pavarura, të cilat profesori shehid nuk i ka theksuar në tefsirin e kësaj sureje. Natyra e këtij hulumtimi më detyroi që të ndër marr një hap të tillë për të kompletuar mendimin e prof. Sejjid Kutubit. Unë poashtu do të transmetoj edhe nga burimet tjera të prof. Sejjid Kutubit apo nga të tjerët që kanë shkruar për të.

Shqyrtimi im i tematikave të këtij hulumtimi dhe ndarja e tij në kapituj, ashtu siç theksova në formë, mbështeten kryesisht në parimet themelore të da'vetit, në të cilat mbështetej profesor Sejjid Kutubi në përgjithësi në “**Dhilâl-in**” e tij, dhe në suren “**El En'amë**” në veçanti, si dhe për t'u përgjigjur në tri pyetjet e theksuara më sipër.

¹³ **Vërejtje e përgjithshme:** Lexuesit të nderuar i sugjeroj që t'i lexojë faqet vijuese të këtij disertacioni për t'i parë parimet metodologjike të profesor Sejjid Kutubit në të kuptuarit e ajeteve të da'ves (thirrjes) që i kam theksuar gjatë këtij studimi: 70, 71, 72, 73, 75, 76, 77, 78, 80, 87, 90, 93, 94, 99, 100, 104, 108, 113, 117, 121, 124, 128, 129, 131, 135, 141, 142, 148, 149, 154, 160, 161.

KAPITULLI I DYTE

PJESA E PARE

II. Sejjid Kutubi: Lindja, rritja, mendimet, vepra dhe rënia shehid

1. Lindja

Sejjidi është ibn Kutub ibn Ibrahim ibn Hasan Esh-Shadhilij. U lind më 09.10.1906 në fshatin Musha, komuna e Asjut-it. Ishte i biri i parë pas motrës së tij që ishte tre vjet më e madhe se ai. Ai poashtu kishte edhe një vëlla nga babai, i cili ishte shumë më i moshuar se ai. Nëna e tij u gëzua shumë me lindjen e tij për shkak se siguroi vazhdimësinë e jetës së saj martesore, posaçërisht kur dihet fakti se ajo ishte vetëm një grua e babait të tij, i cili i përkiste shoqërisë fshatare sa'idiiane, e cila meshkujt i konsideronte pasuri, mburrje e shumim...¹⁴

Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) u lind në një shoqëri fshatare sa'idiiane që përjetonte kohë të vështira, varfëri e skamje, injorancë, sëmundje, agrikulturë të dobët dhe pushtetarë të këqinj, ndërsa në jetën e tyre mbizotëronin legjendat tradicionale dhe besimet inovative apo risitë (bid'atet), të cilët i shfrytëzonit vjedhësit dhe intrigantët.¹⁵

I ati i tij kishte gjendje të mirë ekonomike, ishte bujar, jetonte nga toka që ishte përafërsisht e madhe dhe sado-kudo ia siguronte të gjitha nevojat e tij, ndaj dhe për shkak të harxhimeve të tij të mëdhaja, shiste pjesë të tokës së tij, me qëllim që t'i pastronte borxhet.¹⁶

Babai i tij (Zoti e mëshiroftë!) ishte i shkathtë dhe i mençur, ndaj bashkëpunonte në një gazetë të përditshme dhe ishte anëtarë i Komitetit të Partisë Nacionale, dhe si dhe përgjegjës i familjes së tij, gëzonte autoritet të madh në fshat, ndaj dhe e kishte obligim mbrojtjen e një autoriteti të tillë. Ai

¹⁴ Hajruddin Zerekli, "El-E'alam Kamusut Teraxhim"; Darul-ilmu lil-melajin, Bejrut-Liban bot. 7, 1987, vëll. 3, fq. 147-148.

¹⁵ Muhammed Husejn Abdulbaki, "Sejjid Kutub, Hajatuhu ve edebuhu"; El-Mensurije, Darul-vefa lit-tiba'ati ven-neshri, bot. 1, 1986, fq. 17; Transmetuar nga "Tiflun fil-karjeti"; fq. 211-212. Poashtu shih: Abdul-Fetah Salah El-Halidi, "Sejjid Kutub-Esh-shehid el-hajj"; fq. 46.

¹⁶ Muhamed Teufik Berekat, "Sejjid Kutub-hulasatu hajatihi, menxhexhuhu fil-hareketi, en-nakdul-muvexhxhehu ilejhi"; fq. 22.

ishite njeri i vendosur, stabil, emocional, energjik dhe nuk iu ngjante atyre që ishin të pasur e që kishin familje të pasura nëpër fshatra.¹⁷

I biri i tij (profesor Sejjid Kutubi) më së miri e përshkruan babain e tij, në një libër të tij me fjalët:

“E mbolle në mua, qysh kur isha fëmijë i vogël, frikën nga Dita e Gjykimit! Ti nuk më këshilloje dhe nuk më nxisje, por jetoje para meje gjithnjë duke pasur kujdes nga Dita e Gjykimit, të cilën e përkujtoje në ndjenja dhe me fjalë. Ti ishe i kujdesshëm në atë që e veproje dhe ishe tolerant nga frika prej Ditës së Gjykimit nëse ndokush të dëmtonte edhe pse kishe mundësi t’ia rikthesh, ti e falje, për të fituar shpërblim në Ditën e Kijametit. Fotografia jote është e thelluar në mendjen time, dhe akoma më kujtohet leximi yt i sures “El-Fatiha” që e bëje në darkë, për çdo mbrëmje dhe lutjen nga leximi i kësaj sureje ia dhuroje shpirtit të babait tënd që ndodhej në botën e Ahiretit. Ne ishim fëmijë të vegjël, përsëritnim atë që e thoje ti edhe pse nuk mund ta mbanin tërësishtë në mend!”¹⁸

2. Rritja dhe zhvillimi i tij

Sejjid Kutubi kishte një fëmijëri që dallohej dhe karakterizohej nga fëmijëria e të tjerëve. Ai u rrit në një familje fisnike fetare e intelektuale dhe në gjendje të mirë financiare. *“...dhe doli nga shtëpia fëmijë i dalluar, poet në ndjenja për ta zhvilluar këtë dallim dhe këto ndjenja në mesin e të afërmëve dhe shokëve të tij në rrugë e në shkollë”.*¹⁹

Në shkollë, kujdestari i klasës tregonte interesim të posaçëm për të, ndaj dhe i jepte mësim gjysëmprivat në klasë, dhe kështu, në këtë mënyrë u rrit në fshat Sejjid Kutubi, dhe me të u zhvilluan dy gjëra: *“Ndjenja në vetvete dhe shpresa të cilën ia kishte ngritur nëna e tij që kur ishte lindur...”*²⁰

Në elegjinë kushtuar nënës së tij, në vitin 1940, ai, mes tjerash, thotë:

¹⁷ Muhamed Teufik Berekat, “Sejjid Kutub, Hajatuha ve edebuhu”; fq.18; marrë nga “Tiflun fil-karjeti”; fq. 21-22.

¹⁸ Muhamed Teufik Berekat, “Sejjid Kutub, Hajatuha ve edebuhu”; fq.18; marrë nga “Tiflun fil-karjeti”; fq. 7.

¹⁹ “Sejjid Kutub-El-Muftera alejhi”; fq. 7.

²⁰ Po aty; fq. 7.

“E parafytyroj vetveten time si një përbërje unicate që kur isha fëmijë në djep, më ofroje shpresë që nga lindja ime dhe në mendjen time u binda se jam i madh, dhe se unë do t’i lyp obligimet që dalin nga kjo madhëri që s’do mend se ishte fryt i ëndrrave tua dhe buronte nga frymëzimi i instiktit tënd!”²¹

Nuk ka kurrfarë fije dyshimi se pikërisht kështu duhet të jetë qëndrimi i fëmijëve të mirë dhe mirëbërës ndaj prindërve të tyre: të njohin të bukurën dhe të mos mohojnë begatinë e vlerën. Pra, kështu duhet të veprojnë nënat e sotshme në edukimin e fëmijëve të tyre.

3. Karakteristikat e fëmijërisë së tij

Fëmijëria e Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!) dallohet me disa karakteristika:

1. Persiatjet e tij rreth teksteve dhe shembujve kur’anor, vetë Sejjid Kutubi kur flet për veten e tij, rreth kësaj çështjeje, thotë:

“Kur isha fëmijë i vogël e lexoja Kur’anin dhe nuk i kuptoja kuptimet e tij, e as që i kuptoja qëllimet e tij, por në vete ndjeja diçka... Iluzioni im naiv (këtë profesor i shehid e thotë nga modestia, vërejtje e H. Hoxhës) parafytyronte forma konkrete gjatë rrëfimit të Kur’anit. Kjo ishte formë e thjeshtë, por ma kënaqte shpirtin dhe më ushqente trurin. Nga format që i parafytyroja gjatë leximit të Kur’anit ishte leximi i ajetit kur’anor: “Ka nga njerëzit që adhuron Allahun me mëdyshje (luhatshëm) nëse e godet ndonjë e mirë ai qetësohet me të, po nëse e godet ndonjë e pakëndshme, ai kthehet në fytyrën e vet të vërtetë (të mëparshme), ai i ka humbur këtë dhe jetën tjetër, e ky ishte ai dështimi i qartë.” (El Haxh, 11). Këtu parafytyroja një njeri që qëndronte në një vend të lartë në një luginë të pjerrtë dhe falej, por i cili nuk mund të qëndronte drejtë dhe luhatej për të rënë. Nga lëvizjet e tij ndjeja kënaqësi dhe lumturi të çuditshme...”

²¹ “Sejjid Kutub, Hajatuhu ve edebuhu”; fq. 20. (transmetuar nga “Mexhel-letur-risaleti”, tetor 1940, Nr. 381, fq. 1602).

2. Dëshira e tij e madhe për leximin dhe studimin e librave, si p.sh. leximin e librave mbi kerametet e evlijave dhe të devotshmëve si dhe literaturë tjetër shkencore e kulturore.²²

3. Kritika e tij e ashpër kundër zhvillimit dhe zullumqarëve, urrejtja e tij ndaj anglezëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre që ndikonin haptazi në varfërinë dhe regresin social e kulturor dhe korrupcionin e ligjeve. Sa herë që i kujtohej kjo gjë, turpërohej ngase nuk kishte reaguar ndaj kësaj të keqe që e kishte kapluar popullin e tij.²³

4.Udhetimi i tij dhe aktiviteti shkencor

Për sa i përket mësimin të tij, Sejjid Kutubi e mësoi hifzin e Kur'anit Fisnik që në moshën dhjetëvjeçare vetvetiu, për të arsyetuar qëndrimin e tij në shkollën që e donte dhe prej të cilës ishin larguar pjesa dërmuese e fëmijëve të fshatit, për shkak se në mesin e popullatës ishte përhapur thashetheme se ai nuk interesohet më për mësimin përmendësh (hifzin) e Kur'anit...²⁴

Më pas, Sejjidi vendosi të vazhdojë shkollimin. Në moshën katërmëdhjetë vjeçare braktisi fshatin dhe vajti në Kajro. Ç'është e vërteta, ai vajti te daja i tij, i cili punonte në arsim dhe gazetari, kurse Sejjidi aspironte me të madhe të bëhej i emancipuar si dajallarët e tij. Sejjid Kutubi arriti në Kajro në vitet e njëzeta me qëllim konkret, dhe kështu u regjistrua në një shkollë të mësuesisë që quhej **“Shkolla Abdulaziz”** dhe aty u përqendrua tërësisht për ta realizuar synimin e tij final, duke ua tejkalluar të tjerëve në mësim dhe kështu fitoi diplomën për mësim fillor.

Në vitin 1929 hyri në fakultetin e mësuesisë **“Darul-Ulum”** ku edhe pas katër viteve diplomoi, gjegjësisht në vitin 1933. Pastaj u caktua mësues në të njëjtin fakultet, meqë ishte student shembullor. Ai poashtu u punësua edhe nga Ministra e Arsimit si mësues i shkollës fillore, rroga e tij ishte 6 paundë egjiptianë.²⁵

²² **“Sejjid Kutub, Hajatuhu ve edebuhu”**; fq. 21. (transmetuar nga **“Mexhel-letur-risaleti”**, tetor 1940, Nr. 381, fq. 196).

²³ Po aty; Gjithashtu shih edhe Abdul-Fetah Ali, **“Sejjid Kutub, siretun dhatijjetun.”**

²⁴ Abdul-Fetah Ali, **“Sejjid Kutub, siretun dhatijjetun”**; fq. 20-21; Shih: **“Sejjid Kutub, Hulasatu hajatihi”**; fq. 9.

²⁵ Muhamed Husejn Abdul-Baki, **“Sejjid Kutub Hajatuhu ve edebuhu”**; fq. 28-26, marrë nga dosja që është në Ministrinë e Arsimit me numër 5/22-125. Këtu ka të dhëna zyrtare mbi Sejjid Kutubin

Gjatë prezencës së tij në shkollë e në fakultet u takua me letrarin dhe profesorin e mirënjohur Abbas Mahmud El-Akkad²⁶ (Zoti e mëshiroftë!), i cili ishte udhëheqësi i reformave letrare në Egjipt, e përcolli me vëmendje dhe u bë nxënësi i tij i sinqertë. Ai u habit nga shkathtësia, aftësia dhe kultura e tij. Profesor Sejjid Kutubi vetë tregon për këtë takim, duke thënë: ***“Akkadi është personaliteti që la përshtypje më të madhe te ne, dhe në të kemi shpresë për rregullimin e kësaj hutie letrare individuale, bile edhe për çrregullimin nga rrënujat shoqërore që rrezikojnë këtë shoqëri. Ne e llogarisim si njeri që qëndron në mënyrë stoike përballë rrethanave dhe vështirësive me të cilat ballafaqohet gjatë jetës së tij individuale dhe aktiviteteve të tij të përgjithshme në jetë!”***²⁷

Në fillim të viteve të dyzeta, gjegjësisht më 01.03.1940 Sejjid Kutubi hyri në Inspektoratin e Përgjithshëm të Kulturës në Ministrinë e Shkencës për të punuar si redaktor i gjuhës arabe, pastaj edhe në Drejtorinë e Përkthimit dhe Statistikës më 17.04.1940. Më vonë, që nga data 01.07.1944 punoi si inspektor i arsimit fillor. Në prill të vitit 1945 u kthye nga Inspektorati në Drejtorinë e Përgjithshme dhe prej kësaj kohe fillojnë hapat e tij në kritikën letrare dhe më vonë u dallua me metodën e tij të posaçme letrare, dhe si rezultat i gjithë kësaj veprimtarie, ai shkroi dy vepra kritike që titulloheshin: **“Kutub ve shahsijjat”**, dhe **“En-nakdul-edebij, usuluhu ve menahixhuhu”**, por, nga kritika letrare ai përfitoi armiq e kundërshtarqë që ndihmuan karrierën e tij...²⁸

Nga ajo që u theksua më sipër, qartë vërehet se Sejjid Kutubi kishte pavarësi intelektuale dhe mbështetej në veten e vet dhe në fuqinë e tij

(Zoti e mëshiroftë!) në të cilat u mbështeta gjatë biografisë së tij më shumë se sa në burimet tjera. Shiko edhe librin **“Sejjid Kutub, Esh-shehid el-hajj”**, fq. 80.

²⁶ Abbas ibn Mahmud ibn Ibrahim ibn Mustafa El-Akkad. U lind në vitin 1889 dhe vdiq në vitin 1964. Gëzonte autoritet të lartë në letërsinë egjiptiane. Është autor i shumë veprave dhe krijimtar. Ishte nga Dimjati, njëri nga të parët e tij punonte në punëtorinë e mëndafshit dhe kështu u quajt Akkad. Babai i tij u martua me një vajzë kurde nga Esvani, dhe nga kjo martesë lindi Abbasin. Në fëmijëri e mësoi anglishten e më pas gjermanishten dhe frëngjishten. Abbasi shkruante në gazeta dhe merrej me shkrime të cilat lexoheshin me ëndje nga populli. Nuri i tij edhe pas gjysëm shekulli akoma vazhdon të shndërrit. Ai shkroi 83 libra nga lëmi të ndryshme me një stil mjaft të lartë letrar si p.sh.: **“Abkarijetu Muhamed Anil-lah”**; **“Rexh’atu Ebil-ala”**; **“El-Fusul, Muraxhat fil-edeb vel-funun”**; **“Abkarijetu Umer”**; etj. Ka poezi të mira, ndaj dhe quhej kampion i poezisë. **Zerekli**, El-A’ëlam, vëll. 3, fq. 266.

²⁷ **“Sejjid Kutub Hajatuhu ve edebuhu”**; marrë nga **“Mexhel-letul-usbu”I**, qershor 1934, 4/31, fq. 28.

²⁸ Po aty, fq. 31.

racionale e letrare, ngase, në bazë të burimeve ai ka qenë kritik i fortë dhe kishte gjuhë thumbuese, gjë që ndikoi të humbas shumë shokë e dashamirë për shkak të mosdakordimit me idetë e tyre. Thuhet madje se edhe profesori i tij Abbas Akkadi u largua prej tij, duke mos fol asnjë fjalë miradie për shkrimet e tij kritike.²⁹

Me datën 03.11.1948 Sejjid Kutubi udhëtoi në Amerikë³⁰ në një delegacion shkencor ministror për t'u specializuar në pedagogji dhe në parimet e metodave amerikane. Siç duket, shkak i dërgimit të profesor Sejjid Kutubit në Amerikë ishte fakti se shteti veçmë kishte filluar të kuptojë rrezikun prej këtij njeriu për shkak të shkrimeve dhe kritikave të tij, dhe kështu filluan të mendojnë se si t'ia ndërronin mendjen këtij njeriu dhe si ta largonin nga mendimet e tilla islame dhe kështu e vetmja mundësi për ta realizuar qëllimin e tyre ishte dhe mbetej: largimi i tij nga vendi në një vend tjetër, gjegjësisht në Amerikë për t'ia ndryshuar mendjen dhe konceptet dhe po të njëjtat t'ia zëvendësonin me ide dhe koncepte amerikane. *“Ata bënin plane e Allahu i asgjësonte, se Allahu është më i Miri që asgjëson (dredhitë).”* (El Enfalë, 30).³¹

Mirëpo, udhëtimi i profesor Sejjid Kutubit në Amerikë ndryshoi diametralisht mendimet e tij, por në të kundërtën e asaj që e pritnin pushtetarët, ngase ky njeri forcoi edhe më shumë besimin dhe bindjen e tij se sa që e kishte më parë... Ai u bind se besimi islam, metoda dhe sistemi islam në jetë janë e vërtetë, ndërsa atë që e kanë dhe posedojnë të tjerët është e pavlefshme dhe hiçgjë. Kur u kthye Sejjid Kutubi nga Amerika, shkroi librin e tij **“Amerika el-leti re’ejtu”**, dhe kështu filloi të ndiejë në vete përgjegjësinë si thirrës dhe mendimtar.

Pritej që pas kthimit të profesor Sejjid Kutubit nga Amerika të bëhej përkrahës i shtetit egjiptian... Por njerëzit dëshirojnë diçka tjetër, përderisa

²⁹ Po aty, fq. 32; Poashtu shih edhe: Muhammed Teufik Barakat, **“Sejjid Kutub, Hulasatu hajatihi”**; fq. 10.

³⁰ Zerekli El-A’ëlam, vëll. 3, fq. 147-148.

³¹ Prof. Salah Abdul-Fetah El-Halidi në librin e tij: **“Sejjid Kutub, Esh-shehid el-hajj”**, i thekson shkaqet e dërgimit të Sejjid Kutubit në Amerikë dhe thotë: **“Përveç qëllimit të tyre për ta larguar nga Kajroja, ata dëshironin që t’i ndëronin edhe mendimet e tij dhe ta pasuronin me kulturë amerikane e pastaj kur të kthehej në Egjipt, të bëhej ithtarë i Amerikës, ngase Amerika përgatiste udhëheqës egjiptian për t’i realizuar projektet amerikane. Ata i ofruan program special për prishjen e moralit, ideve dhe shpirtit të tij dhe të kthehej ashtu siç ktheheshin të tjerët, por këtë herë dështuan, ngase Zoti i kishte caktuar tjetër rrugë!”** fq. 126.

Zoti dëshiron dhe ndodhë vetëm ajo që dëshiron Ai... Ky është ligji hyjnor por shumica e njerëzve nuk e dinë. Profesor Sejji dKutubi u bë kundërshtar i madh i shtetit sipas konceptit të tyre, dhe pikërisht mu për shkak të ideve të tilla e pagoi me vetë jetën e vet!³²

5. Bashkangjitja e Sejjid Kutubit me Vëllezërit Muslimanë³³

Udhëheqësi dhe themeluesi i **Vëllezërve Muslimanë** Shejh Imam Hasan El-Benna³⁴ (Zoti e mëshiroftë!) me personalitetin e tij islamik dhe kulturën e tij të shkëlqyer ndikoi dukshëm në përgatitjen e **Vëllezërve** për të thirrë në rrugën e Zotit. Ai e kishte balancuar shpirtin, diturinë e lëvizjen në një tërësi anë dhe shkollat e posaçme islame, si sufiste, selefiste e doktrimore në

³² “**Sejjid Kutub, sire dhatije**”; fq. 33, 39. “**Sejjid Kutub, hulusatu hajatihi**”; fq. 9; “**Sejjid Kutub, Hajatuhu ve edebuhu**”; fq. 32-42.

³³ Më hollësisht për bashkëpunimin e tij me **Vëllezërit** shih: “**Sejjid Kutubi Esh-shehid el-hajj**”; fq. 132.

³⁴ Imami, Shejhu dhe edukatori Hasan ibn Abdurahman El-Benna, u lind në vitin 1906 në Mahmudijje afër Aleksandrisë dhe ra dëshmor në vitin 1946. Është themeluesi i shoqatës “**Vëllezërit Muslimanë**” në Egjipt dhe organizatori kryesor i kësaj lëvizje. Diplomoi në shkollën “**Darul-Ulum**” në Kajro, punoi në arsim dhe udhëtoi në shumë vende për të mësuar jetën dhe traditat e tyre, pastaj punoi mësues në qytetin Ismailije, ku përfitoi disa njerëz të sinqertë që i prematuan se do ta ndihmojnë për të ngritur fjalën e Islamit, dhe për veten e vet e zgjodhi emrin: “**udhëzues i përgjithshëm**”. Ata filluan të thirrin në fëmijërisë përmes ligjëratave, botimeve, udhëzimeve duke vizituar edhe vende të tjera, pasi dërgoi njerëz të besueshëm në disa vende, i forcoi qendrat e tij, ndërsa qyteti Ismailije ishte qendra e thirrjes. Ai nuk i thirrte vetëm burrat por në Ismailije hapi edhe një Institut për nënat e besimtarëve, me qëllim që t’i edukoj vajzat me edukatë të mirë islame. Thirrja e tij filloi të përhapet masovikisht, gjersa numri i tyre arriti në gjysëm milion dhe kështu shteti u frkësua të ballafaqohet me të, ndaj dhe u orvat që ta bindte të largohet nga politika. Në një hutbe të tij Shejhu, mes tjerash, tha: “**Feja islame është besim, adhurim, atdhe, nënshtetësi, tolerancë, fuqi, moral, materie, kulturë dhe ligj.**”

Vëllezërit Muslimanë morën pjesë në luftën e Palestinës dhe ishin ndër më aktivët në këtë luftë. Pas një kohe të shkurtër, përderisa Hasan El-Benna një natë ishte duke qëndruar para Qendrës së Rinisë Islame në Kajro, tre persona e vranë dhe ikën, dhe kështu nga plagët e marra, pas dy ore Shejhu vdiq. Shejhu i nderuar ishte ligjërues i shkathët, ligjëronte dhe mbante vaze nga goja e të cilit dilnin rrjedhshëm ajetet kur’anore, si dhe punonte i qetë dhe i sigurtë. Ai ka shkruar ditare që janë botuar pas vdekjes së tij si dhe vepra autobiografike. Deshti Allahu i Madhëruar që pas 80 vite persekutimi, ekzekutimi të anëtarëve të kësaj Shoqate; që kjo Shoqate/Parti Islame të fitoj në zgjedhjet e fundit në Egjipt në krye me kryetarin Dr. Muhamed Mursi, pas revolucionit të rinjëve musliman me 25.01.2011(*ne pranverën e revolucioneve arabe*). Shih: Zerekli *El-a’elam*; vëll. 2, fq. 183-18. Më hollësisht për Imam Hasan El-Benna, lëvizjen dhe aktivitetet e lëvizjes së tij shih: Dr. Ali Abdulhalim Mahmud, “**Menhexhut-terbijeti indel-ihvan el-muslimin-dirase tahlilije**”; Darul-vefa’l lit-tiba’ati ven-neshri, bot. 1, 1992, vëll. 1, fq. 10-27. Njëherit ky është edhe libri më i mirë që është shkruar rreth historisë së **Vëllezërve Muslimanë**.

anën tjetër, si dhe në strukturën organizative të shoqërisë. Kjo strukturë dallohej ngase ishte vepër kolektive në formë të partisë islame.³⁵

Disa burime të tjera theksojnë se profesor Sejjid Kutubi, para udhëtimit të tij në Amerikë e shkroi librin e tij të njohur “**El-adaletul-ixhtima’ije fil-Islam**”, “**Drejtesia Sociale në Islam**”. dhe një kopje të këtij libri ua kishte dhuruar **Vëllezërve Muslimanë**.

Unë jam i mendimit se pikërisht ky gjest i profesor Sejjid Kutubit, pra dhurimi i librit të tij **Vëllezërve Muslimanë**, njëherit ishte edhe fillim i marrëdhënieve të tij të mëtutjeshme me **Vëllezërit**.³⁶

Dy ngjarje ndikuan dhe ishin vendimtare që profesor Sejjid Kutubi t’iu bashkangjitet **Vëllezërve Muslimanë**, madje këtë edhe vetë ai e thekson³⁷.

Ngjarja e parë ndodhi kur ai ishte në Amerikë. Më 12.02.1948, ditën kur në Kajro u vra Shejh Imam Hasan El-Benna, udhëheqësi i **Vëllezërve Muslimanë**, ai në SHBA çuditërisht kishte vërejtur gëzim të madh, si asnjëherë më parë...; dhe:

Ngjarja e dytë kishte të bëjë me një agjent të fshehtë britanik që quhej James Heyworthe Dunne, i cili ishte përqendruar në Sejjid Kutubin dhe vazhdimisht përsëriste se sipas tij, “**Vëllezërit** ishin pengesa kryesore e depërtimit të qytetërimit perëndimor në Lindje...”³⁸

Këto dy ngjarje i lëvizën ndjenjat e Sejjid Kutubit për të studiuar idetë e Imam Hasan El-Bennasë me thellësi dhe seriozitet të madh, si dhe dukshëm ndikuan që të tregojë interes për lëvizjen e **Vëllezërve** si organizatë dhe për nevojën obligative për ta mbrojtur Islamin.

³⁵ Teufik Berekat, “**Sejjid Kutub, Hulusatu hajatihi**”; fq. 16-17; poashtu shiko Zerekli El-A’elam, vëll. 2, fq. 184; Shiko hyrjen që e ka shkruar Shejh Ebu Hasen Ali Hasen En-Nedevij në librin “**Mudhek-kiratu al da’weti wa-da’ijeti**”; nga Imam shehid Hasan El-Benna, Ez-Zehra lil-l’amil-arabij, Kajro 1990; fq. 15-16, Darul-fikril-islami, 1991, Kajro.

³⁶ Muhamed Husejn Abdulbaki, “**Sejjid Kutub, Hajatuhu ve edebuhu**”; fq. 39.

³⁷ “**Sejjid Kutub, Esh-Shehid el-hajj**”; fq. 135.

³⁸ Po aty; Poashtu shih edhe: “**Sejjid Kutub, sire dhatijje**”; fq. 23; “**Sejjid Kutub, Esh-shehid el-hajj**”; fq. 136.

Kur Sejjid Kutubi u kthye nga Amerika, ai u prit nga një delegacion i madh i **Vëllezërve Muslimanë** me mikpritje të ngrohtë³⁹, dhe kjo ngjarje la gjurmë të madhe në ndjenjat e tij ndaj **Vëllezërve**, edhe pse ai akoma në mënyrë zyrtare nuk i ishte bashkangjitur lëvizjes. Ky afrim me **Vëllezërit** u rrit edhe më shumë kur Sejjid Kutubi filloi të shkruajë në revistën e tyre “**Da’ve**”, nga shkurti i vitit 1951, derisa në fillim të vitit 1953 u ftua që të formoj Departamentin e Thirrjes brenda lëvizjes së **Vëllezërve** e që njëherit ishte një nga qendrat kryesore të **Vëllezërve Muslimanë** në Kajro.

Në vitin 1953 profesor Sejjid Kutubi u caktua kryeredaktor i revistës javore të **Vëllezërve Muslimanë**, e cila revistë në vitin 1954 u ndalua nga botimi.

6. Veprimtaria dhe literatura e tij

Profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) ka lënë pas vetes një bibliotekë të pasur librash të botuara dhe të pabotuara, si dhe qindra artikuj të pabotuar nëpër gazeta e revista të ndryshme. Pra, trashëgimia e tij konsiderohet një bibliotekë e madhe për gjeneratat e ardhshme. Kjo pasuri e madhe, njëherit paraqet edhe argumentin më të madh mbi diturinë dhe kulturën e tij të gjerë. Në bazë të periudhave dhe zhvillimeve intelektuale në të cilat kaloi ky dijetar i famshëm, këtë pasuri të vlefshme shkencore mund ta ndajmë në dy periudha:

a. Veprimtaria dhe literatura para anëtarësimit të tij në lëvizjen Vëllezërit Muslimanë, apo para punimeve të tij islame; dhe:

b. Veprimtaria dhe literatura pas anëtarësimit në lëvizjen Vëllezërit Muslimanë, apo pas përqendrimit të tij plotë në përpilimin e literaturës islame.

Në realitet kjo çështje është shumë e rëndësishme, ngase njohuria kronologjike e veprimtarisë së tij në bazë të periudhave që i ka përjetuar në jetë ka rëndësi të madhe, sepse në këtë mënyrë do të vërehet zhvillimi intelektual i autorit dhe vetëm kështu do të kuptohet qartë se ai ka përjetuar

³⁹ “**Sejjid Kutub, hajatuhu ve edebuhu**”; transmetuar nga “**El-Mexhel-le el-kuvejtije**”; gusht 1974, nr. 215, fq. 7; Ahmed Salahud-din El-Musal-li, “**El-fikrul-islamij el-muasir**”; Bejrut, Daru Hudar lit-tiba’ati ven-neshri, 1990, fq. 26, 27.

periudha të ndryshme në jetë... Ata që shkruajnë për profesor Sejjid Kutubin i mbyllin sytë ndaj këtij aspekti historik të jetës së tij (Zoti e mëshiroftë!) dhe pastaj i komentojnë gabimisht idetë e profesor Sejjid Kutubit.

Kjo çështje, gjithashtu ka raport të pjesërishëm edhe me temën e disertacionit, ndaj dhe për këtë shkak ishte e domosdoshme që t'i qasem kësaj çështjeje. Më duhet të theksoj se këtë çështje më së miri e ka shqyrtuar Prof. Dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidi në shkrimet e tij mbi profesor Sejjid Kutubin. Zoti e shpërbleftë për këtë vepër të madhe që e ofroi për shoqërinë islame dhe për gjeneratat e ardhshme.

Prof. dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidi (Zoti e ruajtë!) thotë:

“U lodha shumë gjatë rregullimit të saj në këtë formë dhe shfrytëzoj rastin që të them se ribotimet e shumta të këtyre librave (në mënyrë zyrtare apo jozyrtare) kanë bërë një gabim shumë të madh, ngase nuk kanë theksuar kohën e botimit të parë pas ribotimit, me qëllim që lexuesi i nderuar të kuptoj drejt e të mos bie në kurth, ngase mendimet e autorit janë në evoluim e sipër, dhe një mendim që ka thënë në botimin e parë mund ta anulojë në ribotimin tjetër, pra mendimet e tij evoluojnë. Një evoluim i tillë është shumë evident në mendimet e Sejjid Kutubit dhe kjo do të kuptohet vetëm nëse i radhit veprat e tij në këtë kronologji. E këshilloj secilin që merret me zhvillimin e mendimeve të Sejjid Kutubit t'i sistematizojë veprat e tij në bazë të viteve të botimit të tyre!”⁴⁰

Veprat e periudhës së parë fillojnë nga viti 1933 deri në vitin 1948, ndaj dhe unë po filloj me radhitjen që e ka bërë prof. Halidi sipas viteve të botimit të tyre:

1. “Muhimmetush-sha’ir fil-hajat ve shi’rul-xhijlil-hadir, në realitet kjo është një ligjëratë e mbajtur në fakultetin **Darul-Ulum** dhe është botuar në vitin 1933;

2. “Esh-shati’ul mexhhul” është divani i tij i parë dhe i fundit, është botuar në vitin 1935;

⁴⁰ Prof.dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidi, “**Sejjid Kutub, esh-shehid el-hajj**”; fq. 219-220.

3. “Nakdu kitabi Mustakbalith-thekafeti fi Misre” (kritikë ndaj opinionit dhe mendimeve të dr. Taha Husejnit). Ky libër u botua në vitin 1937, dhe shkaktoi një huti të madhe, ngase dr. Husejni ishte i mendimit se Egjipti është pjesë e qytetërimit perëndimor, ndërsa Sejjid Kutubi në këtë vepër i kritikoi mendimet dhe opinionet e Taha Husejnit në mënyrë bindëse dhe me argumente nga aspekti edukativ dhe arsimor;

4. “Et-tasvirul-fenij fil-Kur’an”, është vepra e parë e tij islame, flet për Kur’anin dhe ilustrimin artistik në të, dhe konsiderohet bazë e bibliotekës kur’anore. Sikur të mos ishte ky libër nuk do të dinim zhvillimin e rrugës së ardhshme të Sejjid Kutubit. Botimi i parë doli në vitin 1945;

5. “El-Etjaf el-erbe’atu” e përpiloi së bashku me të vëllain dhe me motrën e tij. U botua për herë të parë në vitin 1945 në kuadër të botimeve universitare;

6. “Tiflun fil-karjeti” është një rrëfim për fëmijërinë e Sejjid Kutubit. Këtë vepër e botoi komiteti për botime universitare në vitin 1946. Këtë libër ia ka dedikuar dr. Taha Husejnit, autorit të romanit **“Ditët”**, ngase ai (*Sejjid Kutubi, vërej. e përkt.*) ishte tejet i impresionuar nga ky libër i dr. Taha Husejnit, ashtu siç ishte i impresionuar edhe me librin e Teufik Hakimit **“Jaumijjat Na’ib fil-erjaf”** dhe në këtë formë e përpiloi edhe librin e tij;

7. “El-Medine el-mes-hure”, e shkroi në vitin 1946 dhe është rrëfim iluzor simbolik në formë të librit **“Një mijë e një net”**;

8. “Kutub ve shahsijjat”. Ky është libri i tretë i botuar në vitin 1946, pas dy librave **“Tiflun fil-karjeti”** dhe **“El-Medine el-mes-hure”**. Këtë libër ua ka kushtuar letrarëve, poetëve, tregimtarëve dhe hulumtuesëve, të cilëve ua kishte kritikuar veprat;

9. “Eshvak” - edhe ky është një tregim romantik dashurie. U botua në maj të vitit 1947, dhe aty vërehet qartë aftësia e tij si letrar, tregimtar që rrëfen për një ngjarje romantike-dashurie të vërtetë, në mes tij dhe një vajze të bukur nga Kajroja;por profesori Sejjid Kutub nuk u martua me atë vajzë për disa shkaqe dhe për fat të keq nuk la trashigimtar pas tij;

10. “Meshahidul-kijameti fil-Kur’an” u botua për herë të parë në prill të vitit 1947 dhe ky është libri i dytë nga biblioteka e Kur’anit, libër ky i përpiluar në bazë të metodës së librit **“El-tasvirul-fenij fil-Kur’an.”**;

11. “Raudatul-tifli” - është një seri e Sejjid Kutubit në bashkëpunim me Emine Es-Sa'id dhe Jusuf Murad. Këtë e botoi në Shtëpinë Botuese *“Darul-Me'arif”* në Egjipt;

12. “El-Kasas Ed-dinij” - është një seri e veprave fetare për fëmijë në bashkëpunim me Abdulhamid Xheude;

13. “El-Xhedid fil-lugatil-arabijjeti”, në bashkëpunim me autorë të tjerë dhe siç duket Ministria e Arsimit e Egjiptit këtë vepër e kishte caktuar si literaturë obligative shkollore për lëndën e gjuhës arabe;

14. “El-Xhedid fil-Mahfudhat” - e përpiloi me disa autorë të tjerë, e cila gjithashtu ishte literaturë shkollore didaktike, por prof. Halidi, për fat të keq, nuk pati mundësi t'i gjejë këto katër libra dhe të njihet me tematikat e tyre...;

15. “En-Nakdul-edebijju-Usuluhu ve Menahixhuhu” e botoi në qershor të vitit 1948 dhe ky është libri i tij i katërt kritik dhe njëherit edhe i fundit;

16. “El-Adaletul-ixhtima'ijjetu” - vepër këtë, të cilën e shkroi para udhëtimit të tij në Amerikë. Profesor Sejjid Kutubi para se të udhëtoj për në Amerikë, i obligoi dy vëllezërit e tij që ta botonin këtë vepër. Botimi i parë doli në prill të vitit 1949 dhe njëherit është edhe libri i tij i parë në lëmin e mendimit islamik. Ky libër përjetoj edhe disa botime tjera të korrektuara nga vetë Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!). Këtu duhet të theksojmë edhe atë që të dy librat e tij të mëparshëm: **“Et-tasvirul-fennij fil-Kur'an”** dhe **“Meshahidul-Kijameti fil-Kur'an”** - janë vepra letrare ngase aty e shqyrton metodën ekspresive të Kur'anit dhe karakteristikat e metodës së tij;

17. “Ma'reketul-Islam ver-re'smalijje”. Këtë libër e shkroi në shkurt të vitit 1951, sepse Sejjid Kutubi për dy vjet të tëra u ndal nga të shkruarit, kjo për shkak të udhëtimit të tij në Amerikë dhe gjendjes politike të keqe që mbretëronte në Egjipt, e cila jashtëzakonisht ishte përkeqësuar, kjo kohë njëherit konsiston edhe me njohjen dhe bashkëngjitjen e tij radhëve të lëvizjes së **Vëllezërve Muslimanë**;

18. “Es-Selamul-alemij vel-Islam” u botua në tetor të vitit 1951 nga Shtëpia Botuese *“Darul-Kitabil-Arabij”* në Kajro;

19. “Fi dhilâlil-Kur'an”. Kur profesor Sejjid Kutubi e shkroi librin e tij **“Et-tasvirul-fennij fil-Kur'an”** në vitin 1945, ai shprehi dëshirë që tërë

Kur'anin ta elaborojë në këtë mënyrë, çdo sure dhe çdo ajet. Kjo dëshirë vazhdoi të qëndrojë në brendinë e tij një kohë bukur të gjatë, gjersa në dhjetor të vitit 1951 Se'id Ramadani e botoi revistën **“El-Muslimun”** që ishte revistë mujore intelektuale. Se'id Ramadani kërkoi prej profesor shehid Sejjid Kutubit që të bashkëpunoj dhe të shkruaj artikuj për këtë revistë mujore. Profesor Sejjid Kutubi me kënaqësi e pranoi ofertën e tij. Kështu, Sejjid Kutubi filloi të komentojë Kur'anin nën titullin **“Fi dhilâlil-Kur'an”**, dhe më pas, e ndërpreu shkrimin, ngase u kishte premtuar lexuesve që do të përpilojë një tefsir të posaçëm në tridhjetë vëllime dhe vërtetë doli vëllimi i parë i tefsirit **“Edh-dhilâl”** në tetor të vitit 1952.;⁴¹

20. “Dirasat Islamijje” u botua për herë të parë nga libraria e Komitetit të Rinisë Islame në vitin 1953 dhe përmban artikuj të ndryshëm që i ka shkruar dhe botuar profesor Sejjid Kutubi në revista të ndryshme;

21. “Hadhed-din”. Pas burgosjes së pjestarëve të **Vëllezërve Muslimanë** në burgjet e presidentit egjiptian, diktatorit dhe kriminelit Xhamal Abdul-Naser, si rrjedhojë e maltretimt dhe vuajtjeve nga më çnjerëzoret, disa pjestarë, së pari e humbën besimin në vetveten e tyre, dhe më pas edhe në këtë fê dhe në fuqinë e saj për t'u përballur me injorancën;

Së dyti, profesor Sejjid Kutubi menjëherë e kuptoi këtë gjë, ngase ai ishte udhëheqës që ndiente vuajtjet e vëllezërve të tij dhe për këtë shkak, iu rrek shkruarjes së këtij libri, me qëllim që t'i sqaroj karakteristikat e kësaj feje, e cila njëherit është edhe rrugë për njerëzit dhe se Zoti po të dëshiroj mund t'ju ndihmojë me engjëjt e Tij, mirëpo për shkak të shumë urtësive, Zoti dëshiron që njerëzit të ndihmohen përmes njerëzve. Ky libër konsiderohet periudhë e re ideologjike e Sejjid Kutubit dhe e metodës së tij dhe njëherit ky është fillimi i drejtimit të tij islamik-dinamik;

22. “El-Mustakbel li hadhed-din”. Ky libër plotëson misionin e librit të parë **“Hadhed-din”**. Pasiqë ky libër e rikthen besimin e tyre në vetvete, në këtë libër sqaroi se ardhmëria i takon kësaj feje, ngase është metodë e plotë, e përkryer universale dhe i plotëson të gjitha nevojat njerëzore. S'ka fe tjetër që e kryen këtë mision!;

⁴¹ Shiko detajet e shkruara kronologjikisht rreth **“Dhilâl-it”** brenda burgut dhe jashtë tij në: **“Sejjid Kutub, Esh-shehid el-hajj”** nga prof. dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidi, fq. 241-245.

23. “Hasaisut-tesav-vuril-Islami ve mukav-vimatuhu”. Këtu, në këtë libër, profesor Sejjid Kutubi flet për besimin islam dhe për karakteristikat e tij. Libri ndahet në dy pjesë, edhe këtu Sejjid Kutubi kaloi kohë të gjatë studimesh e hulumtimesh derisa e përfundoi këtë libër. Këtë libër e shkroi nga viti 1951 deri në vitin 1961.⁴²

24. “El-Islam ve mushkilatul-hadareti”. Sejjid Kutubi këtë vepër e shkroi me qëllim që njerëzve t’ua jep ilaçin efektiv për t’i shëruar dhe njehërit ata (njerëzit) ta pranojnë Islamin si çelësin e vetëm për t’i zbërthyer dhe zgjidhur të gjitha problemet e tyre; dhe:

25. “Me’alim fit-tarik” – (*Shenja në Rrugë*) është libri i fundit i tij i botuar, ngase Sejjid Kutubi dhe **Vëllezërit** e tij (*fjala është për pjestarët e lëvizjes Vëllezërit Muslimanë, vërej e përkth.*) pas botimit të këtij libri burgosen, ndërsa autori i kësaj vepre Sejjid Kutubi menjëherë u dënua me vdekje.

Tiranët kërkonin prej të burgosurve që të largohen nga leximi i këtij libri. Këtë libër, Sejjid Kutubi e shkroi me një stil dhe metodë avangarde-revolucionare. Këtu në këtë vepër, ai ishte tejet i guximshëm dhe shumë i drejtpërdrejt në mendimet e tij. Ky libër ka të bëjë me besimin, sistematizimin, organizimin, mendimin dhe lëvizjen. Në këtë libër vërehet qartë pjekuria intelektuale dhe përvoja e tij e madhe jetësore.

Në fund të këtij libri, prof. dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidi thotë: **“Këto janë të njëzetepesë librat që i botoi Sejjid Kutubi gjatë jetës së tij.”**⁴³

Ka disa libra që janë botuar pas rënies së tij shehid dhe lexuesit mendonin se ishin të Sejjid Kutubit dhe se ai i kishte nxjerrë në atë formë, por nuk është ashtu, ngase këto libra janë përmbledhje e mendimeve të profesor Sejjid Kutubit gjatë periudhës së qëndrimit të tij në Amerikë, prej vitit 1949 deri në vitin 1951, të cilat i ka shënuar në letrat që ia ka dërguar vëllait, motrës dhe shokëve të tij në Egjipt dhe në vende tjera. Një pjesë prej tyre janë artikuj

⁴² Shkrimtari dhe profesori dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidi thekson në librin e tij se **“...vetëm pjesa e parë e këtij libri është botuar.”** Siç duket prof. dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidi e ka shkruar këtë libër në fillim të viteve të tetëdhjeta dhe sot është botuar edhe pjesa e dytë, meqë unë i posedoj të dy pjesët e librit.

⁴³ Prof. dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidi, **“Sejjid Kutub, Esh-shehid el-hajj”**; fq. 251.

që i ka botuar në revista të ndryshme, të cilat më pas janë botuar me tituj të ndryshëm.

Librat e tillë janë:

1. **“Efracur-ruh”;**
2. **“Nahve muxheme’in islamijjin”;** dhe:
3. **“Fit-tarihi-fikretun ve minhaxh”.**

Nga librat që janë nxjerrë nga tefsiri **“Fi dhilâlil-Kur’an”** me tituj të ndryshëm për shkaqe tregtie e profitabile do t’i theksojmë:

1. **“Ma’reketuna me’al-jehud”;**
2. **“Tefsiru suretish-shura”;**
3. **“Tefsiru ajatir-riba”;**
4. **“Kissatu ajatid-da’veti”;**
5. **“Islamun eu la Islame”;**
6. **“Ila el-mutethakiline anil-xihad”;** dhe:
7. **“Risaletus-salat”.**

Nga hulumtimet dhe artikujt e pabotuar theksojmë:

1. **“Muhimmetush-sha’ir fil-hajat”;**
2. **“Dirasetun an Sheuki”;**
3. **“El-Murahekatu, atharuha ve ilaxhuha”;**
4. **“El-Mer’etu legzun besit”;**
5. **“El-Mer’etu fi kasasi Teufik El-Hakim”;**
6. **“Es-da’uz-zemen”;**
7. **“El-Ke’sul-mesmumetu”;**
8. **“Kafiletur-rekik”;**
9. **“Hilmul-fexhri”;**
10. **“El-Kitat ed-dal-letu”;**
11. **“Min a’makil-vadij”;**
12. **“El-Medhahib el-fennijjetu el-mu’asire”;**
13. **“Es-suver, vedh-dhilâl fish-shi’ril-arabijj”;**
14. **“El Kis-satu fil-edeb”;**
15. **“Shu’ara’u sh-shebab”;**

16. “El-Kissatul-hadithetu”;
17. “Arabijun-elmuftera alejhi”;
18. “Esh-Sherif Er-Radij”;
19. “Lahadhat me’al-halidin”;

20. “Amerika el-leti re’ejtu”;

Në këtë kontekst prof. dr. Halidi thotë se Sejjid Kutubi dëshironte ta botojë këtë libër, ngase kur ishte burgosur në vitin 1954 e kishte fshehur dorëshkrimin te një mik i tij, gjersa të qetësohej situata dhe të përfundonte kriza, mirëpo miku i tij e kishte djegur dorëshkrimin kur ishin shtuar me të madhe përndjekjet dhe burgosjet e **Vëllezërve Muslimanë**.⁴⁴

1. “El-Kissatu bejnet-Teurati vel-Inxhili”;
2. “En-Nemadhixh el-insanijetu fil-Kur’an”;
3. “El-Mentikul-vuxhdaniju fil-Kur’an”;
4. “El-Esalibul-fennijje fil-Kur’an”;
5. “Me’alim fil-tarik” (kodeksi i dytë);
6. “Fi dhilalis-sireti”;
7. “Fi Meukibil-Iman”;
8. “Mukav-vimatut-tesav-vuril-islamijj”;⁴⁵
9. “Ev-vlevijjat fi hadhed-din”;
10. “Hadhel-Kur’an”;
11. “Tevibat fil-fikril-islamij el-el muasir”;
12. “Nahve muxhteme’in islamijjin”.⁴⁶

7. Rënia e tij shehid (mbytja e tij)

Profesor Sejjid Kutubi qartë e kuptoi se shoqëria e **Vëllezërve Muslimanë** është një grup me parime dhe elemente të fuqishme që kishin për qëllim përhapjen e Ligjit dhe Sheriatit të Zotit në tërë botën dhe për këtë shkak e pa se ndiente obligim që t’ju bashkohej atyre. Pas rënies shehid të themeluesit të parë Shejh Imam Hasan El-Bennasë (Zoti e mëshiroftë!), Sejjid

⁴⁴ “Sejjid Kutub, Esh-shehid el-hajj”; fq. 259-260.

⁴⁵ Ky libër është i botuar dhe gjendet në duart e lexuesve.

⁴⁶ “Sejjid Kutub, Esh-shehid el-hajj”; fq. 221-261.

Kutubi u bë udhëheqës i njohur i mendimit islamik në Egjipt dhe në vendet tjera islame e botërore.⁴⁷

Sejjid Kutubi i përjetoi të gjitha sprovat dhe vështirësitë që i përjetuan edhe **Vëllezërit Muslimanë**, të cilat sprova dhe vështirësi filluan qysh nga viti 1954, e vazhduan derisa u dënua me vdekje në vitin 1966. Fundja, a nuk ishin pikërisht mu pejgamberët dhe të dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ta!) ata që më së shumti se çdokush tjetër në faqe të dheut u sprovuan me plot vuajtje e vështirësi... Ky është ligj i Zotit në Tokën e Tij për njerëzit e Tij të zgjedhur, në këtë kontekst, Zoti i Madhërishtëm thotë: **“Ky është ligj i Tij edhe me të dërguarit që i dërgoi para teje. E në ligjin Tonë ti nuk gjen ndryshim.”** (Israë, 77).

Sejjid Kutubi shpeshherë e ka përsëritur thënien në tefsirin dhe në veprat e tij se rruga e davetit (thirrjes) nuk është e shtruar me lule e trëndafila, përkundrazi...

Pushteti egjiptian i akuzonte **Vëllezërit Muslimanë** si terroristë për shkak të pjesëmarrjes së tyre në kryengritjen⁴⁸ e korrikut në të cilën morën pjesë oficerë⁴⁹ dhe ushtarakë. Konflikti filloi për shkak të një vendimi të datës 13.01.1954 të nxjerrë nga Qeveria dhe kështu, pushteti i diktatorit, kriminelit Xhamal Abdul-Naser filloi me të madhe t’i burgosë **Vëllezërit** nëpër burgjet egjiptiane. Në fillim, menjëherë burgosi 1000 pjestarë prej tyre dhe me procedurë të përshpejtuar disa prej tyre u dënuan me vdekje. Në mesin e tyre ishin edhe dy figura eminente dijetarësh: Prof. Hasan El-Hudajbi dhe prof.

⁴⁷ Muhamed Teufik Berekat, “**Sejjid Kutub, Hulusatu hayatih**”; fq.17; Muhamed Husejn Abdalbaki, “**Sejjid Kutub, Hajatuhu ve edebuhu**”; fq.45; “**Risale ila ed-da’vat el-islamijje**”; fq. 17-18.

⁴⁸ **Vëllezërit Muslimanë** nuk besonin në revolucion, as në dobitë e as në rezultatet e tij për shkak të përvojës së Egjiptit me çështje të tilla të dështuara; Më gjerësisht shih: “**Mexhmua’tu resailil imam El-Benna**”; Darush-shihab, pa vit botimi fq. 170. Edhe në revolucionin e të rinjëve musliman në Egjipt me 25.01.2011, **Vëllezërit Musliman** nuk kanë qenë prej organizatorëve të këtij revolucioni, sepse në parimet e **Vëllezërve Musliman** nuk parashihet revolucioni, grushteti apo ndryshimi nga lartë, por te ata qëndron ideja dhe parimi i ndryshimit pozitiv nga baza, populli, edukimi dhe pregaditja e tyre në çdo aspekt. Në (*pranverën e revolucioneve arabe*) deshti Allahu xh.sh, që pas largimit të diktatorit Mubarak përsëri të fitojnë **Vëllezërit Muslimane** në zgjedhjet e Egjiptit pas 80 vitesh vuajtje, burgosje, ekzekutime. Me këtë deklaratë ua bëjmë me dije tërë atyre (*arabe apo të tjerë*) që akuzojnë pa dije dhe pa argumente **Vëllezërit Musliman**; kinse ata kanë qenë organizatorë të revolucionit të 25.01.2011!

⁴⁹ “**Risale ila d-da’vetil-islamijeti**”; fq. 21.

Abdulkadir Audeh⁵⁰ (Zoti i mëshiroftë!). Të tjerët u dënuan me vdekje, kurse prof. El-Hudejbi u dënua me burg të rëndë dhe të përjetshëm.⁵¹

Në mesin e shumë të burgosurve ndodhej edhe profesor Sejjid Kutubi, i cili akuzohej si pjesëmarrës në lëvizjen për grushtet, ndaj dhe për këtë shkak, në vitin 1954 e dënuan me pesëmbëdhjetë vjet burgim. Gjatë viteve të burgimit, ai përjetoj shumë maltretime dhe vuajtje të mëdha, por megjithatë, edhe përkundër vuajtjeve dhe mynxyrave, arriti të shkruaj disa punime islame brenda në burg dhe as edhe për një çast të vetëm nuk e ndërpreu thirrjen (da'vetin) e as shkrimin aty brenda. Nga punimet e tij të shkruara në burg, janë: **“Hadhed-din”**; **“El-Mustakbil li hadhed-din”**; si dhe plotësoi tefsirin e tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”**, duke bërë korrektimin e vëllimeve që ishin botuar para rënies së tij në burg.⁵²

Pas amnestisë së tij, në maj të vitit 1964, për shkaqe shëndetësore dhe pas intervenimit të Presidentit irakian Abdus-Selam Arif⁵³ për lirimin e tij,

⁵⁰ Profesori dhe shehidi Abdulkadir Audeh ishte avokat eminent dhe njëri nga njohësit më të mirë të ligjit dhe Sheriatit në Egjipt. Ishte njëri prej udhëheqësve të **Vëllezërve Muslimanë**. Kur presidenti kriminel egjiptian Xhemal Abdul-Naseri urdhëroi konstituimin e gjykatës së Popullit, ky shehid shkruajti një kritikë kundër kësaj gjykate. Aty, mes tjerash, theksohet se kryetari i gjykatës Xhemal Salim ka kërkuar prej disa të akuzuarëve që t'i lexojnë mbrapsht ajetet kur'anore. Ai u gjykua për vrasjen e Xhemal Salimit në vitin 1954 dhe u dënua me varrje së bashku me disa shokë të tjerë. Nga veprat e tij theksojmë: **“El-islam u ve evda’una es-sijasijetu”**; **“Exh-xheshr’ul-xhemaj el-islamij muharemen bil-kanun el-vad’ij”**; **“El-Malu vel-hulum fil-Islam”**; **“El-islam bejne xhehli ebnaihi dhe axhzi ulemaihi”**; etj. Zereкли El-A’elam, vëll. 4, fq. 42.

⁵¹ **“Sejjid Kutub, Hajatuhu ve edebuhu”**; fq. 47.

⁵² **“Sejjid Kutub, Hajatuhu ve edebuhu”**; fq. 47.

⁵³ Abdus-Selam ose Muhamed Abdus-Selam ibn Muhamed Arif u lind në Bagdad në një familje tregtarësh në vitin 1921, ndërsa vdiq në vitin 1966. Ishte Presidenti i dytë i Republikës së Irakut. Hyri në ushtri në vitin 1938 dhe punoi si oficer në njësitin e tanksave në vitin 1939. Mori pjesë në betejën e Xheninit në Palestinë në vitin 1948. Diplomoi në Akademinë Ushtarake në vitin 1951 dhe iu bashkangjiti njësive britanike në Gjermaninë Perëndimore në vitin 1956. Pastaj u bë asistent i komandantit të forcave të armatosura të Irakut në vitin 1958, mirëpo ra në konflikt me Abdul-Kerim Kasimin (Presidenti i parë i Republikës së Irakut) dhe u gjykua me vdekje. U burgos dy vjet e tre muaj, pastaj u lirua dhe u bë shumë aktiv. Më 8 shkurt të vitit 1963, pas ekzekutimit të Abdul-Kerim Kasimit, Komiteti Revolucionar e zgjodhi President të Republikës së Irakut në të njëjtën ditë. E udhëhoqi Irakun tre vjet e dy muaj në një gjendje jostabile për shkak të kryengritjes së kurdëve dhe për shkak të mosmarrëveshjeve të tij me Partinë e Ringjalljes. Bëri marrëveshje me Xhemal Abdul-Naserin për bashkimin në mes Egjiptit dhe Irakut por nuk realizuan gjë. Kishte qëllime islame, sjellje të mirë, ishte i devotshëm, nuk pinte alkool dhe nuk bënte padrejtësi. Përderisa kthehej nga Kazablanka (Maroku), helikopteri me të cilin udhëtonte u dogj dhe shpërtheu, ndaj së këndejmi lindën edhe dyshimet dhe dilemat: helikopteri u dogj vetvetiu apo u gjuajt?! Ditari i tij u botua pas vdekjes. Zereкли E’alam, vëll. 4, fq. 9.

Sejjid Kutubi përsëri u rikthye në burg, ngase shkroi një letër kundër sigurimit të shtetit pas burgosjes së vëllait të tij Muhamed Kutub më 30.07.1965, dhe kështu, gjykata e dënoi me vdekje, bashkë me shtatë **Vëllezër** të tij. Ai u ekzekutua në mëngjesin e ditës së hënë më 29.08.1966 (Xhemadel-ula, 1386 hixhri).

Pas vendimit të gjykatës, profesor Sejjid Kutubi e shprehu fjalën e tij të njohur: ***“Falënderoj Allahun! Pesëmbëdhjetë vjet punova për të rënë dëshmor!”***⁵⁴

Dhe kështu, në këtë mënyrë u shua një yll nga yjet e ndritur e të shkëlqyeshëm nga jeta, ndërsa bota islame humbi një dijetar, një thirrës të famshëm dhe një mendimtar më të spikatur për shkak se tha:

“Allahu është Zoti Ynë! Duhet të aplikojmë metodën e Tij, duhet të praktikojmë Sheriatin e Tij dhe duhet të marrim pushtetin nga njerëzit dhe t’ia mbështesim Zotit të njerëzve për të ecur me fjalët e Zotit të Madhërishëm: *“A thua mos po kërkojnë gjykimin e kohës së injorancës, po për një popull të bindshëm që beson, a ka gjykim më i mirë se ai i Allahut?”* (El-Maide, 50).

Zoti e përfshiu me Mëshirën e Tij të Madhe dhe e bëri banor të Xhennetit të Tij të gjerë!

Zoti na bëftë si ai dhe prej atyre të cilët nuk i frikohen askujt përveç Zotit dhe na mbroftë nga dëmtimi i të keqit! Amin!

Zoti padyshim që këtë vlerë ia jep atij që dëshiron dhe Ai ka vlerë të madhe!

Mendoj se këto të dhëna mjaftojnë rreth profesor Sejjid Kutubit, ngase nuk kemi hapësirë të mjaftueshme për t’u zgjeruar më shumë.

Lus Zotin e Madhërishëm që autorin e këtyre veprave ta shpërblejë me shpërblime të mira, duke uruar: Zoti na bëftë sikur ai dhe të na bekojë në jetën

⁵⁴ “**Sejjid Kutub, Hajatuhu ve edebuhu** “; fq. 47-48; “**Sejjid Kutub, sire dhatije**”; fq. 49; Zejneb El-Gazali, “**Ejjam min Hajati**”; fq. 182.

tonë dhe në kohërat tona dhe të na bëjë prej atyre që i shërbejnë kësaj feje si materialisht ashtu edhe me ide! Amin!

PJESA E DYTË

I. Parimet, rregullat dhe mendimet e Sejjid Kutubit

Ska dyshim se ai që e kalon pjesën dërmuese të jetës dhe të kohës së tij me libra të shkencës duke hulumtuar të vërtetën, duke përhapur ide, duke korrigjuar gabime dhe duke sqaruar çështje të ndryshme, atëherë është aksiomatike se idetë e subjektit të këtij hulumtimi do të ndryshojnë dhe do të zhvillohen për shkak të lindjes së problemeve të reja, ideve të ndryshme, të mendimeve kontradiktore, të afërta apo të largëta, të cilat mund të jenë të vogla apo të mëdhaja.

Në këtë rrugë duhet të ecë muslimani në përgjithësi dhe thirrësi në veçanti. Natyrisht se kjo nuk dëmton personalitetin e hulumtuesit ose të thirrësit, përkundrazi, e ngre lartë autoritetin dhe vlerën e tij, argumenton aftësinë e tij të madhe mentale dhe analitike...

Pikërisht kjo ndodhi me profesor Sejjid Kutubin, ngase ai kaloi nëpër disa periudha të ndryshme mendimesh... Në jetën e tij, në thirrjen (da'vetin) e tij dhe në shkrimet e tij vërehet një kërcim i çuditshëm. Disa që shkruan për profesor Sejjid Kutubin u përpoqën të ndiejnë periudhat e tij (Zoti e mëshiroftë!) në disa sosh.

Disa prej tyre thonin se profesor Sejjid Kutubi ka kaluar nëpër tri periudha të mendimeve,⁵⁵ ndërsa disa të tjerë e ndajten në më shumë periudha.⁵⁶ Prof. Muhamed Teufik Berekat thotë:

“Në përgjithësi, jetën e tij mund ta ndajmë në tre periudha:

- 1. Periudha para përcaktimit të tij doktrinor islamik;**
- 2. Periudha e Islamit; dhe:**
- 3. Periudha e përgjithshme e Islamit.**

Dy periudhat e fundit deri diku janë të ndërlidhura njëra me tjetrën.

Perudha e dytë ishte rezultat i periudhës së parë dhe periudha e parë nuk ishte kategorikisht e ndarë nga periudha e posaçme doktrimore islame.”⁵⁷

⁵⁵ Muhamed Teufik Berekat, “**Sejjid Kutub-hulusatu hajatihi - menhexhu fil-hareketi ven-nakdul muvexhxehe ilejhi**”; fq. 11.

⁵⁶ Prof. Dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidi, “**Esh-shehid El-Hajj**”; fq. 132.

⁵⁷ Muhamed Teufik Berekat, “**Sejjid Kutub, Halasatu hajatihi**”; fq. 11.

Nuk ka dyshim se kjo është një e vërtetë!

Ai që i lexon veprat e profesor Sejjid Kutubit, fare qartë do ta vërejtë këtë gjë. Mirëpo, kjo nuk nënkupton se kjo periudhë ka qenë larg Islamit, përkundrazi...⁵⁸

Periudha e dytë e jetës së tij dallohet me veprën e tij **“El-adaletul-ixhtimaijjetu fil Islam”** dhe kjo vërteton pedestalin e tij intelektual në këtë periudhë. Pastaj vijon periudha e tretë dhe e fundit e tij, e cila karakterizohet me bashkangjitjen e tij lëvizjes së **Vëllezërve Muslimanë**, me transformimin e mendimeve të tij të para burgosjes, pas rënies në burg, si dhe evoluimin që pësoi më pas, gjegjësisht përforcimin në rrugën e Islamit. Në burg filloi të shkruaj librat: **“Fi dhilâlil-Kur’an”**, **“Hadhed-din”**, **“El-Mustekbel li hadhad-din”** etj.

Në bazë të njohurive rreth këtyre periudhave, kuptojmë se rikthimi i Sejjid Kutubit në Islam ka qenë vendim dhe udhëzim nga Zoti i Madhërishëm. Kjo nuk e ulë autoritetin e tij, ashtu siç mendojnë disa njerëz, të cilët thonë se gjoja profesor Sejjid Kutubi ka pasur njohuri të pakta islame në bazë të periudhave që ka kaluar! Përkundrazi...

I. Parimet, rregullat dhe mendimet e Sejjid Kutubit

Profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) kishte shkathtësi të mëdha intelektuale dhe kishte njohuri të thella rreth kësaj feje, rreth natyrës së saj, si dhe rreth mënyrës së aplikimit të saj dhe rreth praktikimit të Sheriatit në bazë të realitetit në tokë.

Në bazë të leximit dhe analizave të disa veprave dhe librave të shehidit (Zoti e mëshiroftë!), qartë vërehet se të kuptuarit e tij mbështetej në disa parime, elemente e teori, dhe se këto parime e elemente ishin themel i disa premisave, rregullave e parimeve të të kuptuarit të tij të mëvonshëm.

Koncepti i tij ishte rezultat i vizioneve të posaçme dhe i mendimeve precize të tij, si dhe i studimit të thellë dhe i analizave precize të teksteve të

⁵⁸ **“Sejjid Kutub, Esh-shehid el-hajj”**; fq. 133; **“Mudhekkiratu Sa’ihin fish sharkil-arabij”**; En-Nedevij; fq. 189; u përpoqa ta gjej librin e fundit por, për fat të keq, nuk arrita...

Sheriatit (Kur'anit e Sunnetit). Profesor Sejjid Kutubi jetoi gjatë nën hijen e Kur'anit dhe një gjë të tillë, edhe vetë ai nuk ngurron ta potencon disa herë në tefsirin e tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”** dhe në librat e tij të tjerë.

Plotësisht jemi të vetëdijshëm se megjithatë është e pamundshme të theksohen apo të rezimohen të gjitha parimet, premiset e elementet e tilla në këtë hyrje të këtij disertacioni shkencor që ka faqe dhe tema të kufizuara...

Qëllimi kryesor dhe synimi themelor i eksperimentit të këtyre premisave, parimeve e teorive të këtij personaliteti të njohur e të spikatur islam, është lehtësimi dhe përgatitja e rrugës për lexuesin fisnik, me qëllim që ta kuptoj metodën e të menduarit të këtij njeriu dhe kooperimin e tij me tekstet e kësaj feje të pastër nëpërmjet studimit të metodës së tij dhe të kuptuarit të tij të ajeteve kur'anore që flasin për da'vetin (thirrjen) në suren **“El En'amë”**.

Hulumtuesi i sistematizon këto parime, premisa e teori në pika e në tituj anësorë për të sqaruar idenë e këtij njeriu dhe për të treguar horizontet e tij, gjithnjë duke u mbështetur në librat dhe në veprat e tij, posaçërisht në komentimin e sures **“El En'amë”**. Pra, në këtë mënyrë do t'i sqarojmë parimet dhe rregullat e tilla duke u mbështetur në besnikërinë shkencore, parimet metodologjike-shkencore dhe në studimin objektiv.

Këtu e shoh të udhës që patjetër të potencoj dhe të sqaroj një gjë shumë të rëndësishme për lexuesin e respektuar, gjegjësisht faktin se profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) dallohet me një metodë të posaçme e unike, të cilën madje edhe vetë ai e quan **“metoda dinamike”**.

Prof. dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidi (Zoti e ruajtë!), në librin e tij **“Mefatih lit-te'amu meal Kur'anil-Kerim”**, thotë:

“Ne deklarojmë atë që e deklaronte profesori ynë Sejjid Kutubi rreth teorisë së re për të kuptuar, komentuar e menduar rreth Kur'anit, gjegjësisht teorinë e tefsirit dinamik, dhe ne e konsiderojmë profesor Sejjid Kutubin avangardist të kësaj teorie, sqarues të parimeve të saj dhe themelues të shkollës së tefsirit dinamik që e ofron Kur'anin si organizëm të gjallë që ndikon në muslimanët bashkëkohorë. Zoti i Madhërishëm ia

*dhuroi çelësin origjinal dinamik për të çelur thesarin e Kur'anit dhe t'ia ofrojë njerëzve në "Dhilâl."*⁵⁹

Këtë kuptim e ka sqaruar edhe vetë profesor Sejjid Kutubi në shumë vende të shkrimeve të tij. P.sh. në librin e tij: **"Hasaisul-tesavuril-islamij"** - vëll. I, thotë:

"Çështja e kuptimit të domethënive dhe inspirimeve të Kur'anit nuk ka të bëjë me të kuptuarit e fjalëve dhe teksteve të tij, dhe kjo nuk nënkupton komentimin e Kur'anit (ashtu siç e kemi traditë të themi). Kjo çështje nuk e nënkupton këtë gjë, por nënkupton përgatitjen e shpirtit, ndjenjave, perceptimitt, përvojave. Këtu duhet të ketë ndërlidhje në mes ndjenjave, perceptimeve e përvojave dhe në mes Shpalljes së tij, gjegjësisht me jetën e muslimanëve që ka të bëjë me xhiadin, epshet dhe njerëzit. Xhiadi kundër epsheve dhe xhiadi kundër kundërshtarëve, përpjekje dhe sakrificë, frikë e fuqi, rënie e ngritje, atmosfera e Mekës dhe fillimi i da'vetit, numri i vogël dhe dobësia, i huaj në mes njerëzve...

Pastaj vijon periudha e Medinës, e cila ka të bëjë me atmosferën e formimit të parë të shoqërisë islame në mes intrigave, hipokrizisë, sistemimit e përpjekjeve, atmosfera e Bedrit, Uhudit, Hendekut, Hudejbijes, Çlirimit të Mekkes, Hunejnit, Tebukut... Atmosfera e formimit të Ummetit islam, formimit të sistemit shoqëror dhe kontaktet e gjalla në mes ndjenjave, interesave e parimeve në fillim të formimit dhe gjatë sistemimit.

*Në këtë atmosferë u shpallën ajetet e Kur'anit me plotë gjallëri, realitet e energji. Fjalët dhe tekstet kishin domethënie e inspirime. Në një atmosferë të tillë filloi një jetë e re për muslimanët, ngase Kur'ani ua hapte njerëzve zemrat me thesarin e tij, ua dhuronte fshehtësitë e tij, u jepte aromë të bukur e freskuese si dhe u siguronte qetësi e dritë..."*⁶⁰

⁵⁹ Salah Abdul-Fetah El-Halidi, **"Mefatih lit-te'amul me'al Kur'an"**; Damask, Darul-Alem, bot. 2; 1994, fq. 57-58.

⁶⁰ Sejjid Kutub, **"Hasaisut-tesavuril-Islami"**; vëll. 1, Bejrut, Darush-shuruk, pa vitë botimi, fq. 7-8. Shiko poashtu tefsirin e tij **"Fi dhilâlil-Kur'an"**; vëll. 3, fq. 1559-1560.

Parimet e profesor Sejjid Kutubit të cilat i thekson prof. dr. Salah Abdul-Fetah Halidi, janë:

“1. Pajisja e tij me sasi të madhe të ndjenjave, përceptimeve e përjetimeve gjatë studimit të teksteve të Kur’anit, të cilat gjithnjë e inspironin atë; dhe:

2. Përjetimi dhe rikthimi i ndjenjave të tij si në kohën kur u shpall Kur’ani në Mekë dhe në Medinë, gjë kjo që dukshëm bëri për të kuptuar sa më mirë ndikimin e Kur’anit dhe efektin e tij...”⁶¹

Për të kuptuar më mirë këto dy parime, dmth, rëndesinë e aspektit praktik të Islamit, gjegjësisht t’i përjetojmë më për së afërmi idetë e profesor Sejjid Kutubit, në vijim do t’i citojmë vetë fjalët e Sejjid Kutubit, i cili në librin e tij të njohur **“Me’alim fit-tarik”** thotë:

”Por Islami nuk mund të luaj rolin e vet përveç nëse personifikohet në shoqëri apo në Ummet. Njerëzimi nuk dëgjon (posaçërisht në këtë kohë), nëse nuk e sheh besimin konkretisht në jetë të dukshme, pra në formë konkrete. Si zakonisht, njerëzimi nuk i përgjigjet metodës së lexuar ose të dëgjuar, por i përgjigjet metodës së gjallë dinamike të konkretizuar në një grup njerëzish dhe të aplikuar (përkthyer) në një realitet që syri e sheh dhe dora e prek dhe që intelektet i vërejnë gjurmët e tij. Shkruhet libër për Islamin, jepet ligjeratë në xhami, klasë apo shesh, jepet film për të propaganduar Islamin, dërgohet delegacion nga Universiteti i Az’harit ose nga ndonjë institucion tjetër në çdo vend... E gjithë kjo nuk bën pasurimin e një shoqërie të vogël që jeton në një vend të tokës sipas metodës së Islamit dhe për Islamin, e as që personifikimi me karakteristikat e kësaj metode e pasqyron formën e jetës në Islam...”⁶²

Nga ajo që u tha më parë vërehet qartë se profesor Sejjid Kutubi ka përfituar nga përvoja e tij e begatë në thirrje (da’vet). Fjala pa vepra nuk vlenë kurrjë! Islami nuk është shpallur vetëm për të deponuar mendime e leksione

⁶¹ Salah Abdul-Fetah El-Halidi, **“Mefatih-lit-te’amul meal-Kur’an”**; fq. 5.

⁶² Sejjid Kutub, **“Me’alim fit-tarik”**; fq. 4-5.

pa aplikim praktik. Profesor Sejjid Kutubi e konfirmon këtë ide edhe një herë duke thënë:

“Natyra e metodës dinamike islame është t’u përshtatë këtë realitet njerëzor me lëvizje të përshtatshme e superiore në periudha të ndryshme dhe me metoda ripërtëruese...”⁶³

Pra, në këtë mënyrë arrijmë në një të vërtetë aksiomatike, gjegjësisht në të vërtetën se jobesimtarët janë një trup dhe një organ dhe kështu, Islami patjetër të realizohet në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën formë si në brendi ashtu edhe jashtë, bile duhet të formojmë epërsi mbi ta, nëse dëshirojmë të realizojmë atë që e dëshiron Zoti i Madhërishtëm, si dhe të korrin fitore e sukses mbi ta.⁶⁴

3. Vështrimet e tij rreth lëvizjes së sahabëve në atmosferën e Mekës dhe Medinës me Kur’anin, kooperimi i tyre dhe jeta e tyre me të...⁶⁵

Nëse i përcjellim me vëmendje këto mendime të Sejjid Kutubit, do ta kuptojmë parimin e fuqishëm e të fortë, mbi të cilin është mbështetur teoria e tij dinamike, në këtë kontekst, prof. Sejjid Kutubi thotë:

“Natyra e kësaj feje refuzon deponimin e njohurive të ftohta në frigoriferët e mendjeve të stagnuara! Dituria në këtë fê shndërrohet menjëherë në “lëvizje” ngase në të kundërtën nuk do t’i takojë kësaj feje!”⁶⁶

E tërë kjo përforcon çështjen e theksuar më parë, gjegjësisht faktin se nuk do të ketë progres në qoftë se nuk do t’i praktikojmë këto ajete kur’anore tërësisht në jetën tonë. Profesor Sejjid Kutubi e mbështet këtë teori me argument shumë të fortë, duke thënë se parimet e Sheriatit nuk janë shpallur në periudhën mekase për t’u deponuar në mendime e pastaj të praktikohen në Medinë. Në këtë kontekst, ai (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Parimet e Sheriatit zbritën në Medinë si lëvizje për shoqërinë islame që u formua atje, dhe asnjë parim nuk u shpall në Mekë për t’u deponuar

⁶³ “Fi dhilâlil-Kur’an”; vëll. 10, fq. 170.

⁶⁴ Po aty; vëll. 10, fq. 170.

⁶⁵ Prof. dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidi, “Mefatihul lit-te’amil me’al-Kur’an”; fq. 59.

⁶⁶ Po aty; fq. 59.

(si njohuri abstrakte) derisa të vijojë koha e aplikimit të tyre në Medinë. “L’art pour l’art”- nuk është metodë islame, ngase në Islam njohuria është për lëvizje, dituria për punë dhe besimi për jetë.”⁶⁷

Ky parim vërehet edhe më qartë në shqyrtimet e profesor Sejjid Kutubit që u bën ajeteve kur’anore të periudhës mekase dhe të urtësisë nga periudha e gjatë e shpalljes në këtë periudhë...

“Thirrësit në fenë e Zotit dhe në formimin e sistemit ku aplikohet kjo fê në jetën e realtë duhet të qëndrojnë gjatë përpara këtij fenomeni të madh që ka të bëjë me shpalljen e Kur’anit në Mekë plotë trembëdhjetë vjet, kështu që të konfirmojnë burimin pa u përqendruar në detaje rreth sistemit dhe ligjeve që e rregullojnë shoqërinë islame.”⁶⁸

Biografia e pastër profetike ka luajtur një rol të rëndësishëm në formimin e njohurive fetare të profesor Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!), përkatësisht në të kuptuarit e tij të kësaj feje. Ajo ishte pikënisje themelore e metodës së tij për të sqaruar të vërtetat fetare.

4. Përqendrimi i tij në synimet themelore të Kur’anit dhe metoda e tij realiste dinamike që njëherit është edhe jetë e Ummetit islam dhe zbritja e ajeteve kur’anore në bazë të realitetit serioz të gjallë e orvatës...⁶⁹

Nëse i analizojmë këto fjalë të Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!) do të vërejmë qartë se profesor Sejjid Kutubi është përqendruar në disa synime themelore të Kur’anit Fisnik më shumë se në synimet tjera. Me një fjalë, ai është përqendruar shumë në besimin që është bazë e jetës së njeriut, si dhe e ka sqaruar domethënien e hyjnisë dhe adhurimit të vërtetë të Zotit të Madhërishëm, Pushtetin Absolut të Zotit të Madhërishëm në gjëra të imta e të mëdhaja të jetës sonë, pozitën e njeriut në këtë ekzistencë dhe fundin e tij, etj.

Profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

⁶⁷ Sejjid Kutub, “**Mukav-vimatut-tesav-vuril-Islami**”; Bejrut, “Darush-Shuruk”; bot. 4. 1993, fq. 24-23; Sejjid Kutub, “**Hasaisut-tesav-vuril-Islami ve mukav-vimatuhu**”; Bejrut, “Darush-Shuruk”; bot. 8, 1983, fq. 10.

⁶⁸ Sejjid Kutub, “**Me’alim fit-tarik**”; fq. 21-22.

⁶⁹ “**Mefatihut-te’amuli meal-Kur’ani**”; fq. 59.

*“Sa herë që theksohet besimi në Kur’an apo besimtarët, paralel theksohet edhe vepra (puna) që është aplikim i besimit. Kjo çështje nuk ka të bëjë vetëm me ndjenjat, por ka të bëjë edhe me lëvizjen e formimit të realitetit në bazë të konceptit islamik të jetës.”*⁷⁰, sqaron vlerën e madhe të besimit te Zoti i Madhërishtëm duke thënë:

*“Vlera e besimit është shumë e madhe te Zoti, dhe gjëja më e vlefshme për shije në tregun e Zotit është padyshim besimi. Fitorja më e mirë është ngadhënjimi i shpirtit ndaj materies, i besimit ndaj dhimbjes, i besimit ndaj fitnes... Në këtë natyrë shpirtit e besimtarëve kanë ngadhënjyer frikën e dhimbjes, aspektet e tokës dhe jetës si dhe fitnen për hir të mbarë njerëzimit të të gjitha vendeve. Ja, ky është ngadhënjimi!”*⁷¹

Ajo që argumenton se ai (Zoti e mëshiroftë!) vërtetë përqendrohet në çështjet themelore të kësaj feje e jo në çështjet sekondare, është fakti se ai nuk e ndante fenë nga jeta e kësaj bote, ngase metoda hyjnore nuk lejon përkufizimin e fesë vetëm në simbolet adhuruese, mbrenda mureve të xhamisë apo vetëm në jetën private, dhe në këtë kontekst, ai thotë:

*“Natyra e kësaj feje nuk lejon që të ndahet nga kjo botë dhe natyra e metodës hyjnore nuk lejon që të përqendrohem vetëm te ndarja shpirtërore në moralin edukativ, gjegjësisht në simbolet adhuruese, ose në ndonjë shtyllë të ngushtë prej shtyllave të jetës njerëzore, e që quhet “e drejta civile”.*⁷²

Zot! Sa i madh është sot numri i thirrësve dhe i dijetarëve që kërkojnë mosndarjen e fesë nga kjo botë dhe sa i madh është numri i pushtetarëve që e refuzojnë këtë dhe nuk dëshirojnë ta bëjnë një gjë të tillë?! Pushteti dhe fuqia i takojnë vetëm Allahut Zotit të Lartësuar e të Madhërishtëm!

Prof. Muhammed Husejn Fedlull-llah thotë:

“Islami erdhi për të përhapur da’vetin (thirrjen) dhe për të ndërtuar shtetin; Ai u përqendrua në këtë jetë për ta përhapur thirrjen në Zot në tokë,

⁷⁰ Sejjid Kutub, “Hasaisut-tesav-vuril-Islami”; fq. 182-183.

⁷¹ Sejjid Kutub, “Me’alim fit-tarik”; fq. 170-171.

⁷² Sejjid Kutub, “Me’alim fit-tarik”; fq. 170-171.

të përjetojë dhe të ndërtojë mbi këtë bazë sistematizimin dhe rregullimin e jetës e ta mbroj njeriun nga të këqijat e vetvetes dhe nga të këqijat e njerëzve të tjerë, dhe për këtë shkak natyra e shtetit në Islam nuk lejon të ndahet nga shpirti i da'vetit, por i bën të harmonizuar ashtu siç është uji me shtratin e vet.

Pra, profesor Sejjid Kutubi nuk ka qenë diçka risi në mesin e thirrësve që ftonin në realizimin e unifikimit të këtij parimi “S’ka ndarje të fesë nga shteti e as të shtetit nga feja.”⁷³

Kishte edhe vëllezër të tjerë të tij që thirrnin në këtë qëllim të lartë e sublim! Pra, le t’i hedhim një shikim kësaj çështjeje të rëndësishme, për të cilën ishte i përqendruar edhe vetë profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!).

Ai i jepte përparësi fesë së Zotit në çdo gjë dhe mbronte qëndrimin se feja e Zotit nuk mund të jetë as e nënshtuar e as e udhëhequr, por gjithmonë duhet të jetë vendosëse, udhëheqëse e gjithëpërfshirëse mbi çdo gjë, dhe në këtë kontekst, ai (Zoti e mëshiroftë!) thotë: *“Në asnjë mënyrë feja e Zotit nuk pranon diçka tjetër përveç të jetë zotëri që sundon, i fuqishëm dhe i kapshëm, fisnik e bujar, sundues e jo i sunduar, udhëheqës e jo i udhëhequr!”⁷⁴*

Arsyeja kryesore që e shtyu Sejjid Kutubin të mbështetet në këto çështje themelore është interesi ynë në këtë botë dhe në botën tjetër, ngase vetëm në këtë mënyrë do ta praktikonim Islamin e vërtetë (të mirfilltë) e jo diçka tjetër. Ai (Zoti e mëshiroftë!) thotë: *“Ne jemi të obliguar që ta realizojmë këtë metodë duke filluar prej vetvetes sonë dhe gjetiu.”*

Ai poashtu thotë: *“Ne jemi të obliguar që ta realizojmë këtë metodë për arsye që kanë të bëjnë me vetë metodën! Kjo metodë është e vetmja që*

⁷³ Muhamed Husejn Fedlull-llah, **“Uslubud-da'veti fil-Kur'an”**; (Ez-Zehra lit-tiba'ati ven-neshri); bot. 4; 1982, fq. 32.

⁷⁴ Sejjid Kutub, **“El-Mustekbel li hadhad-din”**; El-it-tihad al-alemij el-islamij lil-munadh-dhamat et-tul-labijjeti, 1988, botimi i 1 i Fejsulit, fq. 93; Kapitulli **“El-uluhijje vel-ubudijje”** në **“Mukav-vimat ut -tesavuril-Islami”**; fq: 84, 107, 109, 132, 134.

realizon nderin e njeriut, i jep liri të vërtetë dhe e bën të adhurojë vetëm Zotin.”⁷⁵

5. Roli i tij praktik xhihadist dhe përvoja e tij e gjallë e da’vetit (thirrja) - në disa aspekte për shumëçka i ngjanin përvojës së sahabëve fisnikë, posaçërisht atmosferës së hershme të periudhës në Mekë, gjegjësisht lëvizja praktike me Kur’anin, preokupimi i njerëzve tërësisht me të, në raste të rënda e mjerime, e pastaj kthimi dhe animi kah Kur’ani për të gjetur përgjigjen e qartë dhe ilaçin shërues...”⁷⁶

Dhe kështu, për të pa rolin, qëndrimin, stoicizmin dhe besimin në Zot të profesor Sejjid Kutubit si dhe shpresën e tij të madhe se ardhmëria do të jetë e besimtarëve të sinqertë dhe rizgjimit islamik në çdo kohë e çdo vend, ne obligohemi, së pari, të qëndrojmë fortë dhe të jemi këmbëngulës, të mos dorëzohemi para padrejtesisë së madhe që u bëhet muslimanëve, dhe të marrim shembull në sahabet e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)

Në këtë kontekst, ai (Zoti e mëshiroftë) thotë:

“Nuk duhet të hyjë dyshimi në zemrat tona nga sulmet e ashpra që i godasin pionierët e ringjalljes islame në çdo vend, e as nga parimet gjigante mbi të cilat bazohet qytetërimi materialist. Nuk është vendimtare madhëria e të gabuarës e as fuqia e sulmeve që e godasin Islamin, por vendimtare është rezistenca kundër sulmeve të tilla që e godasin Islamin e të vërtetës dhe...Ne nuk jemi të vetëm ngase kemi bazën e instiktit, instiktin e Universit, fuqinë, superioritetin.”⁷⁷

Këtu vërehet qartë fuqia e sinqeritetit të prof. Sejjid Kutubit, argumenti i tij i fortë, mbështetja e tij në Zotin e Madhërishëm për çdo të mirë dhe çdo të keqe, mbështetja e tij vetëm në Librin e Zotit të cilit nuk mund t’i vijë ndonjë e keqe as nga para e as nga pas...

Çdo thirrës, nëse dëshiron që fjala e tij të ketë ndikim të madh e aktiv, duhet patjetër të furnizohet me këtë cilësi dhe me këtë moral që ka burimin thell në brendinë e ajeteve Kur’anore. Profesor Sejjid Kutubi thotë:

⁷⁵ Po aty. fq.16.

⁷⁶ Salah Abdul-Fetah El-Halidi, “Mefatih lit-te’amul me’al Kur’an”; fq. 59.

⁷⁷ Sejjid Kutub, “El- Mustekbel li hadhed-din”; fq. 116-117; “Hasaisut-tesavuril-Islami”; kapitulli: “Eth-thebat”, fq. 87.

“Këtë të vërtetë e nxjerrim nga shoqërimi i gjatë me këtë Kur’an si dhe nga shoqërimi i gjatë me zbërthimin e problemeve të njerëzve dhe me aktivitetin e gjatë individual në shkrime...”⁷⁸

“Kur’ani nuk kaloi trembëdhjetë vite të plota për të ndërtuar besimin për shkak se u shpall për herë të parë. Jo, asnjëherë!! Sikur të dëshironte Zoti, do ta shpallte këtë Kur’an menjëherë dhe pastaj do t’i linte sahabët që ta studionin trembëdhjetë vjet, ose më pak apo më shumë-derisa të kuptonin “teorinë islame”, por Zoti dëshironte diçka tjetër, gjegjësisht Ai dëshironte një metodë të posaçme unike. Ai dëshironte formimin e shoqërisë, lëvizjen e besimit si dhe formimin e besimit me shoqëri e lëvizje. Ai dëshironte që besimi të jetë realitet aktiv i shoqërisë! Kjo është pasqyra e besimit! Zoti i Madhërishëm e dinte se shpirtërat dhe shoqëritë nuk ndërtohen për një ditë e për një natë...”⁷⁹

Profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) përfitoi nga përvoja e sahabëve gjatë leximit të Kur’anit dhe nga mënyra e bashkëpunimit të tyre me të. Ata (sahabët e ndershëm) e lexonin Kur’anin për ta mësuar dhe për ta aplikuar e jo për t’u kënaqur nga leximi, dhe në këtë kontekst, profesori (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Metoda e mësimit për praktikim e veprim e formoi gjeneratën e parë, ndërsa metoda e mësimit për studim e kënaqësi i prodhoi gjeneratat e mëvonshme.”⁸⁰

Pra, nga e gjithë kjo mund të themi se patjër duhet t’i kthehemi biografisë së selefët të mirë e të bekuar (**selefus-salih**) që t’i zgjidhim krizat tona intelektuale, psiqike e sociale, si dhe të mësojmë prej tyre se si ata e kanë lexuar Kur’anin dhe si e kanë kuptuar dhe e kanë merituar ndihmën e tij, ngase sot shumica e muslimanëve e kanë keqkuptuar leximin e Kur’anit Fisnik dhe mënyrën e kooperimit me të, ndaj dhe mu për këtë shkak edhe çështja e tyre është në flakë...

⁷⁸ Sejjid Kutub, “**Mukavimatut-tesavuril-Islami**”; pjesa e dytë, fq. 24,25, Bejrut, Darush-Shuruk, bot. 4, 1993; Sejjid Kutub, “**Hasaisut-tesavuril-Islami**”; Bejrut, Darush-Shuruk, bot. 8, 1983, fq. 10.

⁷⁹ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâlil-Kur’an**”; vëll.7, fq. 89-90; “**Me’alim-fit-tarik**”; fq. 38-39.

⁸⁰ Sejjid Kutub, “**Me’alim fit-tarik**”; fq. 19.

6. Vërejtja e tij se formimi i njeriut në Kur'an mbështetet në parimin e mendimit e besimit, apo mbështetet në besim dhe që aty fillon. Sjellja dhe lëvizjet e tij praktike janë fryt natyror për regullimin e këtij aspekti apo parim ideologjik ose besimor...”⁸¹

Për të kuptuar vërtetësinë e këtyre fjalëve dhe se ai vërtetë e kishte kuptuar këtë gjë, do të duhet që t’i analizojmë derisa të bëhet mendimi i tij edhe më i qartë. Njeriu nuk formohet e as nuk ka për t’u formuar në baza të pasurisë, autoritetit, pozitës apo nderit, por ne obligohemi që të përmirësojmë besimin dhe mendimin e tij, e pastaj të mbështetemi në parime të tjera të jetës së tij.

Profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Formimi shpirtëror, shoqëror e politik, që u mbështet në këtë metodë të lartë e unike dhe që zgjati vetëm një shekull, në realitet gjysëm shekulli, sfidoi të gjitha peripecitë, të gjitha armiqtë dhe të gjitha sulmet e ashpra kundër tij më shumë se një mijë vjet, bile këto parime akoma kanë mundësi të ringjallin gjeneratën e re nëse i pranojnë...”⁸²

Profesor Sejjid Kutubi vazhdon dhe sqaron nevojën e njerëzve dhe të njerëzimit për Zotin e Madhërisëm:

“Metodë e jetës së realtë njerëzore me të gjitha parimet e saj...Metodë që përmban konceptin e besimit e që sqaron natyrën e ekzistencës, përcakton pozitën e njeriut në këtë ekzistencë, ashtu siç e përcakton qëllimin e ekzistencës së tij njerëzore, përmban sisteme e organizime, si sistemi i moralit dhe i parimeve në të cilat mbështetet, pushtetin, sistemin politik dhe karakteristikat e tij, parimet e sistemit shoqëror, filosofinë e sistemit ekonomik dhe problemet e tij, sistemin ndërkombëtar, marrëdhëniet e lidhjet...”⁸³

“Kjo është një uri i një lloji tjetër, gjegjësisht uri kah besimi me një fuqi më të madhe të njeriut, kah bota që është më e lartë se ana materiale e kësaj jete të botës, kah ndërlidhja në mes ndjenjave të njeriut dhe realitetit të tij. Në mes njerëzisë që kontrollon ndjenjat e tij dhe Sheriatit që

⁸¹ Adnan Muhamed Zerzur, “Med’hal ilat-tefsir ve ulumihî”; Damask, Darul-Kalem, bot. 1, 1995, fq. 267.

⁸² Sejjid Kutub, “Hadhed-din”; Bejrut, Darush-Shuruk, fq. 36-37.

⁸³ Sejjid Kutub, “El- Mustekbel li hadhed-din”; fq. 3.

kontrollon jetën e tij, në mes metodës së lëvizjes individuale dhe metodës së lëvizjes kozmologjike rreth tij, kah Zoti Një, prej të Cilit e merr sheriatin e zemrës së tij dhe sheriatin e shoqërisë së tij në të njëjtën mënyrë!”⁸⁴

Ai i sqaron arsyet dhe zbërthen domosdoshmërinë e kësaj urie për këtë besim duke thënë:

“Rregull e metodës hyjnore që buron nga dituria e jo nga injoranca, nga përkryerja e jo nga mangësia, nga fuqia e jo nga dobësia, nga urtësia e jo nga epshi dhe mbështetet në parimin: “Nxjerrja e njerëzve nga adhurimi i robërve në adhurimin e Zotit e jo të dikujt tjetër!”⁸⁵

Nga parimet që unë i zbulova gjatë studimit të metodës së tij (të *Sejjid Kutubit vërej. e përkth.*) në të kuptuarit e ajeteve të da’ves në Zotin e Madhërishëm, janë:

1. Arritja e tij në bindje të prerë e kategorike se të gjithë njerëzit drejtohen kah humbja nëse nuk e praktikojnë Sheriatin e Zotit të Madhërishëm. Njerëzit në këtë kohë mund t’i përmirësojë ajo që i ka përmirësuar gjeneratat e para në fillim; dhe:

2. Ai (Zoti e mëshiroftë!) karakterizohej me trimëri të madhe dhe me besim të madh dhe për këtë shkak nuk i jepte fare rëndësi jetës së kësaj bote dhe para syve të tij, ajo ishte e vogël dhe e shëmtuar. Kështu ai nuk i frikësohej askujt përveç Zotit të Madhërishëm, dhe kjo vërehet qartë në veprat dhe në metodën e tij.

Pas pasqyrimit dhe zberthimit të teksteve të shehidit (Zoti e mëshiroftë!), mendoj se për lexuesin e respektuar u bënë të qarta disa nga parimet dhe elementet e mendimit të këtij thirrësi: P.sh.: si i arriti këto mendime, në bazë të cilave parime ia drejtoi thirrjet Ummitit islam në përgjithësi dhe thirrësve, hoxhallarëve e dijetarëve që janë bartës të flamurit të Islamit në veçanti. Ai iu drejtohej atyre që të jenë të kujdesshëm me

⁸⁴ Po aty, fq. 68-69; Shih kapitullin: “**Uluhije ve ubudijje**” në veprën “**Mukav-vimat at-tesavuril-Islami**”; fq. 101; Sejjid Kutub, “**Nahve muxhtema’in Islamijjin**”; fq. 29.

⁸⁵ Po aty, fq. 8; Shih kapitullin: “**Er-rebbanijje**” në librin “**Hasaisut-tesavuril-Islami ve mukav-vimatuhu**”; fq. 43; Shih hyrjen e librit: “**Nahve muxhteme’in Islamijjin**”; fq. 5-134; Shih kapitullin: “**Tijhun ve rukam**” në librin “**Hasaisut-tarikil-Islami**”; fq. 22.

Kur'anin Fisnik të cilin Zoti e dërgoi si udhëzues dhe mëshirë për të gjithë njerëzit.

Tani, pas sqarimit dhe shpjegimit të parimeve dhe mendimeve të këtij dijetari, gjithsesi se më lehtë do ta kuptojmë tefsirin e tij të Kur'anit Fisnik në mënyrë të përgjithshme, pastaj nxjerrjen dhe konkludimin e metodës së tij në të kuptuarit e tij të ajeteve të da'vetit (thirrjes) në Kur'anin Fisnik në mënyrë të posaçme, ku do ta shohim me poshte ne kapitullin qe vijon.

PJESA E TRETË

I. Metoda e profesor Sejjid Kutubit në tefsirin e tij

Këtu, në këtë vend ia vlen të theksohen disa fjalë miradie nga disa dijetarë bashkëkohorë rreth tefsirit të tij dhe karakteristikave të përgjithshme që ai (Zoti e mëshiroftë!) ka përdorur në tefsirin e tij në përgjithësi dhe më pas rreth metodës së tij në të kuptuarit e ajeteve të da'vetit (thirrjes) në veçanti.

Qëllimi kryesor i paraqitjes së kësaj metode në mënyrë përmbledhëse është pasqyrimi i metodës dhe mendimeve të këtij dijetari në përgjithësi, ngase kjo vepër do të jetë në hyrje në të kuptuarit e këtij thirrësi dhe në metodën e tij të vërtetë gjatë zbërthimit të ajeteve të da'vetit në Kur'anin Fisnik, posaçërisht në suren “**El En'amë**”.

1. Përskrimi i profesor Shejh Menna'ë El-Kattan-it (Zoti e mëshiroftë!).

Shejh Menna'ë El-Kattani (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Nga burrat e kësaj shoqërie u dallua një dijetar i spikatur dhe një mendimtar i shkëlqyeshëm shehid Sejjid Kutubi, i cili e zbërtheu mendimin islamik dhe i zbuloi konceptet e tij të vërtetë në mënyrë të qartë e të madhërueshme. Ky njeri ra dëshmor në rrugë të besimit të tij duke lënë pas vete gjurmë intelektuale, e në rradhë të parë librin e tij në tefsirin e Kur'anit që titullohet: “Fi dhilâl-Kur'an”. Ky tefsir vërtetë është pasuri e madhe intelektuale e shoqërore, për të cilin padyshim ka nevojë çdo musliman bashkëkohor.”⁸⁶

2. Përshkrimi i prof. dr. Adnan Muhammed Zarzur-it (Zoti e ruajtë!)

Profesor Adnani thotë:

“Dhilâli” ishte argument praktik i shkruar (nëse mund të shprehem kështu) për shoqërinë islame dhe për mbarë Ummetin islam. Nuk është argument kulturor i shkencave të tefsirit të Kur'anit ose të kulturës islame si fikhu, antologjia dialektike...! Tefsiri i tij i Fjalëve të Zotit është si një plan i përshtatshëm ujitës, i cili me lejen e Zotit - qetë ecën nëpër fusha e vende të mbjellura dhe avash-avash i nxjerr bimët e mira, gjegjësisht bën që të lindin gjeneratat e Kur'anit në formën më të mirë të mundshme, si ripërsëritje e gjeneratës pasë të Kur'anit. (Nëse dëshiron Zoti!)”

⁸⁶ Menna'ë El-Kattan, “**Mebahith fi ulumil-Kur'an**”; Kajro, “Daru garib lit-tiba'ati ven-neshri”; bot. 5, 1981, fq. 334-335.

Kush e di? Mbase kjo deklaratë e shejh Adnan Muhammed Zarzur-it rreth këtij tefsiri ka të bëjë me atë që e theksuam më herët dhe faktin që Sejjid Kutubi këtë tefsir e shkroi dy herë: një herë me ngjyrën e dijetarit dhe një herë me gjakun e shehidit... Shejh Adnani përfundon:

“Shkronjat e Kur’anit janë dritë...

Gjaku i sehidëve është dritë...

“Fi dhilâlil-Kur’an” është dritë mbi dritë...”⁸⁷

3. Përshkrimi i prof. dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidit (Zoti e ruajtë!)

Prof. dr. Halidi thotë:

“Fi dhilâlil-Kur’an” është tefsiri më i rëndësishëm rreth Librit të Zotit të Madhërishëm, ngase paraqet një frymë të re në tefsir për të tjerët më pas, parim për shkollën e re unike e të dalluar në tefsir, gjegjësisht shkollën e tefsirit dinamik. Sejjid Kutubi me “Dhilâl-in” e tij është udhëheqësi i mendimit islam bashkëkohorë dhe ripërtrirësi i tematikave elementare në tefsir...”⁸⁸

A ndërsa unë lirisht mund të them: *se esenca e tefsirit të profesor Sejjid Kutubit është shkruajtur me ngjyrë të lapsit dhe të gjakut të tij, pastaj është mbjellur në dheun e besimit, është ujitur me ujë të sinqeritetit dhe është ritur nën kujdesjen e trimërise. Allahu di më mirë.*

Tefsiri i profesor Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!), i cili titullohet **“Fi dhilâlil-Kur’an”** karakterizohet me disa tipare e veçori. Sipas mendimit tim, ky është tefsiri më i rëndësishëm dhe burimi më i vlefshëm në këtë kohë nga aspekti i të kuptuarit bashkëkohorë të ajeteve dhe nga aspekti i ndërlidhjes së ngjarjeve të realta me tekstet kur’anore.

Për nga përmbajtja ky tefsir përmban një fshehtësi të padukshme, të çuditshme e atraktive si dhe ka një metodë ideale në nxjerrjen e mësimëve e leksioneve nga ajetet kur’anore për ta udhëzuar muslimanin thirrës dhe për ta

⁸⁷ Adnan Muhamed Zarzur, “Med-hal ila tefsiril Kur’an ve ulumihi”; fq. 261-270.

⁸⁸ Salah Abdul-Fetah El-Halidi, “Fi dhilâlil-Kur’an fil-mizan dirase ve takvim”; (Darul-menareti lin-neshri vet-tenzilë), Xhidde, Arabia Saudite, bot.1, 1986, fq. 5.

mësuar atë se si të përballohet me sfidat e kohës dhe të shoqërisë ku jeton. Kjo, në asnjë mënyrë nuk nënkupton nënçmimin e tefsireve tjera dhe askush nuk guxon të mendojë në këtë mënyrë, ngase secili tefsir ka vlerën dhe peshën e vet të posaçme...

Siç dihet, falë Zotit të Madhërishëm, merita më e madhe në këtë kohë i përket profesorit të njohur dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidit (Zoti e ruajtë!), ngase ai e studioi më detajisht dhe në mënyrë të përpiktë këtë tefsir dhe autorin e tij, për ta mbrojtur të vërtetën, diturinë dhe dijetarët.

Tani po kalojmë në tefsirin e profesor Sejjidit duke e studiuar për së afërmi. Shtrohet pyetja se çfarë janë tiparet dhe karakteristikat më kryesore të këtij tefsiri?

Karakteristikat e dukshme të këtij tefsiri janë:

- 1. Realizimi dhe serioziteti në hulumtim;**
- 2. Metodologjia selefiste (e të parëve të mirë selefus-salih);**
- 3. Sqarimi i rolit dhe i pozitës së njeriut;**
- 4. Njohuritë historike mbi shpalljen e Kur'anit;**
- 5. Sqarimi i kooperimit të sahabëve me Kur'anin;**
- 6. Korrektimi i mendimeve islame bashkëkohore dhe analiza e botës islame aktuale;**
- 7. Diskutimi i çështjeve të da'vetit dhe lëvizjes për t'u përballuar me sfidat materialiste injorante;**
- 8. Tefsiri estetik i formave artistike në Kur'an;⁸⁹ dhe:**
- 9. Analizat e shumta të ajeteve që kanë të bëjnë me besimin, ndriçimin e kuptimeve, sqarimin, rezultatet, parimet dhe analizat;⁹⁰**

Karakteristikat dhe tiparet e këtij tefsiri të cilat u theksuan më sipër, argumentojnë vlerën e librit “**Fi dhilâlil-Kur'an**” ngase, në këtë libër, autori flet për shumë çështje të ndryshme. Analizat e ndryshme qartë konfirmojnë se autori kishte dituri dhe njohuri të gjerë.

Përveç këtyre karakteristikave mund të theksojnë edhe disa të tjera si:

⁸⁹ “**Fi dhilâlil-Kur'an fil mizan**”; fq. 305-400.

⁹⁰ “**Med-hal ilat-tefsiri ve ulumil-Kur'an**”; fq. 267.

1. Mbështetja në të vërtetat e besimit islam dhe konsiderimi i tij si bazë dhe esencë për çdo gjë; dhe:

2. Ripërsëritja e qeshtjeve akaidologjike, dhe përforcimi i parimit të besimit dhe të pushtetit hyjnor derisa të përforcohet në zemrat e njerëzve, të cilat, nëse janë të shëndosha atëherë çdo gjë është e shëndoshë, e nëse ato (zemrat) janë të prishura, atëherë prishet çdo gjë...⁹¹

I. Metoda e profesor Sejjid Kutubit në tefsirin e tij

Gjatë studimit të autorit dhe të tefsirit të tij, si dhe të disa studiuesve që shkruajtën rreth metodës së tij, mund të përfitojmë këto rezultate rreth metodës dhe parimeve të Sejjid Kutubit gjatë komentimit të fjalëve të Zotit të Madhërishtëm:

Profesor Sejjid Kutubi së pari e thekson ajetin ose ajetet dhe më pas rrëfen për qëllimet e tyre, synimet dhe unitetin tematik të sures ose të personaliteteve të saj, dhe pastaj vazhdon të komentojë dhe të sqaroj në mënyrë të plotë e të detajshme, duke nxjerrë edhe mësimet e leksioneve.⁹²

Ai poashtu e thekson shkakun e zbritjes të ajetit, kuptohet nëse ai ekziston, dhe mbështetet në transmetimet e vërteta autentike. Gjithashtu, thekson mendimet e ndryshme të dijetarëve rreth kuptimit të ajetit, por pa e tepruar në të. Ai shkruan pak rreth hulumtimeve gjuhësore dhe pastaj tenton ngjalljen e vetëdijes, korrektimin e koncepteve dhe ndërlidhjen e Islamit me jetën.⁹³

Ai i thekson thëniet e filosofëve dhe i shqyrton idetë e tyre me argumente racionale, i refuzon dyshimet e tyre dhe sqaron pavlefshmërinë e metodës së tyre rreth çështjeve të besimit e monoteizmit (tevhidit).⁹⁴

⁹¹ Sejjid Kutub, “*Mukav-vimatut-tesavuril-Islami*”; kapitulli: “*Uluhijje ve ubudijje*”, fq. 41; Kapitulli: “*Hakikatul-uluhijje*”; fq. 81.

⁹² Prof. dr. Adnan Muhammed Zarzuri thekson se “*Sejjid Kutubit i përket ideja e unitetit tematik të sures kur’anore, qoftë ajo e gjatë apo e shkurtër dhe ky është i pari që e shqyrton këtë çështje*”; Më gjerësisht shih në: “*Med-hel ilat-tefsir ve ulumih*”; fq. 267.

⁹³ Menn’aë El-Kattan, “*Mebahith fi ulumil-Kur’an*”; fq. 334.

⁹⁴ Ndoshta kjo rrugë e saktë dhe e drejtë e Sejjid Kutubit gjatë tefsirit të ajeteve të Zotit ka qenë arsyeja kryesore dhe më e madhe e disa akuzave që janë bërë ndaj tij, nga ana e disa armiqëve të tij, gjoja se ai nuk i ka njohur “*çështjet e thella filosofike...*” Dr. Ahmed Salahuddin El-Musil-

Ai i sqaron dhe i analizon sistemet sociale e pozitive si komunizmin, marksizmin, demokracinë, kapitalizmin, me qëllim që të vërtetoj pavlefshmërinë e metodave të tilla pozitive. Ai i bën analiza politike e sociale qëndrimeve të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ndaj idhujtarëve, çifutëve dhe shkaqeve të hixhretit (shpërnguljes).

Ai nuk nguron në përdorimin e fjalëve të rënda e thumbuese kundër jobsimtarëve dhe hipokritëve, si p.sh.: *inorantë, të verbër, të degjeneruar* etj.⁹⁵

Ai nuk i thekson israilijatet në tefsirin e tij për shkak të mosekzistimit të transmetuesve autentikë, por edhe përkundër asaj se ishte tejet i kujdesshëm, përsëri vërejmë se, megjithatë, diçka ka arritur t'i ikë nga kujdesi...⁹⁶

li thotë: *"Por Kutubi, megjithatë nuk ka pasur njohuri të thella në filosofi, histori e shkencë, madje as në shkencat tradicionale. Edhe pse njohuritë e tij ishin të përgjithshme dhe të llojllojshme, Sejjid Kutubi nuk i ka dhënë Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ndonjë rol tjetër, përveç transmetimit të Shpalljes dhe kështu e zvogëlon gradën e tij në krahasim me kolumnistët, filosofët e juristët (fukahatë). Pra, ai ishte i varfër në njohuritë rreth profetësisë, përderisa dijetarët tjerë, bile edhe jomuslimanët, kishin mendim më të mirë ndaj pejgamberit se sa Sejjid Kutubi, dhe shumë mendime të Sejjid Kutubit janë të ngjashme me mendimet e filosofëve..."* Më gjerësisht shih në: "El-fikrul-islamij El-mu'asir"; "Studime e personalitete - Sejjid Kutub - studim komparativ i parimeve të usulistëve dhe reformatorëve"; të Dr. Ahmed Salahudin El-Musal-li, fq. 46-56, 57-152. Replika ime kundër këtij profesori dhe bashkëmendimtarëve të tij në mënyrë të thuktë mbështetet në dy aspekte:

1. Në Islam nuk ka shenjtërim të personave ose të qenieve, ashtu siç ekziston në disa fê tjera. Ne, në Islam nuk mund t'i japim Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) më shumë se ç'i ka dhënë vetë Zoti i Madhërishtëm. Ne nuk mund ta lartësojmë autoritetin e tij, ashtu siç e lartësuan të krishterët Isain, të birin e Merjemes. Pra, mendo rreth thënies hyjnore dhe do ta kuptosh këtë të vërtetë, kur Zoti i Madhërishtëm thotë: *"Thuaj: "Unë jam vetëm njeri, sikurse ju, mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti juaj..."* (El Kehf, 110). Të kuptuarit e Sejjid Kutubit rreth Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) ka qenë i mbështetur në këtë ajet dhe brenda limiteve të këtij ajeti dhe ky insha'Allah është edhe rezonimi i shëndoshë rreth pozitës së Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*). Ai është njeri, por është Shpallja që i vjen nga Zoti për njerëzit, ajo e cila e dallon nga të tjerët. Prof. Musal-lijë mund të jetë nën ndikimin e mendimeve të orientalistëve. Pas diplomimit në Universitetin e Az'harit, prof. Musal-lijë është ushqyer me idetë e tyre! Pastaj, është kthyer në Universitetin Amerikan në Liban për të ligjësuar, dhe tani, paramendo se çfarë ideshë do të ketë mundur të përfitojë atje...!?

2. Thënia e tij: *"Sejjidi s'ka qenë dijetarë"*-nenkupton se profesor Sejjidi është inorant!? Për të konfirmuar këto fjali ose këtë akuzë, sipas metodës shkencore, duhet të kemi fakte në bazë të rregullës shkencore: *"Nëse transmeton, vërteto transmetimin, dhe nëse tenton sjell argumentin!"* Për fat të keq, këtë nuk e gjejmë te profesori akademik El-Musal-li. Të gjitha këto akuza, megjithatë nuk kanë kurrfarë argumenti rreth gabimeve të Sejjid Kutubit, qoftë në lëmin e historisë, filosofisë apo në shkencat tjera. Më vjen keq, por dr. Ahmed Salahuddin El-Musal-li nuk ka kurrfarë argumenti për pohimet e tij, ndaj dhe fjala e tij bie poshtë dhe është e pa bazë (Zoti e di më së miri!).

⁹⁵ Sejjid Kutub, "Fi dhilâil-Kur'an"; vëll. 1. fq. 45.

⁹⁶ Po aty; fq. 45.

Ai përqendrohej në aspektin retorik dhe në simbiozën artistike të ajeteve⁹⁷ Ai, më së shumti transmeton nga komentatorët klasikë, siç janë Ibn Kethiri e Taberiu, por fare pa rënë nën ndikimin e tyre në tefsir dhe komentim.⁹⁸ Ndonjëherë bën ixhtihad dhe mbështetet në aspektin sipërfaqësor të tekstit dhe nuk del nga konteksti, një mënyrë e tillë e komentimit p.sh. qartë vërehet në tefsirin e ajetit të agjërimit.⁹⁹

Sejjid Kutubi ishte komentator moderativ, nuk anonte kah të tepruarit ekstremizmi, por as kah liberalët, të cilët i lehtësonin parimet e Zotit...Në tefsir bënte aplikimin e metodës së selefut të mirë (**selefus-salih**) dhe këtë gjë ai vetë e deklaronte shumë herë në tefsirin e tij.¹⁰⁰ Bënte preferimin e mendimeve në fikh dhe zgjidhte mendimin që mbështetej në argument të vërtetë, si p.sh. çështja e vazhdimësisë dhe njëpasnjshmëria në agjërimit.¹⁰¹

Ai flet edhe për shkencat bashkëkohore mjekësore, astronomike, fizike e kimike, por ishte shumë i kujdesshëm nga tefsiri shkencor i Kur'anit, gjegjësisht nga zbulimet e reja shkencore, sepse çështjet shkencore janë relative e të ndryshueshme, përderisa ajetet kur'anore kurrë nuk ndryshojnë, ndaj pikërisht për këtë shkak ishte shumë i kujdesshëm në këtë çështje.

Pra, nuk është ashtu siç trumbetonin zhurmshëm disa, se gjoja Sejjid Kutubi nuk e pranonte dhe e refuzonte tefsirin shkencor të ajeteve, qoftë kjo në përgjithësi, apo edhe në veçanti, përkundrazi...¹⁰² Në çështjet e besimit, ai i konfirmon Cilësitë e Zotit që theksohen në Kur'an, si jeta, fuqia etj.

Ai (Zoti e mëshiroftë!) bënte dallim në mes Kur'anit, gjegjësisht ajeteve të shpallura në Mekë dhe atyre në Medinë, ngase secila periudhë i kishte tematikat e posaçme, ndaj dhe nuk bënte ndonjë përzierje në mes tyre.¹⁰³

⁹⁷ Dr. Muhji Hilal Serhan Muslim Al-Xha'fer, "**Menahixhul mufessirin**"; (Darul-ma'rifeti), bot.1, 1980, fq. 268; "**Fi dhilâlil-Kur'an**"; vëll. 3; fq. 3598-3599.

⁹⁸ "**Med-hal ilel-tefsir ve ulumihi**"; fq. 269.

⁹⁹ "**Fi dhilâlil-Kur'an**"; vëll. 6; fq. 3598-3599.

¹⁰⁰ Po aty; vëll. 6; fq. 3560.

¹⁰¹ Po aty; vëll. 6; fq. 3560.

¹⁰² Po aty; vëll. 3; fq. 1216-1217; vëll. 6; fq. 3713-3714.

¹⁰³ Më hollësisht mbi metodën dhe mënyrën e Sejjid Kutubit në shkrimet e tij, shih literaturën vijuese: **1.**Fehd ibn Abdurrahman ibn Sulejman Er-Rumi, "**It-tixhahatut-tefsir fil-karnir-rabi' asher**"; vëll. 3; fq. 999; **2.** Salah Abdul-Fetah El-Halidi, "**Mefatih lit-te'amu me'al-Kur'an**"; **3.** Salah Abdul-Fetah El-Halidi, "**Fi dhilâlil-Kur'an fil mizan**"; kapitulli "**Simatudh-dhilâl**"; fq.19. **5.** Menna'ë El-Kattan,"**Mebahith fi ulumil-Kur'an**"; fq. 334; **6.** Adnan Muhamed Zarzur, "**Med-hal ilat-tefsir ve ulumihi**"; fq. 260-270.

Hulumtuesi (*Hajredin Hoxha, vërej. e përkth.*) përfundon fjalën e tij rreth metodës së profesor Sejjid Kutubit me theksimin e parimeve në të cilat mbështetej shehid Sejjid Kutubi gjatë tefsirit të tij të Fjalëve të Zotit të Madhërishtëm. Pra, ai (Zoti e mëshiroftë!) mbështetej në:

- 1. Metodën letrare;**
- 2. Përjetimin e tekstit kur'anor;**
- 3. Realizimin dhe dinamizmin; (ishte realistik dhe dinamik)**
- 4. Tefsirin estetik-artistik;**
- 5. Unitetin tematik;**
- 6. Inspirimin e tekstit pa paragjykime;**
- 7. Mosdetajizimin në çështjet e paqarta në Kur'an;**
- 8. Kujdesin nga israilijetet;**
- 9. Braktisjen e mosmarrëveshjeve juridike në çështjet e fikhut;**

dhe:

10. Distancimin nga thellimi në çështjet gjuhësore dhe kooperimi i tij me tekstin kur'anor.¹⁰⁴

Si studiues, jam i mendimit se mbështetja ime hulumtuese në këto parime, njëherit është edhe përgjigjja ime më e mirë e mundshme dhe e mjaftueshme kundrejt atyre që thanë e që, për fat të keq, vazhdojnë të thonë se libri “**Fi dhilâlil-Kur'an**” nuk është tefsir dhe autori i tij nuk është komentator...! O Zot! Ç'ironi!!

Pasha jetën time! Nëse këto nuk janë kushte dhe parime të komentatorit, atëherë çfarë janë?!

Nga parimet që arriti t'i zbërthen hulumtuesi, janë edhe këto dy:

1. Kapaciteti i tij për të shqyrtuar ajetet nga aspekte të ndryshme duke mos qenë fare nën ndikimin e komentatorëve të mëparshëm dhe atyre bashkëkohorë; dhe:

2. Besimi në vetvete dhe mos-hutimi i tij nga idetë e ndryshme, gjersa ishte duke formuar mendimin e tij;

¹⁰⁴ Më gjerësisht shih: Fehd ibn Abdurrahman ibn Sulejman Er-Rumi, “**It-tixhatut-tefsir fil-karnir-ab'asher**”; fq. 999-1000 dhe më tej.

Me ndihmën e Zotit, kaq pata mundësi të flas për **“Dhilâl-in”** dhe autorin e tij në këtë kapitull, por nuk ka asnjë fije dyshimi se ka edhe shumë gjëra për të sqaruar, por mundësitë tona këtu i kemi të kufizuara!

Të vërtetën Zoti e di më së miri!

KAPITULLI I TRETE:

III. Thirrja (da'veti) dhe metoda e saj nëpërmes sures “El El En'amë”

I.

1. Arsyet e zgjedhjes së sures “El El En’amë”.

Ekzistojnë disa arsye dhe shkaqe që ndikuan në mua për ta zgjedhur dhe studiuar suren e bekuar “**El El En’amë**”, e jo ndonjë sure tjetër të Kur’anit:

* Kjo sure e bekuar dhe e gjatë është prej sureve mekase, përveç disa ajeteve për të cilat thuhet se janë medinase. Suret mekase përgjithësisht karakterizohen nga ajo që, së pari mbështeten më shumë në aspektin e besimit dhe të da’vetit (thirrjes), se sa në aspektet tjera. Kjo sure plotësisht përputhet me përmbajtjen e këtij hulumtimi;

* Kjo sure e bekuar përmban në vete shumë argumente e fakte kozmologjike që konfirmojnë ekzistimin e Zotit të Madhërishëm, krijimin, fuqitë dhe kontrollimin e Tij të këtij Universi, çështjet e robërve (njerëzve), njerëzve dhe xhinëve, besimtarëve dhe jobesimtarëve... Shihni ajetet 11-14, 59-66, 95-99. Kjo ka lidhje të drejtpërdrejtë me tematikën e disertacionit që fokusohet në thirrjen në Zotin e Madhërishëm;

* Kjo sure e bekuar flet për popujt e kaluar (të mëhershëm), për gjendjen e tyre pas ardhjes së pejgamberëve dhe të dërguarëve në mesin e tyre nga Allahu i Madhërishëm, me qëllim të udhëzimit të njerëzve, dhe për qëndrimin që mbajtën popujt ndaj pejgamberëve dhe të dërguarve. Këtu flitet gjithashtu edhe për qëndrimin e pejgamberëve ndaj tyre. Edhe ne sot kemi shumë nevojë për një gjë të tillë, veçanërisht ne-thirrësit në fê. (ajetet 6-10);

* Në këtë sure të bekuar ka mënyra e metoda të shumta të da’vetit (thirrjes), metoda këto, për të cilat ka nevojë thirrësi musliman në këtë kohë. Pra, thirrësi sot ka nevojë për durim, qëndrim, llojllojshmëri të mënyrave të da’vetit, varësisht nga gjendja e popullit siç është p.sh.: argumentimi racional dhe orientimi i pyetjeve në drejtim të kundërshtarëve, për të argumentuar Fuqinë e Zotit dhe dominimin e Tij mbi çdo gjë (shihni ajetet 17-18, 33-34-35-38 dhe 50-52); dhe shërben për të marrë mësim të mirë, nga përjetimet e popujve të kaluar dhe nga fati (përfundimi) i tyre. Pastaj, këtu, në këtë sure, ekziston metoda, e cila të nxit dhe të tërheq vërejtjen, të urdhëron dhe ndalon,

që njëherit është edhe rikujtim për begatitë e Zotit si dhe metodë e sfidimit. Shihni ajetet 11-12-13, 46-47;

* Kjo sure e bekuar flet për Ithtarët e Librit (Ehli-Kitabë) dhe për fshehjen e njohurive të tyre mbi Pejgamberin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Kjo pikë është shumë e rëndësishme, posaçërisht për thirrësin në Zot gjatë dialogut të tij;

* Kjo sure e bekuar tregon në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë dallimin esencial dhe të plotë në mes muslimanëve dhe kriminelëve, dhe nga ky sqarim, thirrësit në fê duhet të kuptojnë se nuk kanë nevojë për kompleksitet gjatë da'vetit dhe thirrjes së tyre në fê. Rruga në mes muslimanëve dhe jobesimtarëve duhet të jetë haptazi e qartë dhe e ndarë. Shihni ajetet 55-57-68;

* Kjo sure e bekuar sqaron legjitimitetin e hulumtimit, kërkimin dhe argumentimin e të vërtetës dhe të saktës, gjë kjo që qartë vërehet në ngjarjen e Ibrahimit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kur e pa hënën natën dhe...! Shihni ajetet 74-79;

* Kjo sure e bekuar e ka theksuar numrin më të madh të peygamberëve dhe të dërguarëve të cilët kishin metoda të ndryshme, por një da'vet (thirrje) të përbashkët. Shihni ajetet 82-80. Kjo çështje është shumë e rëndësishme për thirrësit, të cilët duhet t'i unifikojnë qëllimet e tyre të da'vetit edhe pasi të kenë metoda dhe mënyra të ndryshme;

* Kjo sure e bekuar përmban parime të mëdha nga aspekti i besimit (imanit) dhe nga lëmi të ndryshme, si legjislacioni, marrëdhëniet juridike, ibadetet... Shihni ajetet 103-108-118-137-121-151-153. Kjo luan rol të rëndësishëm dhe tejet të madh në moralin dhe në kulturën e da'vetit dhe thirrësit;

* Kjo sure e bekuar sqaron adhurimet e periudhës së xhahilijetit (injurancës), të cilat i praktikonin idhujtarët e Mekës, gjegjësisht ndarjen e dhuratave dhe kurbaneve në emër të Zotit dhe të zotërave që e shoqëronin Atë. Nga kjo nënkuptohet se thirrësit duhet të kuptojnë dhe të studiojnë realitetin e shoqërisë, të cilën dëshirojnë ta thirrin. Shihni ajetet 136-140-146;

* Kjo sure e çmuar përmban në vete këshilla të rëndësishme, të cilat dijetarët i kanë quajtur **“dhjetë këshilla”**. Nuk e teproj nëse them se këto dhjetë këshilla konsiderohen si kulminacioni i legjislacionit islamik si p.sh.: Mosbërja shok Zotit të Madhërishëm, e që në thelb nënkupton monoteizmin (*tevhidin*) që njëherit është dhe mbetet baza e besimit të besimtarit; Sjellja e mirë ndaj prindërve. Edhe kjo është ndër veprat më të preferuara të Zotit të Madhërishëm; Mosmbytja e fëmijëve nga frika prej varfërisë, ngase Zoti i Madhërishëm është Furnizuesi dhe Përgjegjësi. Më gjerësisht shihni ajetet 151-153, të cilat i udhëzojnë dhe i mësojnë thirrësit se duhet të përqendrohen në çështjet parësore-prioritare fetare, në çështjet e rëndësishme në fê dhe pas kësaj të kthehen drejt çështjeve dytësore-sekondare;

* Hyrja e gjatë, e këndëshme dhe mjaft e rëndësishme, të cilën e shkroi profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!), konsiderohet si hyrje më e gjatë në tefsirin e tij të **“Fi dhilâlil-Kur’an.”** Në këtë hyrje, profesor Sejjid Kutubi sqaron rëndësinë e Kur’anit gjatë periudhës mekase dhe rolin e hapat që duhet të ndërmerren në formimin e shoqërisë islame. Kjo periudhë e gjatë duhet t’ju tregojë thirrësve se kanë nevojë për të kaluar kohë të gjatë me ata që i thirrin gjatë periudhës së formimit të besimit dhe mbjelljes së tij në zemra e intelektet (mendje). Ata nuk duhet të shpejtojnë në vjeljen e rezultatit, përpara se t’ua sqarojnë njerëzve fshehtësinë (sekretin) e ekzistimit të tyre, t’ua sqarojnë ekzistimin e këtij Universi rreth tyre, t’ju tregojnë atyre se kush janë ata, prej nga kanë ardhur, si kanë ardhur, për çka kanë ardhur dhe ku do të shkojnë në fund. Kështu shkruan profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) në tefsirin e tij;

* Mbase kjo ishte edhe arsyeja më e fortë që më nxiti ta studiojë këtë sure të bekuar, gjegjësisht sfidat me të cilat ballafaqohemi sot, ne thirrësit, ndaj dhe mu për këtë shkak obligohemi që t’i studiojmë suret e periudhës mekase, të cilat përmbajnë strategji të ndryshme të da’vetit, derisa të gjejmë shpëtim, rrugëdalje e alternativë nga ajo ku ne sot, fatkeqësisht jemi katandisur, pra në këto ditë të përçarjes, coptimit e mosmarrëveshjeve në mes thirrësve, si dhe në mos-sistematizimin e strategjisë së aktiviteteve të tyre dhe dobësinë e devijimit për shkak të injorancës së thirrësve dhe të atyre që punojnë në këtë lëmi...;

* Kjo sure e bekuar është përplotë qëndrime e dëshmi mbi jetën e arabëve gjatë periudhës së injorancës (*asaj paraislame, të xhahilijetit*). Injoranca (*xhahilijeti*) i sotshëm bashkëkohor dhe largimi i njerëzve nga Islami, haptazi apo fshehurazi, qofshin këta pushtetarë apo njerëz të rëndomtë, si individë apo si kolektivitet; nuk është fare më e lehtë se injoranca (*xhahilijeti*) i parë; dhe:

* Kjo sure e bekuar i ka vëndosur parimet kryesore për të ecur me lejen e Zotit, në drejtim të realizimit të metodës hyjnore dhe për ta nxjerrë e shpëtuar mbarë Ummetin nga injoranca që i ka kapluar bijtë dhe thirrësit e tij. Gjithsesi nuk ka dyshim se ka për të ardhur dita, kur besimtarët do të gëzohen nga aplikimi i Ligjit të Zotit dhe nga përjetimi i kësaj metode hyjnore në jetën e tyre të përditshme.

2. Tematikat e sures “El El En’amë”.

Kjo sure e bekuar i zbërthen disa çështje të rëndësishme nga jeta e individit, shoqërisë dhe Ummetit, si dhe kundërshton haptazi dhe në mënyrë reale: devijimin dhe pikëpamjet injorante (*xhahiliste*) të idhujtarëve ndaj të vërtetës së Zotit të Madhërisëm dhe Sheriatit të Tij. Tematika e besimit është bazë e kësaj sure, duke filluar prej fillimit e deri në mbarimin e saj.

Në këtë kontekst, profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Tematika e cila shqyrtohet prej fillimit e deri në mbarim-është ajo e besimit me të gjitha parimet dhe elementet e tij. Kjo sure ka të bëjë me shpirtin e përgjithshëm të njeriut, me ekzistencën në tërësi, me burimet e besimit dhe me çështjet inspiruese të fshehta apo të dukshme të kësaj ekzistence të madhe. Ajo e dërgoi njeriun në botën e qiejve e të tokës, i sheh errësirat dhe dritën, shikon diellin, hënën e yjet në xhennetet e rrethuara dhe të parrethuara në të cilat rrjedh uji i pastër; Kjo sure e dërgon njeriun edhe në popujt e zhdukur dhe ia tregon gjurmët e tyre që akoma janë të dukshme dhe evidente. Pastaj e dërgon në errësirat e tokës dhe të detit, në

fshehtësitë (misteret) e botës të padukshme dhe të shpirtit, ku i gjalli del nga i vdekuri dhe i vdekuri del nga i gjalli, në farën e mbjellur e që jeton në errësiat e mitrës. Poashtu e shëtit edhe nëpër botën e xhinëve dhe të njerëzve, të shpezëve dhe atë të egërsirave, të të parëve dhe të fundëve, të të vdekurve e të gjallëve, të engjëjve mbrojtës ditën dhe natën...”¹⁰⁵

Profesor Sejjid Kutubi kur flet rreth tematikave të kësaj sure, diku, në një vend tjetër, thotë:

“Kjo sure e shqyrton çështjen elementare të besimit, çështjen e hyjnisë së Zotit, i njofton robërit (njerëzit) me Zotin e tyre dhe u tregon se kush është Ai, cili është burimi i kësaj ekzistence, çfarë fshehtësie ka pas kësaj bote, cilët janë robërit, kush i solli në këtë ekzistencë, kush i krijoi, kush i ushqen, kush kujdeset për ta, kush i rregullon çështjet e tyre, kush i ndryshon zemrat dhe sytë e tyre, kush e ndryshon natën dhe ditën, kush bën fillimin dhe mbarimin e tyre (natës dhe ditës), prej çka i krijoi, sa do të jetojnë, ku do të shkojnë?”

Kjo jetë lulëzon kudo, dhe kush e mbolli atë brenda këtyre të vdekurve? Ky zbukurim i madh, ky syth që del, kjo farë që mbinë, ky yll vezullues, ky mëngjes që agon, kjo natë që kaplon, ky Univers që rrotullohet, pra, kush qëndron pas të gjitha këtyre gjërave? Kush?

Ç’ndodhë dhe çfarë fshehtësirash ka pas tërë këtyre gjërave? Këto popuj dhe këto shekuj (apo këto gjenerata që zhduken dhe ata që vijnë), që shkatërrohen e që lindin pasardhës... Kush i krijon pasardhësit dhe kush i shkatërrojnë? Pse krijon pasardhës? Pse shkatërrohen e zhduken? Çfarë fundi, çfarë llogarie dhe çfarë shpërblimi do të marrin pas shkatërrimit, sprovave dhe vdekjes?”¹⁰⁶

¹⁰⁵ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâlil-Kur’an**”; botoi: Darush-Shuruk, Bejrut; botimi i 11; botim i ri ligjor dhe i korrektuar, viti 1985, vëll. 2, fq. 1016.

¹⁰⁶ Po aty; vëll. 2, fq. 1016.

“Tematika kryesore, të cilën e shqyrton kjo sure është e ndërlidhur dhe nuk mund të ndahet në pjesë. Kjo sure është si valët, të cilat qëndrojnë njëra pas tjetrës...”¹⁰⁷

Në kontekst të kësaj teme, prof. dr. Vehbe Zuhajli thotë: *“Në përgjithësi, kjo sure përmbledh:*

* Konfirmimin e parimeve të besimit në bazë të bindjes, ndikimit, dialogut, diskutimit, përgjigjes dhe pyetjes;

* Konfirmimin e peygamberllëkut, mesazhit e shpalljes dhe kundërshtimin ndaj dyshimeve të idhujtarëve me argumente racionale e të kuptueshme;

* Sqarimin e parimeve të fesë, moralit, etikës shoqërore dhe të **“dhjetë këshillave”**;

* Fenë e cila që nga koha e Ademit deri te Muhammedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është po ajo fê e njëjtë në esencë, mënyra dhe në synime;

* Drejtësinë hyjnore që ka caktuar popuj dhe individ të ndryshëm dhe faktin që Zoti i shkatërron zullumqarët, u jep begati adhuruesëve dhe ia mundëson më të mirit që të trashëgojë në tokë...; dhe:

* Allahun i Cili është burimi i legjislacionit, hallallit dhe haramit.”¹⁰⁸

Prof. Rashid Imam Husejn, në librin e tij **“Kur’anijjat”**, kur flet për zbërthimin praktik të problemeve dhe të krizave të botës, thotë:

“Kjo sure është luftë kundër eksploatuesëve të të dobtëve. Shihi ajetet 119-161. Ndërsa ajeti 152: “Mos iu afroni pasurisë së jetimit derisa ai të arrijë pjekurinë” - tregon qartë se si të veprohet në punë të ndryshme juridike. Prej këtij ajeti nxirren leksione të rëndësishme, të cilat nëse

¹⁰⁷ Po aty, vëll. 2, fq. 1022.

¹⁰⁸ Vehbe Zuhajli, **“El-tefsirul-munir fl-akideti vesh-sheriati vel-menhexh”**; Darul-fikril-Mua’sir, Bejrut, Liban, bot. 1, 1991, vëll. 7, fq.126.

praktikohen me parimet dhe rregullat, do të drejtohej e tërë ekonomia e botës.”¹⁰⁹

Profesor Rashidi vazhdon më tej duke thënë:

“Shtetet e pasura nuk duhet t’i shfrytëzojnë shtetet e varfëra, përkundrazi, ato duhet t’u ndihmojnë që të shpëtojnë nga problemet dhe nga vështirësitë ekonomike. Të pasurit duhet t’u ndihmojnë të varfërve, dhe vetëm në këtë mënyrë nuk do të ketë arsytim e as argument për përhapjen e imoralitetit për shkak të papunësisë. Çdo orvatje duhet të ketë për qëllim lumturinë dhe progresin e njerëzimit e jo të vrapohet vetëm pas interesave personale. Nga analizimi i kësaj sureje të bekuar mund të konkludojmë se çdo leksion që merret prej saj, mjafton të zërthejë të gjitha problemet e botës.”¹¹⁰

Kjo i bëri mjaft përshtypje Bernard Shoit, i cili u shpreh:

“Unë gjithmonë fenë e Muhamedit e shihja në pedestal për shkak të vitalitetit të saj. Ajo është feja e vetme që posedon fuqi dhe potencial për t’u përballur me sfidat e ndryshme në periudha të ndryshme të jetës.”¹¹¹

Mendoj se çka u tha më lartë është e qartë dhe evidente në suren “El En’am”, dhe po që se ia hedhin një shikim nga afër do të bindemi plotësisht.

3. Emri dhe arsyeja

Për sa i përket fshehtësisë (urtësisë) së emrit të kësaj sureje, prof. dr. Vehbe Zuhajli, në tefsirin e tij thotë:

“Sureja “El El En’amë” është e gjashta me rradhë, dhe quhet kështu për shkak të theksimit të begative në të: “Ata i lënë All-llahut, prej

¹⁰⁹ Husain Rashid, “**Quranology-the practical solution to the World’s problems and Crisis**”; London, Ta-ha Publishers, Ltd, 1987, fq. 78-79.

¹¹⁰ Husain Rashid, “**Quranology-the practical solution to the World’s problems and Crisis**”; London, Ta-ha Publishers, Ltd, 1987, fq. 78-79.

¹¹¹ Po aty, fq. 78-79.

asaj që Ai i krijoi vetë, një pjesë të drithit dhe një pjesë të kafshëve dhe thonë: “Kjo është për All-llahun” sipas bindjes së tyre, “e kjo për shokët (zotërat tonë)”. Mirëpo, ajo që u dedikohet zotërave të tyre nuk arrin te All-llahu, ndërsa ajo që është për All-llahun u arrin zotërve të tyre. Sa keq gjykojnë ata!”(El El En’amë,136).

Me këtë nënkuptojmë shkakun e emrit të kësaj sureje, dmth;përmendja e kafshëve, sepse termi: El En’am ne gjuhën arabe përfshin këto lloje të kafshëve: Devet, Lopët dhe Delet.

A ndërsa rasti apo arsyeja është; se kjo ndërlidhet me konceptet e mëparshme, ngase të dy suret “El Ma’ide” dhe “El El En’amë” kundërshtojnë qëndrimet dhe besimet e Ithtarëve të Librit, i theksojnë ushqimet e ndaluara, prerjet si dhe kritikojnë ithtarët e xhahilijetit për shkak të ndalimit të tyre të disa begative për t’u afruar me idhujt e tyre...”¹¹²

Në këtë kontekst duhet thënë se edhe Shejhu dhe mendimtari i madh islam, zotëriu Muhamed Reshid Rida, ka një komentim të rëndësishëm në tefsirin e tij “El-Menar”, që mendoj se ia vlen ta theksoj këtu, me qëllim që të shohim edhe një fshehtësi nga fshehtësitë e shumta të kësaj sureje...

Ky mendimtar (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Kush e analizon rregullimin e sureve në mus-haf do të kuptojë se në sistematizimin e tyre ka fjali të gjata, mesatare dhe fjali të shkurtëra, me qëllim që të bëhen sa më të lehta për lexim dhe mësim përmendësh. Lexuesi fillon të lexojë e të transferohet nga më të gjatat drejt atyre më të shkurtërave dhe akoma më të shkurtërave¹¹³, kësisoji që të jetë më vital dhe të mos e kaplojë mërzia. Nga fundi mësohet përmendësh për shkak se është më e

¹¹² Vehbe Zuhajli, “Et-tefsir el-munijru fil-akideti vesh-sheri’a vel-munhexh”; vëll. 7, fq. 127; Më hollësisht shih librin: “Tefsir’ul Kur’an el-hakim esh-shehir bi tefsiril-menar” të Imam Muhamed Reshid Rida, Darul-Menar, 14, Shariul-insha, bot. 3, 1367 hixhri, vëll. 7, fq. 384-385.

¹¹³ Rreth shtatë të gjatave(sureve të gjata), Shejh Muhamed Reshid Rida thotë: “**Thuhet se e para e shtatë të gjatave është sureja “El-Bekare” ndërsa e fundit sureja “El Teube”. Suret qindëshe janë suret që kanë më shumë apo më pak se njëqind ajete, apo edhe më të shkurtëra. Ndër suret e shkurtëra është edhe sureja “El Fatiha” dhe quhet “e ndarë” - për shkak të ndarjeve të shumta në sure**”. Shih librin: “Tefsirul-Kur’an el-hakim esh-shehir bi tefsiril-menar”; të Sejjid Muhamed Reshid Rida, vëll. 7, fq. 287.

lehtë për fëmijët. Pasi që besimi është më prioritar në fê, çështja e Ithtarëve të Librit shqyrtohet më shumë se ajo e idhujtarëve, ndaj dhe për këtë shkak ata kritikohen më detajisht dhe më pas vijon me idhujtarët.

Një gjë e tillë vërehet më qartë në suren “El El En’amë” se sa në suret tjera, ngase kjo sure plotëson suren “El-Bekare” rreth çështjeve të besimit. Pastaj vijon sureja “El A’ërafë” e cila i sqaron ligjet e Zotit të Madhërishëm për pejgamberët e të dërguarit rreth çështjeve të popujve të tyre me ta. Kjo është argument për idhujtarët dhe Ithtarët e Librit. Sureja “El El En’amë” flet më hollësisht për Ibrahimin të cilit i përkasin arabët dhe Ithtarët e Librit në rrjedhë e fê.”¹¹⁴

4. Rreth vlerës së sures dhe zbritjes së saj

Rreth vlerës së kësaj sureje dijetarët, mufessirët transmetojnë disa mendime. Transmeton Sai’id ibn Jubeir nga Ibn Abbasi i cili thotë: *“Nëse dëshiron të mësosh mbi injorancën e arabëve, lexoje ajetin e 130 dhe me tej të sures “El El En’amë”:*

“S’ka dyshim se kanë dështuar keq ata që mbytën fëmijët e tyre nga mendjehetësia e pa kurrfarë dije dhe ata që duke i shpifur Zotit, shpallën të ndaluar atë që Zoti u kishte dhuruar. Ata kanë humbur rrugën e drejtë dhe prej fillimit nuk ishin në udhëzim.” (El En’amë, 140).”¹¹⁵

Poashtu transmeton Imam El Daremiu në **“Sunenin”** e tij, i cili thotë: *“Transmetohet nga Ebu Ne’imi, nga Ebu Zuhejr ibn Is’haku, nga Abdullah ibn Halife se Omeri ka thënë: “Pastaj “El El En’amë” është nga pjesët e zgjedhura të Kur’anit.”¹¹⁶*

Transmetohet nga ibn Ebu Shejbe se në veprën e tij ka thënë:

¹¹⁴ Po aty, fq. 287.

¹¹⁵ El Buhari, Ebu Abdullah Muhamed Ibn Ismail; **El Xhami’u El Musned El Sahih El Muhtasar min Umuri Resulilah va Sunanihi va Ejamihi**, Darul Ma’rifeh, Bierut, bot.2, 1999, No: 3524

¹¹⁶ Abdullah ibn Abdurrahman Ebu Muhamed Ed’duranij, **“Sunenu-d-Daremijj”**; Darul-kitabil-Arabij, Bejrut, bot.1; 1407 hixhri. vëll. 2, fq. 245; recenzoi Fevvat Ahmed Zumerli dhe Halid Es-Sebi El-ilami.

“Affani përcjell nga Hemmami, i cili thotë: ”Kam dëgjuar Ebu Imran El-Xheunin se ka thënë: “Na ka transmetuar Abdullah ibn Rebbahi, i cili ka thënë: “E kam dëgjuar Ka’bin duke thënë: **“Çelësi i Teuratit (fillimi i Teuratit) është çelësi i sures Hud.”**”¹¹⁷, dhe ne disa versione: Çelësi i Teuratit është fillimi i Suretu-l-Maide dhe fundi i saj(dhjetë keshillat e fundit).

Shejh Muhamed ibn Darijs në librin e tij **“Fedailul Kur’an”** thekson:

“Na kanë informuar Sulejman ibn Hazbi, Musa ibn Ismaili dhe Ali ibn Zejdi nga Jusuf ibn Mehrani, e ky nga Ibn Abbasi se ka thënë: **“Sureja “El El En’amë” tërësisht zbriti natën”**. Edhe Ali ibn Musa ka thënë: **“Zbriti natën në Mekë dhe rreth saj shtatëdhjetë mijë engjëj bënin tesbih.”**”¹¹⁸

Imam Muhamed ibn Darijsi thekson se Ismail ibn Ajjashi transmeton nga ibn Ebbani, ky nga Shehr ibn Hansheb se ka thënë: “E kam dëgjuar Ibn Abbasin duke thënë: **“E tërë sureja “El El En’amë” ka zbritur në Mekë dhe rreth saj ka pasur grup engjëjsh, të cilët bënin tesbih në mes qiellit e tokës, saqë e tërë toka dridhej nga jehona e tesbihut të tyre.”** Ibn Abbasi vazhdon e thotë: **“Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kur e dëgjoji tesbihun e tyre, u frikësua dhe ra në sexhde, derisa iu shpall sureja.”**”¹¹⁹

Në brendi të disa librave të tefsirit hasa në disa të dhëna mbi vlerën e sures **“El El En’amë”**, ndaj dhe në vijim do t’i theksoj për të pasur një pasqyrim sa më të plotë rreth vlerës së kësaj sureje të bekuar:

1. Imam Fahrudin Raziu (Zoti e mëshiroftë!), në tefsirin e tij “Tefsirul-Kebir” thotë:

“Sureja “El El En’amë” është mekase, përveç ajeteve 20-23-91-114-141-151-152-153.”

Imam Fahrudin Raziu transmeton nga Ibn Abbasi i cili thotë:

“Kjo sure është mekase dhe ka zbritur në tërësi nën përcjelljen e shtatëdhjetë mijë engjëjve. Engjëjt zbritën dhe i mbushën të dy brigjet e

¹¹⁷ Ebu Bekir Abdullah ibn Muhamed ibn Ebu Shuejbe El-Kafi, **“Musannef ibn Ebi Shejbe”**; “Mektebetul-Reshid”; Rijad, bot. 1, 1409 hixhri, recenzoi Kemal Jusuf El-Hut. Vëll. 6. fq. 152.

¹¹⁸ Ed-Daris ibn Muhamed, **“Fadailul-Kur’an”**; botoi: “El-Mektebetush-shamiletu”; vëll.1; fq. 206.

¹¹⁹ Po aty; vëll.1; fq. 206.

Mekës, ndërsa Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i thirri shkruesit dhe ata e shkruan atë natë, përveç gjashtë ajeteve, të cilat janë medinase.”¹²⁰

Transmetohet nga ibn El Munkedir, i cili thotë:

“Kur zbriti sureja “El El En’amë”, Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) bëri tesbih e tha: “Kjo sure u shoqërua me engjëj sa që e mbuluan tërë hapësirën!”¹²¹

Usulistët thonë se kjo sure dallohet me dy karakteristika:

“Ajo u shpall përnjëherë dhe shapalljen e saj e shoqëruan shtatëdhjetë mijë engjëj, tërë kjo, ngase përmban në vete argumente të monoteizmit (tevhidit), drejtësisë, pejgamberllëkut, ringjalljes, ç’vlerësimin e doktrinave të jobesimtarëve e ateistëve, gjë kjo që argumenton se shkenca e usulit ka vlerë dhe rëndësi të pakufizuar.”¹²²

Imam El Kurtubiu në tefsirin e tij, thotë:

“Sipas shumicës kjo sure është mekase” ; dhe më pas transmeton nga Ibn Abbasi i cili thotë: “Nëse dëshiron të mësosh mbi injorancën e arabëve, lexoje ajetin e 130 dhe me tej të sures “El El En’amë”:

“S’ka dyshim se kanë dështuar keq ata që mbytën fëmijët e tyre nga mendjelehtësia e pa kurrfarë dije dhe ata që duke i shpifur Zotit, shpallën të ndaluar atë që Zoti u kishte dhuruar. Ata kanë humbur rrugën e drejtë dhe prej fillimit nuk ishin në udhëzim.” (El En’amë, 140).¹²³

Imam El Sheukani thotë:

¹²⁰ Imam Fahrudin ibn El-lame Dijaud-din Umer Er-Razi, i njohur si Hatib Er-Razi. Është autor i tefsirit të njohur me titullin **“Tefsirur-Kebir”** ose **“Mefatihul-gajbi”**; botoi: “Darul-fikri lit-teba’ati ven-neshri”, Bejrut, Liban, bot. 3, 1985, vëll. 6,7. fq. 149.

¹²¹ Po aty; vëll. 6,7. fq. 149.

¹²² Po aty; vëll. 6,7. fq. 149.

¹²³ Ebu Abdullah Muhamed ibn Ahmed El-Ensar El-Kurtubi, **“El-xhami’u li ahkamil-Kur’an”**; botoi: “Darul-Kitab el-Arabi”; Bejrut, Liban; vëll. 6. fq. 382-383.

“Transmetohet nga Taberaniu, nga ibn Merdevejhi, Ebu Shejhi, El-Bejhekiu në **“Shu’ab”**, e ky nga Enesi i cili thotë se Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Sureja “El El En’amë” zbriti në shoqërim të engjëjve që kishin kapluar tërë hapësirën duke bërë tesbihe e duke e shenjtëruar”. Toka dridhej, ndërsa Muhammedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) vazhdimisht thoshte: Sub’hanallahi-l-Adhijm, Sub’hanallahi-l-Adhijm **“I pastër nga të metat është Zoti i Madhërishëm, i pastër nga të metat është Zoti i Madhërishëm...”**¹²⁴

5. Mënyrat e da’vetit (thirrjes) në Kur’anin Fisnik në përgjithësi

Kur’ani Fisnik është Libër i dhëzimit, retorikës dhe elokuencës. Ai u shpall nga Allahu, Zoti i botëve, e zbriti Shpirti Fisnik (engjëlli Xhibril) në zemrën e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në gjuhën e pastër arabe që të tërheq vërejtjen.

As retoristët arabë e as ata të huajë, nuk patën asnjë mundësi që të bëjnë një sure të vetme me dhjetë ajete, po madje as edhe një ajet të vetëm, të ngjashëm me ndonjë ajet të Kur’anit Fisnik...

Kur’ani Fisnik dallohet me stilin e lartë superior gjuhësor të elokuencës dhe retorikës, si dhe me një metodë atraktive e rrjedhshmëri të këndëshme. Mënyrat e da’vetit ndryshojnë varësisht nga mënyrat e tilla gjuhësore...

Prof. dr. Ahmed Ebu Zejdi i thekson disa metoda të da’vetit (thirrjes) në Kur’anin Fisnik dhe thotë:

¹²⁴ Muhamed ibn Ali ibn Muhamed Esh-Sheukani, **“Fet-hul-kadir el xhami’u bejner-rivajeti ved-dirajeti fi ilmit-tefsir”**; Vdiq në San’a të Jemenit, në vitin 1250 hixhri. Recensimin dhe nxjerrjen e haditheve të transmetuara në veprën e tij e bëri Dr. Abdurrahman Umejre me ndihmën e një komisioni nga **Akademia Shkencore në “Darul-Vekf’i”**; (Darul-Vef’i, lit-tiba’ati ven-neshri); vëll. 2, bot. 4, 1994; El-Mensurije, fq.1001-102. Më gjerësisht rreth vlerës së kësaj sureje shihe librin **“Tefsirush-Shejhi Muhamed Mutevel-li Esh-Sha’ravi”**; vëll. 6, fq.3491, 3492. Daru Ahbaril-Jeum; Gjithashtu shihe edhe tefsirin **“El-Menar”** të Shejh Muhamed Reshid Ridasë. Vëll. 7, fq. 281-287.

- Pjesa dërmuese e këtyre mënyrave përputhen me natyrat e ndryshme të njerëzve dhe kanë të bëjnë me urdhërin, ndalimin, urtësinë, këshillën, udhëzimin e fundit të popujve të kaluar, nxitjen për veprim dhe kërcënim, shembuj, rrëfime-tregime, fjalë të drejtuara intelektit etj.

Në vijim do të theksojmë disa detaje nga mënyrat e tilla me shembuj kur'anor:

- Metoda e urdhërit dhe ndalimit: ***“Falni namazin dhe jepni zeqatin!”*** (El-Bekare, 43).

- Metoda e dialogut bindës: ***“Populli i Nuhit i përgënjeshtroi të dërguarit, kur iu tha atyre vëllai i tyre Nuhu: “A nuk i frikësoheni (Zotit)? Unë për ju jam peygamber besnik!” Ata thonë: “E si të të besojmë ty, kur ty të besojmë më të ultit?”*** (Shuaraë, 105-106).

- Metoda e këshillave dhe udhëzimeve: ***“Një njeri besimtar nga familja e Faraonit, që e fshehte besimin e vet, tha “A doni ta mbytni një njeri vetëm pse thotë Zoti im është Allahu?”***

- Metoda e nxitjes dhe kërcënimit: ***“Dhe ngutuni (me punë që meritoni) në falje mëkatesh nga Zoti juaj dhe për në një Xhennet për të devotshmit.”*** (Ali-Imran, 133).

“E Xhehennemi është në pritë (në pusi), (ai) është vendstrehim i arrogantëve....” (Nebe'ë, 21-25).

- Metoda e përkujtimit për begatitë: ***“Allahu është Ai që i krijoi qiejt dhe tokën, dhe Ai lëshoi prej së larti ujë (shi), e me të nxjerr fruta si ushqim për ju, dhe për të mirën tuaj u vuri në shërbim anijet, të lundrojnë nëpër det me urdhrin e Tij, e në shërbimin tuaj i vuri edhe lumenjtë; Për ju i nënshtroi diellin dhe hënën që në mënyrë të zakonshme vazhdimisht udhëtojnë. Për ju përshtati edhe natën e ditën; Dhe Ai ju dha gjithatë që e kërkuat (që kërkoji nevoja juaj) dhe, edhe në qoftë se përpiqeni t'i numëroni të mirat e Allahut, nuk do të mund të arrini t'i përkufizoni (në numër). Vërtet, njeriu është i padrejtë dhe shumë përbuzës”.*** (Ibrahim, 32-34).

- Metoda e përkujtimit të përfundimit të popujve të mëparshëm:

“Themudi dhe Adi përgënjeshtroan tronditjen (Kijametin). Sa i përket Themudit, ata u shkatërruan me krisma të tmerrshme, ndërsa Adi është shkatërruar me një erë të fortë, të pakufishme.” (El Hakka, 4-10).

Kjo metodë ka të bëjë me përfundimin e popujve të mëhershëm.

- Metoda e këshillave: ***“ (Përkujtoja popullit tënd) kur Llukmani duke e këshilluar, birit të vet i tha: “O djali im, mos i përshkruaj Allahut shok sepse idhujtaria është padrejtësia më e madhe.”*** (Llukman, 13).

- Metoda e shembujve: ***“A nuk ke kuptuar se si Allahu bëri shembull: Fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë (në tokë) e degët e saj janë lartë.”*** (Ibrahim, 24).

- Metoda e fjalëve drejtuar intelektit: ***“Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve.”*** (El Bekare, 164).

- Metoda e pyetjeve: ***“A nuk është Allahu që mjafton robit të vet (Muhammedit)?”*** (Zumer, 36).

“A nuk udhëtuan ata nëpër tokë e të shohin se si ishte përfundimi i atyre që patën qenë para tyre?” (Gafir, 21).

- Metoda e sfidimit: ***“E në qoftë se keni dyshim në atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë sillnie ju një kaptinë të ngjashme si ai (Kur’ani) dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotërat) pos Allahut, nëse jeni të sigurtë (në thëniet tuaja se Kur’ani nuk është prej Zotit)?”*** (El-Bekare, 23-24).¹²⁵

¹²⁵ Shih: **“Minhaxhud-da’ijeti”**, Ahmed Ebu Zejd, libër mujor që botohet në Ligën Botërore Islame, viti XII, Rebiul-evvel, 1414 hixhri, nr. 135, fq. 116-126. temën: **“Rreth da’vetit”**. Shih poashtu Ahmed Faiz, **“Ed-da’vetu Fi dhilâlil-Kur’an”**; libër dyvëllimor, ku autori i ka përmbledhur të gjitha fjalimet mbi da’vetin dhe mënyrën e metodën e tij, të cilat Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) i ka theksuar në tefsirin e tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”**. Njëherit ky është edhe një ndër librat më të mirë rreth kësaj tematike që kam lexuar deri tani. Poashtu shih: **Reva’iu El Dhilal**, pregaditur nga: Ramij Umer Ba’Atijeh, Dar Vujuh Lin-neshri vet-Teuzi’e, bot.4, 2012, Rijad, Arabia Saudite; Poashtu shih: **Mekasidu El Sherij’ati El Islamijeti fi Fikri el Imam Sejjid Kutub**, nga: Nusejr Zervak; Darus

Pjesa dërmuese e këtyre mënyrave apo metodave të da'vetit janë theksuar në suren “**El El En'amë**” dhe së shpejti një gjë të tillë do ta shohim në këtë sure. Ne ishim të obliguar t'i shqyrtojmë këto metoda, me qëllim që të kuptojmë metodën e profesor Sejjid Kutubit në tefsirin e tij dhe mënyrën se si ai e ka bërë nxjerrjen, të pjesës më të madhe të metodave të tilla nga Kur'ani Fisnik.

II.

Karakteristikat dhe specifikat e metodës së Sejjid Kutubit në të kuptuarit e ajeteve të da'vetit.

Para se të flas për metodën e Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!) mendoj se duhet të shqyrtoj disa karakteristika të metodës së tij. Kush e lexon librin e tij “**Fi dhilâlil-Kur'an**” dhe kush jeton nën hijen e tij, gjithsesi do të vërej disa karakteristika e specifika të cilat janë:

- Analiza e realitetit politik vendor/lokal dhe atij botëror, raporti i tij me Kur'anin dhe pasqyrimi i tij në bazë të zbërthimit të tij;
- Përjetimi i rrethanave aktuale politike të botës islame si dhe i gjendjes së dobët fetare e sociale të Ummetit islam;
- Kundërshtimi i ligjeve pozitive njerëzore, siç janë komunizmi, marksizmi, demokracia, kapitalizmi;
- Konfirmimi i ndikimeve negative të kishës(Ortodokse&Katolike) në Ummetin islam;
- Sqarimi i projekteve dhe metodave cioniste të çifutëve dhe të krishterëve kryqtarë-misionarë;

Selam lin Neshri vet Teuzij', Kajro, bot.1, 2009; **Sejjid Kutub ba'de 43 A'men min Istish'hadih** - **Mexhmua'tun min El bahithijne**, Hyrje nga prof: Salah Abdu' Fettah Al Khalidi; pregaditur nga: l'sam Faris, Daru Ammar lin Neshri vet Teuzi'e, bot.1, 2010. (*Keto tre librat e fundit jane shume me rendesi te madhe per mendimin e profesor Sejjid Kutubit te botuar risht,i citova ketu une; autori i librit:Dr.Hfz. Hajredin Hoxha, me rastin e pregaditjes, recensimit dhe kontrollimit te librit te perkthyer nga arabshija per botim se shpejti in sha Allah. Doha-Katar, 02.02.2013*)

- Rënia e tij në ndikimin e metodës kur'anore dhe përqendrimi i tij në parimet dhe prioritetet, mbi të cilat mbështetej metoda kur'anore në da'vetin (thirrjen) në Zotin e Mëdhërishëm, si p.sh.: *çështja e besimit, monoteizmit, hyjnisë, pushtetit...*; dhe:

- Raporti i ajeteve me biografinë e Pejgamberit dhe me ngjarjet historike, qoftë me kontratat dhe marrëveshjet që u lidhën në mes të muslimanëve e çifutëve ose në mes tyre e të krishterëve, qoftë me thirrjen e mbretërve dhe udhëheqësve në Islam, në bazë të letrave dhe ambasadorëve.

Këto ishin disa nga karakteristikat dhe specifikat më themelore, të cilat, lexuesi i nderuar i vëren gjatë çasteve të tij që kalon duke e lexuar tefsirin e profesor Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!).

Gjatë studimit të kësaj sureje të bekuar, vërejta disa parime dhe elemente tek të cilat mbështetej profesor Sejjid Kutubi në tefsirin e tij dhe në të kuptuarit e tij të ajeteve të da'vetit të kësaj sureje.

Profesori (Zoti e mëshiroftë!) përpiquej që të ndriçonte disa pika, ashtu siç përpiquej të vendoste disa parime të shkëlqyera e të ndritshme për thirrësit në Zotin e Madhërishëm nga ajetet që flasin për da'vetin, për çështjet dhe për metodat e tij. Natyrisht që është e pamundshme t'i shqyrtoj tërësisht këto çështje në bazë të studimit të një sureje... Por, sidoqoftë, do të përqendrohemi në një tematikë brenda pikave të caktuara, gjithnjë duke e lutur Zotin e Madhërishëm që të jem sa më i suksesshëm në këtë çështje!

Këto parime dhe elemente rreth të cilave u zhvillua zbërthimi i profesor Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!) në tefsir, vërehen qartë në studimin e tij të aspektit të da'ves (thirrjes) dhe janë dinamik më shumë se në aspektet tjera. Ky është argument i qartë se ai (Zoti e mëshiroftë!) i vendoi vetes një rrugë dhe një metodë të posaçme gjatë tefsirit të tij të ajeteve të da'vetit...

Por, a thua vallë, cilat ishin parimet e tilla dhe cilat ishin rregullat e metodës së tij? Cila metodë i ndihmoi që të dallohet prej të tjerëve në disa ide e mendime dhe të bëjë ixhtahade(*analiza-konkludime-analogji*) të tij të posaçme?

Unë, me lejen e Zotit të Madhërishëm, do të mundohem dhe përpiqem, që t'i sqaroj këto gjëra, dhe vendosa që t'i tuboj parimet dhe rregullat e tilla e t'i sistematizoj sipas formës vijuese, gjithnjë duke qenë i vëmendshëm dhe duke pasur kujdes ndaj hapave që ndërmirren gjatë periudhave të aktiviteteve në da'vet (thirrje). Uroj që sa më mirë t'ia kem dalë mbanë!

III.

Thirrja e muslimanëve në përmirësim(El Islah)

1. Thirrje në përmirësimin e besimit në bazë të të vërtetës hyjnore dhe adhurimit:

Për të pasqyruar siç duhet këtë hap të parë të rëndësishëm rreth metodës së profesor Sejjid Kutubit në mënyrë korrekte, ndihet nevoja për tubimin e mendimeve dhe ideve të Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!) nga vende të ndryshme e të llojllojshme të veprës së tij, e më pastaj ato t'i krahasojmë dhe në fund do të japim një rezymë. Besoj se kështu, në këtë mënyrë, më së miri do ta sqarojmë mendimin dhe metodën e tij.

Njerëzit e shkathtë e dijnë se ky obligim ka nevojë për të dëshmuar së pari me fjalët e autorit dhe së dyti, për të vepruar në bazë të natyrës së metodës induktive. Vetëm Zoti e di se sa shumë herë e kam lexuar dhe studiuar tefsirin e sures **El El En'amë**, vetëm e vetëm për t'i nxjerrë këto ide, parime e rregulla, të cilat Sejjid Kutubi i ka mbështetur gjatë tefsirit të tij dhe të cilat kanë qenë bazë e mendimit të tij. Ai është bindur plotësisht në rëndësinë e fillimit të da'vetit për në *besim* dhe të da'vetit për në *Zotin e Madhërishëm(thirje ne Akide)*.

Këtu ia vlen të theksohen numrat e faqeve, në të cilat flitet pikërisht për këtë çështje (besimin) në mënyrë të qartë, aluduese ose simbolike, pastaj këto do të përdoren si dëshmi, por gjithnjë duhet të kihet parasysh se nuk mund t'i theksojmë dhe t'i nxjerrim të gjitha mendimet dhe tekstet...sepse kjo punë e tejkalon siperfaqen e lejuar te studimit, Kush dëshiron diçka më tepër,

atëherë ai duhet të mbështetet në tefsirin e Sejjid Kutubit dhe t'i lexojë faqet që hulumtuesi i thekson në studimin e tij.¹²⁶

Profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) flet për këtë aspekt të rëndësishëm dhe elementar të jetës së individit dhe shoqërisë si dhe dëshiron që për këtë t'i informojë muslimanët në përgjithësi dhe thirrësit islam në veçanti. Në fillim të da'vetit ne duhet të fillojmë nga një parim, gjegjësisht nga da'veti në përmirësimin e besimit, të konceptit dhe domethënien e gjerë dhe universale të tij. Nëse plotësohet ky parim, atëherë fillohet me çështjet e tjera sekondare.

Përmirësimi i besimit luan rol të madh dhe ka rëndësi të jashtëzakonshme për jetën e Ummetit në përgjithësi dhe jetën e thirrësit në fë në veçanti. Kjo e vërtetë buron nga vetë Fjala e Zotit të Madhërishëm në suren “**Hudë**” kur Pejgamberi Shuajb (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i tha popullit të vet:

“O popull im, më thuani pra, nëse unë kam argumente të sigurta nga Zoti im dhe nga ana e Tij, Ai më furnizoi mua me të mira (si mund të mos ju udhëzoj në rrugë të drejtë?) Unë nuk dua t’ju kundërshtoj (duke punuar) për atë nga e cila po ju ndaloj, unë nuk dua tjetër vetëm të përmirësoj aq sa mundem, por këtë mund ta arrij vetëm me ndihmën e Allahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm te Ai jam i drejtuar!”. (Hudë, 88).¹²⁷

¹²⁶ Shqyrtimi i hyznisë dhe i të vërtetës së saj theksohet në këto faqe të tefsirit “**Fi dhilâlil-Kur’an**”: 1030, 1031, 1047, 1048, 1053, 1068, 1095, 1106, 1108, 1111, 1124, 1131, 1133, 1137, 1146, 1157, (vëll.2), si dhe në faqet e vëll. 1: 1179, 1180, 1187, 1193, 1205, 1206, 1211, 1229, 1228, 1240, 1235.

¹²⁷ Në tefsirin e këtij ajeti, Ibn Kethiri thotë: **“Unë nuk dua tjetër vetëm të përmirësoj aq sa mundem, po ju urdhëroj e ju ndaloj për të përmirësuar aq sa kam mundësi dhe fuqi.”** vëll. 2 fq. 39; Mua më duket se ka dallim gjuhësor dhe fshehtësi stilistike në mes termit “**El-islam**” dhe termit “**Es-salah**”. Ajeti fisnik thotë: **“Unë nuk dua tjetër vetëm të përmirësoj aq sa mundem”**; dhe nuk e përdorë termin “**Es-salah**” dmth: **te bëjë mire, mirësi**, por “**El-islam**” përmirësim. Fshehtësia, gjegjësisht urtësia e përdorimit të termit të tillë qëndron aty se, këtu nënkuptohet përmirësimi i vetes para përmirësimit të të tjerëve. Ndërsa termi tjetër “**Es-salah**” përdoret për përmirësimin e të tjerëve e jo të vetvetes së thirrësit, pra, në rast të tillë, thirrësi i thirr të tjerët ndërsa e harron vetveten dhe kjo çështje e dobëson thirrjen dhe nocionin e saj. Mendimin tonë e argumentojmë me ajetin e njëjtë : **“Unë nuk dua t’ju kundërshtoj (duke punuar) për atë nga e cila po ju ndaloj.”** Zoti e di më së miri!

Fillimi i da'wetit me përmirësimin, rregullimin, spastrimin e besimit, përmban në vete mbrojtje dhe preventivë nga hidhërimi i Zotit dhe nga dënimi i Tij ndaj popullit. Këtë të vërtetë e kemi nxjerrë nga vetë Fjala e Zotit të Madhërishëm:

“E Zoti yt nuk është që të shkatërrojë mizorisht vendet, nëse banorët e tyre janë punëmirë.” (Hudë, 117).

Tani, të shohim se ç' thotë profesor Sejjid Kutubi rreth rolit të Kur'anit Fisnik në periudhën mekase dhe rreth asaj se çka shëroi, dhe cka kërkoi nga populli, besimtarët në fillim të shpalljes së tij. Në këtë kontekst, ai (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Ai shqyrtonte çështjen e parë, çështjen më të madhe dhe çështjen esenciale të kësaj feje të re, gjegjësisht çështjen e besimit që kishte të bëjë me parimin kryesor të hyjnisë dhe adhurimit,¹²⁸ marrëdhëniet në mes tyre... Kur'ani i periudhës mekase ia shpjegonte njeriut fshehtësinë e ekzistimit të tij dhe të Universit rreth tij. Ai thoshte: ”Kush është ai? Prej nga erdhi? Si erdhi? Pse erdhi? Ku do të përfundojë? Kush e solli nga hiçi e asgjëja? Kush e dërgoi atje dhe çfarë përfundimi do të ketë? Ai e pyeste atë: Ç'është kjo ekzistencë që e ndjen dhe që e sheh? Kush është Ai që e mbikqyr, por nuk duket? Kush e krijoi këtë Univers përplotë fshehtësi (mistere)? Kush e sistematizoi dhe kush e kontrollon? Kush ndryshon ashtu siç i vërejmë gjërat para syve? Ai poashtu i thoshte? Si të kooperojë me Krijuesin e këtij Universi dhe me vetë Universin? Si të veprojnë robërit me Krijuesin e robërve? Kështu i kaloi trembëdhjetë vjet të plota për të konfirmuar këtë çështje madhore...”¹²⁹

Nga ajo që u theksua më parë del në pah edhe një karakteristikë tjetër nga karakteristikat e metodës së prof. Sejjid Kutubit në të kuptuarit e ajeteve të da'vetit. Ai mendonte se besimi islam është çështje e madhe dhe themelore, dhe se në bazë të kësaj çështjeje formohen shoqëritë njerëzore, dhe pikërisht në bazë të kësaj çështjeje u formuan gjenerata e parë e sahabëve dhe tabi'inëve

¹²⁸ Shejh Muhamed Es Saleh Al-Uthaimin, **“The Muslim Belief”**; translated by dr. Mani'e Hammad Al-Johani, fq. 9.

¹²⁹ Sejjid Kutub, **“Fi dhilâlil-Kur'an”**; vëll. 2, fq. 1004.

si dhe u realizua përhapja madhore e Islamit nëpër botë. Në bazë të aktiviteteve të tyre, kjo fê u përcoll deri te ne. Këtë parim e pranoi profesor Sejjid Kutubi dhe këtë parim e argumenton në bazë të realitetit, intelektit, historisë dhe fesë. Thirrësi duhet të veprojë brenda këtij parimi dhe gabon nëse thirret në bazë të ndonjë parimi tjetër.

Që ta kuptojmë më mirë rëndësinë e përqendrimit të besimit në thirrjen në Zotin e Madhërishëm, do të shohim se ç’thotë profesori Sejjid Kutubi rreth kësaj tematike. Përsëritja e shpeshtë e kësaj çështjeje të ndijshme na bën të kuptojmë se çfarë vlere ka kjo për thirrësin dhe se në të duhet përqendruar një *kohë bukur të gjatë*, me qëllim që rrënjët e këtij lisi të depërtojnë në thellësitë e zemrave dhe të japin frytin e tyre dhe të përdoren, kuptohet me lejen e Zotit, në çdo kohë.

Rreth ajetit të parë të sures “**El El En’amë**”: *“Falënderimi i qoftë vetëm Allahut, që krijoi qiejt me tokën, që formuloi errësirat e dritën, e megjithë këtë (që Ai meriton lavdërim) ata që mohuan i barazojnë (idhujt) me Zotin e tyre.”* (El El En’amë, 1); - profesor Sejjid Kutubi thotë:

*“Teshih dhe pranin për faktin se vetëm Ai meriton të falënderohet, si dhe falënderim për hyjninë e Tij që vërehet në krijim e formim. Me këtë arrihet prej hyjnisë së lavdëruar në specifikën e parë të krijimit... Fillon me krijimin në formë më të madhe të ekzistencës.”*¹³⁰

Mendimi i profesor Sejjid Kutubit rreth hyjnisë(*El Uluhije*) është i gjerë dhe universal, ngase përfshinte këtë jetë, këtë Univers dhe tërë atë që është në mes tyre. Universalizmi hyjnor i jetës nënkupton se vetëm Zoti i Madhërishëm ka pushtet(*El Hakimije*) absolut. Nga Ai buron ç’do gjë dhe më pas vetëm Atij i kthehet gjithçka. Vetëm Ai i sjell sheriatet, parimet, ligjet.. Kjo argumentohet me ajetin e të po të njëjtës sure, dhe në këtë kontekst profesori (Zoti e mëshiroftë) thotë:

“Pjesa e tretë i përmbledh të dy pjesët e para brenda një qarku, ngase konfirmon hyjninë e Zotit në Univers dhe në jetën njerëzore: Ai është Allahu (që adhurohet e madhërohet prej çka ka) në qiej e në tokë. “Ai i di

¹³⁰ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâlil-Kur’an**”; vëll. 2, fq. 1004.

fshehtësitë dhe publikimet tuaja dhe Ai e di atë që e bëni.” (El El En’amë, 3). Ai që krijoi qiejt dhe tokën është Zoti në qiej e në tokë, i Vetmi që adhurohet; të gjitha çështjet hyjnore vërehen në to dhe me nënshtrmin e njerëzve para ligjit të Zotit si dhe realizimi i urdhërave të Tij.”¹³¹

Rreth të vërtetave dhe fakteve të kësaj hyjnie, thotë se ato nuk i ngjanë hyjnisë filosofike-teorike negative¹³² të cilën e predikojnë fetë tjera. Kjo hyjni është parim origjinal në brendi të njerëzve dhe buron nga instikti.¹³³

Pastaj profesori (Zoti e mëshiroftë) thotë:

“Vala e parë e paraqet të vërtetën e hyjnisë që vërehet në krijimin e qiejve dhe të tokës, në krijimin e errësirave dhe dritës, në krijimin e njeriut nga dheu, në përfundimin e jetës së njeriut dhe në ringjalljen e tij. Kjo e vërtetë argumenton universalizmin hyjnor të Zotit në qiej e në tokë, i Cili i di fshehtësitë e njerëzve dhe veprat e tyre të dukshme si dhe përfitimet e tyre të dukshme e të fshehta. E gjithë kjo nuk është argumentim i hyjnisë filosofike-teorike negative, por i të vërtetave të jetës njerëzore. Ata duhet t’i mbështeten vetëm Zotit. Ai nuk mund të zëvendësohet me asgjë dhe në asnjë mënyrë nuk mund të kontestohet monoteizmi i Tij. Universalizmi hyjnor dominon mbi çështjet e Universit dhe mbi çështjet e jetës njerëzore, haptazi ose fshehurazi. Në bazë të sistemimit të rezultateve natyrore konfirmohen të vërtetat mbi pushtetin absolut të Zotit në çështjet e jetës tokësore si dhe mbi Pushtetin e Tij në çështjet kozmologjike.”¹³⁴

Përqendrimi në besim ose në monoteizëm(*El Ijman ve El Teuhid*) së pari i përfshinë të tre dimensionet¹³⁵ gjatë da’vetit në Zotin e Madhërisëm

¹³¹ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâil-Kur’an**”; vëll. 2, fq. 1004.

¹³² Ali Muhsin, “**Da’ë El-Inxhilë jetekel-lemu**”; disertacion mbi gabimet e inxhilëve dhe të të krishterëve. (Ali Muhsin, “**Let the Bible speak**”; Islamic Da’ëe Guide Center; Daman, Saudi Arabia, fq. 7).

¹³³ Karakteristikë e metodës së profesor shehid Sejjid Kutubit është ajo se ai, shpeshherë mbështetej në instiktin si aparat i kapshmërisë instiktive, në zgjimin dhe lëvizjen e instiktit që është i nevojshëm për da’vet. Ai flet për instiktin në faqet vijuese: vëll. 2: 1053, 1087, 1088, 1098, 1123, 1137, 1138, 1146, 1153, 1161; vëll. 3: 1202.

¹³⁴ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâil-Kur’an**”; vëll. 2, fq. 1047; Vlen të theksojmë se edhe Shejh Muhamed Reshid Rida ka mendime të njëjta me ato të Sejjid Kutubit. Shihi në “**Tefsirul-Menar**”, vëll. 7, fq. 299-300.

¹³⁵ Shejhul-Islam Ahmed ibn Tejmije (Zoti e mëshiroftë!), kur flet për mendimin e medh’hebit të selefët të mirë (selefus-salih) rreth çështjes së Emrave dhe Cilësive Hyjnore, thotë: “**Njohja e këtij**

dhe kjo ishte prej çështjeve prioritare të profesor Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!). Në këtë kontekst, gjatë bisedës se tij rreth dimensioneve të teuhidit-monoteizmit, ai e zgjeron këtë domethënje duke thënë:

“- Monoteizmi i udhëheqjes dhe udhëzimit;

- Monoteizmi i nënshtrimit dhe adhurimit; dhe:

- Monoteizmi i burimit të shariateve dhe urdhërave”.

Unë them se monoteizmi i Zotit në këto sfera ka dimensione të besimit, dimensione edukative dhe të da'vetit në jetën e muslimanëve në përgjithësi dhe në jetën e thirrësve islam në veçanti. Kjo ka rëndësi shumë të madhe dhe nuk duhet filluar me diçka tjetër në da'vetin tonë në Zotin e Madhërishëm. Pra, njerëzit duhet të jenë shumë të kujdesshëm ndaj kësaj çështjeje.

Të shohim se çka thotë profesor shehid Sejjid Kutubi në këtë kontekst:

“Kjo valë e re ka për qëllim poashtu të paraqet të vërtetën e hyjnisë që vërehet në pushtet, aktivitet, furnizim, garancë, fuqi, shkatërrim, dobi, dëm... E gjithë kjo nuk konfirmon hyjninë filozofike-teorike negative, por konfirmon të vërtetat e monoteizmit të udhëheqjes e udhëzimit dhe faktin se monoteizmi dhe udhëzimi janë pasqyrë e nënshtrimit dhe adhurimit. Kur Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) urdhëroi që të mos merret askush si mbikqyrës përveç Zotit, ai me këtë sqaroi se ky urdhër mbështetet në faktin se Zoti ushqen dhe Ai (larg qoftë!) nuk ushqehet.

parimi është fê dhe burim i udhëzimit, më e mira dhe më pozitivja që e kanë përfituar zemrat, njerëzit dhe intelektet. Këtu mund të rezimohet se Zoti mund të cilësohet me atë që Ai Vet e ka cilësuar Vetën e Tij, dhe me atë që e kanë cilësuar Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), të parët dhe të hershmit, pra, të mos tejkalohet Kur’ani e as Hadithi”. Imam Ahmedi (Zoti e mëshiroftë!) thotë: ***“Zoti cilësohet vetëm me atë që vetë Ai e cilësoi për Vetveten dhe Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), pa dalë jashtë Kur’anit dhe Hadithit”.*** Sipas medhhebit të selefit, Zoti i Madhërishëm përshkruhet me atë që Ai vetë e ka përshkruajtur Vetën dhe me atë që e ka përshkruar Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) pa devijim, pa privim, pa krahasim dhe pa ngjashmëri. ***”Mexhmu’ul-fetava”;*** vëll. 5, kapitulli: ***“El-Esmau ves-sifat”***, fq. 6-26, botuar me urdhër të ekselencës së tij Mbretit Fehd ibn Abdulaziz Al-Sa’ud, botimi i parë, viti 1389 hixhri. Kjo është mënyra më e shëndoshë dhe më e saktë rreth kësaj çështjeje akaidologjike. Por, megjithatë, vetëm Zoti e di më së miri të saktën!

*Pastaj, mbështetja tek dikush tjetër përveç se tek Allahu, kundërshton urdhërin e Islamit, si dhe krijon idhujtari...*¹³⁶

Nga fjalët e profesor Sejjid Kutubit mund të konkludojmë disa karakteristika të metodës së tij në të kuptuarit e ajeteve të da'vetit, të cilat janë:

Konfirmimi i tij i parimeve të monoteizmit të hyjnisë(*Teuhid El Ulihije*) dhe i rëndësisë së tij, dhe pas kësaj thirret në vepra të zemrës dhe të gjymtyrëve, përkundër metodës filosofike-teorike negative. Ai (Zoti e mëshiroftë!) i jep dimensione praktike e dinamike këtij aspekti të rëndësishëm të monoteizmit.

Në tefsirin e ajetit 14 të së njejtës sure: **“Thuaj: “A pas Allahut, krijues i qiejve dhe i tokës, që ushqen të tjerët, ndërsa Vet nuk ushqehet, të pranoj Zot tjetër?” Thuaj: “Unë jam i urdhëruar të jem i pari që bindem dhe (urdhërohem): të mos bëhem kurrsesi nga idhujtarët!”** - ai jep komentim të gjerë dhe thotë:

*“Kjo çështje, gjegjësisht çështja e konsiderimit të Zotit si mbikqyrës të vetëm me plotkuptimin e fjalës, nënkupton nënshtrimin e plotë të njeriut në adhurimin e Tij dhe në Pushtetin e Tij absolut, vetëm Atë të adhurojë dhe vetëm Atij t’ia kushtojë të gjitha ritet fetare. Njeriu duhet të mbështetet vetëm në ndihmën e Tij dhe vetëm Atij t’i drejtohet në raste të vështira. Ky është thelbi i çështjes së besimit. Pra, ose sinqerisht t’i mbështetesh Zotit me plotëkuptimin e fjalës, e që nënkupton Islamin ose t’i bësh shok Atij, gjë kjo që konsiderohet idhujtari(Shirk). E, idhujtaria dhe Islami assesi nuk mund të qëndrojnë bashkë në një zemër!...”*¹³⁷

Dijetari i madh El-Alusij El-Bagdadi, në tefsirin e tij thotë:

“Një nga kuptimet e “Mbikqyrjes” është adhurimi”; dhe më pas shton: **“Kjo nënkupton edhe ndihmën e Tij, dhe ky është kuptimi i njohur i**

¹³⁶ Sejjid Kutub, “*Fi dhilâlil-Kur’an*”; vëll. 2, fq. 1047; “*Mukav-vimatut-tesavvuril-Islami*”; -Pjesa e dytë- kapitulli: “*El-uluhijje vel-ubudijje*”, fq. 81; dhe: kapitulli: “*Hakikatul-uluhijje*”, fq. 189.

¹³⁷ Sejjid Kutub, “*Fi dhilâlil-Kur’an*”; vëll. 2, fq. 1054.

tij. Kush mbështetet në ndihmën e ndokujt tjetër nuk mund ta adhurojë Atë...”¹³⁸

Këtu, El Imam El Alusi dhe profesori i çmuar Sejjid Kutubi (Zoti i mëshiroftë!) argumentojnë realisht dhe me fakt shariatit se mbështetja duhet të jetë vetëm ndaj Zotit të Madhërishëm, e ndaj askujt tjetër! E, a thua vallë kujt mund t’i mbështetesh nëse jo Zotit të Madhërishëm?

Profesori (Zoti e mëshiroftë) thotë: *“Kjo është logjika e fortë dhe e thellë e instiktit..., se kujt i takon mbështetja e kujt jo? Kujt nëse jo Krijuesit të qiejve e tokës, të cilat i krijoi dhe i formoi? Kujt nëse jo Furnizuesit të qiejve e tokës, i Cili ushqen dhe nuk lypë ushqim?”¹³⁹*

Ai gjithashtu vazhdon e thotë: *“Kjo është një çështje qartë e përcaktuar, nuk pranon as dobësi e as luhatje: Vetëm Zotit t’i drejtohesh me adhurim, nënshtrim, ibadet, mbështetje e ta pranosh pushtetin e Tij absolut në çdo gjë dhe të refuzosh t’i bësh shok! Të veprosh me zemër e me vepra vetëm për hir të Tij e jo për ndokënd tjetër! E gjithë kjo nënkupton Islamin... Nëse i shoqëron ndokënd tjetër, atëherë kjo quhet idhujtari! E, idhujtaria dhe Islami assesi nuk mund të qëndrojnë bashkë në një zemër!...”¹⁴⁰*

¹³⁸ Dijetari i madh Ebu El-Fadl Shihabud-din Es-Sejjid Mahmud El-Alusi El-Bagdadi, vdiq në vitin 1270 hixhri. Është autori i tefsirit të njohur **“Ruhul Me’ani fi tefsiril-Kur’anil-Adhim ves-seb’ul-methâni”**; botoi: “Daru ihjait-turathil-Arabi”; Bejrut, Liban, bot. 4, 1985, vëll. 1, fq.109.

¹³⁹ Sejjid Kutub, **“Fi dhilâlil-Kur’an”**; vëll. 2, fq. 1054.

¹⁴⁰ Po aty; Vlenë të theksohet se nocioni **“idhujtari”(El Shirk)** sipas Sejjid Kutubit, ka kuptim më të gjerë se ai që e dijnë dhe nënkuptojnë shumica e njerëzve dhe dijetarëve. Në tefsirin e ajetit 70 të sures **“El En’amë”**: **“Braktis ata të cilët e marrin fenë (në vend që ta respektojnë) për lojë e dëfrim!”**-profesor Sejjid Kutubi thotë: **“Ende kemi nevojë për të vendosur se kush janë idhujtarët? Të tillë janë ata që i bëjnë shok Zotit në çështjet e hyjnisë, qoftë në besimin, në hyjninë e ndokujt tjetër krahas Zotit, ose në pranimin e shariatit dhe të pushtetit nga ndokush tjetër përveç Allahut! Edhe pse kanë emra muslimanësh, mendoj se më mirë do të ishte sikur të mos quheshin kështu! Të jemi të bindur në fenë tonë!”**; **“Fi dhilâlil-Kur’an”**; vëll. 2, fq.1129. Në një vend tjetër të tefsirit të tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”** gjatë komentimit të sures **“El En’amë”**, thotë: **“Ata që e akuzojnë idhujtarin për idhujtari, e nuk e auzojnë atë që gjykon në emër të tiranit, që frikohen prej këtij e jo prej Atij, siç duket nuk e lexojnë Kur’anin si duhet dhe nuk e njohin natyrën e kësaj feje! Pra, le ta lexojnë mirë Kur’anin, ashtu siç e shpalli Zoti dhe le të veprojnë seriozisht sipas fjalëve të Zotit: “Dhe nëse ju nënshtroheni atyre atëherë ju jeni idhujtarë!” - “Fi dhilâlil-Kur’an”**; fq. 1216. Në këtë vepër, pra në tefsirin e tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”**, ai gjithashtu flet rreth konceptit të idhujtarisë në vëll. 2, fq. 1130 dhe vëll. 3. fq. 1233; Ndaj dhe për shkak të kësaj, disa e akuzojnë profesor Sejjidi Kutubin se çdo gjë rreth tij e sheh si injorancë (*xhahilijet*) dhe idhujtari (*shirk*), dhe duke u nisur nga kjo edhe shoqërinë e

Jam i mendimit se, siç duket, idetë dhe mendimet e Sejjid Kutubit rreth idhujtarisë(*Shirkut*) dhe konceptit të saj, përputhen në mënyrë identike me mendimet e Shejhul-Islam Ibn Tejmijes.¹⁴¹

Nga fjalët e theksuara të profesor Sejjid Kutubit, konkludojmë se ai që therrët në fê e që punon në këtë lëmi, duhet të jetë i kujdesshëm dhe i vetëdijshëm gjatë thirrjes së njerëzve në të vërtetën e hyjnisë dhe parimeve të saj, duhet ta kuptojë mirë Kur'anin Fisnik dhe Sunnetin e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) që njerëzve t'ua ofrojë Islamin, ashtu siç e ka zbritur Zoti i botëve pa shtuar ose pa cunuar gjë. Ai duhet t'ua paraqet Islamin e vërtetë, e jo ashtu siç dëshirojnë epshet dhe emocionet.

Pra, kjo ishte metoda e Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!). Ai përdori metodë të posaçme gjatë deduktimit të mësimave, këshillave e leksioneve nga Libri i Zotit të Madhërishëm! Ai nuk kishte rënë nën ndikimin e ndonjë dijetari dhe nuk bënte ndonjë imitim të verbër, por mbështetej në fuqinë e Zotit... Ai u udhëzua në këto fakte dhe në këto të vërteta.

percepton si idhujtare ose injorante!? Unë them se ata gabojnë, gjegjësisht bëjnë një gabim të madh, ngase nuk i lexojnë tërësisht fjalët e Sejjid Kutubit që janë të shpërndara nëpër veprat e tij rreth kësaj çështjeje, por i lexojnë pjesërisht(*lexim selektues*) apo zgjedhin fjalë konkrete, e pastaj e akuzojnë autorin pa të drejtë kështu?! Nuk e teproj nëse them se profesor Sejjid Kutubi gëzon autoritet të lartë dhe pozitë të posaçme, si dhe është dijetar që di t'i përdori fjalët dhe kuptimet në vende të veta dhe me domethënie përkatëse.

¹⁴¹ Në tefsirin e ajetit kur'anor: **“Ata i konsideruan “ahbarët” (rabinët çifutë) të tyre, “ruhbanët” (murgjit e krishterë) të tyre dhe Mesihun (Isain) birin e Merjemes për Zot pas Allahut.”** (Teube, 31). Ibn Tejmije thotë: **“Të tillët iu nënshtrohen atyre në lejimin e asaj që e kishte ndaluar Zoti dhe në ndalimin e asaj që e kishte lejuar Zoti, dhe kjo ndodhë në dy mënyra:**

1. Të dijnë se e kanë ndryshuar fenë e Zotit, e praktikojnë ndryshimin dhe besojnë në lejimin e asaj që e ka ndaluar Zoti dhe në ndalimin e asaj që e ka lejuar Zoti, duke ndjekur udhëheqësit e tyre edhe pse e dijnë se ata kundërshtojnë fenë e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe kjo konsiderohet kufër, ngase Zotit të Madhërishëm i bëjnë shok, edhe pse nuk u falen atyre e as nuk u bëjnë sexhde. Kush e ndjek ndokënd i cili e kundërshton fenë dhe e di se ai e kundërshton fenë dhe u beson fjalëve të tij, e jo fjalëve të Zotit dhe atyre të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), ai konsiderohet idhujtar, ngjashëm sikur ata; dhe:

2. Besimi i tyre në ndalimin e hallallit dhe në lejimin e haramit të jetë në rend të dytë, por megjithatë ata i ndjekin në mëkate ndaj Zotit, ashtu siç vepron muslimani i cili bën mëkate me vetëdije të plotë. Të tillët trajtohen njësoj si mëkatarët. Në “Sahih” transmetohet se Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: “Muslimani duhet të dëgjojë, respektojë atë që do ose e uren, përderisa nuk urdhërohet të bëjë mëkat.” Dhe: “Krijesa nuk duhet të respektojë mëkatin ndaj Krijuesit...” (“Mexhmu’ul-fetava”; Kreu: “Kitabul-Imam”; vëll. 7, fq. 70.)

Ndaj, e shoh të udhës se muslimanët në përgjithësi, dhe thirrësit islam në veçanti (*hoxhallarët, studentët e shariatit*) duhet t'i përjetojnë këto citate nga tefsiri i tij dhe ta kuptojnë më shumë këtë çështje, gjegjësisht t'i qartësojnë më mirë gjërat dhe të kuptojnë sa më qartë e më mirë rëndësinë e saj...

Ai (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Kjo është një qasje tjetër rreth të vërtetës së hyjnisë (El Uluhiye)... Qasje e fuqisë së madhe mbi robërit, e kontrollimit të përherhshëm. Atë nuk e zë fare gjumi. Kaderit (Caktimit) të Tij që nuk vjen as më herët e as më vonë, fundit që s'mund t'i ikë askush, llogarisë së fundit që nuk harron asgjë! E gjithë kjo dominon mbi njerëzit dhe ndikon në ta!

“Vetëm Ai është mbizotërues ndaj robërve të vet. Ndaj juve dërgon rojë (cakton engjëj) derisa kur t'i vijë ndonjerit prej jush vdekja, atij ia marrin shpirtin të dërguarit Tanë (engjuj të tjerë) dhe ata nuk bëjnë kurrfarë lëshimi. Pastaj i kthehen Allahut, Sunduesit të vërtetë të tyre. Vetëm i Tij është sundimi (gjykimi) dhe Ai është më i shpejti i llogaritësve.”
(El El En'amë, 61-62).

(Ai është mbizotërues ndaj robërve të vet) - Ai ka fuqi shkatërruese dhe ata janë nën pushtetin e Tij dhe fare janë të dobët nën pushtetin e këtij Sundimtari, nuk kanë as fuqi as ndihmues por janë robër! Sundimi është mbi ta dhe ata i nënshtrohen Atij.”¹⁴²

Profesor Sejjid Kutubi, këtu jep argumente të realta historike, argumente Sheriati mbi fenomenet e mëshirës së Zotit të Madhërishëm, mbi të vërtetën e Hyjnisë së Tij (i pastër është Ai nga të metat!) në shumë sfera... Kjo është një pjesë e metodës së tij dhe kjo ka të bëjë me kthimin në biografinë e pastër të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për të marrë shembull dhe leksione nga ngjarjet e tij.

Në këtë kontekst, ai (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

¹⁴² Sejjid Kutub, “**Fi dhilâil-Kur'an**”; vëll. 2, fq. 1109.

“Aspektet në të cilat vërehet Mëshira e Zotit dhe e hyjnisë së Tij, janë ata ndryshime, të cilat do t’i përmbledhim këtu, para se t’i detajizojmë gjatë paraqitjes së teksteve kur’anore:

1. Mëshira e Zotit qartë vërehet në zemrën e Pejgamberit të Zotit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*), dhe ai gjenë argument në vetvete nga Zoti i tij. Ai është i bindur në të dhe fare nuk e luhatin gënjeshttrat dhe intrigat e gënjeshtarëve. Pastaj përqendrohet tërësisht në Zotin e tij dhe largohet nga devijimet e popullit të vet, ngase ishte i bindur në atë që e udhëzoi:

“Thuaj: “Unë jam i ndaluar të adhuroj ata që adhuroni ju, pas Allahut!” Thuaj: “Unë nuk ndjekim dëshirat tuaja, pse atëherë do të isha i humbur e jo prej të udhëzuarëve (në rrugë të drejtë).” Thuaj: “Unë i përmbahem të vërtetës (që më erdhi) nga Zoti im. Ju e gënjet Atë, e për atë që nguteni ju, (dënimin), nuk e bëj unë, vendimi i takon vetëm Allahut; Ai e rrëfen të vërtetën, Ai është më i Miri i gjykatësve.” (El El En’amë, 56-57).

2. Në vendimin e Zotit të Madhërishëm kundër gënjeshtarëve dhe mospranimi i propozimit të tyre që të sjellë ndonjë mrekulli fizike, që të mos përshpejtojë dënimin e tyre për shkak të përgënjeshtimit të tyre, ashtu siç vepronte zakonisht Zoti i Madhërishëm me gjeneratat e mëparshme. Sikur të ishte në dorë të Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) atë që e kërkonin ata që të përshpejtohet, ai nuk do të mund ta largonte. Ky prolongim është Mëshirë dhe Rahmet i Zotit, si dhe fenomen ku qartë vërehet hyjnia e Tij:

“Thuaj: “Sikur të ishte ajo për të cilën nguteni ju te unë, çështja mes meje dhe mes jush do të ishte e përfunduar. (por kjo nuk është)Allahu më së miri e di për mizorët.” (El El En’amë, 28).

3. Në diturinë e Zotit për gjërat metafizike dhe përfshirja në këtë dituri e çdo gjëje që është në këtë ekzistencë. Çdo gjë që është ashtu siç e ka krijuar Zoti dhe vetëm Zoti mund t’i jep format e tilla, e askush tjetër përveç Tij:

“Çelësat e fshehtësisë janë vetëm te Ai, atë (fshehtësi) nuk e din kush pos Tij. Ai e di çka ka në tokë dhe në detë. Ai e di për çdo gjeth që bie dhe s’ka kokër në thellësi të tokës, s’ka të njomë dhe s’ka të thatë që nuk është (shënuar) në Librin e qartë (Levhi-Mahfudh).” (El El En’amë, 59).

4. Në mbizotërimin dhe mbikqyrjen e Zotit të Madhërisëm mbi njerëzit në çdo situatë dhe gjendje të tyre, në gjumë e në zgjuarje, në vdekje e në jetë, në këtë botë dhe në botën tjetër (ahiret):

“Ai është që ju vë në gjumë natën dhe e di çka vepruat ditën, pastaj ju ngjall-zgjon në të (ditën) për deri në afatin e caktuar (vdekje). Pastaj do të ktheheni e do t’ju njoftojë me atë që keni pas vepruar. Vetëm Ai është mbizotërues ndaj robërve të Vet. Ndaj juve dërgon rojë (cakton engjëj) derisa kur t’i vijë ndonjërit prej jush vdekja, atij ia marrin shpirtin të dërguarit Tanë (engjuj të tjerët) dhe ata nuk bëjnë kurrfarë lëshimi. Pastaj i kthehen Allahut, Sunduesit të vërtetë të tyre. Vetëm i Tij është Sundimi (grykimi) dhe Ai është më i Shpejti i llogaritësve.” (El En’amë, 60-62).

5. Në instiktin e vet përgënjeshtarëve, kur ata të ballafaqohen me Xhehennemën dhe atëherë vetëm prej Zotit kërkojnë ndihmë për të shpëtuar. Ata bëjnë idhujtari (shirk) dhe harrojnë se Zoti, të Cilin e lusin për t’i shpëtuar mund t’i bëjë që të shijojnë lloje të ndryshme të dënimit edhe se askush nuk mund t’u ndihmojë:

“Thuaj: “Kush ju shpëton prej errësirave (trishtuese) të tokës e të detit e (nga trishtimi) ju luteni Atë haptas e fshehtas (duke thënë): “Nëse Ai na shpëton prej kësaj, ne do të jemi (besimtarë) mirënjohës?” Thuaj: “Allahu ju shpëton nga ajo dhe nga çdo brengosje.” Megjithëkëtë, ju Atij i përshkruani shok. Thuaj: “Ai ka fuqi (t’ju shpëtojë, por edhe) t’ju sjellë dënim prej së larti ose prej së poshti nën këmbët tuaja apo t’ju ndajë në grupe e ta luftoni njeri-tjetrin. Shih se si i sqarojmë faktet në mënyrë që të kuptojnë”. (El En’amë, 63-65).¹⁴³

Nga ajo që pamë më sipër, vërejmë se metoda e profesor Sejjid Kutubit rreth të kuptuarit të ajeteve të da’vetit mbështetet në rikthimin në histori, në historinë e pastër të Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*), në historinë e popujve të kaluar dhe në qëndrimin e tyre ndaj pejgamberëve si dhe në mësimet që mund të merren prej tyre. Metoda e tij poashtu mbështetet në faktin që njerëzit duhet të kthehen në *Cilësitë e Zotit të Madhërisëm, të cilat vërehen në çdo gjë, si p.sh.: njohuritë e Tij mbi botën e padukshme, kontrolli i Tij i veprave të njerëzve dhe gjendjes së tyre, etj.*

¹⁴³ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâlil-Kur’an**”; vëll. 2, fq. 1108-1109; dhe: “**Mukav-vamatut-tesav-vuril-Islami**”; kapitulli: “**Hakikatul-uluhijjeti**”; fq. 189.

Pastaj ai (Zoti e mëshiroftë!) shqyrtoi një çështje tjetër, që njësoj është e rëndësishme si edhe çështjet tjera të besimit, gjegjësisht çështja e sqarimit të qëllimit të definicioneve sheriatores:

Qëllimi i hyjnisë dhe pushtetit!(*El Uluhije ve El Hakimije*) Ai thekson se vetëm Zoti i Madhërishëm është Ai që vendos për jetën e robërve (njerëzve) dhe se askush tjetër nuk ka një autoritet të tillë. Askush përveç Tij nuk mund të ndalojë, as të vendos sheriat e të gjykojë... - të gjitha këto janë karakteristika të hyjnisë. Në jetën e njerëzve askush s'ka të drejtë përveç Zotit, ngase askush përveç Zotit të Madhërishëm nuk krijon, nuk furnizon, nuk ngjallë, nuk vdes, nuk dëmton, nuk sjell dobi, nuk jep, nuk ndalon, nuk mund t'i jep as vetes e as të tjerëve qoftë në këtë botë apo në botën tjetër.

Konstruksioni i sures rreth kësaj çështjeje i thuri argumentet në mënyrë të mahnitshme, duke ilustruar me pamje, qëndrime e intonacione që ndikojnë thellë në zemër në çdo mënyrë dhe në çdo aspekt!¹⁴⁴

Kuptimi i profesor Sejjid Kutubit (*Zoti e mëshiroftë!*) ndaj çështjes së besimit, ashtu siç theksuam më parë, është formuar nga një parim i fuqishëm, i qëndrueshëm dhe i fortë, i bazuar në parimin e dëshmisë (shehadetit): **“Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe Muhammedi është i Dërguari i Zotit!”**

Ai (Zoti e mëshiroftë!), shumë herë e përsëriste këtë të vërtetë dhe shpesh në këtë kontekst thoshte:

“Besimi në Islam mbështetet në dëshminë se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, dhe në këtë mënyrë njeriu e heq nga zemra e vet hyjninë e mjerimit dhe mbështetet vetëm në adhurimin e Zotit, si dhe largon pushtetin absolut nga njerëzit dhe i nënshtrohet vetëm Pushtetit Absolut të Zotit...”¹⁴⁵

Në këtë mënyrë, ai formoi një ide të qartë dhe një metodë eksplicite rreth të kuptuarit të kësaj feje. Arsyeja që e shtyri të formojë ide dhe parime të tilla është fakti se Islami ka natyrë të posaçme dhe se natyra e kësaj feje (sipas profesor Sejjid Kutubit) bazohet mbi:

“Parimin e hyjnisë së Zotit Një. Të gjitha sheriatet dhe sistemimet e Tij rrjedhin nga ky parim i madh. Sistemi i kësaj feje dominon në të gjitha poret e jetës për të gjithë njerëzit, qofshin ata të mëdhenj apo të vegjël. Ky

¹⁴⁴ Sejjid Kutub, “*Fi dhilâlil-Kur’an*”; vëll. 3, fq. 1179, 1180; dhe: “*Hasaisut-tesavuril-Islami ve mukavimatuhu*”; kapitulli: “*Er-Rububijje*”.

¹⁴⁵ Sejjid Kutub, “*Hasaisut-tesavuril-Islami*”; kapitulli: “*El-Uluhije*”; vëll. 3, fq. 1211.

aspekt përfaqëson fshehtësinë dhe natyrën e kësaj feje, përcakton metodën në formimin e vetvetes dhe gjetiu, formon besimin që depërton në thellësi të secilit njeri dhe që konsiderohet e domosdoshme për formimin korrekt.”¹⁴⁶

Profesor Sejjid Kutubi e kuptoi rëndësinë e fillimit të zbritjes së Kur’anit suksesivisht brenda një kohe të gjatë të periudhës mekase. Ky fenomen, të cilin profesori e quajti: **“fenomeni i Kur’anit mekas”**, bëri që të përqendrohet gjatë kohë në këtë periudhë dhe të nxjerr këshilla e leksione, të cilat e inspironin për strategjinë dhe mënyrat e da’vetit. Nuk ka kurrfarë dyshimi se kjo konsiderohet si parim esencial i metodës së fuqishme të tij në të kuptuarit e ajeteve të da’vetit. Ndoshta kjo ishte edhe arsyeja kryesore që ai e shkroi një hyrje të gjatë për suren **“El En’amë”**, në krahasim me hyrjet që shkroi për suret tjera, gjatë definimit të tyre.

Në këtë hyrje të gjatë të sures **“El En’amë”** edhe njëherë e konfirmoi metodën e tij në të kuptuarit e ajeteve të da’vetit dhe faktin se kjo metodë është zhvilluar dhe formuar nga studimi i tij i periudhës së gjatë mekase, që përqendrohej në formimin e njeriut nga aspekti i besimit (*akides*), para obligimit të tij me obligime sheriatore.

Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Kjo metodë e bekuar nuk do të realizohej deri në këtë nivel të lartë, sikur të mos fillonte da’veti nga ky parim dhe sikur të mos e lartësonte këtë flamur, gjegjësisht flamurin: La ilahe il-lall-llah “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!” Pra, asgjë tjetër nuk vlen përveç këtij parimi! Kjo metodë duket e vështirë, por në thelb është e lehtë.

***Kjo metodë e bekuar pati sukses, ngase mbështetej sinqerisht vetëm në Zotin e Madhërishëm dhe sikur të bazohej në thirrje racionale apo në thirrje sociale e morale ose në ndonjë parim tjetër, krahas parimit: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!” - nuk kishte për të korrë asnjë sukses”.**¹⁴⁷*

Besoj bindshëm se kjo analizë e jona është e mjaftueshme për temën që biseduam dhe Allahu di më mire.

¹⁴⁶ Sejjid Kutub, **“Fi dhilâlil-Kur’an”**; vëll. 2, fq. 1009.

¹⁴⁷ Sejjid Kutub, **“Fi dhilâlil-Kur’an”**; vëll. 2, fq. 1009.

2. Përmirësimi i shoqërisë sipas metodës kur'anore

Në bazë të asaj që u theksua më parë, mund të konkludojmë se Islami së pari i ftonë njerëzit në përforsimin e besimit dhe pas kësaj, ata (njerëzit) fillonin ta kuptonin të vërtetën e hyjnisë dhe të adhurimit në kuptimin më të gjerë.

Kur të realizohet kjo, besimi fillon e depërton thellë në shpirtin e njerëzve dhe atëherë do të bindemi se ky parim është përforsuar dhe stabilizuar. Pas këtij hapi, thirrësi vazhdon të ndërtojë ndërtesën, gjegjësisht shoqërinë nga aspekti i moralit, jetës dhe sistemit. Kjo shoqëri duhet të mbështetet në parimin e shëndoshë e të fortë, i cili parim nxirret nga Kur'ani dhe Sunneti, si dhe të vazhdojë më tej në jetë, sipas parimeve të Islamit.

“Thirrësi duhet të ndiejë se thirrja e tij është e gjallë, kreative, e lëvizshme dhe aktive. Se ajo lëviz dhe gjallëron nga ndjenjat dhe gjaku. Se thirrja nuk e lë të preokupohet me fëmijët apo me pasurinë e tij... Ja, ky është thirrësi i singertë! Vetëm kështu do të ndiejë besim të fortë në da'vetin e tij, i cili ndikon në zemrat e njerëzve dhe i vë në lëvizje ndjenjat e tyre aty ku aspiron të arrijë.”¹⁴⁸

Cila është metoda me të cilën i drejtohem popullit dhe si ta nxjerrim atë nga sureja “**El En'amë**”? Cilat janë çështjet e mëdha fetare të cilat duhet t'i kuptojë thirrësi, për të pasur sukses në përmirësimin e shoqërisë sipas metodës kur'anore? Për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, ne sërish do t'i referohemi mendimeve të profesor Sejjid Kutubit, rreth disa çështjeve dhe problematikave fetare aktuale, si çështja e *dhunës, përdorimi i saj, largimi dhe distancimi nga kriminelet e mëkatarët, idhujtaria e idhujtarët*, etj.

Unë them se profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!), i ka deduktuar të gjitha këto çështje dhe çështjet tjera nga sureja “**El En'amë**” gjatë tefsirit të saj, posaçërisht gjatë tefsirit të ajeteve të cilat flasin për da'vetin dhe thirrësit.

¹⁴⁸ El-Khulij El-Behijj, **Tedhkiretud-dua't** El-Itihadul-Islami El-Alemi lil-munedh-dhamat et-tul-labijjeti, Darul-Kur'anil-Kerim, Bejrut, bot. 2; 1983, bot. 2. fq. 44-50.

Në vijim do t'i theksojmë disa çështje të cilat i shqyrton profesor Sejjid Kutubi gjatë tefsirit të ajeteve të da'vetit në tefsirin e tij **“Fi dhilâlil-Kur'an.”**:

A). Çështja e mbështetjes së thirrësve në dhunë dhe në përdorimin e forcës:

Këtu vlen të theksojmë disa mendime të profesor Sejjid Kutubit, i cili i ka shprehur ato, në disa shkrime të tjera rreth kësaj çështjeje, me qëllim që thirrësi ta kuptojë sa më mirë rolin e tij të rëndësishëm që ka në shoqëri.

Në një letër kundër pushtetit diktatorial egjiptian, gjatë marrjes së tij në pyetje në një burg ushtarak të sigurisë së lartë, letër kjo, që njëherit konsiderohet dokument sekret, profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) shprehet për aktivitetin e tij, organizimin e lëvizjes dhe anëtarësimin e tij në radhët e **Vëllezërve Muslimanë**, ndaj dhe rreth këtyre aktiviteteve thotë:

*“Nuk duhet të fillohet me asnjë organizim, përpos nëse individët arrijnë shkallë të lartë të të kuptuarit të besimit dhe nëse pajisen me moral islam në sjellje, bashkëpunim e vetëdije. Nuk duhet të nisemi nga parimi i formimit të sistemit islam dhe Sheriatit, por pikënisja duhet të jetë nga transformimi i shoqërive (pushtetarëve dhe popullit) drejt koncepteve të vërteta islame dhe nga formimi i një parimi, i cili edhe nëse nuk e përfshinë tërë shoqërinë, mjafton të ketë ndikim në elementet dhe institucionet që kanë ndikim në udhëzimin dhe në drejtimin e kahjes së tërë shoqërisë, për të shprehur dëshirë që të formojnë sistemin islam dhe ligjin e Sheriatit. Formimi i sistemit islam dhe ligji i Sheriatit nuk mund të realizohen në bazë të grushtshteteve nga lartë, por nga ndryshimi i konceptit dhe botkuptimit të tërë shoqërisë apo të bashkësive që mund ta lëvizin tërë shoqërinë. Shoqëria duhet të bindet se vlerat morale dhe aplikimi i Islamit mund të bëjnë që sistemi i tyre të jetë Sheriati si ligj i legjislativit.”*¹⁴⁹

¹⁴⁹ Sejjid Kutub, **“Limadha a'demuni?”**; botoi: Kitabush-Sherkil-Eusat; distribuoi kompania “Esh-sherike es-Sauidijje lil-ebhadh vet-tesvik”; fq. 43.

Nga fjalët e profesorit shehid nënkuptojmë se shoqërinë duhet ta edukojmë me edukatë të vërtetë islame, e cila bazohet në Kur'an dhe Sunnet, dhe se kjo dëshmi e profesor Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!) është e qartë sikur Dielli dhe njëherit bindshëm na vërteton se ai nuk besonte në përdorimin e dhunës, fuqisë, shkatërrimit dhe eksplodimit për të arritur në pushtet, gjegjësisht përmes metodave të grushtshteteve apo revolucioneve, përkundrazi... Mirëpo, shumë shkrimtarë dhe hulumtues të huaj apo edhe arabë, me pa të drejtë, kanë ngritur akuza dhe kanë trilluar gënjeshtër nga më të ndryshmet për të dhe për partinë e **Vellezrve Musliman** që kanë fitu me shumicë të madhe në zgjedhjet demokratike të fundit në Egjipt, pas Revolucionit të 25 Janarit 2011...¹⁵⁰, por përseri armiqtë e Islamit dhe të Muslimanëve janë kah bëjnë trazira¹⁵¹ dhe demonstrata kundër presidentit Muhamed Mursi, duke e akuzuar partinë e **Vëllzërve Musliman** kinse ata kanë grabitur lulet dhe frytet e Revolucionit të 25 Janarit të vitit 2011!!

Kjo është argument dhe dëshmi shumë e fortë për pastërtinë e tij dhe të **Vëllezërve Muslimanë** nga trillimet e armiqtëve të tyre cionistë e kryqtarë dhe të bashkëpunëtorëve të tyre. Imam Hasan El-Benna, udhëheqësi i përgjithshëm i **Vëllezërve Muslimanë** (Zoti e mëshiroftë!) dhe profesor Sejjid Kutubi ishin shtyllat më të rëndësishme dhe më të mëdha të udhëheqësisë fetare që frymëzonin **Vëllezërit Muslimanë** me edukatë të shëndoshë islame dhe urtësi, ata aspak nuk thirrreshin në ekstremizëm, kryengritje, dhunë dhe vrasje, ndaj dhe akuzat për një gjë të tillë, janë tendencioze, me prapavijë (cioniste e kryqtare) dhe plotësisht të kota e të pakuptimta.

Nuk ka dyshim se ata gjykojnë nga larg sipas epsheve dhe paragjykimeve të tyre, e jo sipas të së vërtetës dhe realitetit, ngase sikur t'i lexonin me vëmendje mësimet e Imam Hasan El-Bennasë dhe mendimet e idetë e profesor Sejjid Kutubit (Zoti i mëshiroftë të dy!), do të kuptonin fare qartë, se ata të dy janë të pastër nga akuzat, shpifjet dhe gënjeshtër e këtilla. Ne kështu mendojmë për ta

¹⁵⁰ Akuzat, shpifjet dhe gënjeshtër e tilla vërehen në internet, siç vërehen edhe sulmet e ashpra kundër Islamit pas ngjarjes së 11 Shtatorit.

¹⁵¹ Javën që shkoj, dje dhe sot, data 03.02.2013, (Dr.Hfz.H.Hoxha) Doha-Qatar

dhe llogaritësi më i mirë i tyre gjithësesi është Zoti i Madhërishtëm! E, ne, para Zotit nuk mund ta pastrojmë askënd!¹⁵²

B). Natyra dhe universalizmi i kësaj feje

Këtu, vlen të theksojmë disa mendime të profesor Sejjid Kutubit, me të cilat sqaron natyrën e kësaj feje dhe universalizmin e saj për thirrësit në Zot. Thirrësi duhet të kuptojë se për shoqërinë është e përshtatshme metoda hyjnore e cila përbëhet nga mësimet e pastërta të Kur'anit Fisnik dhe Sunnetit të Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*).

Në këtë kontekst, profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Natyra e kësaj feje e bën të veten! Kjo është fê që mbështetet tërësisht në parimin e hyjnisë monoteiste. Të gjitha sistemet dhe të gjitha ligjet sheriatore dalin nga ky burim i madh. Kjo është sikur një lis i madh që bën hije të madhe dhe ka degë të gërshetuara që i rrijnë lartë dhe që ka nevojë për rrënjë të thella për ta mbrojtur trupin e vet. E tillë është edhe kjo fê, ngase sistemi i saj regullon çdo gjë në jetë.

Kjo fê i sistemon çështjet e të gjithë njerëzve, qofshin ata të mëdhenj apo të vegjël, sistemon jetën e njeriut, jo vetëm në çështjet e kësaj dynjaje, por edhe në ato të botës tjetër (ahiretit), jo vetëm në marrëdhëniet e dukshme materiale por edhe në ndjenja, në fshehtësi e qëllime! Kjo fê është institucion i madh, i gjerë, gjithpërfshirës dhe dominues, ndaj dhe për këtë shkak ka nevojë për rrënjë...!”¹⁵³

Ai (Zoti e mëshiroftë!), poashtu thotë:

“Ky është një aspekt i fshehtësisë dhe natyrës së kësaj feje, që përcakton metodën e vet për formimin e njeriut dhe më tej..., përcakton formimin e besimit, depërtimin e universalizmit të këtij besimi thellë në shpirt. Kjo është e domosdoshme për formim korrekt, sigurim për të siguruar raportin në mes

¹⁵² Shiko librin e mëparshëm nga fillimi deri në mbarim. Dr. Abdulhalim Mahmud, “**Menhexhuterbijeti indel-Ihvanil-Muslimin**”; studim analitik-historik, vëll. 1, 2 ;El-Mensura, Metabiu Daril-Vefi'n, bot. 2, 1992; “**Përmbledhja e mesazheve të Imam Hasan El-Bennasë**”; Darush-Shihab, pa vit dhe vend botimi.

¹⁵³ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâlil-Kur'an**”; vëll. 2, fq. 1009-1010.

formës së dukshme të drurit mbi tokë dhe rrënjëve të tij në thellësi të tokës. Kur të përcaktohet besimi: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!” - në brenditë më të thella, atëherë gjithsesi do të përforcohet edhe sistemi që del nga parimi: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”

Nënshtrimi është parim i besimit dhe nëpërmjet këtij nënshtrimi, njerëzit me kënaqësi dhe vullnet i pranojnë parimet e Islamit dhe ligjet e tij. Ata nuk i refuzojnë që në fillim dhe nuk i aplikojnë vetëm në mënyrë formale. Kështu do të zhduken vera (alkooli), kamata, bixhozi, traditat e xhahilijetit, tërë kjo- falë ajeteve të Kur’anit dhe haditheve të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Edhe pse qeveritë tokësore bëjnë përpjekje që t’i ndalojnë gjërat e tilla me ligje, sisteme, vendime, dekrete, ushtri, pushtet, propagandë e mediume, ata megjithatë, përsëri dështojnë në këtë gjë...”¹⁵⁴

Nga kjo që u tha më sipër, vërehet se metoda e profesor Sejjid Kutubit mbi të kuptuarit e ajeteve të da’vetit, gjatë dhënies së shembujve për njerëzit, ekskluzivisht mbështetej në Kur’anin Fisnik. Nga e gjithë kjo, ai tentonte të vërtetojë universalizmin e kësaj feje në çdo aspekt të jetës, si për të mëdhenjtë ashtu edhe për të vegjëlit, si për njerëzit e elitës, ashtu edhe për njerëzit e thjeshtë, të dukshmen dhe të padukshmen...

Pa universalizmin e tillë nuk do të mund të stabilizohet gjendja e muslimanëve dhe e gjeneratave të ardhëshme. Shembulli paraprak me lirin është shembulli më i mirë për thirrësit në Zot, mbi vlerën dhe rëndësinë e besimit, dhe para se gjithash: Mbi mbjelljen e tij në zemra.

C). Pikënisja - përcaktimi i rrugës së besimtarëve ndaj rrugës së kriminelëve

Ndokush mund të thotë: “Mirë, ne e pranojmë Kur’anin si metodë të jetës sonë, por cilat janë pikat dhe çfarë projekti ka kjo metodë hyjnore në besim e dinamikë, si dhe kush do t’i caktojë për ne pikëpamjet e kësaj metode? Ku është

¹⁵⁴ Sejjid Kutub, “Fi dhilâlil-Kur’an”; vëll. 2, fq. 1009-1010.

pikënisja? Në cilat parime duhet të mbështetemi për edukimin tonë dhe të shoqërisë sonë?”

Për t’iu përgjigjur këtyre pyetjeve, duhet patjetër të shqyrtojmë disa çështje të rëndësishme rreth thirrjes apo da’vetit në përmirësimin e shoqërisë, sipas metodës së vetme kur’anore, sipas vizionit të profesor Sejjid Kutubit. Vlen të theksojmë se disa nga këto çështje dhe sqarimin e tyre e kemi theksuam edhe më sipër.

Përgjigjen ndaj kësaj pyetje e gjejmë të ky dijetar idealist (Zoti e mëshiroftë!) kur e caktoi parimin e besimit për pikënisje dhe epiqendër. Siç duket, përsëritja e shumtë e kësaj çështjeje, na bën që të ndalemi më hollësisht në të, me qëllim që t’i sqarojmë dimensionet e saj fetare dhe domethënien edukative të saj.¹⁵⁵ Kjo pikënisje konsiston qartësinë dhe dallueshmërinë e rrugës së besimtarëve dhe jobesimtarëve, të mirëve dhe të këqinjëve, të singertive dhe hipokritëve...etj. Kur bëhet dallimi në mes të këtyre grupeve; atëherë kuptohet haptazi dhe në mënyrë decisive mesazhi i thirrjes sonë.

Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Nga kjo epiqendër duhet të fillojë çdo lëvizje islame për të përcaktuar rrugën e besimtarëve dhe rrugën e kriminelëve.

Duhet të fillosh me definimin e rrugës së besimtarëve dhe me definimin e rrugës së kriminelëve, për t’i dalluar besimtarët nga kriminelët në botën reale e jo në botën e teorive, dhe kështu thirrësit muslimanë dhe lëvizja islame do të dijnë se kush në të vërtetë është musliman e kush kriminel.

Pas përcaktimit të rrugës së besimtarëve, metodës dhe shenjave të tyre si dhe të rrugës së kriminelëve, metodës dhe shenjave të tyre, atëherë nuk do të përzihen këto dy rrugë, dhe për rrjedhojë nuk do të ketë gabim në adresë

¹⁵⁵ Rreth çështjes së dallimit dhe ndarjeve në mes rrugës së besimtarëve dhe asaj të idhujtarëve dhe injorantëve (xhahilëve) shiko në faqet vijuese të tefsirit të tij: **“Fi dhilâlil-Kur’an”**; vëll. 2; 1167, 1168, 1053, 1055, 1054, 1055, 1057, 1058, 1105, 1106, 1107, 1109, 1123, 1126, 1127, 1128, 1131, 1141, 1167, 1168, dhe faqet 1239, 1215 -vëll. 3.

dhe nuk do të ketë më përzierje në mes cilësive e karakteristikave të besimtarëve dhe atyre të kriminelëve.”¹⁵⁶

Për mos me e lënë lexuesin dhe thirësin të habitur dhe pa përgjigje për pyetjen e shtruar nga pytësi: se vallë çfarë është ajo rrugë?dhe e kujtë është? Profesori përgjigjet vet duke thënë se:

“Rruga e muslimanëve është rruga e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe e atyre që janë me të në këtë fê. Ky përcaktim ekzistonte dhe ky sqarim ishte i plotë, në ditën kur Islami i kundërshtonte idhujtarët në Gadishullin Arab. Rruga e muslimanëve të mirë është rruga e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe e atyre që ishin me të, ndërsa rruga e idhujtarëve kriminelë-ishte rruga e atyre që nuk ishin futur me të në këtë fê. Islami kudo e luftonte idhujtarinë, totemizmin, ateizmin dhe fetë e ndryshme të devijuara nga burimi qiellor, pas intervenimeve njerëzore. Islami, kudo dhe kurdo që ballafaqohej me këto sekte e fraksione, rrugën e kishte plotësisht të qartë: Ajo ishte rruga e besimtarëve të devotshëm, e cila tërësisht ishte e qartë, ashtu siç ishte e qartë edhe rruga e idhujtarëve jobesimtarë e kriminelë, dhe këtu, në këtë gjë, nuk ka kurrfarë përzierje apo hutie!”¹⁵⁷

Pas ilustrimit të pikënisjes dhe epiqendrës, ai vazhdon të flas për vështirësitë dhe peripecitë me të cilat do të ballafaqohen thirrësit për të realizuar Sheriatin e Allahut të Madhërishëm dhe për aplikimin e tij në tokë. Në këtë kontekst, ai (Zoti e mëshiroftë) thotë:

“Peripecia e madhe e cila do t’i sfidojë lëvizjet e Islamit dhe të vërtetës sot, nuk ka të bëjë me këtë, por ka të bëjë me ekzistimin e njerëzve nga radhët e muslimanëve, të cilët jetojnë në vendet që më parë ishin vatra të Islamit e të fesë dhe Sheriatit të Zotit, kurse tash, në tokat e tilla, njerëzit largohen nga Islami i vërtetë dhe atë (Islamit) e bartin vetëm në emra. Ata e mohojnë

¹⁵⁶ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâlil-Kur’an**”; vëll. 2, fq. 1106; Ahmed Faiz, “**Tarikud-da’veti fi dhilâlil-Kur’an**”; botoi: “Muessesetu Dar-Risaleti”; Bejrut, Liban, 1985; bot. 11, vëll. 1, fq. 153.

¹⁵⁷ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâlil-Kur’an**”; vëll. 2, fq. 1106; Ahmed Faiz, “**Tarikud-da’veti fi dhilâlil-Kur’an**”; botoi: “Muessese Dar-Risaleti”; Bejrut, Liban, 1985; bot. 11, vëll. 1, fq. 153.

besimin dhe realitetin e parimeve të Islamit, edhe pse mendojnë se kanë besim islam!”¹⁵⁸

Nga kjo që u cek më lartë prej fjalëve të profesor Sejjid Kutubit, duhet të kuptojmë mirë se Islami nuk mjafton me anën teorike, por kërkohet në mënyrë decizive edhe aspekti praktik i Islamit. Nuk mjafton për ne të emërtohem me emra musliman a ndërsa me veprat tona i kundërshtojmë parimet Islame. Profesori pastaj vazhdon t’ua sqarojë të vërtetën e Islamit thirrësve në Zot, duke u thënë:

“E vërteta e Islamit... Islami është dëshmi se “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”... Dëshmia: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!” vërehet në parimin e besimit se vetëm Zoti është Krijues i këtij Universi, se njerëzit vetëm Zotit duhet t’i drejtohen gjatë adhurimit dhe aktiviteteve tjera në jetë, se vetëm nga Zoti i marrin ligjet dhe se vetëm pushtetit të Tij i nështrohen në jetën e tyre...”

Secili individ që nuk dëshmon se “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!” në këtë kuptim, nuk konsiderohet se ka bërë dëshmi dhe se ka hyrë në Islam, përkundër asaj se ka emër, pseudonim apo rrjedhë islame.

Sot në tokë ka njerëz që kanë emra muslimanësh, janë nga rrjedha e muslimanëve dhe janë nga vendet të cilat një kohë ishin vatër e Islamit, por sot as njerëzit nuk dëshmojnë se “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”, e as ka vende të cilat, me plot kuptimin e fjalës besojnë në Zot... Vazhdon profsor Sejjid Kutubi në diagnozimin e problemit që ballafaqohen thirësit e Islamit dhe lëvizjet Islame, duke thënë:

Këto lëvizje, sot më së shumti vuajnë nga:

- Kaosi, paqartësia dhe tollovia që e kanë kapluar kuptimin e parimit: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”, si dhe të Islamit nga njëra anë dhe kuptimin e idhujtarisë e të injorancës (xhahilijetit) nga ana tjetër;

¹⁵⁸ Po aty; vëll. 1, fq. 153.

- *Mosqartësimi në mes rrugës së muslimanëve të devotshëm dhe rrugës së idhujtarëve kriminelë; dhe:*

- *Përzierja e simboleve dhe titujve, tollovia në mes të emrave e cilësisë dhe mosekzistimi i dallimeve në mes rrugëve.”¹⁵⁹*

Nga fjalët e mësipërme të profesor Sejjid Kutubit, qartë nënkuptohet se ai mbështetet në domosdoshmërinë e sqarimit të metodës islame, detajet e hollësitë e saj për Ummetin islam në përgjithësi, dhe për thirrësit në veçanti. Kjo është një pjesë nga metoda e tij në të kuptuarit e ajeteve të da’vetit, gjegjësisht nga indukcioni i koncepteve të tilla nga ajeti fisnik: **“Që të dalë në shesh rruga e kriminelëve.”** (El En’amë, 55).

Ai thekson se arsyeja e përzierjeve të nocioneve dhe koncepteve të muslimanëve, sot, në kohën tonë, është moskuptimi i kësaj teme dhe largimi i njerëzve nga mësimet dhe parimet e kësaj feje, si dhe ardhja gjer te përzierja e gjërave në të shumtën e rasteve.

Këtu vlen të theksohen disa çështje dhe problematika që kanë të bëjnë me atë që u theksua më sipër, gjegjësisht me përcaktimin e distancimit nga mëkatarët, kriminelët, dhe pyetjet që lindin më pas: Sa mund të largohemi prej tyre, prej cilëve të largohemi, si dhe a mund të ulemi dhe kur të ulemi me ta?!

Profesor Sejjid Kutubi thotë:

“Akoma ndiejmë se kemi nevojë të përcaktojmë se kush janë idhujtarë? Idhujtarë janë ata të cilët i bëjnë shirk Zotit në çështjet hyjnore:

- **qoftë në besimin në ndonjë tjetër krahas Zotit;**
 - **qoftë me simbolet adhuruese për ndonjë tjetër krahas me Zotin;**
- dhe:**
- **qoftë në pranimin e pushtetit dhe sheriatit nga ndonjë tjetër përveç Zotit.**

¹⁵⁹ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâlil-Kur’an**”; vëll. 2, fq. 1106.

Më mirë do të ishte sikur të thonim se të ai i cili ka lidhje me njërin nga këto tre pika - ata janë idhujtarë – edhe nëse quhen muslimanë! prandaj të jemi të bindur në fenë tonë!

Përkufizimi i shoqërimit me zullumqarët (idhujtarët), të cilët e konsiderojnë fenë si lojë dhe zbavitje! Veç u theksua më parë se kjo ka të bëjë me rikujtim dhe kujdes e jo për diçka tjetër! Apo nëse e marrin si lojë e zbavitje në çfarëdo mënyre që i theksuam më parë.”¹⁶⁰

Në kontekst të këtij ajeti, në librin “El-Xhami”u li ahkamil-Kur’an”, Imam El Kurtubiu thotë:

“Në këtë ajet kundërshtohen ata që mendojnë se imamët, që janë udhëheqës e argument, duhet të ulen me mëkatarët për t’i korrigjuar mendimet e tyre të gabuara!”

“Ne themi (këto janë fjalët e Sejjid Kutubit, vërejtje e H. Hoxhës) se ajeti lejon në mënyrë të kufizuar uljen apo shoqërimin e tyre (mëkatarëve) me qëllim të këshillimit, përkujtimit¹⁶¹ dhe të korrigjimit të ideve të tyre devijuese e të gabuara. Ndalohet mosreagimi ndaj fjalëve dhe veprave të mëkatarëve të devijuar, ngase në këtë mënyrë konstatohet se pranohet e keqja dhe dëshmohet kundër të vërtetës.

Këtu krijohet huti për njerëzit, lojë me fenë e Zotit dhe me fetarët, ndaj dhe për këtë shkak, në rast të tillë, duhet të ketë largim dhe distancim.”¹⁶²

Nga ajo që u theksua rreth metodës dhe sqarimit të profesor Sejjid Kutubit, gjegjësisht rreth ndarjes dhe distancimit nga mëkatarët dhe kriminelët, vërejmë se ai qëndrimin e tij e shpreh, duke u bazuar në ajetin kur’anor: **“Ja,**

¹⁶⁰ Sejjid Kutub, “Fi dhilâlil-Kur’an”; vëll. 2, fq. 1106.

¹⁶¹ **Sqarim:** Transmetohet se Imam Hasan El-Benna rreth da’vetit të njerëzve thoshte: **“Shpërndahuni çdokund përreth jush dhe përhapeni Islamin dhe da’vetin: Në dyqane e rrugë, shtëpi, xhamia e kafene! Në takime të përgjithshme apo të posaçme! Në fshatra, qytete e kryeqytete! Në fabrika e prodhimtari, çerdhe e shkolla!”** Më gjerësisht shih atë që e shkruanin udhëheqësit e **Vëllezërve Muslimanë** në revistën e tyre të da’vetit me rastin e kalimit të periudhës pesëdhjetëvjeçare nga rënia shehidit dhe Imamit të çmuar Hasan El Benna, Nr. 82, sheval, 1419 hixhri; Janar-shkurt 1999, fq. 14-16, 28-48.

¹⁶² Sejjid Kutub, “Fi dhilâlil-Kur’an”; vëll. 2, fq. 1129.

kështu Ne u sqarojmë argumentet në mënyrë që të dalë në shesh rruga e kriminelëve.” (El En’amë, 55)

“ Këtu vlen të përmendet problematika apo fenomeni negativ bashkëkohor i disa të rinjëve ekstremist shqiptar -*hoxhallarë dhe studentë*-, boshnjak, turq, anglez, amerikan pakistan, arab etj, ku ata në shumë raste janë bërë vegël destruktive më shumë se sa vegël konstruktive. Dmth, ata në të shumtën e rasteve që i kam përjetuar dhe i kam pa anëmbanë globit tokësor- *gjatë kohës së studimeve si student dhe si akademik nëpër universitete të ndryshme*- nuk e kanë të qartë këtë realitet. I kam pa ata duke diskutuar, debatuar dhe duke shaktuar probleme nëpër xhamija ku falen pes kohët e namazit nëpër qytetet e Kosovës dhe gjetiu, me pleq, besimtarë të udhëzuar, të drejtë, të pafajshëm; pa ndonjë arsye serioze apo shkencore domethënëse! Saqë ka shkaktuar kjo dukuri urretje te masa e gjerë, dhe në qarqe të ndryshme ndaj këtyre hoxhallarëve dhe studentëve!

Përkundrazi, ata duhet të dalin nëpër shitore, rruge, kafene, qajtore, shadërvane, qendra tregtare, shkolla, kompani të ndryshme, fakultete, bregdete, etj, etj. Aty ku kundërshtohet haptazi Allahu xh.sh. dhe Muhamedi a.s. Ata duhet të bëjnë dallimin e atyre që janë në rrugë të drejtë dhe atyre që janë në rrugë të shtrembur. Ata duhet ta kuptojnë mirë këtë ajet kur’anor për rreth se cilës e kemi edhe fjalën. Ata shokë, kolegë nuk bën me qenë viktima te djallit dhe të epshit të tyre. Ata duhet me pas punë dhe me ba da’vet me kriminel, vjedhësa, narkoman, alkoholiqar, ma ata që zhvillojnë tregti ilegale me organe te njerëzve, me mallra, me njerëz të korruptuar moralisht, financiarisht, shpirtnisht, familjarisht, politikisht, ekonomokisht, akademikisht...etj; e jo me i shqetësue xhematin nëpër Xhamija që falin pes kohët e namazit!”¹⁶³

Besoj se këto fjalë mjaftojnë për atë që dëshiron të përkujtojë dhe të orientohet me metodën e Kur’anit Fisnik, gjatë da’vetit në Zotin e Madhërishëm.

Ç). Historia islame argument për distancim nga mëkatarët

Ajeti kur’anor: *“E mua më është shpallur ky Kur’an që me të t’ju tërheq vërejtjen juve dhe atij që i komunikohet (dhe të gjithë atyre që vijnë pas jush*

¹⁶³ Këto komente i shtova ma datën 04.02.2013, Doha-Katar me rastin e recensimit dhe kontrollimit të përkthimit të librit tim para botimit të tij. *Dr.Hfz.Hajredin Hoxha*

deri në Ditën e Kijametit). Ju po dëshmoni se pos Allahut ka edhe zotra të tjerë, a? Thuaj: “Unë nuk dëshmoj!” (El En’amë, 19) - është një nga ajetet që flasin për da’vetin në mënyrë të nxitjes dhe pyetjes.

Sejjid Kutubi kur bën komentimin e këtij ajeti, ai e komenton këtë pjesë e cila theksohet në konstruksionin kur’anor të këtyre ajeteve si p.sh; çështje e miqësisë me jo besimtarët,(*el Vela’u*) monoteizmit (*el Tevhid*) dhe ajo e distancimit nga të keqinjët (*el Mufaselatu*).¹⁶⁴

Profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) vazhdon e thotë:

“Kjo çështje e këtij besimi dhe këtij parimi, është një e vërtetë e madhe, ndaj dhe për këtë, sot besimtari duhet të qëndrojë gjatë kohë para këtij mësimi hyjnor... Këtë shoqëri e sulmon i tërë xhahilijeti i botës, njësoj siç sulmohej kur u shpallën këto ajete për të përcaktuar pozitën e tyre dhe për të ecur sipas parimeve të tilla. Të tillët duhet të ulen gjatë para ajeteve të tilla për të projektuar rrugën e tyre të udhëzimit.

Koha është e njëjtë si atëherë kur iu shpall kjo fê njerëzimit, ashtu dhe sot. Njerëzit janë shndërruar njësoj siç ishin atëherë kur iu shpall Kur’ani Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe kur i erdhi Islami me sqarimet e veta të rregullës së madhe, gjegjësisht parimi i Dëshmisë: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”; ashtu siç, Rib’ij ibn Amir, ambasadori i Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), ia sqaroi udhëheqësit të persianëve Rrustemit, i cili kur e pyeti: “Çka u ka sjellë?”; Ri’biju iu përgjigj: “Zoti na dërgoi që ta transferojmë atë që don nga adhurimi i robërve në adhurimin e Zotit, nga devijimi i fesë në drejtësinë e Islamit”. Ai e dinte se Rrustemi dhe populli i tij nuk i besonin Kisras si Krijues i Universit dhe nuk i dhuronin sakrifica e dhurata, por merrnin prej tij ligje dhe në këtë kontekst e adhuronin atë, gjë kjo që në Islam, rreptësisht refuzohet dhe kundërshtohet. Ai i tha se Zoti i ka dërguar për t’i nxjerrë njerëzit nga sistemet

¹⁶⁴ Muhamed ibn Salim El-Kahtani, “*El-Vela’u vel-berau fil-Islam min mefahimi akidetis-selefi*”; Disertacion magjistrature i botuar. Bot. 1, 1401 hixhri, Tajjibe, Rijad, Arabia Saudite; Ky libër konsiderohet ndër më të mirët në këtë tematikë.

dhe gjendja e adhurimit të njerëzve në adhurimin e Zotit dhe në drejtësinë e Islamit...”¹⁶⁵

D). Çmimi i këtij distancimi dhe largimi

Nëse e kuptojmë tamam ashtu siç duhet çështjen e distancimit dhe të mosshoqërimit me zullumqarët dhe mëkatarët kriminelë, përpos me qëllim rikujtimi e këshillimi, atëherë kjo konsiderohet thelbi i besimit, dhe në këtë kontekst duhet të dijmë çmimin dhe sakrificat që duhet t’i bëjmë për gjërat e tilla...

Pra, të shohim në vijim se çka thotë profesori shehid rreth këtij çmimi:

“Distancimi dhe largimi mund t’i krijojë shoqërisë besimtare sakrifica e vështirësi, por, sakrificat dhe vështirësitë e tilla nuk kanë për të qenë më të dëmshme e më të mjerueshme se sa mosdallimi i qëndrimeve dhe koncepteve, për shkak të shoqërisë injorante (xhahilite) që jeton për rreth tyre.

Nëse i kthehemi historisë së da’vetit në Zot nga ana e të gjithë peygamberëve të Zotit, përfundimisht do të bindemi se ndihma e Zotit dhe realizimi i premtimit të Zotit për fitoren e peygamberëve të Tij dhe të besimtarëve, nuk ka ardhë menjëherë para ndarjes së shoqërisë së besimtarëve nga populli i tyre, për shkak të besimit dhe metodës së jetës (fesë), si dhe nga besimi i tyre injorant dhe jeta e tyre xhahilite. Kjo ishte pika ku ndaheshin të gjitha thirrjet dhe rruga e këtij da’veti është një, ndaj dhe për këtë shkak, rruga e tillë duhet të jetë ashtu siç ka qenë në kohën e të gjithë peygamberëve (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të gjithë ata!)”¹⁶⁶

¹⁶⁵ Sejjid Kutub, “Fi dhilâlil-Kur’an”; vëll. 2, fq. 1057.

¹⁶⁶ Muhamed ibn Salim El-Kahtani, “El-Velau vel-berau fil-Islam min mefahimil-akidetis-selefi”, fq. 40, kapitulli “El-velau vel-bera’u min levazimil-imam”; Kapitulli: “El-velau vel-berau fil-ahdil-mekkij”; fq. 60 dhe Kapitulli: “El-velau vel-bera’u fil-ahdil-medenij”; fq. 188. Në tefsirin e këtij ajeti: “*Thuaj: “Cili send ka dëshminë më të madhe? “Thuaj: “Allahu është Dëshmues mes meje e jush.”* (En’amë, 19) - Shejh Muhamed Reshid Rida thotë: “*Këtu ka pyetje për të konfirmuar me mohim e largim, dhe Zoti e udhëzoi që të përgjigjet se nuk dëshmon ashtu siç dëshmojnë ata. Pastaj Zoti i Madhërishëm e urdhëroi që të dëshmojë me dëshmi tjetër që ishte në kundërshtim me dëshminë e tij, gjegjësisht me dëshminë se “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”*, të distancohet nga idhujt që i adhurojnë dhe nga format tjera të shirkut-idhujtarisë. “*Thuaj: “Ai është vetëm një Zot!” edhe këtu e ripërsërit urdhërin pa e ndërlydhur me fjalët paraprake, ngase këtu për qëllim ka vetëm monoteizëm dhe nuk ka nevojë për të dëshmuar me idhujtari (shirk).”*

Aludojmë nga kjo q u tha më lartë se rruga e të mirëve duhet të dallohet nga ajo e të këqinjëve, e të drejtëve të dallohet nga ajo e kriminelëve, e të sinqertive nga ajo e hipokritëve, e të korruptuarëve nga ajo e të pastërve, ajo e Muslimanëve nga ajo e Qifutëve dhe e Krishterëve. Kjo metodë është metodë Kur'anore dhe profetike. Ai i cili e kundërshton atë dhe vepron kunder saj; ska dyshim se është larguar nga rruga e drejtë dhe është futur në rrugë të xhahilave.

3. Korrektimi i metodës së mendimit, hulumtimit dhe da'vetit sipas metodës gnostike dhe edukative

Kur'ani Fisnik erdhi për të korrigjuar shumë çështje dhe koncepte të xhahilijetit, si nga aspekti i moralit, jetës sociale, ashtu edhe nga aspekti ekonomik, prandaj sureja “**El En'amë**” është shembulli më i mirë i një korrektimi të tillë. Nga konceptet e gabuara të arabëve të cilat i shqyrtoi Kur'ani Fisnik, ishte edhe projektimi i rrugës, nëse dëshironin ta kuptonin këtë fê dhe natyrën e saj ashtu siç duhej, ndaj dhe i obligoi që fuqitë e tyre njerëzore dhe njohuritë e tyre të kufizoheshin t'i mbështesin në fê, si dhe të mos tejkalojnë në çështjet e padukshme që të mos hutohen dhe kështu, të humbasin në errësirat e injorancës, hamendjes dhe të hutisë...

Ne obligohemi që të respektojmë gjërat që i ka ndaluar, të mos zhytemi në çështjet e determinizmit dhe indeterminizmit (*kadasë dhe kaderit*), ashtu siç zhyteshin idhujtarët në çështje të tilla dhe thoshin: ***“E ata që i shoqëruan Zotit, do të thoshin: “Sikur të donte Allahu nuk do ti bënim shok (nuk do të ishim idhujtarë), as ne, as prindërit tanë, e as nuk do të ndalonim asnjë send.”*** (El En'amë, 148).

Profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) në tefsirin që i bën ajetit kur'anor ***“E ata që i shoqëruan Zotit, do të thoshin: “Sikur të donte Allahu nuk do ti bënim shok (nuk do të ishim idhujtarë), as ne as prindërit tanë, e as nuk do të ndalonim asnjë send. Kështu patën gënijer edhe ata që ishin para tyre derisa (për shkak të mëkatit) përjetuan dënimin tonë të ashpër. Thuaj: “A mos keni ndonjë fakt e të na e prezentoni atë neve?” Ju mbështeteni vetëm hamendjes, në të vërtetë vetëm gënjeni. Thuaj: “Allahu ka argumentin më të***

plotë dhe sikur të donte Ai, do t'ju vinte në rrugë të drejtë të gjithëve.” (El En'amë, 148-149); - thotë:

“Çështja e dytë kishte të bëjë me korrektimin e metodës së mendimit dhe persiatjes. Zoti i urdhëroi dhe i ndaloi nga veprat e këqija dhe këtë duhet ta dijnë dhe ta besojnë me bindje të plotë. Dëshira e Zotit është çështje e fshehtë dhe atë nuk mund ta dijë askush. Pra, si ta dijmë atë? E nëse nuk e dijmë, atëherë si të bindemi dhe si të mbështetemi në këtë?”

“Thuaj: “A mos keni ndonjë fakt e të na e prezentoni atë Neve?” “Ju i mbështeteni vetëm hamendjes, në të vërtetë vetëm gënjeni.”

Urdhërat dhe ndalesat e Zotit dihen në mënyrë kategorike, dhe pasiqë i dijnë, atëherë pse t'i braktisin ato e të thellohen në gjëra që nuk i dijnë? Kjo është përfundimtare rreth kësaj çështje. Zoti i Madhërishëm nuk i obligon njerëzit që të dijnë fshehtësinë dhe kaderin e Tij e as që të veprojnë sipas dëshirës së tyre, por i obligon që t'i dijnë urdhërat dhe ndalesat dhe të jetojnë sipas tyre. Kur përpiqen të bëjnë një gjë të tillë, Zoti i Madhërishëm i udhëzon, ua hapë zemrën në Islam, dhe në raste të tilla, kjo çështje duket shumë e lehtë dhe e qartë nga aspekti shkencor dhe është larg paqartësisë së dialogut e bisedave të tilla hamendëse!

Zoti i Madhërishëm ka mundësi që t'i krijojë njerëzit të udhëzuar, t'i drejtojë në udhëzim ose t'ua hedhë udhëzimin në zemrat e tyre e të udhëzohen fare lehtë, por Zoti i Madhërishëm dëshiroi që njerëzit t'i bëjë të kenë fuqi për t'u drejtuar kah udhëzimi ose humbja dhe t'i ndihmojë atij që dëshiron të udhëzohet, pra, t'ia mundësojë një gjë të tillë. Ai vepron sipas dëshirës së Vet!

“Thuaj: “Zotit i takon argumenti i madh (fortë), dhe sikur të dëshironte, do t'ju udhëzonte të gjithëve.” Kjo është çështje e qartë dhe e formuluar në një formë shumë të lehtë e të kapshme për njerëzit, prandaj për Islamin dhe për metodën islame, diskutimi rreth kësaj çështjeje është i panjohur, ngase asnjë dialog i tillë filozofik ose teologjik nuk ka përfunduar me ndonjë rezultat të kapshëm... Dialogu e shqyrton këtë çështje në një mënyrë që nuk

përputhet me natyrën e saj, ngase natyra e çdo të vërtete përcakton metodën¹⁶⁷ e shqyrtimit dhe mënyrën e zbrërthimit të saj. P.sh.:

- E vërteta materialiste mund të analizohet në bazë të eksperimenteve laboratorike;

- E vërteta matematikore mund të shqyrtohet nga aspekti i parimeve teorike;

- E vërteta metafizike duhet të analizohet me ndonjë metodë tjetër; dhe:

- Kjo është ashtu siç thamë më parë: ***“Metoda e shijes praktike të kësaj të vërtete nga aspekti praktik.”***

Si në të kaluarën, ashtu edhe sot, njerëzit janë përpjekur të zhvillojnë dialog e të shqyrtojnë çështjet mendore me metoda të tilla... Pastaj erdhi kjo fë (Islami) që të realizojë një realitet shkencor me urdhra e ndalesa të qarta, ndërsa thellimi në dëshirën metafizike është hyrje në huti, ngase aty flet mendja pa argumente dhe aty humbet energji e madhe, në vend që kjo energji të harxhohet në vepra pozitive, realiste e të dukshme¹⁶⁸ nga njëra anë, dhe nga ana tjetër u erdhi Kur’ani Fisnik me metodë gnostike e edukative, krejtësisht të re për ta. Profesor Sejjid Kutubi e ilustron këtë metodë gjatë tefsirit të tij të ajetit kur’anor: ***“Thuaj “Ecni nëpër tokë e mandej shikoni se si qe përfundimi i gënjeshtarëve.”*** (El En’amë, 11).

Këtu gjithsesi do të vërejmë një pjesë të rëndësishme të metodës së profesor Kutubit, të cilën ai e përdori gjatë tefsirit të ajeteve që ka të bëjë me rëndësinë e historisë dhe me rolin e saj në edukimin e gjeneratave. Ne poashtu do të vërejmë se si ai i sqaron pikat qendrore dhe shtyllat e studimit të historisë nga aspekti islam¹⁶⁹.

¹⁶⁷ Rreth ketyre qeshtjeve te rendesishme.. shih analizen dhe studimin detal te Sheikh prof.Dr.Seid Ramadan al Buti, hyrjen e librit te tij: **Kubra el Jekijnijat el Keunije**, fq: 10-70, ke per te hasur ne reaalitete shume te dobishme per jeten dhe mendimin tone.

¹⁶⁸ Sejjid Kutub, **“Fi dhilâil-Kur’an”**; vëll. 3, fq. 1227.

¹⁶⁹ E patëm nderin që në dizertacionin e doktoraturës, në kapitullin e parë të saj (100 faqet e para) të bejmë një studim dhe analizë kritike të historisë sonë shqiptare, asaj antike dhe moderne nga kendveshtrimi Islam, i cili ka qenë studmi i parë i ketij lloji në ato vite kur është bërë studimi (2003) dhe kemi apelue për rishkrimin e historisë sonë të devijuar..më gjerësisht referoju librit

Në shumë vende të tefsirit të tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”** kërkon rishkrimin e historisë islame prej fillimit. Arabët ecnin nëpër tokë për shkaqe tregtie e jetese dhe nuk ua vënin veshin gënjeshtarëve kur kalonin rreth shtëpive të tyre natën e ditën, e as që i dëgjonin. Në kontekst të kësaj, Kur’ani fisnik thotë: **“E ju (mekas) me siguri kaloni aty pari mëngjes (ditën) e mbrëmje (natën). Pra, a nuk mblidhni mend?”** (El Saffatë, 137-138).

Zoti i Madhërishtëm dëshiron që t’i informojë ata, neve dhe gjeneratave që do të vijnë pas nesh, deri në Ditën e Kijametit se jeta në tokë duhet të eci ashtu siç thekson Ai (Zoti) duke marrë mësim e këshilla dhe të mos i dënojë Zoti ashtu siç i dënoi ata (popujt e mëparshëm)...

Ky ajet është një ndër ajetet që flasin për da’vetin (thirrjen) por në mënyrë këshilluese. Të shohim se ç’thotë profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) rreth kësaj çështjeje. Në tefsirin e ajetit kur’anor: **“Thuaj: “Ecni nëpër tokë e mandej shiheni se si qe përfundimi i gënjeshtarëve”.** (El En’amë, 11); - ai thotë:

“Ecja nëpër tokë duhet të ketë qëllim shikimi, mendimi e persiatjeje si dhe për t’i njohur ligjet e Zotit, të regjistruara në ngjarje e ndodhi dhe në gjurmë të dukshme, gjegjësisht në historinë e transmetuar nga ngjarjet që reflektohen përmes gjurmëve në tokë e në popuj.

Pra, ecja duhet të jetë e kësaj natyre dhe duhet të realizohet me vetëdije dhe për qëllime të tilla. Natyrisht se për arabët të gjitha këto gjëra ishin të reja!

Paramendo transformimin që ua bëri metoda islame hyjnore prej xhahilijetit në këtë nivel të vetëdijes, mendimit, zbërthimit dhe njohurive. Ata duhej të ecnin sipas metodës gnostike-edukative dhe kjo ishte diçka e re për ta. Kjo metodë e re i barti ata prej xhahilijetit në rrugën që lartëson deri në pedestal.”¹⁷⁰

tone:Doc.Dr.Hfz.Hajredin Hoxha, **Doktrinat e Tefsirit në Trojet Shqiptare, shek 19&20**, Shtëpia botuese Cabej, bot.1,Tetovë, 2010.(shën, i autorit;H.Hoxha, Doha, Katar 2013)

¹⁷⁰ Dr. Imaduddin Halil, **“Fit-tarihi fikretun ve minhaxhun”**; bot.1, Bejrut, 1996.

Më pas, Sejjid Kutubi e përfundon fjalën e tij rreth kësaj çështjeje të rëndësishme duke thënë:

“Kjo metodë, nga aspekti i komentimit të historisë ishte diçka e re për intelektin njerëzor të asaj kohe, ngase nuk kishte shumë informata historike, përpos transmetimeve nga ngjarjet, traditat dhe njerëzit, por pa pasur ndonjë metodë analitike ose strukturale që i ndërlihdh ngjarjet në mes veti, ashtu siç ndërlihdhen sot, në mes premisave dhe rezultateve si dhe në mes periudhave e ngarjeve.

Metoda kur’anore i ngriti njerëzit në lartësi të tilla dhe i obligoi që të përdorin metodën e shikimit në ngjarjet e historisë njerëzore. Kjo metodë nuk është periudhë e mënyrave, mendimit apo e njohurisë, jo, por është metodë që i jep komentim të saktë historisë njerëzore.”¹⁷¹

Nga kjo që u cek më lartë rreth tefsirit të ajetit Kur’anor mund të nxjerrim shumë mësim të rëndësishme për jetën tonë. Sa herë që ndëgjojmë për termete, vërshime, vullkane, tsunami, kallje të pyjeve, stuhi, të reshura atmosferike (shi, borë), epidemi, uri, thatësi, etj etj, ne duhet të marim mësim nga këto ndodhi dhe ti lutemi Allahut xh.sh. për mirqenien tonë. Të ruhem nga shkaqet që na shpiejnë drejt hidhërimit të Allahut xh.sh, dhe të marim mësim prej këtyre ndodhive katastrofale që sot e kanë kapluar tërë planetin tonë. Ti analizojmë veprat, dukuritë negative të atyre popujve që janv sprovuar me këso sprova të rënda, në mënyrë që ta evitojmë dënimin e Allahut Fuqiptotë, me teube dhe istigfar dhe korixhim të veprave individuale apo kolektive, me urdhëresë kah e mira dhe ndalimin nga e keqja.

¹⁷¹ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâil-Kur’an**”, vëll. 2, fq. 1045-1046; Sejjid Kutub, “**Hasaisut-tesavuril-Islami ve mukav-vimatuhu**”; Pjesa e dytë: “**Et-tefsirul-Islami lit-tarih**”.

4. Thirrja e jobesimtarëve në Islam

A). Thirrja (da'veti) në bazë të rrugës së shikimit dhe persiatjes rreth ajeteve të Universit

Islami është fê ndërkombëtare dhe mesazhi i tij është mesazh botëror. Dërgimi i Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ishte i përgjithshëm për mbarë njerëzit e xhinët, për besimtarin, për të mirin e të keqin, në këtë kontekst, Zoti i Madhërishtëm thotë:

“Ne nuk të dërguam ty ndryshe vetëm se për të gjithë njerëzit”. (Sebe'e, 28).

“Unë jam i Dërguari i Allahut te të gjithë ju”. (El a'raf, 158).

“Dhe nuk të dërguam ty përpos mëshirë për botët!” (El enbija, 107).

“Po ai (Kur'ani) nuk është tjetër vetëm se këshillë për botën (e njerëzve e të xhinëve)”. (El kalem, 52).

“Është i Madhëruar Ai, që ia shpalli Kur'anin (dallues të së vërtetës nga e pavërteta) robit të Vet (Muhammedit) që të bëhet Pejgamber i botës (këshillues)”. (El furkan, 1).

Në **“Sahih”** transmetohet nga Ebu Hurejra se Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Jam vlerësuar më shumë se pejgamberët tjerë me gjashtë (karakteristika): “Më janë dhënë të gjitha dituritë, nuk kam frikë, më është lejuar pasuria e luftës, e gjithë toka më është bërë xhami (vend për t'u falur), u dërgova për të gjitha krijesat dhe jam vula e pejgamberëve.”¹⁷²

Në një transmetim, tjetër thuhet: *“Çdo pejgamber i dërgohej vetëm popullit të vet, ndërsa unë u dërgova për të kuqin e të ziun.”¹⁷³*

¹⁷² **“Sahihul-Muslim”**; vëll. 1, fq. 371; **“Kitabul-Mesaxhid ve mevadius-salat”**; botoi: Mektebetu ve metba'atu, Darul- ihjail-kutubil-arabijjeti; komentoi: Muhamed Fuad Abdulbaki. Hadithin e nxori Imam Tirmidhiu, vëll. 3, fq. 56; i cili thotë: **“Ky hadith është hasen sahih”**. Transmetim nga dr. Muhamed Sejjid ibn El-Habib: **“Ed-da'vetu ila llahi fi sureti Ibrahim El-halil”**; Kajro, bot. 2.; botoi Abdullah Baba Esh-Shenkitij, Mektebetu ve metba'atu Daru ihjail-kutubil-arabijjeti, fq. 136.

¹⁷³ Transmeton Imam Buhariu në **“Sahihun”** e tij; vëll. 1, fq. 91; **“Kitabut-tejjeummum”**; po aty, fq. 137.

Ai që i kupton këto ajete dhe hadithe që flasin për universalizëm, do të kuptojë se mesazhi i Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është i përgjithshëm për të gjithë njerëzit...

Islami na urdhëron që t'i thërrasim muslimanët dhe jomuslimanët, që të shpëtojmë nga përgjegjësia, dhe këtu vërehet qartë mrekullia e Islamit si vulë e mesazheve të mëparshme hyjnore, si dhe vlera e tij superiore ndaj mesazheve të mëparshme.

Biografia e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është e pasur me argumente, situata e rrëfime të vërteta autentike...; Pejgamberi a.s. u dërgoi disa mesazhe udhëheqësve, mbretërve e prijësve të fiseve për t'i thirrur në Islam. Disa prej tyre iu përgjigjën thirrjes së tij, u udhëzuan dhe pranuan Islamin, ndërsa disa të tjerë refuzuan e kundërshtuan, bënë mëkate, nuk besuan dhe u ngritën në këmbë (u rebeluan)...

Islami nuk erdhi që t'i shpëtojë vetëm muslimanët nga injoranca (xhahilijeti) por tërë botën. Da'veti i Islamit është i qartë dhe transparent, ndaj dhe kush dëshiron beson, e kush dëshiron bën kufër, ngase nuk ka dhunë në fê.

Në këtë kontekst Zoti i Madhërisëm thotë:

“Thuaj: Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras te Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është Allahu, e unë nuk jam nga idhujtarët”. (Jusuf, 108).

Fakt është se sot, shumë jobesimtarë nuk e njohin fare të vërtetën e Islamit, Kur'anit dhe Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) Në Kur'an thuhet për Ithtarët e Librit që jetonin në kohën e Pejgamberit a.s:

“Atyre që u kemi dhënë Librin, ata e njohin atë (Muhammedin) siç i njohin bijtë e vet, e një grup prej tyre edhe pse e dinë këtë, janë duke fshehur të vërtetën”. (El-Bekare, 146).

Ata i dinë këto të vërteta dhe këto gjëra shumë mirë dhe bëjnë orvatje të mëdha, përfshirë orientalistët dhe misionarët e ndryshëm, për t'i larguar njerëzit nga Islami në përgjithësi, dhe muslimanët në veçanti sic po ndodh tek ne në Kosovë, Shqipëri, ku numri shoqatave evangjeliste dhe të krishterë ka marv

përmasa të mëdha¹⁷⁴. Këta kanë ndikim të madh botëror në mediumet e ndryshme botërore, qofshin ato perëndimore, arabe apo edhe islame.¹⁷⁵

Sidoqoftë ne jemi të urdhëruar që t'i thirrjmë në tavolinën e Islamit. Nuk ka vetëm një metodë të posaçme e korrekte për thirrjen e tyre, por ekzistojnë shumë metoda nga më të ndryshmet për t'ua transmetuar këtë besim dhe këtë dritë. Të gjithë ne, përfshirë thirrësit, udhëheqësit e grupeve dhe lëvizjeve islame, obligohemi që të zgjedhim rrugën dhe mënyrën më të lehtë e më të përshtatshme si dhe të zhvillojmë dialog në formën më të mirë e më të vlefshme të mundshme, ngase kështu na urdhëroi Zoti i Madhërishëm dhe Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)

Në këtë kontekst, Zoti i Madhërishëm thotë:

“Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai e di më së miri për të udhëzuarit“. (Nahl, 125).

“Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos Allahut, e (si hakmarrje) të fyejnë Allahun nga armiqësia duke mos ditur (për Madhërinë e Tij).” (El En’amë, 108).

Nga metodat që patën sukses në thirrjen e jobesimtarëve dhe të gjithë njerëzve është metoda e shikimit të shenjave dhe argumenteve në Universin e gjërë e të mbushur plotë me argumente folëse, të cilat e konfirmojnë ekzistimin dhe monoteizmin e Zotit.

Në këtë kontekst, Zoti i Madhërishëm thotë:

“Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës..., ka argumente të qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt”. (Ali-Imran, 190).

“Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në detë që u sjell dobi njerëzve, në atë shi e që e lëshon Allahu prej së larti e me te ngjallë tokën pas vdekjes së saj dhe përhapë

¹⁷⁴ Rreth ketyre shoqatave krishtere dhe rolit te tyre te rrezikshem referoju studimit te Mr.Fehim Daragusha, me titull: **El Edjan ve el Harekat el Tebshirije fi Kosova**, (Dizertacion Magjistrature) bot,1, 2009. Brunei

¹⁷⁵ Lexuesit te nderuar duhet t'i lexojë faqet e tefsirit të tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”** që të furnizohet me më shumë të dhëna mbi projektet e çifutëve, të krishterëve dhe orientalistëve kundër Islamit. Argumentet që i thekson shehid Sejjid Kutubi mund të mos jenë në duart e të tjerëve. Rreth projekteve të tilla shikoni vëllimin e 1 të **“Dhilâlil-it”** të tij, gjejësisht faqet: 1032, 1033, 1034, 1061, 1087, 1094; Ndërsa në vëllimin 3, shikoni në faqet 1195, 1201, 1208, 1218.

në të nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e tokës (në të gjitha këto), për një popull që ka mend ka argumente”. (El-Bekare, 16).

Shejhul-Islam Ibn Tejjmije (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Bindja ndodh edhe nga persiatja rreth Kur’anit dhe ajeteve që flasin për njerëzit, për horizontet dhe për veprat në bazë të diturisë...”¹⁷⁶

Edhe Imam Gazaliu në librin e tij voluminoz **“Ihjau Ulumiddin”**, flet rreth vlerës dhe të vërtetës së persiatjes e meditimit.¹⁷⁷

Kjo hyrje është e domosdoshme para se të filloj bisedën rreth mendimit të profesor Sejjid Kutubit që i ka shprehur në tefsirin e tij rreth kësaj çështje të rëndësishme gjatë tefsirit të ajeteve kur’anore dhe si ai, ua prezantonte ajetet e Zotit jobesimtarëve nëpërmes metodës së shikimit, persiatjes e zbulimit.

Në tefsirin e tij që i bën ajetit kur’anor:

“Ai është që lëshoi nga lartë shiun e me të nxorri bimën e çdo sendit dhe prej bimës gjelbrim dhe prej tij (prej gjelbërimit) kokrra të dendura në kallinj. E nga hurmet, nga sythat e tyre kalaveshë të afërt (për t’i vjelë). Edhe kopshtin me hardhi ullinj e shegë të ngjashme (në dukje) e të llojlojshme (në shije). Shikoni pra frutat e tyre kur i formojnë dhe kur piqen (të gjitha këto nga shiu). Edhe në këto ka fakte për njerëzit që besojnë”. (El En’amë, 99) - ai thotë:

“Roli i ujit nëpër çdo gjë është një rol që e sheh çdokush shumë qartë, goftë analfabet apo intelektual, i prapambetur ose i civilizuar. Roli i ujit është më i madh se ajo që vërehet, dhe kjo theksohet edhe në Kur’an. Me caktimin e Zotit, uji e bëri cipën e tokës të pjellshme. (Nëse është e vërtetë, sipas disa teorive, sipërfaqja e tokës në fillim ka qenë e zjarrtë pastaj e thatë dhe jo e përshtatshme për mbjellje, e pastaj me ndihmën e ujit dhe nën ndikimin e faktorëve atmosferikë, ndryshohet në dhë të butë). Uji e zbutë këtë shtresë të fortë me nitrogjen-azot, dhe sa herë që del rrufeja, formohet elektricitet, pastaj nga retë bie shiu për të kthyer pjellshmërinë në pushtet.

Njeriu i imiton ligjet e Universit dhe formon ushqim artificial në të njëjtën mënyrë. Nëse kjo lëndë (uji) nuk ekziston, zhduket pjellshmëria e tokës në tërësi!

¹⁷⁶ Ahmed Ibn Tejjmije, **“Muxhmu’ul-fetava”**, vëll.3, fq. 330. **“Muxhmel-l’tikadus-selef”**.

¹⁷⁷ Salih Ahmed Esh-Shami, **“El-Mudheh-heb min Ihjai Ulumid-din”**; Darul-Kalem, Bejrut, vëll. 2, fq. 420-440.

Zbulimet bashkëkohore konfirmojnë rolin e madh të ujit në këtë jetë...(A nuk thuhej në Kur'an: “Vërtetë në këtë ka argumente për popullin që beson...”)

Besimi i hap zemrat, ndriçon të pamurit, i nxitë aparatet përceptuese të instiktit dhe njeriun e bën të gjallë si dhe e thirrë intuitën të besojë në Zotin, Krijuesin e çdo gjëje. Sikur të ndodhte e kundërta, zemrat do të ishin të vulosura, sytë të mbyllur, instikti i ngulfatur dhe nuk ndjen asgjë, madje edhe nëse kalon rreth krijimit të tillë pa u përgjigjur fare “Përgjigjen ata që dëgjojnë...” Vetëm ata që besojnë i kuptojnë këto ajete!”¹⁷⁸

Nga kjo analizë e krijimit, vërehet qartë metoda e profesor Sejjid Kutubit gjatë jetesës së tij nën hije të këtij ajeti, që është një ndër ajetet që flasin për da'vetin, por me një përsëritje të begative të Zotit me qëllim që t'ia përkujtojnë njeriut një gjë të tillë: **“Këtë metodë obligohen që ta aplikojnë thirrësit!”**

Ekziston edhe një metodë tjetër, të cilën e përdor profesor Sejjid Kutubi në thirrjen e jobesimtarëve në besim për të konfirmuar ekzistimin e Krijuesit dhe Kreatorit të Madhërishëm. Sipas mendimit të Sejjid Kutubit, shkencat kozmologjike nuk mohojnë ekzistimin e Zotit të Madhërishëm por e kundërta e kësaj është e vërtetë.

Në këtë kontekst, ai dëshmon me thënie e deklarata të dijetarëve specialistë për të konfirmuar të vërtetat e tilla. Ai e zbërthen ateizmin në Perëndim dhe e definon si sëmundje të fesë dhe konceptit të Zotit nën ndikimin negativ të kishës, dhe në vazhdim do të shohim se si i shqyrton çështjet e tilla:

“Pakica e veçantë sot diskuton për ekzistimin e Zotit pa u mbështetur në shkencë, ngase shkenca nuk e pranon ateizmin, sepse nuk mund ta argumentojë një gjë të tillë, as nga ndonjë fakt shkencor e as nga natyra e Universit. Kjo e keqe i ka kapluar nga kisha dhe nga “Zoti i kishës”, ngase nuk mbështetej në asnjë parim fetar. Natyra instiktive e diskutuesve të tillë ndikon negativisht në rolin themelor të qenies njerëzore, ashtu siç ndodh metamorfoza e krijesave!

E vërteta e krijimit (si e vërteta e lulëzimit të jetës) nuk theksohet në Kur'an pa konfirmimin e ekzistimit të Zotit ngase diskutimi rreth kësaj çështje nuk ka vlerë të madhe dhe nuk meriton një qasje serioze në Kur'an, por

¹⁷⁸ Sejjid Kutub, “Fi dhilâliil-Kur'an”; vëll. 2, fq. 1162.

përdorej vetëm për t'i drejtuar njerëzit në rrugë të drejtë si dhe gjatë jetës së tyre të jenë të bindur në monoteizmin e Zotit, në adhurimin e Tij, në Fuqinë e Tij, në Pushtetin e Tij dhe në të vërteta të tjera! Pra, vetëm Atij i takon adhurimi dhe nuk ka nevojë për shok...!

Xhulian Haksli, autori i veprave: “Njeriu nuk qëndron vet” dhe “Njeriu në botën moderne”, thekson disa ide që janë të pabaza dhe rrjedhin nga imagjinata e tij.

Në librin “Njeriu në botën moderne”, gjegjësisht në kapitullin: “Feja si çështje objektive”, flet gjëra të tilla të çuditshme dhe thotë:

“Progresi i shkencave; i logjikës dhe i psikologjisë - ka ndikuar që Zoti të jetë i padobishëm, ndaj dhe e kanë dëbuar shkencat natyrore nga intelektet tona sa që është zhdukur si krijues i Universit dhe është bërë vetëm “arsye e parë” ose parim i përgjithshëm dhe i paqartë”.

Vili Deurant, autor i veprës “Ndriçimet e filosofisë” thotë:

“Filosofia hulumton Zotin, por jo Zotin e teologëve që e parashohin si diçka jashtë botës së natyrës. Ajo hulumton zotin e filosofëve që është ligj i botës... edhe pse thuhet, është vështirë të pranohet”.

Ne nuk i konsiderojmë argument të Kur'anit e as si argument për intelektet tona të disiplinuar me udhëzues të Kur'anit, por i theksojmë si dijetarë të diturisë njerëzore, të cilët merren seriozisht me këtë çështje.

Xhon Klivland Kotran, kimist e matematicient, doktor i Universitetit të Kornellit, njëherit edhe shef i Departamentit të Shkencave Natyrore i Univeritetit të Dolthit dhe autor i librit: “Zoti manifestohet në kohën e shkencës”, në kapitullin: “Rezultati i domosdoshëm”, thotë:

“A mund të paramendojë ndonjë i mençur, ose të besojë se materia është larg intelektit dhe urtësisë dhe se ajo befas vetë e ka krijuar veten e saj? Apo ajo e ka krijuar këtë sistem dhe këto ligje, e pastaj ato ai ka imponuar vetvetes? Nuk ka dyshim se përgjigjja do të jetë negative. Materia shndërrohet në energji ose kur energjia shndërrohet në materie, ndodhë procesi sipas ligjeve konkrete dhe kështu edhe materia u nënshtrohet ligjeve të njëjta, të cilat vetë ajo paraprakisht i krijoi...”

Mirëpo, nga ana tjetër kimia argumenton se disa materie zhduken dhe humbasin, madje disa zhduken me shpejtësi të madhe, ndërsa disa të tjera më ngadalë, dhe kështu, materia nuk është as e përhershme e as eternale, ngase

ka fillim. Argumentet kimike dhe të shkencave tjera konfirmojnë se fillimi i materies nuk ka qenë i ngadalshëm e as gradual, por është gjetur papritmas dhe kështu, shkencat e tilla kanë mundësi të na caktojnë kohën kur janë formuar materiet e tilla.

Nga kjo nënkuptohet se kjo botë materiale duhet të jetë e krijuar dhe se, që nga krijimi i saj, lëviz në bazë të ligjeve dhe rregullave të caktuara kozmologjike, dhe kështu, zhduket teoria e befasisë. Pasi që kjo botë nuk mund ta krijojë veten e vet e as ligjet e veta, atëherë patjetër duhet të ekzistojë një Krijues që është jomaterial. Të gjitha argumentet konfirmojnë se ky Krijues duhet të jetë i mençur dhe i urtë.

Intelekti nuk mund të funksionojë në botën materiale (siç thuhet në mjekësi e psikologji) pa pasur dëshirë, dhe ai që dëshiron patjetër të jetë ekzistent nga vetja e vet. Rezultati i logjikshëm i intelektit tonë është se ky Univers, jo vetëm që ka Krijues, por Krijuesi i saj duhet të jetë i Urtë, i Gjithdijshëm dhe i Fuqishëm për çdo gjë që të ketë mundësi të krijojë, sistematizojë e rregullojë këtë Univers.

Ky Krijues duhet të jetë Ekzistent, i Përhershëm dhe të manifestojë faktet e Tij në çdo vend. Dhe kështu, detyrohem të pranojmë ekzistimin e Zotit, Krijuesit dhe Mbikqyrësit të këtij Universi, ashtu siç thamë në fillim të këtij pasusi: “Progresi i shkencave që nga koha e Kalvinit, na bën që të bindemi si asnjëherë më parë, se ne, nëse mendojmë thellë, shkencat do të na obligojnë që të besojmë në Zot.”

Frank Alen, naturalist dhe biolog, në librin e tij: “Formimi i botës, rastësi apo qëllim?”, thotë:

“Shumë herë thuhet se ky Univers material nuk ka nevojë për krijues pa ne. Nëse pranojmë se ky Univers ekziston, atëherë si do ta sqarojmë ekzistimin e tij? Rreth kësaj çështje, ekzistojnë këto teori:

- 1. Ky Univers është iluzion dhe kjo kundërshton atë që e thamë më parë rreth ekzistimit të saj;*
- 2. Kjo botë është e përhershme pa fillim; dhe:*
- 3. Kjo botë ka krijues.*

Teoria e parë nuk është asgjë tjetër përveçse një teorie emocionale, ngase atë që e shohim nuk është diçka tjetër përveç iluzion dhe nuk është e vërtetë. Kohëve të fundit, Xhejms Xhinsi i kthehet këtij mendimi dhe thotë se “Universi

në të vërtetë nuk ekziston, por është vetëm parafytyrim në iluzionet tona.” Mirëpo, në bazë të kësaj teorie, mund të themi se ne jetojmë në botën e iluzioneve, si p.sh. trenat që i shohim e që i prekim janë iluzione, udhëtarët janë iluzion, kalojmë lumenj që nuk janë të vërtetë, ecim mbi ura jomateriale etj. Ky mendim është totalisht iluzion i skajshëm, ndaj dhe nuk meriton të shqyrtohet e as të polemizohet!

Sipas mendimit të dytë, kjo botë, përfshirë materien dhe energjinë, u krijua nga hiçi, andaj as kjo teori nuk është më e mirë se ajo e para, ndaj dhe për këtë shkak nuk meriton të shqyrtohet, e as që ia vlen të polemizohet.

Sipas mendimit të tretë, Universi është i përhershëm dhe pa fund. Ky mendim ndërlidhet me mendimin që thotë se ky Univers ka Krijues, por dallohet në parimin se është i pafillim. Pra, përhershmeria duhet t’i përket ose botës që vdes ose Zotit që është i Gjallë e që krijon, dhe nuk është vështirë të zgjedhim mendimin më të përshtatshëm dhe më adekuat.

Ligjet e “termodinamikës” vërtetojnë se Universi dalë ngadalë po e humbet energjinë, sa që një ditë kjo nxehtësi do të arrijë në një shkallë shumë të ulët, gjegjësisht në zero absolute dhe atëherë, do të zhduket energjia dhe jeta do të jetë e pamundshme. Pra, në këtë situatë të zeros absolute, krijesat dhe trupat do të zhduken me kalimin e kohës.

Dielli i ndritshëm, yjet që xixëllojnë dhe toka e pasur me lloje të ndryshme të jetës - janë argumente të qarta se burimi i Universit ndërlidhet me një kohë të caktuar që ka nisur në një moment konkret, dhe në këtë mënyrë janë krijuar krijesat. Kjo nënkupton se Universi duhet të ketë Krijues të përhershëm, i Cili është pa fillim, i Gjithdijshëm për çdo gjë, i Fuqishëm me fuqi të pakufizuar dhe se Ai është Krijues i këtij Universi.”¹⁷⁹

Lexuesi vëren se metoda e profesor Sejid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!) ka të bëjë me thëniet e dijetarëve dhe të filosofëve europianë, si argument kundër atyre që mohojnë ekzistimin e Zotit të Madhërishtëm. Kjo metodë vlen të ndiqet

¹⁷⁹ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâlil-Kur’an**”; vëll. 2, fq. 1164, 1166. I nderuar lexues! Sinqerisht kërkoj falje për këtë tekst kaq të gjatë, por e theksova për një arsye shumë të rëndësishme, gjegjësisht për të treguar se shumë thirrës muslimanë, që nuk janë specialistë të shkencave kozmologjike, nuk mund t’ua servojnë muslimanëve këto të vërteta shkencore e as jomuslimanëve ashtu siç duhet, për shumë shkaqe, edhe pse tentojnë me të madhe që t’i sqarojnë dhe përpiqen t’i sqarojnë të vërtetat e tilla. Që të mos akuzohemi për injorancë dhe keqinterpretim, e pashë të udhës që këto çështje t’i transmetoj nga ekspertë e specialistë, edhe pse nuk janë të fesë tonë, por me qëllim që të jem më bindës dhe më i kapshëm për kundërshtarit. Uroj ta kem bërë më të mirën!

në jetën tonë të përditshme gjatë diskutimit, polemikës sonë me ateistë, sekular, filosof, jobesimtar; ngase mund të përdoret për të argumentuar me mendimet e tyre rreth çështjeve shkencore.

B). Thirrja e jobesimtarëve në bazë të dialogut të qëlluar dhe diskutimit më të mirë

Ky pasus ka vlerë shumë të rëndësishme, përkundër asaj se në fillim është shqyrtuar në mënyrë të thuktë. Këtu, tani do të përpiqem që të jap një zberthim pak më të gjerë e më të detajshëm.

Shumë njerëz e thirrës janë marrë me da'vet në mbarë botën dhe disa prej tyre e kanë kuptuar urtësinë e aktivitetit të tillë, janë orvatur që të realizojnë rrugën e pejgamberëve dhe të dërguarëve (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ta!*) dhe e kanë kryer me sukses obligimin e tyre, duke korrë fitore kundër vetes dhe kundër armiqëve të tyre. Mirëpo disa prej tyre, nuk e kanë kuptuar veprën dhe rolin e misionit të tyre, duke menduar se da'veti duhet bërë vetëm disa ditë, disa muaj ose disa vite, dhe kështu, kanë dështuar dhe pësuar disfatë pa e arritur pëlqimin e Zotit të tyre...

Sipas mendimit tim, thirrësi(hoxha, studiuesi i shekncave Islame) në Zotin e Madhërishëm i ngjanë tamam mjekut kirurg, qoftë në punë apo në detyrë, kjo ngase kirurgu operon qindra njerëz të sëmurë, pa marrë parasyshë shtetësinë, natyrën, fenë ose moralin e tyre. Mjeku obligohet që t'i trajtojë të gjithë njësoj, të jetë i qetë dhe i durueshëm në shërimin e tyre dhe i bindur se kjo është puna e vet në jetën e tij, ndaj dhe për këtë shkak, nuk ka arsye pse të hidhërohet apo të preket nga ankesat dhe pakënaqësitë e shumta të të sëmurëve.

Unë gjithashtu mendoj se thirrësit në Zotin e Madhërishëm duhet të kenë gadishmëri të plotë për t'u takuar individualisht me çdo njeri, qoftë ai i mirë apo mëkatar, besimtar apo jobesimtar, dijetar apo xhahil. Pra, duhet me zemërgjerësi t'i dëgjojnë ankesat e tyre, të cilat janë të shumta si dhe duhet të kenë kujdes ndaj të tjerëve.¹⁸⁰

¹⁸⁰ El-Huli El-Behij, "Tedh-hiretud-dau'at"; kapitulli: "Mizaxhud-dau'ati"; fq. 51.

Nuk është aspak urtësi që da'veti të përkufizohet vetëm brenda qarqeve të muslimanëve dhe kjo njëherit është edhe padrejtësi e madhe, ngase duhet të praktikohet edhe brenda qarqeve të jomuslimanëve.

Pyetja e rëndësishme, e cila mund të shtrohet këtu është: Kush prej thirrësve duhet t'i thërras jobesimtarët e të depërtojë në qarqet dhe në vendet e tyre? A ka kushte që janë të domosdoshme për thirrësin që do të veprojnë në mesin e njerëzve të tillë?

Pra, sipas mendimit tim, thirrësit duhet të ndahen në thirrës të muslimanëve dhe në thirrës të jomuslimanëve, si dhe duhet të posedojnë cilësi e shkathësi të posaçme, të cilat nëse plotësohen atëherë do t'i lejohet thirrësit të merret me një aktivitet të tillë madhor. Ne do t'i shqyrtojmë këto çështje në pjesën tjetër vijuese të këtij hulumtimi dhe do të flasim për cilësitë e thirrësit, të cilat mbështeten në metodën kur'anore.

Shejh Salih ibn Abdullah ibn Hamejdi në traktatin e tij mbi rëndësinë e sjelljes së mirë dhe mbi thirrësin e suksesshëm, thotë:

“Nga mënyrat e rëndësishme për të qenë thirrja e suksesshme në Zot dhe për t'i afruar njerëzit ndaj Islamit e për t'i praktikuar urdhërat dhe ndalesat e tij, është sjellja e mirë e thirrësit, gjegjësisht ai të jetë i pajisur me vepra të mira, cilësi të larta dhe moral të pastër, kështu, gjithnjë për të qenë shembëlltë për të tjerët dhe për t'i inspiruar njerëzit me konceptet e Islamit dhe të bëjë që të afrohen njerëzit ndaj tij. Ndikimi me vepra e sjellje ka ndikim më të madh se sa fjalët...”¹⁸¹

Këto fjalë rreth sjelljes së mirë janë shumë të rëndësishme, qoftë për muslimanët qoftë për të tjerët. Për shkak të vlerës së madhe të kësaj çështjeje, profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) ka qëndrim të fortë e konkret rreth saj, dhe kjo vërehet qartë në tefsirin e tij të ajetit kur'anor të sures **“El En'amë”**, i cili ajet flet për da'vetin nëpërmjet urdhërit e ndalesës:

“Ju mos ua shani ata (zotat) që u lutën (idhujtarët), pos Allahut, e (si hakmarrje) të fyejnë Allahun nga armiqësia, duke mos ditur (për Madhërinë e Tij). Kështu, Ne i kemi zbukuruar çdo popull veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre, e Ai shpërblen për atë që vepruan”. (El En'amë, 10).

¹⁸¹ Salih ibn Abdullah ibn Humejd, **“El-Kudvetu, Mebadiu vel-Nemadhixh”**; Darul-Vatan, bot. 1, 1414 hixhri; botoi: Asambleja Ndërkombëtare e Rinisë islame (WAMY).

Gjatë tefsirit të këtij ajeti, Sejjid Kutubi thotë:

“Edhe pse Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) urdhëroi që të kundërshtohen idhujtarët, gjegjësisht i urdhëroi besimtarët që t’iu kundërshtohen idhujtarëve, ai megjithatë i udhëzoi që t’i kundërshtojnë me sjellje të mirë e me edukatë të lartë, ashtu siç u takon të sillen besimtarëve. Ata urdhërohen që të mos i fyejnë zotat e idhujtarëve, që pastaj edhe idhujtarë të mos e fyejnë Zotin e Madhërishëm, ngase ata (idhujtarët) nuk e dinin Madhërinë dhe Lartësinë e Zotit. Pra, nëse besimtarët i shanin zotat e tyre, atëherë ata do ta shanin Zotin e Madhërishëm: “Ju mos i shani ata (zotat) që u luten (idhujtarët), pos Allahut, e (si hakmarrje) të fyejnë Allahun nga armiqësia, duke mos ditur (për Madhërinë e Tij). Kështu Ne i kemi zbukuruar çdo populli veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre, e Ai i shpërblen për atë që vepruan”. (El En’amë, 108).

Sipas natyrës që Zoti ua krijoi njerëzve, secili njeri që vepron diçka, kënaqet dhe e mbron veprimin e vet, pra edhe nëse vepron vepra të këqija, përsëri kënaqet e i mbron ato. Nëse është i dhunuar, bën vepra të mira, madje edhe nëse është në humbje e vepron keq, ai vepron duke qenë i bindur se vepron mirë. Pra, e tillë është natyra e njeriut.¹⁸²

Ata thërrasin në shokë krahas Zotit, edhe pse e dijnë se Zoti është Krijues dhe Furnizues. Nëse muslimanët i fyejnë zotat e tyre, ata do të distancohen nga besimi i tyre në Zot dhe do t’u luten hyjnive të tyre për të mbrojtur adhurimin, konceptet, pozitat dhe traditat e tyre!

Pra, besimtarët duhet t’i lënë ashtu siç janë: “Pastaj ata do t’i kthehen Zotit të tyre dhe do t’i informojë për atë që vepruan”. Kjo sjellje përputhet me natyrën e besimtarit, i cili është plotësisht i qetë në fenë e vet dhe tërësisht i bindur në besimin e vet, me zemër të udhëzuar, në të cilën nuk mund të depërtojë asgjë e keqe.

Nëse i shajnë zotat e tyre, nuk do t’i udhëzojnë, përkundrazi, akoma do t’ua shtojnë edhe më tepër këmbënguljen, e për një kundërveprim të tillë, asnjë

¹⁸² Alusi, “Ruhul-me’ani” vëll. 7-8, fq. 250-251.

*besimtar nuk ka nevojë! Pra, një sjellje e tillë mund të ndikojë që idhujtarët t'ua shajnë muslimanëve Zotin e tyre të Madhërishëm!”*¹⁸³

Ne mendojme se nga ajo që u theksua më sipër, është vështirë të realizohet ky parim, ndaj dhe për këtë shkak thirrësi duhet të ketë një strategji të posaçme me shoqërinë rreth kësaj çështjeje, që të ketë mundësi të praktikojë një parim të tillë.

Thirrësi duhet të veprojë në atë mënyrë, që të tjerët të kuptojnë se ai nuk u takon atyre, dhe kjo mënyrë do të ishte kështu:

- **Të largohet prej tyre kur nuk bën da'vet;**
- **Të mos lejojë veten që ta vizitojnë të tjerët; dhe:**
- **T'u tregojë se ai nuk dakordohet me situatën e tyre, dhe se ngushtohet nga gjendja dhe sistemi i tillë i jetesës së tyre, ndaj dhe për këtë shkak, patjetër duhet të kërkohet rrugëdalje e ndryshim.**

Nga fjalët e profesor Sejjid Kutubit nënkuptohet parimi i ndërmarrjes së hapave preventive, si dhe parimi i krahasimit në mes veprave të mira dhe atyre të këqija. Këto gjëra duhet të aplikohen në sferën da'vetit islam, me qëllim që që thirrësi të mos përjetojë diçka të papëlqyer apo edhe të dështojë në da'vet, për shkak të veprave e fjalëve të tyre, nëse nuk përdoren urtësia dhe parimet e theksuara të Sheriatit.

¹⁸³ Sejjid kutub, “**Fi dhilâlil-Kur’an**”; vëll 2, fq. 1169; Husni Ed’hem Xherra, “**Ed-da’vetu ilel-Islami-mefahiu ve minhaxh ve vaxhibat**”; Darud-dija’l lin-neshri vet-teuri; Aman, Jordani, bot, 1, 1984, fq. 166, 178.

IV.

Metoda e Kur'anit në eliminimin e koncepteve xhahilite

A). Gradualiteti

Gradualiteti është një ndër parimet më të mëdha të fesë sonë të pastër dhe në këtë mënyrë zbriti Kur'anit Fisnik në zemrën e Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) që të jetë tërheqës i vërejtjes në gjuhën e pastër arabe.

Në këtë kontekst, Zoti i Madhërishëm thotë:

“Dhe (ta shpallëm) Kur'anin që Ne e ndamë pjesë-pjesë për t'ua lexuar njerëzve dalëngadalë dhe ashtu e shpallëm atë një pas një”. (Israë, 106).

“E ata që nuk besuan thanë: “Përse të mos i ketë zbritur atij (Muhammedit) Kur'anit për njëherë?” Ashtu (e zbritëm pjesë-pjesë) që me te të forcojmë zemrën tënde dhe Ne e sollëm atë ajet pas ajetit (dalëngadalë).” (Furkan, 32).

Gradualiteti është një ndër karakteristikat më të rëndësishme në metodën kur'anore në edukimin e Ummetit dhe në eliminimin e koncepteve të ndryshme xhahilite. Kjo ishte edhe një ndër karakteristikat e rëndësishme të periudhës mekase të Kur'anit, në të cilën Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) u ndal shumë gjatë në tefsirin e tij. Kur besohet rreth gradualitetit, duhet theksuar disa urtësi, fshehtësi e leksione që përfitohen nga zbritja graduale e Kur'anit.

Kur flet për urtësinë e gradualitetit prof.Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Ky Kur'an erdhi për të edukuar një Ummet, për të formuar shoqëri dhe për të vendosur sistem. Edukata ka nevojë për kohë që të ndikoj me veprime dhe fjalë, si dhe për lëvizje që do ta shndërrojë ndikimin dhe

veprimin në realitet. Thënë ndryshe: Shpirti njerëzor nuk ndryshohet brenda një dite dhe një nate nga leximi i Librit të plotë që ka metodë krejtësisht të re. Ndikimi vjen ngadalë nga kjo metodë dhe zhvillohet hap pas hapi, dhe kështu dalë ngadalë mësohet me obligimet. Nuk do të pranohej sikur të ofrohej përnjëherë diçka e rëndë, e vështirë dhe e madhe. Në këtë mënyrë, obligimi zhvillohet çdo ditë dhe njeriu gradualisht sa vjen e më shumë përgatitet për pranimin e obligimit tjetër, ndaj gradualiteti ndikon që ai më lehtë të pranon dhe më shumë të ndiejë kënaqësi.”¹⁸⁴

Nga urtësitë¹⁸⁵ dhe leksionet që përfitohen nga zbritja e Kur’anit gradualisht dhe në mënyrë sukcesive; ne do të theksojmë vetëm disa, ngase këtu, nuk kemi mundësi për t’u zgjeruar më tepër:

* Glorifikimi i Kur’anit dhe atij që i është shpallur...;¹⁸⁶

* Përforcimi dhe aftësimi i zemrës së Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*) si dhe ripërtëritja e zotimit të tij me engjëllin Xhibril, që të jetë shpresëdhënës dhe ndihmës i tij;¹⁸⁷

* Shpallja në përputhshmëri me ngjarjet, pyetjet dhe rastet e ndryshme e të reja. Kur’ani shpallej në çdo ndodhi, për të gjykuar me drejtësi rreth çështjes konkrete;¹⁸⁸

* Në bazë të thënies së Zotit të Madhërishëm: **“Dhe e shpallëm atë një pas një”**, këtu ekziston një fshehtësi e shpalljes në formë të tillë. Këtu ka ngadalësi dhe qetësi në fjalë e sqarim për bindje e konfirmim dhe në këtë formë përfitohet bindje dhe formim i plotë dhe një gjë e tillë nuk ndodh nëse

¹⁸⁴ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâil-Kur’an**”, vëll. 5, fq. 2562.

¹⁸⁵ E patëm nderin që me datën 28-31 Prill, 2013, të marim pjesë në Konferencën Internacionale e organizuar nga Forumi Internacional Akademik (IAFOR) , në Osaka-Japan, dhe ta prezantojmë kumtesën tonë në gjuhën Angleze me titull: **Wisdoms Behind the Gradual Revelation of the Noble Qur’an –Some Contemporay Religious, Spiritual, Social and Educational Wisdoms** (*Urtësi ne Zbritjen Graduale të Kur’anit- Disa Urtësi Bashkëkohore Fetare, Shpirtërore, Sociale dhe Edukative.*

¹⁸⁶ Menna’ë El Kat-tan, “**Mebahidh fi ulumil-Kur’an**”; vëll. 1, fq. 452, 469.

¹⁸⁷ Seid Havva, “**EI-Esas fit-tefsir**”; Darus-selam lit-tiba’ti ven’neshri, bot. 1, 1985, vëll. 7, fq. 3874.

¹⁸⁸ Muhamed Abdullah Derraz, “**En-Nebe’ul-adhim, Nedharat xhedide fi fêhmil-Kur’an**”, Darul-Kalem; Damask, bot. 2, 1970, fq. 61.

shpallet përnjëherë, por ndodh nëse shpallet në mësim edukativë dalë ngadalë duke përfitur nga ngjarjet dhe rastet;¹⁸⁹

*Argumentimi para jobesimtarëve një nga një, duke ua rikujtuar atyre devijimin dhe besimin e shtrembëruar e negativ. Sikur Kur’ani të shpallej përnjëherë, jobesimtarët do të talleshin me të, menjëherë do ta refuzonin dhe njerëzit do ta harronin...;¹⁹⁰. Malik ibn Nebij në librin e tij **“Edh-Dhahiretu El-Kur’anijetu”** thotë:

*“Sikur Kur’ani të shpallej përnjëherë, shumë shpejtë do të shndërrohej në fjalë të shenjtë boshe, në ide të vdekur dhe në dokument fetar. Lëvizja historike shoqërore e shpirtërore me të cilat erdhi Islami nuk do të mund të realizohej përveçse nëpërmjet këtij gradualiteti.”*¹⁹¹

*Konfirmimi stilistik dhe legjislativ i mrekullisë Kur’anore duke i sfiduar Arabët dhe oratorët e Mekes me kaptina(sure) dhe verse(ajete) te ndryshme.

*Zbulimin e kurtheve, fshehtesive, planeve të politesiteve (Mushrikeve) në Meke, dhe hipokriteve(Munafikeve), çifuteve(Jahudive), të krishterëve (Nasranive) në Medinë kundër Muslimanëve dhe Muhamedit a.s.

*Lehtesimi i mesimit përmendsh të Kur’anit dhe të praktikimit të ajeteve. Sepse po të zbriste Kur’ani menjëherë kishte meqenë veshtire që të mesohej përmendsh të Kur’anit. Zbritja graduale u mundësoi muslimanëve gjatë periudhës mekase dhe medinase ta mesojnë Kur’anin përmendsh dalngadale, sepse mjetet e shkrimit, kompilimit ishin ende shumë primitive. Kjo urtesë edukativo- arsimore, akademike dominon anembane globit tokësor nëpër univerzitetë dhe shkollë.

¹⁸⁹ Po aty, fq. 61; Shih edhe: **“El-Esas fit-tefsir”**; vëll. 7, fq. 3864.

¹⁹⁰ Sabir Hasan Muhamed Ebu Sulejman, **“Reva’iul-bejan fi ulumil-Kur’an”**; El-Mektebul-Islami; Bejrut, bot. 1, 1988, fq. 41-42.

¹⁹¹ Malik bin Nebij, **“Edh-Dhahiretu el-Kur’anijje”**; përktheu Abdus-Sabur Shahin, hyrjen e shkroi Abdullah Muhamed Derraz dhe Mahmud Shakir, botoi: Darul-fikril-Mu’asir, Bejrut, Liban, bot. 4, 1987, fq. 175.

*Korrektimi i veprave, qendrimeve, vendimeve te Muhamedit a.s. dhe te Sahabeve kur ata gabonin ne ndonje çeshtje fetare, sociale, ushtarake apo familjare; siç eshte rasti i mosmarjes pjese ne luften e Tebukut te disa sahabeve nga Medineja, rasti i pengjeve te luftes ne luften e Bedrit, rasti i ndalimit te Muhamedit a.s. te disa ushqimeve hallall per hater te bashkeshorteve te tij, rasti i largimit dhe mosinteresimit te Muhamedit a.s. me pyetjet te sahabiut te verbert Abdullah ibn Umi Mektum etj¹⁹².

Pra, mund të konkludojmë se Kur’ani Fisnik u shpall gradualisht për t’u folur njerëzve dhe për t’i zbritur parimet e ligjet, e kjo metodë u pranua nga arabët dhe kështu ata, dalë ngadalë i nxorri nga terri në dritë dhe i udhëzoi në rrugë të drejtë, gjegjësisht në rrugën e Zotit, në të cilën rrugë gjenden të gjitha qeniet që ekzistojnë në qiej e në tokë.

Në historinë islame ka shumë shembuj mbi zbritjen e parimeve të Kur’anit në këtë mënyrë si p.sh.: ndalimi i alkoolit, i cili u zhvillua në tre ose katër etapa (sipas transmetimeve të ndryshme). Gjithashtu edhe ecuria e ndalimit të kamatës është zhvilluar njësoj sikur ajo e alkoolit. Kështu ndodhi edhe me ligjet, obligimet dhe ndalesat tjera, si p.sh.: me hixhabin(mbulesen), agjërimin, xhihadin etj. Ajetet që i obligonin këto ligje zbritën në Medinë. Periudha mekase perplot trembedhjte vite ishte periudhe teorike pregaditese, themeluese e bindjes dhe besimit te vertete ne Allahun xh.sh. A ndersa peruidha medinase ishte periudhe e praktikimit te ligjeve te Allahut xh.sh. Ky realitet historik Kur’anor nuk guxon te mungoje nga kokat e thirresve ne Islam; perndryshe puna dhe metoda e punes se tyre do te konsiderohej anti Kur’anore.

Në bazë të kësaj metode hyjnore (metoda e gradualitetit në parime e adhurime), Kur’ani i eliminoi konceptet xhahilite. Profesor Sejjid Kutubi u përqendrua gjatë kohë në këtë metodë duke menduar rreth fshehtësive të saj, dhe për këtë shkak, konkretisht për këtë metodë, ai shkroi mjaft gjerë e gjatë

¹⁹² Per me teper referoju punimit tone ne gjuhen angleze : **Wisdoms Behiend the Gradual Revelation...**qe u permend ma heret; poashtu referoju punimit tone ne gjuhen arabe me titull: **Nahve Menhexhin Kur’anij fi Ta’limi el Ulum el Sher’ije**, punim seminarik u lexua ne Konferencen Internacionale ne Univerzitetin Sultan Sherif Ali –fakulteti i Usuludinit ne Brunei, 2010.

në tefsirin e tij dhe e quajti: **“Kur’ani mekas”** ose **“natyra e Kur’anit mekas.”**

Kjo periudhë e Kur’anit, gjegjësisht periudha mekase e Kur’anit kishte qëllime specifike dhe natyrë të posaçme në zbërthimin e çështjeve dhe në sfidimin e koncepteve, parimeve e moralit të xhahilijetit.

Pra, ç’është kjo metodë, cilat janë hapat e saj dhe prej ku filloi?

“Natyrës së Kur’anit mekas”, profesor Sejjid Kutubi i zbuloi edhe një fshehtësi, gjegjësisht faktin se pse Zoti i Madhërishëm nuk e urdhëroi Pejgamberin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) që të fillojë e të thirrë popullin e vet në nacionalizëm arab apo në reformimin e shoqërisë arabe xhahilite e cila ishte përplot amoralitet në sjellje, jetë e koncepte? Sejjid Kutubi përgjigjen e kësaj pyetje e zbuloi në periudhën mekase të shpalljes së Kur’anit. Ai e kuptoi se nuk ka dobi të shpëtohen popujt nga xhahilijetet e ndryshme, përpos nëse, në zemrat e tyre të prishura, mbjelljet ajo çka duhet.

Në vazhdim le të përrjetojmë disa çaste të këndshme me prof. Sejjid Kutubin rreth kësaj çështjeje të rëndësishme dhe të shohim e kuptojmë se si ai e shqyrton atë dhe si i thërret dhe u drejtohet, gjegjësisht si i udhëzon thirrësit në Zotin e Madhërishëm që ta përdorin të njëjtën metodë në veprimin e tyre dhe në edukimin e tyre me të tjerët.

Ai (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Thirrësit në fenë e Zotit dhe caktimi i sistemit që jetëson këtë fê në jetën reale duhet të qëndrojnë një kohë bukur të gjatë përpara këtij fenomeni të madh që ka të bëjë me Kur’anin e periudhës mekase gjatë trembëdhjetë viteve për ta përforcuar sa më mirë këtë besim. Ai ne fillim nuk jep detaje rreth sistemit të tillë dhe rreth ligjeve që aplikohen në shoqërinë islame. Urtësia e Zotit ka caktuar që da’veti të mbështetet në çështjen e besimit prej fillimit të mesazhit. Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka filluar da’vetin e tij me thirrjen e njerëzve që të dëshmojnë se “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”, që t’i informojë njerëzit për Zotin e tyre të vërtetë dhe që të adhurojnë vetëm Atë.

Kuptohet që kjo, sipas natyrës së çështjes dhe sipas intelektit të kufizuar njerëzor, nuk ishte rruga më e lehtë deri në zemrat e arabëve! Nga gjuha e tyre ata e dinin domethënien e “Zotit”- dhe: La ilahe Il-lall-llah., “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!” Ata e dinin se hyjnia nënkupton pushtetin e lartë absolut dhe se me të nënkuptohet monoteizmi hyjnor i Zotit të Madhërishëm. Kjo nënkupton eliminimin e pushtetit të murgjërve, udhëheqësve të fiseve, prijësve e pushtetarëve dhe pranimin e pushtetit vetëm nga Zoti i Madhërishëm, pushtetin mbi ndjenjat, pushtetin mbi simbolet, pushtetin mbi realitetin e jetës, pushtetin mbi pasurinë, pushtetin mbi gjyqësinë, pushtetin mbi shpirtëra e trupa...

Ata e dinin se: La ilahe Il-lall-llah.. “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!” është revolucion mbi pushtetin tokësor që paraqet edhe karakteristikën e parë të hyjnisë si dhe revolucion mbi çdo gjë në të cilën mbështetet pushteti i tillë, si dhe kundërshtim ndaj pushteteve që gjykojnë me ligje që nuk i lejon Zoti!

Arabët e njihnin mirë gjuhën e tyre, ndaj mjaft bukur e kuptonin domethënien e vërtetë të da’vetit: La ilahe Il-lall-llah.. “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!” se ç’do të thotë realisht kjo për pozitën e tyre, për udhëheqësinë dhe për pushtetin e tyre, dhe për këtë shkak ata e refuzuan këtë da’vet - apo këtë revolucion - aq ashpër sa që veçmë të gjithë njerëzit e dijnë se sa fuqishëm e luftuan atë.”¹⁹³

Nga ajo që u theksua më sipër vërehet qartë arsyeja e refuzimit dhe rezistencës së arabëve kundër këtij da’veti, ngase ata shumë mirë e dinin kuptimin e vërtetë dhe përgjegjësinë që del nga: La ilahe Il-lall-llah.. , “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!” Ata frikësoheshin për veten dhe për pozitën e tyre në këtë botë, ashtu siç ndodh edhe me njerëzit e pozitave të larta në ditët tona. Këtu ka mësim të vlefshëm për thirrësit e ditëve tona, ngase thirrësi mund të rezistohet, jo nga injoranca e padituria, por nga frika e zhdukjes së pushtetit, autoritetit dhe pozitës.¹⁹⁴

¹⁹³ Sejjid Kutub, “Fi dhilâlil-Kur’an”, vëll. 2, fq. 1005.

¹⁹⁴ Sejjid Kutub, “Fi dhilâlil-Kur’an”, vëll. 2, fq. 1005.

Kjo mënyrë e diskutimit dhe kjo metodë e profesor Sejjid Kutubit në këto çështje të fshehta dhe sekrete në zemrat e njerezve, dhe që janë realitete të pamohueshme, ndaj dhe thirrësit duhet ta aplikojnë këtë metodë dhe të mos mbështeten vetëm në çështje të dukshme dhe sipërfaqësore gjatë debatimit dhe diskutimit të ligjeve fetare.

Në vijim vazhdon zbërthimi i Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!), rreth urtësisë së fillimit të thirrjes së pari në besim e jo në diçka tjetër, dhe me plot bindje thotë se kjo metodë e Kur'anit është metoda e vetme e shëndoshë e cila i eliminon konceptet e ndryshme xhahilite dhe se gjithnjë duhet filluar nga baza e jo nga diçka tjetër. Baza e tillë ka nevojë për kohë të gjatë që të forcohet e pastaj të fillohet me periudhën e ndërtimit. Ai shtron pyetjen: *“Pse ishte kjo pikënisje në këtë da’vet? Pse menquria e Zotit ishte e përqendruar aq shumë në këtë çështje? Ai e dërgoi Pejgamberin e Tij me këtë fê, por vendet më të bujshme dhe më të pasura nuk ishin në duart e arabëve, ata ishin në duart e të tjerëve...*

Në veri, territori i Shamit ndodhej në duart e romakëve, kurse në Jug, territori i Jemenit ishte në duart e persianëve, gjegjësisht arabëve të kontrolluar nga persianët. Pra, në të dyja këto territore, arabët sundosheshin nga të huajt apo nga arabët kuislingë. Në duart e arabëve ishte vetëm Hixhazi dhe shkretëtira, e cila aty-këtu kishte vetëm disa oaza.

Sipas Sejjid Kutubit, *“ekzistonin mundësi reale që thirrja e parë të fillonte pikërisht në ato vende, por ndodhi e kundërta...*

- Ai kishte mundësi të nxit nacionalizëm arab që do t’i bashkonte fiset arabe, të cilat ishin përplot hakmarrje e të copëtuar nga grindjet dhe hasmëritë e shumta dhe kështu do të shpëtonin tokën e tyre të okupuar nga perandoritë kolonialiste dhe do të formonin një unitet të fortë në tërë Gadishullin e tyre...”¹⁹⁵

Vazhdon prof. Sejjid kutubi duke thene: *“Sikur Pejgamberi i Zotit të thirrte në këtë parim, do t’i përgjigjeshin të gjithë arabët, në vend që të lodhej e të përjetonte maltretime plot trembëdhjetë vjet e të luftonte kundër*

¹⁹⁵ Sejjid Kutub, “Fi dhilâlil-Kur’an”, vëll. 2, fq. 1005.

rezistimit të pushtetarëve të Gadishullit. Ndoshta Muhammedi do ta bënte një gjë të tillë pasi t'i përgjigjeshin arabët dhe pasi t'ua jepte atyre sundimin dhe pushtetin, pas bashkimit të pushtetit që ishte i përçarë, e pastaj do të ftonte në besimin e monoteizmit me të cilin e dërgoi Zoti i tij dhe njerëzit do t'i bindeshin Zotit të tyre, pasi që t'i kishte marrë nën kontrollin e vet!

Por Zoti i Madhërishëm është i Gjithdijshtëm dhe i Urtë, ndaj dhe nuk e udhëzoi në këtë drejtim, por e udhëzoi që të ftojë në: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!” dhe tërë atë barë të rëndë ta bartë një pakicë e vogël.

Dituria e Zotit është absolute dhe Zoti i Madhërishëm është i Mëshirshëm dhe i Gjithdijshtëm dhe e di më së miri se ç'është në favor të njerëzve. Pse? Zoti i Madhërishëm nuk dëshiron ta lodhë Pejgamberin dhe besimtarin me këtë çështje, ngase Ai e di më së miri se kjo nuk është rruga e duhur. Ai nuk dëshiron që ta shpëtojë tokën nga djalli romak apo nja djalli persian dhe t'ia jep atë djallit arab, ngase të gjithë djajtë janë një. Toka është e Zotit dhe vetëm Zotit duhet t'i drejtohem dhe kjo do të ndodh, vetëm atëherë kur do të ngrihet në tokë flamuri: La ilahe Il-lall-llah.. “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”.

Ai(Allahu e meshirofte!) po ashtu potencon se: “Njerëzit duhet të jenë vetëm robër të Zotit dhe do të jenë robër të Tij vetëm nëse ngritet flamuri: La ilahe Il-lall-llah.. ”Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!” - ashtu siç e kuptonte arabi se vetëm Zotit i takon pushteti, se sheriatit është nga Zoti, se askush nuk mund ta pushtojë askënd, ngase pushteti i takon vetëm Allahut dhe se Islami prej njerëzve kërkon vetëm nënshtetësinë e besimit, në të cilin janë të barabartë arabi, romaku, persiani dhe të gjithë popujt dhe ngjyrat tjera nën flamurin e Zotit, ja kjo është rruga!”¹⁹⁶

Sipas metodës së da'vetit në Kur'an, Zoti nuk kërkoi prej Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) që të bëjë thirrje shoqërore (sociale), ngase edhe kjo është njësoj si e para, nuk do t'u ndihmonte dhe nuk do t'i udhëzonte, ndaj dhe për këtë shkak Zoti i Madhërishëm nuk i thirri në

¹⁹⁶ Sejjid Kutub, “Fi dhilâlil-Kur'an”, vëll. 2, fq. 1006; kapitulli i dytë i librit: “Ed-da'vetu ilall-llah fi sureti Ibrahim El-Halil”, fq. 273.

këtë metode. Të shohim se çka thotë prof.Sejjid Kutubi rreth kësaj çështje të rëndësishme:

“Muhammedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kishte mundësi që të ngriste një flamur shoqëror (social) dhe të fillonte luftë kundër elitës së pasur (aristokratëve), t’ua merrte pasurinë, ta ndërronte situatën dhe t’ua jepte atë të varfërve! Sikur Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) të thirrte në këtë parim, atëherë populli arab do të ndahej në dy grupe: shumica që do të përkrahte këtë ide të re kundër të pasurve që kishin pasuri e autoritet, në vend që të bashkoheshin të gjithë nën: La ilahe Il-lall-llah.. “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”

Zoti i Madhërishëm e dinte se kjo nuk është rruga e duhur dhe se drejtësia shoqërore duhet të burojë nga koncepti i përgjithshëm i besimit në shoqëri dhe se çdo gjë i mbështetet Zotit, që e pranon se çdo gjë që cakton Zoti është e drejtë dhe e kapshme në shoqëri. Pra, në këtë mënyrë do të qetësohetedhe ai që merr edhe ai që jep, ngase këtë sistem e ka krijuar Zoti!
197

Prof.Sejjid Kutubi e analizon edhe mundësinë e tretë të da’vetit; ku potencon se Muhamedi(*paqja dhe meshira e Allahut qoftë mbi të*) po të kishte thir në reforme morale dhe etike; padyshim se edhe kjo metodë kishte me has në mirkuptim, mirpo Muhamedi a.s. nuk e beri këtë, për arsye se Allahu donte që arabët të bashkohen rreth një fjale tjetër: fjala: ***La ilahe Il-lall-llah.. “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”*** Të shohim se si e analizon prof. Sejidi këtë çështje.

“Muhammedi gjithashtu ka pasur mundësi të shpallë thirrje reformiste për të përforcuar moralin, për të pastruar shoqërinë e njerëzit dhe për të ndryshuar vlerat e parimet! Si në çdo ambient, edhe ai do të gjente njerëz të mirë që prekeshin nga fëlliqësirat e tilla dhe kështu do të pranonin që t’i përgjigjeshin thirrjes së reformizmit dhe të pastrimit.

¹⁹⁷ Po aty; vëll. 2, fq. 1006; kapitulli i dytë i librit: “Ed-da’vetu ilall-llah fi sureti Ibrahim El-Halil”, fq. 273.

*Ndokush mund të thotë se sikur Muhammedi të vepronte kështu, në fillim do t'i përgjigjeshin njerëzit e mirë, do të pastronte moralin dhe shpirtërat e tyre dhe kështu do të ishin më afër për ta pranuar besimin, në vend që të ballafaqohesh me rezistencë të madhe që në fillim të rrugës kundër thirrjes së tij: *La ilahe Il-lall-llah..*“Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”¹⁹⁸*

“Por Zoti është i Urtë dhe di çdo gjë, Ai nuk e dhëzoi në këtë rrugë! Zoti i Madhërishëm e dinte se kjo nuk është rruga e duhur dhe se morali mund të mbështetet vetëm në parime e vlera të besimit, dhe se vlerat e parimet vlejnë vetëm nëse mbështeten në këtë parim. Në këtë parim poashtu mbështetet çështja e shpërblimit për ata që i respektojnë këto vlera dhe e dënimit për ata që i refuzojnë. Para përforcimit të këtij parimi, vlerat mund të jenë të luhatshme, ashtu siç është edhe morali pa disiplinë, pa pushtet e pa shpërblim! Pas përforcimit të besimit dhe pas përpjekjeve të mëdha, përforcohet pushteti mbi të cilin mbështetet ky besim:-dhe ketu prof.Sejid Kutubi pohon se -

*** Kur njerëzit të dijnë Zotin e tyre dhe kur të adhurojnë vetëm Atë;**

*** Kur të çlirohen njerëzit nga pushteti i robërve dhe nga pushteti i epsheve; dhe:**

*** Kur të përfocohet në zemra parimi: *La ilahe Il-lall-llah..* “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”; atëherë Zoti e bën atë popull që të veprojë sipas rregullave që i cakton...**

Toka u pastrua nga romakët dhe persianët, por jo për të dominuar pushteti i arabëve, por pushteti i Allahut. Toka u pastrua nga të gjithë djajtë: romakë, persianë dhe arabë. Shoqëria u pastrua nga i tërë zullumi shoqëror, dhe u vendos sistemi islam që vepron drejtë në bazë të drejtësisë së Zotit, që peshon me peshoren e Zotit, që ngre lartë flamurin e drejtësisë vetëm në emër të Zotit e që ky flamur quhet flamuri i Islamit dhe nuk e pranon asnjë

¹⁹⁸ Sejjid Kutub, “*Fi dhilâlil-Kur’an*”, vëll. 2, fq. 1007.

emërtim tjetër... Në këtë flamur shkruhet: La ilahe Il-lall-llah.. “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”

U pastruan shpirtërat dhe morali, zemrat e shpirtërat pa pasur nevojë për ndalesat dhe ndëshkimet që i ka caktuar Zoti - përveç në raste të rralla - ngase kontrolli-friga nga Allahu- kishte depërtuar në brendi, sikundër edhe dëshira për ta përfutur kënaqësinë, shpërblimin e Zotit si dhe turpi e frika nga hidhërimi dhe dënimi i Tij, të cilat kontrollonin dhe dënonin...”¹⁹⁹

Aludon prof. Sejjid Kutubi duke thënë se:” ***Njerëzit u ngritën lartë në bazë të këtij sistemi dhe morali në jetën e tyre si asnjëherë më parë, ngritje kjo që u bë vetëm në saje të Islamit. E gjithë kjo ndodhi ngase ata që e ngritën këtë fê në formë të shtetit, shariatit, sistemit dhe parimeve, më parë e kishin aplikuar këtë fê në shpirtërat e tyre dhe në jetën e tyre në formë të besimit, moralit, adhurimit e sjelljes...dhe kështu, Zoti e dinte tërë atë që ndodhi me ta dhe e dinte se ata u bënë të zotët e këtij amaneti të madh të Tij dhe të këtij besimi, me të cilin Zoti i Madhërishëm i pushtoi zemrat, ndjenjat, sjelljet dhe shpirtërat, në brendi e pasuri, në çdo situatë e gjendje... Ai atyre ua dha zotërimin e fuqisë për të aplikuar Sheriatin e Tij...”²⁰⁰***

Them se këtu vërehen mjaft qartë aspektet metodologjike të profesor Sejjid Kutubit gjatë shqyrtimit të ajeteve të da’vetit. Aspekti më i dukshëm është të kuptuarit e ajeteve kur’anore dhe zbërthimi i tyre sipas periudhave të shpalljes dhe sipas ngjarjeve që ndodhën gjatë jetës së pastër të Pejgamberit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!*). Ai poashtu i formulon idetë dhe mendimet e tij sipas metodës së tillë dhe shumë herë transmeton tekste të plota nga biografia e Pejgamberit, me qëllim që duke u bazuar në to, të nxjerr mësimet e leksione nga ajeti kur’anor. Prandaj për thirrësin në Islam t pastërt e të vërtetë në çdo kohë dhe në çdo vend është e domosdoshme dhe e pakontestueshme jeta dhe vepra e Muhamedi a.s. dhe të sahabeve të tij.

Në fund të këtij shqyrtimi të rëndësishëm konfirmojmë atë që u tha më parë, gjegjësisht faktin se sikur da’veti islam në atë kohë të fillonte me thirrje

¹⁹⁹ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâil-Kur’an**”, vëll. 2, fq. 1007.

²⁰⁰ Po aty; vëll. 2, fq. 1008.

për bashkim nacional, për pastrim të moralit ose për të luftuar elitën (aristokracinë) e asaj kohe e cila ishte mjaft dominuese nëpër fise e familje, thirrja islame do të dështonte dhe nuk do ta kishte këtë sukses të madh e të mrekullueshëm që e arriti për një kohë fare të shkurtër.

Ai (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Kjo metodë e bekuar nuk do të realizohet në këtë nivel të lartë, sikur të mos fillonte me këtë parim dhe nuk do të mund ta ngriste aq lartë flamurin: La ilahe Il-lall-llah..“Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!” Vetëm kjo rrugë e vështirë dhe e rëndë nga aspekti sipërfaqësor dhe e lehtë dhe e bekuar në thelbin e saj, mundësoi që da’veti të bëhet ky që është. Kjo metodë e bekuar nuk do të realizohet për hir të Zotit sikur të fillonte me da’vet

kombëtar,²⁰¹ apo me da'vet social ose me da'vet edukativ apo me ndonjë simbol tjetër krahas simbolit unik: “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”²⁰²

²⁰¹ **Sqarim:** Këtu patjetër e shoh të udhës që të jap mendimin tim personal rreth nacionalizmit, parimeve e pozitës së tij në Islam: Për sa i përket çështjes së nacionalizmit, them se kjo çështje theksohet në Kur'an dhe Sunnet por brenda rregullave të kufizuara. Nga ajo që theksohet në Kur'an rreth kësaj çështjeje, po e përmendi ajetin kur'anor: **“Nga argumentet e Tij është krijimi i qejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja.. Edhe në këtë ka argumente për njerëzit.”** (Er Rum, 22). Zoti i Madhërishëm i thekson këto begati për të mirë e jo për qortim, ashtu siç kuptohet nga konteksti i ajetit, dhe ajeteve para dhe pas tij. Ndryshimet e gjuhëve dhe ngjyrave janë begati të Zotit për njeriun dhe argument mbi ekzistimin e Krijuesit, Zotit të Madhërishëm. Pra, nuk ka nevojë të mohohet kjo e vërtetë dhe duhet të pranohet ashtu siç është. Ishte Dëshira e Zotit të Madhërishëm dhe Urtësia e Tij, që unë të lindi në Kosovë nga prindër shqiptarë. Pra, edhe pse nuk ka nevojë të krenohem, por unë megjithatë jam musliman shqiptar dhe këtu s'ka as dëm e as ndonjë të keqe. Unë duhet të mbroj identitetin tim, gjuhën time, atdheun tim dhe personalitetin që ma krijoi Zoti i Madhërishëm, dhe çdo mohim i gjërave të tilla, nënkupton mohimin e Dëshirës dhe Urtësisë së Zotit, ngase sikur të dëshironte Ai, do të më krijonte arab, turk ose persian, dhe kjo nuk është fare vështirë për Zotin e Madhërishëm. Pra, unë krenohem që jam musliman e shqiptar dhe që jetoj sipas rregullave dhe parimeve të Islamit. Çdo devijim nga rregullat dhe parimet e Islamit nënkupton dalje nga udhëzimi i Islamit. Ne nuk kemi të bëjmë me ata të cilët u japin përparësi ndjenjave kombëtare e nacioanle ndaj ndjenjave fetare, përkundrazi...Mbase prof. Sejjid Kutubi kur flet për këtë çështje, aludon në ta... Zoti i Madhërishëm thotë: **“Ne asnjë nga të dërguarit nuk e dërguam ndryshe vetëm në gjuhën e popullit të vet, ashtuqë ai t'ua shqiptojë atyre (në atë gjuhë). E Allahu e lë të humbur atë që do, dhe e udhëzon në rrugë të drejtë atë që do. Ai është i Fuqishëm, i Urtë”.** (Ibrahim, 4). Nga ky ajet nënkuptohet se Zoti i Madhërishëm nuk e ka zbritur Islamit që t'i luftojë gjërat dhe cilësitë natyrore të njeriut. Unë mendoj se gjuha, atdheu dhe traditat janë cilësi natyrore të njeriut dhe se Islami ka ardhur që t'i rregullojë e t'i pastrojë nga morali i keq dhe rruga e shëmtuar. Ky ajet i konfirmon këto të vërteta, ashtu siç konfirmon se Zoti ka dërguar çdo peygamber me gjuhën e popullit të vet dhe nuk ka kërkuar prej tyre që të mohojnë gjuhën e tyre. Pra, ekzistojnë shumë ajete që flasin rreth kësaj çështjeje si p.sh. ajeti i sures el Huxhurat: *O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat) e All-llahu është i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.*

etj. Argumente të tilla ka edhe në Sunnetin e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Kur Zoti e urdhëroi Pejgamberin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) të emigrojë nga Meka në Medinë, Pejgamberi iu drejtua tokës së Mekës me fjalët: **“Pasha Zotin, oj Mekë! Ti për mua je toka më e dashur e Zotit! Sikur të mos më urdhëronte Zoti të emigroj, nuk do të emigroja!”** Pra, nga ky hadith vërehet qartë dashuria e tij e madhe ndaj atdheut dhe ndaj

B). Kujdesi ndaj gjendjes së atyre që u flitet (dëgjuesëve-xhematit)

Kjo pjesë ndërlidhet me pjesën e kaluar, ndaj dhe për këtë shkak, këtu nuk u ndala më gjatë, por do t'i theksoj vetëm disa ide të profesor Sejjid Kutubit në të cilat vërehet aspekti i da'vetit dhe metoda hyjnore që kishte kujdes ndaj gjendjes së arabëve dhe njerëzve në përgjithësi. Pra, ai merr çdo parim një nga një dhe i transferon ata dalëngadalë, përkatësisht çdo parimi i qaset veç e veç.

Në vijim do të shohim zbërthimin e profesor Sejjid Kutubit që i bën çështjes së formimit të Ummetit si shtyllë mjaft e rëndësishme, si dhe kujdesin e ndërmarrë ndaj situatës së dëgjuesëve. Në këtë kontekst ai (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

“Kur’ani, me këtë besim bënte një betejë specifike, dinamike e realiste. Forma e “teorisë” nuk përputhet me këtë formë që i përshtatet realitetit të situatës aktuale, ngase kjo formë dinamike ballafaqohet me pengesa, sfida, refuzime psikike e realiste që ishin në shpirtërat e gjallë dinamik.

Dialogu teorik që zhvillohet kohëve të fundit nuk mund të përputhet me apolegjetikën²⁰³. Kur’ani i drejtohet realitetit njerëzor dhe të gjitha formave dinamike. Ai u drejtohet të gjithë njerëzve në bazë të këtij realiteti.

Nga ana tjetër, as “teologjia” nuk është formë e përshtatshme.²⁰⁴ Besimi islam edhe pse është besim, përfaqëson besimin që ka të bëjë me

vendlindjes së tij. Këto janë çështje të lindura dhe nuk bien ndesh në Islamin. Në biografinë e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nuk kemi dëgjuar ose lexuar që Pejgamberi të ketë kërkuar nga Bilal Habeshiu, Suhejb er Rumi dhe Selman Persiani pas pranimit të tyre të Islamit, që ata të harrojnë identitetin, gjuhën dhe përkatësinë e tyre kombëtare.

²⁰² Sejjid Kutub, “**Fi dhilâlil-Kur’an**”, vëll. 2, fq. 1009.

²⁰³ Prof. dr. Muhamed Teufik Berekat, në librin e tij: “**Sejjid Kutub, hulasatu hajatihi, menhexhuhu fil-hareketi - en-nakdul-muvexhxhehu ilejhi**”; në një kapitull të posaçëm rreth kritikave kundër Sejjid Kutubit dhe kritikave kundër apolegjetëve (kelamistëve), të cilët në bazë të metodave filosofike i shqyrtojnë çështjet e akaidit, thotë se pikërisht metoda e Sejjid Kutubit na obligon që të shqyrtojmë çështjet e akaidit dhe njëherit na obligon që të shqyrtojmë besimin drejtëpërdrejtë në bazë të metodës së Kur’anit Fisnik. Më hollësisht rreth kësaj çështje..shih në fq. 199.

²⁰⁴ Ali Muhsen, “**Let the Bible Speak**”; fq. 20-55.

metodën e jetës së realtë dhe aplikimit praktik dhe nuk ka të bëjë me formën e kufizuar të hulumtimeve teorike e atyre teologjike!

Islami e ndërton besimin në ndjenja të shoqërisë islame dhe zhvillon betejë të ashpër me xhahilijetin që është për rreth tyre, në brendinë, moralin dhe në jetën e tyre të realtë. Pra, besimi u ndërtua në këtë mënyrë, e jo në:

- **formë teorike**
- **formë teologjike, dhe:**
- **formë të dialogut apologjetik;**
- **por në bazë të formimit sistematik dhe të drejtpëdrejtë të jetës”.**²⁰⁵

Sipas mendimit tim, këto fjalë që u theksuan pak më lartë, nuk kanë qenë të njohura në këtë formë për komentatorët(mufessiret) e vjetër, gjegjësisht ata të periudhave të mëhershme. Profesor Sejjid Kutubi kishte qëndrim të tillë dhe ariti në këto konkluzione, ngase ai e njihnte mjaft mirë qytetërimin perëndimor, meqë thellë e kishte studiuar dhe në fund kishte arritur në përfundim se mësimi i fesë, shqyrtimi dhe zbërthimi i saj në Perëndim bëhej në formë teorike e filosofike ose në formë teologjike, dhe mu për këtë arsye ata kanë mendime të trubullta për religjionin në përgjithësi. Por e ardhmja është në dorë të Allahut xh.sh. dhe në favor të Muslimanëve, dhe se për momentin perëndimi është duke kaluar fazën e transformimit të devijuar të fesë Krishtere në fazën reale dhe të saktë të religjionit Islam.

Komentimi i devijuar kishte ndihmuar që të përfitohen rezultate negative e të kundërshtohen dijetarët e asaj kohe me vrasje dhe djegie për shkak të ndikimit negativ të kishës në shkencë, ndaj dhe pikërisht për këtë shkak kishte mendim specifik rreth kësaj çështje dhe vazhdimisht thoshte se Islami dhe da'veti islam nuk ishin sikur da'vetet e zbrazëta dhe boshe në

²⁰⁵ Studiuesi dr. Ali Muhamed Xhurejshe dakordohet plotësisht me Sejjid Kutubin në këtë pikëpamje kur flet rreth parimeve të da'vetit islamik në librin e tij: **“Usulud-da'vetil-islamijeti”**; Dr. Aliu thotë: **“Parimet e da'vetit: Ky është hyjnor, universal, në projekte dhe metoda...”**

Perëndim. Për këtë shkak, ai ju jep thirrësve parime metodologjike të pastërta e të ndritshme, sipas parimeve që i ka kjo fê, dhe në këtë kontekst, thotë:

“Është e domosdoshme për thirrësit muslimanë që të kuptojnë natyrën e kësaj feje dhe metodën e saj në lëvizje, ashtu siç sqaruam... për të kuptuar se periudha e formimit të besimit, e cila ishte më e gjatë në periudhën mekase nuk ishte e ndarë nga periudha e formimit praktik të lëvizjes islame dhe nga formimi i shoqërisë reale islame... Ngase: Nuk ishte periudhë e mësimi dhe studimit të “teorisë”.

*Pra, periudha e ndërtimit të besimit duhet të zgjatë dhe të ecë dalëngadalë, thellë dhe fuqishëm si dhe nuk duhet të jetë vetëm periudhë e studimit teorik të besimit, por, duhet të jetë periudhë e komentimit të kësaj periudhe në formë dinamike, e cila përfaqësohet në ndjenja të formuara sipas këtij besimi”.*²⁰⁶

Nga fjalët paraprahe të profesorit kuptojmë metodën e tij të të kuptuarit të ajeteve të da’vetit, dhe vërejmë se kjo metodë i kritikon ashpër metodat bashkëkohore perëndimore të mësimi të Islamit, ngase metodat e tyre mësimore akoma janë teorike ose teologjike dhe nuk kanë të bëjnë me anën praktike asgjë. Profesori e sqaron dekadencën e kësaj metode dhe thotë se Islami nuk mund të studiohet e të mësohet në bazë të kësaj metode, ngase Zoti i Madhërishëm dëshiron që në të njëjtën kohë, me një besim të tillë të formojë shoqëri në të cilën besimi do të jetë realitet praktik i saj. Pra, thirrësit e sotshëm duhet ta aplikojnë këtë metodë teorike dhe praktike për të kuptuar da’vetin.

Nga ajo që u tha rreth metodës së profesor Sejjid Kutubit, nënkuptohet se në shqyrtimin dhe në aplikimin e rregullave të Sheriatit në të kuptuarit e ajeteve të da’vetit, nuk duhet të shpejtohet me rezultatet, posaçërisht gjatë periudhës së formimit të Ummetit dhe përgatitjes së tij në formë të plotë. Pra, thirrësit duhet të kuptojnë këtë metodë gjatë da’vetit të tyre në Zotin e Madhërishëm.

²⁰⁶ Sejjid Kutub, “Fi dhilâlil-Kur’an”, vëll. 2, fq. 1009.

Në këtë kontekst, profesor Sejjid Kutubi thotë:

“Kjo është natyra e kësaj feje, ashtu siç nënkuptohet nga metodat e “Kur’anit mekas”, patjetër duhet ta kuptojmë tamam ashtu siç duhet këtë fê, ndaj dhe nuk duhet ta ndryshojmë për shkak të dëshirave të shpejta e të dështuara, gjegjësisht para formave teorike njerëzore!

Me këtë natyrë e formoi në fillim Ummetin islam dhe me të do ta formojë Ummetin sa herë që do të ndihet nevoja për të dalë në skenë, ashtu siç e nxorri Zoti i Madhërishëm për herë të parë.”²⁰⁷

Ndokush mund të thotë se nga aspekti teorik e kuptuam se Kur’ani Fisnik e përdori parimin e gradualitetit dhe pati kujdes ndaj gjendjes së atyre që po thirren në Islam në Gadishullin Arab, për t’i eliminuar konceptet e ndryshme xhahilite, por ne nuk shohim ndonjë shembull të gjallë konkret dhe praktik të fjalëve që u thanë deri tani. Pra, si e kuptoi dhe si e zbërthen Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) këtë çështje?

Në përgjigje të kësaj pyetjeje them se profesor Sejjid Kutubi e sqaroi metodën e të kupuarit të tij të ajeteve me shembuj konkret... Këtu vërehet metoda dhe mënyra e tij në zbërthimin e ajeteve të da’vetit hap pas hapi.

Në tefsirin e ajeteve kur’anore: ***“Dhe nga ajo që krijoi Ai prej të lashtave dhe prej kafshëve shtëpiake, ata (idhujtarët) e ndanë një pjesë për Allahun dhe thanë: “Kjo është për Allahun, mendonin ata, e kjo është e idhujve tanë”.*** (El En’amë, 136) dhe ajeti:

“Dhe kjo është rruga (feja) ime e drejtë (që e caktova për ju), pra, përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t’ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni.” (El En’amë, 153);

Profesor Sejjid Kutubi në fillim i sqaron qëndrimet dhe besimet e idhujtarëve, pastaj vazhdon e flet për mënyrën se si Kur’ani i zbërthen besimet

²⁰⁷ Sejjid Kutub, **“Fi dhilâlil-Kur’an”**, vëll. 2, fq. 1215; Ahmed Faiz, **“Ed-da’vetu Fi dhilâlil-Kur’an”**, vëll. 1, fq. 148-152.

e tilla të kota në të lashta, në kafshë e në fëmijë dhe më pas, në këtë kontekst, thotë:

“ Kjo ishte nga aspekti i përgjithshëm, ndërsa nga aspekti i posaçëm, Kur’ani zhvillonte nëpërmjet këtij besimi betejë dinamike e të reallë kundër destruktivëve të instinktit që ishtë në shpirtërat e reallë të njerëzve. Pastaj, ai nuk formonte ‘teori’ që përshtatej me realitetin e tillë present por zhvillonte një sfidë kundër pengesave, përkufizimeve dhe barrierave psikike që ishin në shpirtërat dinamik. Dialektika iluzore që u zhvillua në kohët e mëvonshme nëpërmes apologjetikës nuk ishte dicka e përshtatshme. Islami gjithashtu ballafaqohej me një realitet të plotë njerëzor në të gjitha aspektet vitale dhe i drejtohej qenies njerëzore brenda realitetit të tillë. As ‘teozofia’ nuk ishte formë e përshtatshme sepse besimi islam ka të bëjë me metodën e jetës së reallë dhe me aplikimin praktik e jo me sferat e ngushta me të cilat merren hulumtimet teorike teozofike.

Kur’ani e formoi besimin në brendinë e shoqërisë muslimane, dhe me popullin e tillë zhvilloi betejë të madhe kundër rrënjëve të xhahilijetit që ishin përhapur në brendi, në sjellje e në realitet. Në këtë atmosferë u formua besimi e jo në formë teorike, as në formë teozofike e as në formë të dialektikës apologjetike. Besimi i tillë formoi një sistem të drejtpërdrejtë të jetës që prezentonte shoqërinë islame. Shoqëria islame dhe konceptet e tyre të besimit u zhvilluan brenda këtij koncepti objektiv për të ç’rrënjësuar xhahilijetin si sistem... Zhvillimi i tillë ishtë një formë e plotë e formimit të besimit dhe jetës... Metodologjia e islamit e përfaqësonte natyrën e tillë...

Ithtarët e da’vetit islamik obligohen që të kuptojnë natyrën e kësaj feje dhe metodën e lëvizjes së një mënyre të tillë, për të kuptuar se periudha e formimit të besimit gjatë shpalljes në Mekke nuk ka qenë e ndarë nga periudha e formimit praktik të lëvizjes islame dhe nga realiteti objektiv i shoqërisë islame. Kjo periudhë nuk kishte të bëjë me studimin e ndonjë “teorie” por ishtë periudhë e formimit të besimit, shoqërisë, lëvizjes dhe ekzistencës objektive. Kështu duhet vepruar sa herë që duhet ripërritur një formim të tillë...Kështu duhet të zhvillohet periudha e formimit të besimit dhe hapat e tillë kështu duhet të ecin thellë, fuqishëm e ngadalë. Periudha e

formimit të besimit nuk duhet të jetë vetëm periudhë e studimit teorik të besimit por edhe ngjallje e një çështjeje të tillë që ka të bëjë me ndjenjat e këtij besimi, të kësaj shoqërie dhe me zhvillimin e vet besimit të tillë. Kjo lëvizje realiste sfidon xhahilijetin, zhvillon betejë kundër ndjenjave të tilla për të formuar besim të gjallë dhe për të zhvilluar një progres dinamik nëpërmes sfidimit të tillë.

Poashtu është gabim trashanik që të paramendohet islami si një teori që duhet studiuar vetëm si teori apo si kulturë.²⁰⁸

Nga metodologjia, bindja dhe parimet e profesorit (Zoti e mëshiroftë) kundër koncepteve dhe besimeve të kota xhahilite, nënkuptojmë se ai nuk pranonte shpalljen dhe metodën e Kur'anit vetëm si teori ose si teozofi por si sfidë dinamike përballë pengesave dhe koncepteve xhahilite. Pra, ai zhvillonte një betejë dinamike kundër koncepteve, besimeve dhe riteve të tilla.

“Kur’ani, në strukturën e vet, eci në bazë të kësaj metode me hapa të ngadalshëm, të gjatë e preciz...”

**** Ai (Kur’ani) konfirmoi disfatën e atyre që i vrasin fëmijët e tyre nga mendjelehtësia e injoranca dhe të cilët u privuan nga furnizimi që u dha Zoti, duke trilluar kundër Zotit, dhe kështu, tregon humbjen e tyre absolute për shkak të koncepteve dhe thënieve të tilla që ia atribuojnë Zotit, pa pasur fare dituri.***

**** Pastaj, ai ua tërhjeq vëmendjen dhe u tregon se Zoti ua ka dhënë pasurinë që e kanë dhe se Ai u ka krijuar kopshte që kanë bimë të ngritura lartë dhe të rrafshta e të shtrira për toke. Ai ua krijoi të gjitha këto begati. Ai që furnizon është i Vetmi që posedon dhe se vetëm ai u dhuron pasuri të tilla. Në këtë kontekst, përdoren disa shembuj konkret nga të mbjellat, të korrat dhe kopshtet me bimë të ngritura lartë e të shtrira për toke.***

**** Pastaj detajisht paraqet naivitetin e madh të ideve të tyre rreth begative e që janë totalisht jashtë logjikës së shëndoshë. Ai i sqaron konceptet e tyre të errëta që të duken të kota të pavlefshme dhe tejet naive.***

²⁰⁸ Kutub, Sejjid, Fi dhilalil-Kur’an, vëll. 2, f. 1012

Në fund të kësaj paraqitje, pyet: “Ju i mbështesni këto ligje të palogjikshme?!” “Apo ishit dëshmitarë kur Zoti u porositi për këtë?”²⁰⁹

Këtu konfirmon pushtetin e ligjdhënësit në Sheriat dhe sqaron se çka ndalon nga ushqimet, gjegjësisht atë që ua ndalon muslimanëve apo çifutëve. Pastaj shqyrton xhahilijetin e idhujtarisë në Zot, ndalimin e asaj që e ka lejuar Zoti në bazë të përkrahimit të Sheriatit, duke ia përkrahur dëshriës së Zotit të Madhërisëm:

“E ata që i shoqëruan Zotit, do të thoshin: “Sikur të donte Allahu nuk do t’i bënim shok (nuk do të ishim idhujtarë) as ne as prindërit tanë, e as nuk do të ndalonim asnjë send.” Këtu tregon se këto fjalë i përdorë çdo jobesimtar dhe gënjeshtar. Këtë e thonë gënjeshtarët derisa t’ju vjen dënimi i Zotit: “Kështu patën gënjer edhe ata që ishin para atyre derisa (për shkak të mëkatit) përjetuan dënimin Tonë të ashpër.” (El En’amë, 148). Sejjid Kutubi vazhdon e thotë:

“Idhujtaria është njësoj si ndalimi pa vendim nga Zoti, ngase të dy grupet i përgënjeshtrojnë argumentet e Zotit.” Dhe më pas, në mënyrë mohuese, i pyet ata: “Ku i mbështesni këto të dhëna që i thoni: “A mos keni ndonjë hamendje, jo, ju në të vërtetë vetëm gënjeni.”²¹⁰

Pastaj përfundon shqyrtimin e kësaj çështje me dëshmi e fjalë kategorike ashtu siç i thirri ata në fillim të sures rreth çështjes së besimit dhe atë duke i përdorë të njëjta fjalë dhe të njëjtat përkrahime për të treguar një çështje, gjegjësisht çështjen e idhujtarisë në Zot dhe çështjen e ligjeve që janë vëndosur pa lejen e Zotit:

“Thuaj: “Sillni dëshmitarët të cilët dëshmojnë se Allahu ndaloi (bëri haram) ato (që i ndaloni vetë).” Në këtë ajet vërejmë unitetin e pasqyrimin, tekstin e fjalëve rreth atyre që bëjnë ligje të tilla, që i ndjekin epshet e tyre dhe që përgënjeshtrojnë argumentet e Zotit dhe ato të ahiretit, si dhe sikur të ndiqnin udhëzimin e Zotit nuk do të formonin për vete dhe për njerëzit

²⁰⁹ Sejjid Kutub, “Fi dhilâlil-Kur’an”; vëll. 2, fq. 1215; Ahmed Faiz, “Ed-da’vetu Fi dhilâlil-Kur’an”; vëll. 1. fq. 148-152.

²¹⁰ Sejjid Kutub, “Fi dhilâlil-Kur’an”; vëll. 2, fq. 1215; Ahmed Faiz, “Ed-da’vetu Fi dhilâlil-Kur’an”, vëll. 1. fq. 148-152.

ligje të tjera që nuk i ka caktuar Zoti, si dhe as nuk do të ndalonin e as nuk do të lejonin diçka pa lejen e Zotit.”²¹¹

Më në fund i thërret që t’ju tregojë se çka ka realisht ndaluar dhe këtu vërejmë parime elementare të jetës shoqërore në krye të të cilave është parimi i monoteizmit të Zotit. Disa prej tyre janë urdhëra dhe obligime, ndërsa ndalimet dominojnë më së shumti. Të gjitha këto i përmbledh me fjalinë:

“Zoti e ndalon idhujtarinë, urdhëron mirësjellje ndaj prindërve dhe ndalon mbytjen e fëmijëve nga varfëria duke ju siguruar furnizim...”²¹²

Gjatë studimit dhe shqyrtimit të metodës së profsorit del në pah ajo që e thashë më parë, gjegjësisht aspekti praktik në Islam, i cili edhe njëherë konfirmon se Islami nuk është fê e teorive filosofike por është metodë e jetës, gjegjësisht mënyrë jetese, ku shoqëria për të qenë islame, duhet që të jetoj sipas parimeve të tij, pra parimeve të Islamit.

Çështja e dytë ka të bëjë me nxjerrjen e një metode të da’vetit nga metoda e Kur’anit për eliminimin e besimeve dhe koncepteve të kota. Thirrësit duhet të kenë kujdes ndaj kësaj metode, shtylla kryesore e së cilës metodë është dhe mbetet: **“Gradualiteti, suksesiviteti dhe kujdesi ndaj gjendjes së atyre që thirren në Islam”**. Por, para kësaj, këtu do të shqyrtoj edhe qasjen e profesor Sejjid Kutubit ndaj formimit intelektual të thirrësit dhe thirrjen e jobesimtarëve në Islam.

C). Kur’ani i flet instiktin njerëzor

Për sa i përket Kur’anit që i flet instiktin njerëzor,²¹³ nuk e teproj nëse them se kjo metodë kur’anore e da’vetit është një ndër më të rëndësishmet për profesor Sejjid Kutubin gjatë tefsirit të tij në **“Fi dhilâlil-Kur’an”**; ngase aspekti i Kur’anit që i flet instiktin njerëzor ka ndikim të madh në zgjimin e ndjenjave dhe përgjegjësiive. Zoti i Madhërishëm i di sytë që tradhëtojnë, atë

²¹¹ Po aty, vëll. 2, fq. 1215; Ahmed Faiz, **“Ed-da’vetu Fi dhilâlil-Kur’an”**, vëll. 1. fq. 148-152.

²¹² Po aty; vëll. 2, fq. 1215; Ahmed Faiz, **“Ed-da’vetu Fi dhilâlil-Kur’an”**; vëll. 1. fq. 148-152.

²¹³ Rreth instiktin shihi shqyrtimet në tefsirin e tij të sures **“En’amë”** në **“Fi dhilâlil-Kur’an”**; vëll.1, fq. 148-152.

që fshihet në zemra dhe atë që është në shpirt, dhe në këtë kontekst, profesor Sejjid Kutubi thotë:

“Kur’ani i drejtohet instiktit të njeriut, vet njeriut dhe gjërave përreth tij. Kur’ani i hap format e pranimit të instiktit, të cilat ishin më parë të dobëta dhe jofunksionale dhe i hap dritaret e instiktit për të pranuar inspirimet ndikuese dhe për t’iu përgjigjur atyre. Sureja që është para nesh është një shembull i përkryer i kësaj metode dhe pas pak çastesh do të flas rreth karakteristikave të saj.

Për thirrësit në Islam është e rëndësishme që të kuptojnë natyrën e kësaj feje dhe metodën e saj të lëvizjes në Islam, me qëllim që sa më mirë të kuptojnë natyrën e vërtetë të kësaj feje. Ata duhet të dijnë se periudha e formimit të besimit ka qenë e gjatë pikërisht për këtë qëllim, se ajo nuk ka qenë e ndarë nga periudha praktike e lëvizjes islame, si dhe nga formimi i realtë i shoqërisë islame.”²¹⁴

Në tefsirin e ajetit kur’anor: *“Janë ata që asgjësuan vetveten, andaj nuk besojnë.”* (El En’amë, 20); ai thotë:

“Ata humbën, dështuan e nuk besuan dhe kjo është një shprehje precize. Ata që nuk besojnë në këtë fê, e cila thirret dhe e inspiron instiktin me inspirime të besimit dhe argumenteve të tij, e kanë humbur paraprakisht instiktin e tyre, dhe siç duket, pranimi dhe reagimi i instiktit është prishur dhe shkatërruar dhe në këtë gjendje, ata e asgjësojnë vetveten e tyre, e pastaj nuk besojnë. Ky është komentim i thellë i mosbesimit të tyre edhe pse ata para vetvetes dhe në çdo gjë që ndodhet përreth tyre kanë plot argumente për besim...”²¹⁵

Nga fjalët paraprake të profesorit del në pah se jobesimtarët e tillë ishin në humbje të madhe dhe arsyeja kryesore qëndronte në shkatërrimin, rrënimt dhe prishjen e instiktit të tyre. Në tefsirin e tij të ajetit kur’anor: *“Thuaju:*

²¹⁴ Sejjid Kutub, “Fi dhilâlil-Kur’an”; vëll. 2, fq. 1012.

²¹⁵ Sejjid Kutub, “Fi dhilâlil-Kur’an”; vëll.2, fq. 1053.

“Nëse u vjen dënimi nga Allahu ose u vjen Kijameti, më tregoni nëse jeni të singertë, a do të thirrni kë pos Allahut (për ndihmë)?”; profesor Kutubi thotë:

“Ky ajet i drejtohet instiktit nëpërmjet pasqyrimin të sfidës... Dënimi i Zotit në këtë botë është dënim i shkatërrimit dhe rrënimit ose ardhja e Kijametit në moment befasie. Kur e parafytyron instikti këtë sfidë, ai e kupton (Zoti e di se ai e kupton) të vërtetën e këtij koncepti dhe dridhet, ngase kjo është një e vërtetë thellë në të. Zoti e di se është aty brenda dhe i drejtohet në mënyrë të përshkrimit, dhe atëherë kërkon ndihmë prej Zotit dhe harron adhurimin, madje edhe vetë idhujtaria harron vetveten. Njohja e Zotit është e vërtetë që gjendet në të, ndërsa idhujtaria është diçka e ardhur nga jashtë.”²¹⁶

Nga fjalët e profesorit nënkuptojmë se idhujtaria, mosbesimi dhe ateizmi janë aksidentale dhe të ardhura nga jashtë në shpirtin njerëzor, ngase shpirti në esencë e njeh Zotin e vet të vërtetë dhe beson në Te kur ballafaqohet me vështirësi dhe sfida në këtë botë dhe në botën tjetër.

Besoj bindshëm pa luhje se ky tefsir ka vlerë të madhe në jetën tonë të da’vetit, dhe kjo vlerë del në pah kur u drejtohem njerëzve të elitave të ndryshme e ju themi se këto kufre e idhujtari që i ekspozojnë haptazi, nuk e tregojnë të vërtetën absolute.

E vërteta absolute është ajo që na e tregoi Ai (Zoti), pra ajo që kur shpirti njerëzor vihet para vështirësive dhe sfidave në këtë jetë dhe në Ditën e Kijametit e pranon Zotin e vet...

Për këtë shkak, profesor Sejjid Kutubi dyshon thellë në sinqeritetin e ateistëve, në atë që besojnë ateistët dhe në praktikimin e ateizmit të tyre në forma dhe mënyra të ndryshme. Unë mendoj se këtë bindje ai e ka përfituar nga metoda e tij në tefsir dhe nga të kuptuarit e tij të të vërtetave fetare dhe të fenomeneve shoqërore, dhe se instikti njerëzor i shëndoshë refuzon dhe nuk e pranon një gjë të tillë.

²¹⁶ Po aty, vëll. 2, fq. 1087.

Këtu profesor Sejjid Kutubi zbulon një fshehtësi të madhe historike nga historia e armiqëve të Islamit. Ata kur orvaten t'i mbjellin idetë dhe doktrinat e tyre, nuk e luftojnë haptazi Islamin që të mos ballafaqohen me instiktin, por idetë dhe doktrinat e tyre të dvijuara i përhapin nën mburojën e formave dhe mënyrave të ndryshme dhe nëpërmes devijimit të moralit.²¹⁷

Profesor Sejjid Kutubi poashtu thotë se zgjimi dhe lëvizja e instiktit pa shpallje, shpie në devijim. E njëjta gjë ndodhë edhe me intelektin pa shpallje dhe mesazh nga Zoti. Pra, patjetër duhet të ketë dërgim të pejgamberëve dhe shpallje derisa të veprojnë drejtë si instikti, ashtu edhe intelektin.²¹⁸

Në tefsirin e tij që i bën ajetit të rrëfimit për Ibrahimin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): ***“Edhe kështu Ibrahimit ia mundësua t'i shohë madhësitë e qiejve e të tokës për t'u bërë edhe më i bindur... Këto janë argumentet Tona që ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij”***. (El En'amë, 74-83); - ai thotë se instikti i shëndoshë në rrëfimin e Ibrahimit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) lypë dhe kërkon Zotin e vërtetë dhe Krijuesin e tij, si dhe i mohon konceptet xhahilite, dhe kur e gjenë të vërtetën, gëzohet, shkëlqen dhe i nënshtrohet Atij! Kjo është një skenë e mrekullueshme e instiktit të shëndoshë.²¹⁹

Instikti mund të devijojë dhe të priset nga presionet e brendshme dhe të jashtme, si dhe nga cytjet e nxitjet e djajve të njerëzve dhe të xhinëve. Zoti i Madhërisëm nga Mëshira e Tij, dërgoi pejgamberë dhe të dërguar që ta shpëtojnë instiktin e shëndoshë nga devijimi dhe humbja.²²⁰

Dhe në fund, profesori e thekson çështjen e instiktit në këtë sure të bekuar dhe thotë që ***“ekziston instikti i shtypur nën presione (i ndrydhur), por si mund të shpëtojë instikti i tillë? Shpëtimi i tij i vetëm është besimi që hap zemrën, ndriçon syrin e që i rregullon format e pranimit instiktiv dhe e zgjon njeriun, i cili që nga ky çast fillon të ekzistojë...”***²²¹

²¹⁷ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâlil-Kur'an**”; vëll. 2, fq. 1088.

²¹⁸ Po aty; vëll. 2, fq. 1098.

²¹⁹ Po aty; vëll. 2, fq. 1137-1138.

²²⁰ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâlil-Kur'an**”; vëll. 2, fq. 1146.

²²¹ Po aty, vëll. 2, fq. 1161.

Pra, ne thirrësit duhet të kemi tepër kujdes e të përqendrohemi në tefsirin dhe zbërthimin e çështjeve të tilla psikike dhe shpirtërore të cilat mund të jenë të vërteta të pranuar por të panjohura për dijetarët e mëdhenj të psikologjisë. Thirrësit duhet ta përdorin dhe ta angazhojnë instiktin që është çështje kyqe për njerëzit e thirrur.

Pra, da'veti ka nevojë për përpjekje, sakrificicë, durim dhe mos-shpejtim, ngase shumica e njerëzve janë të gatshëm të pranojnë thirrjen e instiktit në çdo moment.

Thënë në përgjithësi, metoda e Kur'anit, kur fillon t'i eliminojë konceptet dhe besimet e kota, e lëvizë një aspekt nga aspektet e brendshme dhe të fshehta, gjegjësisht instiktin, i cili ka rol pozitiv në shumë raste.²²²

Nje vështrim të shpejtë të shumë ajeteve të Kur'anit Fisnik na mundëson të kuptojmë këtë realitet, ku Allah xh.sh. e thërret arsyen, intelektin për meditim dhe studim të gjithësisë dhe fenomene tjera natyrore, si dhe instiktin dhe emociet në qindra ajete Kur'anore për të aritur tek besimi i vërtetë-në teuhijd, monoteizm- të Allahut xh.sh.

Besoj se analiza jone rreth këtyre konceptev në këtë studim është e mjaftueshme dhe Allahu di më mirë.

²²² Më gjerësisht shih librin e Sejjid Kutubit: **“Hadhed-din”**; kapitullin: **“El-fisam En-nekid, tijhun ve rukam”**.

KAPITULLI I KATERT:

Cilësitë e thirrësit në metodën kur'anore

I. Përbërja shpirtërore e thirrësit

Profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) tregoi interes të madh për këtë aspekt (apo për cilësitë që i parasheh metoda kur'anore për thirrësin) në tefsirin e tij “**Fi dhilâlil-Kur’an**” kur e komentoi suren “**El En’amë**”,²²³ qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në bazë të aludimit.

Gjatë studimit të kësaj sureje, u bë e qartë se ai (Zoti e mëshiroftë!) i korigjoi disa koncepte të thirrësve ambicioz që para kohe dëshirojnë t’i shohin rezultatet dhe frytet e veprave të tyre, të cilët vërtet gjithnjë mbështeten në ndihmën e Zotit të Madhërishëm, por janë njerëz që shpejtojnë...

Në këtë kontekst, profesor Sejjid Kutubi thotë:

“Disa të sinqertë që shpejtojnë e që nuk persiatin rreth natyrës së kësaj feje dhe rreth natyrës së metodës së fortë hyjnore e cila është formuluar nga Urtësia e të Gjithëdijsimit dhe i Urtit,(Allahut xh.sh.) i Cili e di natyrën e njerëzve dhe nevojave të jetës, ëndërrojnë dhe shpejtojnë! Ata janë sikur ai i cili në fillim propozon të mbështetet da’veti i Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nën flamurin nationalist, social, moral, me qëllim që misioni i thirrjes të realizohet sa më lehtë! Njerëzit para se të hyjnë në detaje, së pari duhet të jenë të sinqertë ndaj Zotit dhe ta adhurojnë Atë duke e pranuar Sheriatin e Tij dhe duke refuzuar në esencë çdo gjë tjetër... Dëshira duhet të burojë nga dashuria ndaj sinqeritetit në adhurimin e Zotit të Madhërishëm dhe të largohet nga çdo pushtet tjetër përveç pushtetit të Tij!”²²⁴

Nga fjalët e profesor Sejjid Kutubit vërehet qartë se metoda e tij mbështetet në elementin shpirtëror, me çka thirrësi duhet të pajiset, gjegjësisht

²²³ Shihi faqet vijuese në tefsirin e tij në vëll. 2: 1011, 1012, 1013, 1014, 1015, 1033, 1054, 1058, 1070, 1071, 1073, 1077, 1078, 1079, 1081, 1082, 1083, 1097, 1099, 1100, 1126, 1127, 1159, 1169; në vëll. 3, f. 1189, 1190, 1191, 1202, 1220, 1227.

²²⁴ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâlil-Kur’an**”, vëll. 2, fq. 1011.

në elementin e sinqeritetit, gradualitetit dhe mos shpejtimit, metodë kjo, që njëherit konsiderohet si bazë e lumturisë ose mjerimit të besimtarit në këtë botë dhe në botën tjetër.

Hulumtuesi saudit²²⁵ kur flet për parimet e sjelljes, i thekson tre parime:

1. Mirësjelljen, të cilën gjithashtu e mbështetet në tre themele:

1. Besim; 2. Adhurim; dhe: 3. Sinqeritet;

2. Karakterin e mirë; dhe:

3. Përputhshmërinë në mes të fjalëve dhe veprave.

Kur flet për sinqeritetin thotë: *“Kjo është një fshehtësi e madhe, portë precize dhe karakteristikë më e kërkuar. Pra, së pari këtë duhet kërkuar nga udhëheqësi, i cili duhet të veprojë e të mësojë vetëm për hir të Zotit të Madhërisëm dhe të qëndroj larg qëllimeve të epshit dhe atyre të krijesave...”*²²⁶

Sipas mendimit tim, gjëja më kryesore dhe arsyeja e të gjitha të mirave është sinqeriteti. Sinqeriteti i dallon njerëzit seriozë nga të tjerët dhe në bazë të kësaj cilësie të madhe, Zoti shpërblen në Ditën kur s’ka dobi as prej pasurisë e as prej fëmijëve, përpos atij që i shkon Zotit me zemër të pastër dhe të shëndoshë. Kjo portë madhështore e përmirëson shpirtin, e pastron atë dhe e edukon.

Ne plotësisht jemi të bindur se me cilësinë e sinqeritetit janë urdhëruar të gjithë peygamberët dhe të dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ta!) që nga Ademi deri në Peygamberin e fundit, zotëriun tonë Muhammedin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), që ishte i sinqertë, besnik dhe i dërguar mëshirë për tërë botët.²²⁷

²²⁵ Salih ibn Abdullah ibn Hamid, “*El-Kudvetu, mebadi’u ve nemadhixh*”; fq. 14, 113.

²²⁶ Po aty; fq. 14, 113.

²²⁷ Sinqeriteti luan rol aktiv në jetën e thirrësit, hoxhës dhe në jetën e kërkuesit të diturisë. Ndër obligimet më të mëdha është pastrimi i shpirtit nga epshet dhe kënaqësitë e saj. Një gjë të tillë duhet ta kuptojë nga mësuesi, hoxha ose profesori i tij ose nga prindërit e tij apo nga tutorët e tij që nga fillimi i ecjes së tij në rrugën e diturisë, të dijetarëve dhe peygamberëve, ngase çdo mangësi në këtë aspekt, do të shkaktojë më vonë dështimin e studentit, të birit dhe për rrjedhojë do të mbetet në udhëkryq, gjegjësisht në mes të rrugës. Kam pasur shokë e vëllezër gjatë studimeve, të cilët sipas mendimit tim, nuk ishin mirë të pajisur me këtë cilësi, ndaj dështuan në këtë obligim dhe në përfundimin e studimeve. Në mua ndikuan dhe luajtën rol mjaft të madh dhe të rëndësishëm

Pra, të jetojmë me këto ajete kur'anore dhe t'i shohim këto udhëzime hyjnore të drejtuara peygamberëve dhe të dërguarëve (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ta!), se si ata urdhëroheshin të veprojnë në bazë të këtij parimi:

“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër por që të adhuronin Allahun me një adhurim të singertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zeqatin, se ajo është feja e drejtë”. (el Bejjine, 5).

“Shpallja e Librit është prej Allahut, të Gjithëfuqishmit, të Urtit. Ne të shpallëm ty Librin për hir të së vërtetës, andaj ti adhuroje Allahun duke qenë i singertë në adhurimin e Tij!” (ez Zumer, 1-2).

“Edhe Iljasi ishte prej të dërguarve Tanë. Kur ai, popullit të vet i tha: “A nuk jeni kah frikësoheni?” A e adhuroni “Ba’el-in” (emër i një statuje) e braktisni adhurimin ndaj më të mirit që është Krijues? Allahun, Zotin tuaj e të prindërve tuaj të hershëm!!” Ata e përgënjeshtroan, andaj ata medoemos janë të sjellë në Xhehennem. Me përjashtim të robërve besnikë ndaj Allahut.” (Saffat, 123-128).

Pra të jemi të vëmendshëm dhe të kemi kujdes ashtu siç pati profesori dhe shehidi Sejjid Kutub (Zoti e mëshiroftë!), ngase ai më së miri e kuptoi dhe punoi sipas domethënies së singëritetit, u maltretua dhe duroi derisa flijoi jetën e vdiq me fytyrë të ndritshme, të ndriçuar e fisnike.

Përmirësimi i aspektit shpirtëror loz rol të madh në personalitetin e thirrësit që të jetë i suksesshëm në qëndrimin dhe në punën e tij. Përmirësimi i shpirtit nga të gjitha aspektet ripërtëritëse të lejuara, është njësoj sikur përmirësimi i një pallati të madh e të lartë. Ata që e injoruan këtë aspekt dështuan dhe nuk korrën asnjë farë suksesi. Përmirësimi i shpirtit të thirrësit,

prindërit e mi fisnikë (Zoti i ruajtë!), posaçërisht nëna ime e çmuar, e cila qysh në fillim të jetës sime në da'vet, dukshëm ndikoi me këshillat dhe udhëzimet e saja të vyera dhe të urta. Poashtu edhe hoxhallarët, profesorët dhe dijetarët e mi të singertë, ndikuan dhe ndihmuan shumë që të unë merrem me da'vet në rrugën e Zotit të Madhërishtëm. Zoti të gjithë i shpërbleftë!

formimi dhe përgatitja e tij për detyra konkrete janë çështje obligative në këtë fê të pastër dhe kushte të nevojshme për përgatitjen e thirrësve.

Gjenerata e parë e sahabëve fisnikë (Zoti qoftë i kënaqur me të gjithë ata!) është marrë me këtë aspekt, ndaj dhe për këtë ishin ndriçues në errësirë, udhërrëfyes dhe udhëzues për në rrugën e drejtë në tërë botën dhe krijesa më të vlefshme. Edhe prof. Hasan Ed'hemi në lidhje me këtë çështje, mendon ngjashëm sikur profesor Sejjid Kutubi. Prof. Hasan Ed'hemi thotë:

“Fuqia shpirtërore është bazë e personalitetit të thirrësit dhe pa të, ai do të jetë i zbrazët, gjegjësisht si trupi pa jetë... Fuqia shpirtërore e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ishte e fuqishme, e lartë, dhe për rrjedhojë u bë shembëlltë, atraktive dhe kështu mjaft ndikoi te njerëzit, të cilët menjëherë, fare pa hezitim, filluan t’i përgjigjen thirrjes së tij dhe instiktivisht e donin me sinqeritet e besnikëri dhe e përcillnin me besim e ambicie, si dhe sakrifikonin në rrugë të Islamit me çdo gjë të vlefshme e të çmueshme.”²²⁸

Në bazë të sqarimit të aspektit të rëndësishëm shpirtëror nga aspekti i metodës kur’anore dhe cilësive që duhet t’i ketë thirrësi, profesor Sejjid Kutubi kishte qëndrim dhe metodë që përputheshin me metodën e Kur’anit Fisnik duke u inspiruar nga disa cilësi të cilat Zoti i Madhërishëm ia mësoi Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), që të qëndrojnë para gjërave të cilat i kërkonin njerëzit që t’i bëjë, por që ishte e vështirë t’i bënte njeriu i rëndomtë...

Pra, të shohim me precizitet dhe koeshiencë fjalët që i thotë gjatë tefsirit të ajetit kur’anor:

“Thuaj: “Unë nuk u them juve se i kam në kompetencë depotë e Allahut (e t’ju sjellë mrekulli), as nuk pretendoj se i di fshehtësitë (e t’ju tregoj) se kur do t’u vijë dënimi”. (el En’amë, 50).

“Xhahilijeti (i cili kishte devijuar nga koncepti i vërtetë i mesazheve qiellore) kishte koncepte të tilla të kota rreth pejgamberllëkut dhe natyrës së

²²⁸ Hasan Ed'hemi Xherrar, “Ed-da’vetu ilel-Islam, mefahim ve minhaxh ve vaxhibat”; fq. 201.

Pejgamberit. Njerëzit prisnin gjëra të tilla prej atyre që proklamnin pejgamberllëkun dhe herë kërkonin që t'ua paratregonin të fshehtë e herë kërkonin që të ndikonin në ligjet e Universit, nëpërmjet magjisë dhe magjistarëve.

Nisur nga kjo, edhe idhujtarët kërkonin të njëjtat gjëra nga Muhammedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ndaj dhe për korrektimin e iluzioneve të tilla, në Kur'an vazhdimisht përsëriteshin të dhëna rreth natyrës së mesazhit dhe natyrës së Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) Në këtë kontekst, në ajetin 50 të sures "El En'amë" thuhet:

"Thuaj: "Unë nuk u them juve se i kam në kompetencë depotë e Allahut (e t'ju sjellë mrekulli), as nuk u them se unë jam engjëll. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet mua. Thuaj: "A janë baras i verbëri dhe ai që sheh?" A nuk mendoni?"

Ai (Muhammedi) urdhërohet nga Zoti që njerëzve t'ju ofrojë:

*** Vetveten të pastër nga thashethemet që ekzistonin në xhahilijet rreth natyrës së Pejgamberit dhe pejgamberllëkut dhe t'ua ofrojë këtë besim që ishte i pastër nga gënjeshttrat e mashtrimet: Këtë besim e bartë Pejgamberi dhe vetëm me udhëzimin e Zotit e ndriçon rrugën!;**

*** Ai duhet të mësojë nga inspirimi i Zotit, i Cili ia mëson atë që nuk e di;**

*** Ai nuk i di fshehtësitë e Zotit që t'ju tregojë ithtarëve të vet;**

*** Ai nuk i ka çelësat e fshehtësive që t'ju tregojë ithtarëve të vet se çka do të ndodhë; dhe:**

*** Ai është njeri, pejgamber dhe besimi është i rëndomtë, i ndritshëm, i qartë dhe i kapshëm.**

Besimi është pëshpëritje e këtij instikti, shtyllë e kësaj jete, udhëheqës për në ahiret dhe udhëzues për te Zoti. Besimi nuk ka nevojë për ornamente dhe ai do të jetë gjëja më e rëndësishme për të. Kush dëshiron ta përdorë si

gjësend tregu, atëherë ai nuk e kupton natyrën e tij, nuk e di vlerën dhe nuk do të ketë kurrfarë dobie prej tij. Për këtë shkak, Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) urdhërohet që besimin njerëzve t'ua ofrojë në këtë mënyrë të pastër nga çdo ornament, ngase nuk ka nevojë për gjëra të tilla. Ata që e pranojnë në këtë mënyrë, nuk vrapojnë pas pasurisë dhe kësaj bote, por njerëzit i dallojnë vetëm në bazë të devotshmërisë dhe anojnë kah udhëzimi i Zotit që është më Fisniku dhe më i Pasuri!”²²⁹

Nga ajo që u theksua më sipër, konkludojmë se metoda e profesor Sejjid Kutubit nënkupton aktivitetin e thirrësit brenda metodës kur'anore dhe mosdaljen nga kërkesa e Zotit dhe ajo e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për t'u edukuar me edukatën e Kur'anit në çdo aspekt. Pra me cilësi të tilla duhet të pajisen thirrësit, si nga aspekti shpirtëror ashtu edhe nga aspekti i sjelljes...²³⁰

Kur flasim për përmirësimin e aspektit shpirtëror nuk nënkuptojmë aspektin sufik; izolimin nga njerëzit dhe qëndrimin në vetmi e nëpër vende të

²²⁹ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâil-Kur'an**”, vëll. 2, fq. 1097.

²³⁰ Imam Ebu Hamid Gazaliu në librin e tij “**Ihju Ulumiddin**”; përkatësisht në kreun: “**Kitabu Adabil-ma'isheti ve ahlak-in-nubuv-veti**”, shkruan rreth cilësive dhe sjelljeve që duhet t'i kenë muslimanët në përgjithësi dhe thirrësit, (hoxhallarët) dhe studentët Islam në veçanti. Një pjesë e cilësive të tilla kanë të bëjnë me aspektin shpirtëror e disa të tjera me sjelljet. Në këtë kontekst, Imam Gazaliu thotë: “*Transmetohet nga Muadh ibn Xhebeli se Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: “Zoti e veçoi Islamin me sjellje të larta dhe me vepra të mira”;* Ndër cilësitë e tilla janë: “*Shoqërimi i mirë, veprat fisnike, butësia, bujaria, dhënia e ushqimit, përshëndetja me selam, vizita e muslimanit të sëmurë, qoftë ai i mirë apo mëkatar, prezenca në xhenazen e muslimanit, mirësjellja ndaj të afërmit, qoftë ai musliman apo jomusliman, mos ofendimi i muslimanit, përgjigjja në ftesë (gostitje), lutje e mirësi në mes njerëzve, të qenit shpirtgjërë, fisnik, tolerant, zemërgjerë, t'ua falësh njerëzve, të largohesh nga dëfrimet që i ka ndaluar Islami, nga harami, kopracia, dorëngushtësia, krenaria, mashtrimi, teprimi, amoraliteti, urrejtja dhe zilia, nga mëkati, armiqësia e zullumi.*” Enesi (Zoti qoftë i kënaqur me të!) thotë: “*Pejgamberi na thirrte në çdo këshillë të mirë, na udhëronte dhe na ndalonte nga çdo e keqe si dhe na tërhiqte vërejtjen!*” Këtu mjafton të theksohet ajeti kur'anor: “*Zoti urdhëron drejtësi e mirësi...*” Muadhi thotë: “*Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) më porositi duke më thënë: “O Muadh! Të porosis që t'i frikësohesh Zotit dhe të flasish drejtë, të ruash premtimin, të mbashë besën, të largohesh nga tradhëtia, të ruash fqin, të jeshë i mëshirshëm ndaj jetimit, të jeshë i butë në fjalë e të japish selam, të veprosh mirë, të keshë shpresë, të kesh besim, të kuptosh Kur'anin, të duash ahiretin, ta kujtosh dhënien e llogarisë dhe të mos anosh! Të ndaloj që të ofendosh të urtin, të përgënjeshtrosh të sinqertin, t'i nënshtrohesh mëkatarit, të dalish kundër imamit të drejtë, të dëmtosh tokën! Të porosis që t'i frikësohesh Zotit në çdo vend, të bësh teube (pendim) për çdo mëkat...*” Ja, kështu, i tillë është morali i robërve të Zotit dhe kështu i thirrte në moral të lartë e sjellje të mira! “**Ihju Ulumiddin**”, vëll, 2, fq. 560.

izoluara(xhami e teqe) për të bërë dhikër, zuhd e askezë... Kjo është temë në vete dhe për këtë çështje nuk është vendi që këtu të flasim më hollësisht.

Aspekti shpirtëror nënkupton përgatitjen e muslimanit që ta dojë Zotin dhe Pejgamberin qysh prej fëmijërisë si dhe ta dojë atë që i afron me ta, siç janë p.sh.: dijetarët e mëdhenj, njerëzit e mirë etj.; dhe të mësojë prej tyre e të shoqërohet me ta për të përfituar nga përvoja e tyre, me qëllim që sa më lehtë të ballafaqohet me sfidat e jetës dhe për të qëndruar i palëkundur para vështirësive që mund t'i shafqen në jetë, si dhe ta mësojë Sheriatin dhe shkencat e ndryshme fetare.

Pyetja e rëndësishme që mund të shtrohet këtu është: Cilat janë mënyrat dhe rrugët për realizimin e këtij qëllimi të lartë e të vlefshëm? Si përgjigje ndaj kësaj pyetje, dijetarët i theksojnë disa rrugë dhe disa mënyra për realizimin e këtij qëllimi:

1. Kujdesi ndaj namazeve, farzeve dhe sunneteve në kohët e parapara, ndaj namazit me xhemat, posaçërisht namazit të sabahut.²³¹

2. Leximi i Kur'anit me persiatje e kuptim si dhe leximi i literaturës së tefsirit në rast të moskuptimit të domethënieve të teksteve apo fjalëve si dhe të ketë kujdesë ndaj nafileve, siç janë p.sh.: namazi i natës dhe namazi i drekës, agjërimi i ditëve që janë sunnet për t'u agjëruar...

3. Kujdesi ndaj dhikrit dhe përmendjes së Zotit të Madhërishëm, të ketë zemër të pastër, mendje të çiltër, të largohet nga lëvizjet e pahijshme gjatë

²³¹ Jo pa qëllim e theksova që në fillim këtë parim, ngase unë kam parë shumë shokë dhe vëllezër të mi gjatë studimeve, po edhe pas studimeve që punojnë në da'vet, janë hoxhallarë, por bëhen përtacë dhe nuk i falin namazet në kohë me arsyetim se janë të preokupuar provime, me çështje të da'vetit, apo janë nëpër mexhlise të ndryshme me xhemat, tribuna publike, tubime të mevlydeve..etj, (e tani edhe në jetën time akademike nëpër univerzitete te ndryshme me profesorë dhe dijetarë të fesë Islame, nëpër seminare dhe konferenca, etj) dhe arsyetohen se kinse nuk kanë kohë për to dhe janë të angazhuar...!! Shumë e quditshme! Prej kur da'veti,seminari, konferenca, tubimi, qenka bërë më i vlefshëm dhe më i rëndësishëm te Zoti se sa falja e namazit në kohë?! Allahu xh.sh thotë: “ **...Namazi është obligim në kohë të caktuar...**”, al Nisa:103. Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: “**Ndër veprat më të dashura te Zoti i Madhërishëm është falja e namazit në kohë...**” Shumica e shokëve të mi të respektuar e kanë keqkuptuar Islamin në këtë aspekt! Ata janë imamë në xhami, i këshillojnë njerëzit, mbajnë hytbe në minbere etj...Unë mendoj se të tillët; nëse vazhdojnë kështu; ata duhet të suspendohen nga puna dhe detyra e tyre, të trajnohen para dijetarëve të sinqertë dhe të mësojnë Islamin nga fillimi, ndoshta kështu do të përmirësohen dhe më shumë do t'i frikohen Zotit e do t'i respektojnë urdhërat e Tij!

dhikrit, si p.sh.: vallëzimi apo lëvizjet e ndryshme gjatë dhikrit, apo ngritja e zërit lartë, ashtu siç veprojnë disa tarikate të devijuara sufiste.²³² Shejhul-Islam Ibn Tejmije thotë:

“Vallja, muzika dhe lëvizja e valltarëve gjatë dhikrit; sipas fesë konsiderohen mëkate, kënaqësi e lojë.”²³³

4. Përgatitja për sakrifikim: “Thirrësi është udhëheqësi i njerëzve ndaj dhe duhet të jetë shembëlltyrë në sakrifikim. Ai duhet të sakrifikojë shumë kohë e pasuri për ata që kanë nevojë dhe të mbulojë boshllëqe. Ai duhet të sakrifikojë në dobi, nuk duhet të kërkojë diçka që zhduket, por duhet të kërkojë atë që është e rëndësishme te Zoti, madje edhe vetë të sakrifikohet në rrugë të Zotit, të lusë Zotin, të insistojë në lutje që të arrijë gradën e shehidëve, e nëse realizohet, begatohet përfiton autoritet dhe ndikon te tjetri.”²³⁴

Profesori Sejjid Kutub (Zoti e mëshiroftë!) e kuptoi tamam ashtu siç duhet këtë domethënie të madhe dhe tregoi kujdes ndaj këtij aspekti shpirtëror të thirrësi musliman. Ai (thirrësi) duhet të përgatitet qysh herët që të mos befasohet nga vështirësitë e rrugës së gjatë. Në tefsirin që i bën ajetit kur’anor: ***“E ata që i bënë të rreme faktet Tona janë shurdhmemecë të mbetur në errësira. Allahu e humb kë të dojë dhe e vë në rrugë të drejtë atë që do”***. (En’amë, 39) - profesor Sejjid Kutubi thotë:

“Rruga e thirrjes në Zot është e vështirë dhe me plot sfida, edhe pse ndihma e Zotit pa kurrfarë dyshimi do të vijë në kohën kur Ai me Diturinë dhe Urtësinë e Tij e ka caktuar. Caktimi i Tij është fshehtësi dhe askush nuk e di... madje as Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Vështirësia vjen për dy arsye: përgënjeshtrimi dhe refuzimi, me të cilat që në fillim ballafaqohet da’veti; lufta dhe dëmtimi që zhvillohen kundër thirrësve! Pastaj nga dëshira njerëzore në shpirtin e thirrësit për t’i udhëzuar njerëzit në të vërtetën dhe dëshira për ta përhapur atë! Kjo dëshirë nuk është më pak e vështirë se përgënjeshtrimi, refuzimi, lufta dhe maltretimi, të cilat janë të gjitha faktorë të rrugës së vështirë...!”²³⁵

²³² Hasan Ed-hemi Xherar, “Ed-da’vetu ilel-Islam, mefahim, minhaxh ve vaxhibat”; fq. 202.

²³³ Shejhuhl-Islam Ahmed ibn Tejmije, “Mexhmu’ul-fetava”; vëll. 5, fq. 83.

²³⁴ “Ed-da’vetu ilel-Islam, mefahime, minhaxh ve vaxhibat”; fq. 205.

²³⁵ Sejjid Kutub, “Fi dhilâil-Kur’an”; vëll. 2, fq. 1081.

Aspekti i sjelljes nuk është aspak më i vlefshëm dhe i rëndësishëm sa ai shpirtëror që kaloi, ngase ky aspekt plotëson të parin, dhe nëse njeri prej tyre humbet, atëherë do të humbet edhe gjysma e bazës, ngase tema e mesazhit qarkullon rreth da'vetit dhe thirrësit. Thirrësi që punon me njerëz duhet të ketë durim, të jetë i butë dhe të ketë mëshirë, ndaj nisur nga kjo, do të flas rreth durimit, butësisë dhe mëshirës, duke argumentuar me fjalët e profesor Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!) gjatë tefsirit të tij të sures “**El En’amë**”. Sejjid Kutubi i jep rëndësi të madhe këtij elementi në tefsirin e tij.

1). Durimi

Të shohim se ç’thotë profesori rreth kësaj çështje, edhe pse ky element mund të jetë i përbashkët edhe për aspektin shpirtëror edhe për atë të sjelljeve. Si e kuptoi Sejjid Kutubi filosofinë e durimit dhe si e shijoi ëmbëlsinë e tij, si e takoi Zotin e tij (si vdiq, gjegjësisht ra shehid) me një qetësi dhe durim të plotë! Si dallohej me të kuptuar dhe metodë specifike në analizimin dhe në tefsirin e këtyre ajeteve që flasin rreth da'vetit?

Profesor Sejjid Kutubi e konfirmon këtë domethënie të rëndësishme në tefsirin e tij të sures “**El En’amë**”, veçanërisht në ajetin që flet për da'vetin duke marr mësim nga rrëfimet e të parëve:

“Janë përgënjeshtruar të dërguar (Pejgamberët) para teje, duruan atë gënjeshtër dhe u torturuan përderisa u erdhi Ndihma Jonë, prandaj s’ka kush që ndryshon Fjalët (Premtimet) e Allahut. E ti je i njohur me disa nga ngjarjet e të dërguarëve.” (En’amë, 34). Profesori i çmuar thotë:

“Da’veti (thirrja) në Zot daton që nga kohërat e lashta... Ajo ka ecur një rrugë të gjatë dhe në vija të drejta e me baza të shëndosha. Kriminelët e të gjitha fiseve i sulmonin rrugët e da’vetit dhe gjenin përkrahje nga ithtarë të tyre të humbur. Ata i dëmtonin dhe torturonin thirrësit, gjaku i tyre derdhej me të madhe... Mirëpo, kjo rrugë nuk shkatërrohet, nuk dëmtohet, nuk devijon dhe nuk dështon. Maltretimi është maltretim, por sa do që të zgjas koha dhe sado që të jetë rruga e gjatë, përsëri në fund të rrugës, gjithnjë vjen ndihma e Zotit: “Janë përgënjeshtruar të dërguar para teje, duruan atë gënjeshtër dhe u torturuan përderisa u erdhi Ndihma Jonë... E

ti je i njohur me disa nga ngjarjet e të dërguarëve (edhe ti do të ndihmohesh sikur ata).” (el En’amë, 34).

Këto fjalë Zoti i Madhërishëm ia thotë Pejgamberit të Tij. Këto fjalë janë përkujtuese, nxitëse, përkrahëse dhe përforcuese si dhe shërbejnë për të sqaruar rrugën e thirrësve në Zot, pas Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Në mënyrë të qartë, përcakton rolin e tyre dhe tregon vështirësitë dhe sfidat e kësaj rruge dhe çka i pret në fund të rrugës. Ai i mëson se Sunneti(ligji, natyra,tradita) e Zotit në da’vet është ajo se shumica e përgënjeshtrojnë këtë rrugë të vërtetë dhe ithtarët e tij dëmtohen... Thirrësit duhet të bëjnë durim nga përgënjeshtrimi, ashtu siç duhet të jenë të durueshëm ndaj sfidave. Kjo rrugë gjithsesi përfundon me fitore e cila vjen në kohën e caktuar.”²³⁶

Profesor Sejjid Kutubi e konfirmon këtë domethënie edhe në një vend tjetër të tefsirit të tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”**:

“Durimi është pjesë e rrugës së da’vetit. Kjo rrugë është e gjatë dhe përplot me sfida e gëmba, me gjak, sprova e maltretime. Durimi duhet të jetë i koncentruar ndaj epsheve të njerëzve dhe ndaj mangësive të tyre, ndaj dobësisë së tyre dhe ndaj injorancës së tyre, ndaj konceptit të keq të tyre, ndaj devijimit të natyrës së tyre, ndaj animit të tyre kah mëkati, ndaj bërjes keq, ndaj dominimit të epsheve, ndaj krenarisë, ndaj numrit të vogël të përkrahësve, ndaj ndihmuesve të dobët, ndaj rrugës së gjatë, ndaj cytjeve të djallit (shejtanit) në momentin e vështirë dhe ndaj hidhëtisë së xhihadit... Ndonjëherë mosbesimi në të mirë është i vogël, ashtu sikur që ndonjëherë shpresa në instiktin njerëzor është e vogël...”

Pastaj durimi duhet të ekzistojë edhe në kontrollimin e vetvetes në momentin e ngadhënjimit, fuqisë dhe fitores, në momentin kur begative duhet falenderuar me modesti e pa e tepruar, të qëndrohet në lidhje me Zotin si në të mirë ashtu edhe në të keqe, dhe ti dorëzohet plotësisht Caktimit të Tij, të jetë i qetë dhe çdo gjë t’ia mbështesë Atij, besimin dhe vendosmërinë. Pra, duhet duruar në të gjitha këto raste dhe në momentin

²³⁶ Sejjid Kutub, **“Fi dhilâlil-Kur’an”**, vëll. 2, fq. 1077.

kur thirrësi do të ballafaqohet me sfida gjatë rrugës së gjatë. Fjalët tona nuk janë në gjendje për ta kristalizuar këtë realitet, ngase fjalët nuk e transmetojnë domethënien e vërtetë të këtyre torturave! Këto vështirësi i kupton vetëm ai që i përjeton, që i ndjen dhe që sprovohet e maltretohet! Pra nuk duhet të humbas durimi i besimtarëve.”²³⁷

Nga fjalët e prof. Sejjid Kutubit kuptojmë metodën e tij në zbërthimin e njërës nga ajetet që kanë të bëjnë me da’vetin. Kjo metodë ka karakteristikë praktike dhe aplikative kur ndërlidhet me urdhërat dhe me tekstet e fesë. Ëmbëlsia e durimit mund të shijohet vetëm atëherë kur përjetojmë vështirësi dhe maltretime të ndryshme si dhe kur gjërat e këtilla i pranojmë me zemërgjerësi e të kënaqur me Caktimin e Zotit, duke kërkuar shpërblim vetëm nga Allahu i Madhërishëm.

Unë së pari e thërras veten time e pastaj vëllezërit e mi thirrës dijetarë e studentë të Sheriatit, të cilët Zoti i Madhërishëm i ka zgjedhur të jenë mbrojtës të kësaj feje, që me plot vëmendje t’i studiojnë këto fjalë progresive të profesor Sejjid Kutubit, nëse dëshirojnë të kuptojnë horizontet edukative dhe fetare. Këtu ka thesar pasurie që shumë pak gjendet te dijetarët tjerë për shkak të vlerës së rënjes së tij Shehid dhe qëndrimit përballë maltretimeve çnjerëzore që i ushtroi pushteti tiran egjiptian i dikatorit gjakatar Xhamal Abdul-Naser kundër tij...²³⁸.

²³⁷ Ahmed Faiz, “**Tarikud-da’veti fidh-dhilâl**”; vëll. 1, fq. 198-199.

²³⁸ Edhe Shejhul-Islam Ahmed ibn Tejmije flet për durimin njësoj sikur Sejjid Kutubi. Ibn Tejmije thotë: **“Besimtari urdhërohet që në vështirësi të bëjë durim dhe të qëndrojë, ndërsa në mëkate të kërkojë falje e teube. Zoti i Madhërishëm thotë: “Ti bën durim se premtimi i Allahut është i vërtetë, kërko falje për mëkatin tënd!” (Gafir, 55). Pra, e urdhëron të durojë në vështirësi dhe të kërkojë falje për mëkate. “Çfarëdo e keqe që ndodhë (godet), nuk mund të jetë ndryshe vetëm sipas caktimit të Allahut, e kush i beson Allahut, Ai ia udhëzon zemrën e tij”. (Tegabun, 11). Ibn Mes’udi thotë: “...Ky është ai njeri që e godet ndonjë e keqe dhe e di se është nga Zoti, dhe për këtë shkak, pranon dhe dorëzohet”. Sipas mendimit të dijetarëve, durimi është obligativ, posaçërisht kur pranohet Caktimi i Zotit. Thuhet se “pajtimi me caktimin e Allahut” është obligativ ose “mustehab” dhe kjo është e saktë. Ai duhet ta falënderoj Zotin për sprovën, dëmin ngase e pranon si begati të Zotit për faljen e mëkateve të tij, për ta lartësuar para Allahut me devotshmëri, sinqeritet, mbështetje dhe kërkesë vetëm nga Zoti”. Shejhul-Islam Ahmed ibn Tejmije, “**El-Furkan bejne eulijaish-shejtan ve eulijair-rahman**”; përgatiti për botim Ebu Abbas ibn Abdulhalim Harrani, pa vit e vend botimi, fq. 107.**

Fenomeni i ekzekutimit dhe i eliminimit të dijetarëve dhe thirrësve ka ekzistue, ekziston edhe tani kur po shkruhem këto vargje dhe do të ekzistojë gjer në ditën e fundit të kësaj jete. Fobia nga Islami mbretëron ende në zemrat e shumë qeveritarëve dhe udheheqësve politik edhe në kohën bashkëkohore në vendet muslimane dhe jo muslimane. Pranvera e Revolucioneve Arabe ka bërë që disa qeveritarë të frigohen ende më shumë prej Islamistëve. Them; kjo frigë e tyre është pavend dhe jo e qëlluar. Tani është koha e ndryshimeve radikale të strukturave të ndryshme në çdo vend. Është koha e luftës së korrupsionit akademik, fetar, ekonomik, politik, industrial, etj. Misioni Kur'anor dhe profetik është që ta luftojë çdo lloj të korrupsionit. A ndërsa Vizioni Kur'anor dhe ai profetik është që tokë të mbretëroj drejtësia, Sheriati, Ligji i Allahut absolut, objektiv i pastër nga korrupsioni. Prandaj nuk është logjike dhe as e drejtë ligjore që qeveritarët të frigohen nga ardhja e qeveritarëve Islamist moderatorë jo ekstremist në pushtet dhe ta qeverisin vendin, pushtetin sipas këtyre parimeve të larta fetare Islame. Pra, pikërisht këtu ka qenë fokusimi i prof.Sejid Kutubit në tërë librat e tija e sidomos në Tefsirin e tij. Kjo përpjekje e prof. Sejid Kutubit i kushtoi shtrenjtë, dhe për ta dëshmuar sinqeritetin e tij të pastër, durimin e tij të thellë, bindjen e tij të paluhatur në këtë ide., ai ra shehid dhe e ekzekutua mizorisht. Padyshim se Allahu Fuqiplot do t'i bashkojë zullumqarët, ekzekutuesit e tij dhe prof.Sejid Kutubin në Ditën e Gjykimit para drejtësisë absolute të Allahut x.sh. për t'i shpërblyer të dy palët, njëri grup do të shkojë në Xhehennem a ndërsa tjetri në Xhennet. Jemi të bindshëm in sha Allh, se zullumqari Abdul Naser dhe bashkëpuntorët e tij do ta marin shpërblimin e veprave të tyre.

2). Butësia dhe mëshira

Sa i përket këtij elementi të dytë të rëndësishëm dhe primar për thirrësit, këtë e hasim edhe në tefsirin e sureve tjera përveç sures “**El En'amë**”. Këto fjalë dhe këtë metodë e hasim në tefsirin e një ajeti të sures “**Ali-Imran**”, ngase gjatë tefsirit të tij Sejjid Kutubi na jep një shembull praktik nga studimi i ndodhive gjatë jetës së pastër të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) si dhe gjatë qëndrimit të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) me shokët e tij në beteja të ndryshme, si p.sh. në betejën e Bedrit dhe të Uhudit.

Në tefsirin e ajetit kur'anor: *“Ti ishe i butë ndaj tyre, ngase Allahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në Allahun, se Allahu i do ata që i mbështeten”*. (Ali-Imran, 159) - Sejjid Kutubi thotë:

“Mëshira hyjnore dukej qartë në moralin e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe në natyrën e tij të mirë e të mëshirshme, të butë e të qetë, e cila ishte e përgatitur për të përfutuar zemra dhe shpirtëra. Mëshira e tillë e Zotit i afroi ata, e bëri të mëshirshëm e të butë me ta. Sikur të ishte zemërfortë dhe i vrazhdë, nuk do t'i përfitonte zemrat dhe njerëzit nuk do të mblidheshin përreth tij. Njerëzit kanë nevojë për sjellje të mëshirshme, kujdes të lartë, tolerancë të madhe, për dashuri që i afron dhe për sjellje që nuk i largon menjëherë nga injoranca e tyre, dobësia e mangësia...

Ata kanë nevojë për zemër të madhe që dhuron mirësi dhe që nuk ka nevojë të merr prej tyre, që i bartë problemet e tyre por assesi nuk i lodh me problemet e tij, që është i sjellshëm dhe i kujdesshëm, i ngrohtë, tolerant, i afërt dhe i dashur në mesin e tyre! Kështu ishte zemra e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe kështu ishte jeta e tij me njerëzit.

Ai kurrë nuk hidhërohej vetvetiu dhe nuk ngushtohej nga dobësia e tyre njerëzore, si dhe nuk siguroi asgjë nga kjo jetë, por ua jepte gjithçka kishte me një tolerancë të madhe. Ai ishte i dashur, i sjellshëm, sentimental dhe fisnik. Secilit që e shoqëronte ose që e shihte, i mbushej zemra me dashuri ndaj tij për shkak të shpirtit të tij fisnik, të madh dhe të gjerë.

E gjithë kjo ishte mëshirë nga Zoti i tij për të dhe për Ummetin e tij. Me një qëndrim të tillë, gjegjësisht nëpërmjet tij, Zoti njerëzve ua rikujton sistemin e jetës së këtij Ummeti.”²³⁹

Këtu, del në pah edhe një pikë tjetër nga metoda e profesor Sejjid Kutubit që ka të bëjë mbi përqendrimin e tij në moralin e Pejgamberit (Paqja

²³⁹ Sejjid Kutub, “Fi dhilâlil-Kur’an”; vëll. 1, fq. 501.

dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) të cilin ia mësoi Zoti i Madhërishëm, ngase nuk ka asnjë fije dyshimi se morali i Pejgamberit ishte vetë Kur’ani Fisnik.

Thirrësit duhet të marrin udhëzime nga fjalët, veprat dhe gjendja e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Islami është fê e punës, aplikimit të urdhërave të Zotit dhe largimit nga ndalesat e Tij. Nuk është vetëm ide e pastër që mjafton vetëm të shqyrtohet me dialogje, diskutime dhe argumente, por është fê praktike që e ka caktuar Allahu për t’u formuar shoqëria ideale islame, dhe për këtë shkak, sjellja, veprat dhe lëvizjet e thirrësve duhet të zhvillohen sipas urdhërave dhe ligjeve të Zotit, që të mos ketë kontradikta në mes asaj që thërret dhe praktikimit, dhe kështu, fjalët do të jenë në një rën anë, kurse veprat në anën tjetër: **“A po i urdhëroni (thirrni) njerëzit për punë të mira, e veten tuaj po e harroni?”** (El-Bekare, 44).

Kur Ajsheja (Zoti qoftë i kënaqur me të!) është pyetur se cili ishte morali i Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), ajo është përgjigjur: **“Morali i tij ishte Kur’ani!”** Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ishte shembëlltyrë e gjallë e asaj që thirrte në të...²⁴⁰

Sjellja, morali, veprat dhe lëvizjet e thirrësit janë më të rëndësishme se dituria dhe kultura e tij e përgjithshme, madje edhe sikur ai të ishte ekspert i shkencave të ndryshme fetare ose humane.

Ekzistojnë shumë thirrës dhe dijetarë, të cilët unë i njoh mjaft mirë dhe të cilët vërtet kanë njohuri dhe horizonte të gjera, elokuencë që i mahnitin dëgjuesit e që ndikojnë në zemra dhe sy, por janë të paskurpullt dhe të

²⁴⁰ Hasan Ed’hem Xherrat, “Ed da’ve ilel-Islam, mefahim ve minhaxh ve vaxhibat”; fq. 203-204; Profesor Salih ibn Abdullah Humejd thotë: **“Shembëlltyrë e muslimanëve të parë, pronar i moralit më të përkryer dhe i metodës më të madhe ishte Pejgamberi ynë Muhammedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe në këtë kontekst Zoti i Madhërishëm thotë: “Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e Allahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shpesh Allahun”. (Ahzabë, 21). Nga kuptimet precize të këtij ajeti theksojmë: Zoti i Madhërishëm e bëri shembëlltyrë të përgjithshme Pejgamberin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), Ai i thekson cilësitë e tij specifike, moralin dhe veprat e tij fsnike, për të konfirmuar faktin se duhet udhëzuar sipas fjalëve të tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), veprave të tij dhe sjelljeve të tij në përgjithësi. Ai udhëzon në bazë të respektimit të ndalesave dhe urdhëresave me veprat, sjelljet, durimin, trimërinë, qëndrueshmërinë, edukatën dhe format tjera të moralit të tij”;** “El-Kudvetu, mebadiu ve nemadhixh”; fq. 7-8.

paturpshëm si dhe nuk veprojnë sipas rregullave dhe parimeve të Sheriatit islam. Nëse i hedhim një shikim të shpejt sjelljes, moralit dhe veprave të tyre të përditshme, dhe nëse i shoqërojmë një kohë, atëherë do të shohim se ata mjerisht, janë shumë larg udhëzimit hyjnor dhe pejgamberik dhe se të tillët më tepër kanë nevojë ta përmirësojnë shpirtin dhe zemrën e tyre në radhë të parë, e pastaj të tjerëve!

3). Toleranca²⁴¹ dhe zemërgjerësia

Sejjid Kutubi e konsideron këtë element të sjelljes si pjesë të llojeve të durimit dhe thotë:

“Durimi është i shumëllojshëm dhe ka forma të ndryshme. Durimi në vepër, xhihad, da’vet e ixhtihad(angazhim dhe përpjekje), durimi në të mirë e në të keqe, dhe vërtet pak njerëz ka që bëjnë durim në begati pa bërë kufër dhe pa devijuar; Durim në marrëzitë e njerëzve dhe në injorancën e tyre kur u ngushtohet zemra...”²⁴²

Profesor Sejjid Kutubi në librin e tij **“Me’alim fit-tarik”** thekson definicionet e kësaj tolerance dhe mënyrën e aplikimit të saj, dhe në këtë kontekst thotë:

“Së pari duhet të konfirmojmë e pastaj të vlerësojmë. Patjetër të kuptojmë të vërtetën e xhahilijetit në bazë të horizonteve të larta ndriçuese të jetës islame që e dëshirojmë. Kjo nuk do të ndodhë nëse ecim disa hapa apo nëse largohemi prej tij, por do të ndodhë nëse përzihemi e zhvillojmë dialog të vërtetë dhe të sinqertë për ta lartësuar me modesti besimin.”²⁴³

Sa fjalë të bukura dhe sa metodë e drejtë dhe e urtë është ky bashkëpunim me të tjerët dhe kjo tolerancë e jona me ta gjatë thirrjes së tyre

²⁴¹ Me nocionet: **“tolerancë”** dhe **“zemërgjerësi”** nënkuptoj se thirrësi duhet të ketë njohuri të gjëra, kulturë e shkathtësi për të kuptuar mentalitetin e njerëzve që i thërret në Islam dhe pastaj për të realizuar qëllimin e paraparë pa kurrfarë kompromisi në dëm të fesë dhe parimeve të saj. Lexo atë që shkruan Sejjid Kutubi rreth kësaj çështje në **“Dhilâl-in”** e tij, vëll. 2, fq. 1073-1074.

²⁴² Ahmed Faiz, **“Tarikud-da’veti fidh-dhilâl”**; vëll. 1, fq. 201.

²⁴³ Sejjid Kutub, **“Me’alim fit-tarik”**; fq. 158.

në fê. Thirrësit në Islam, hoxhallarët, edukuesit e brezave duhet të pajisen mirë me disa tipare dhe veti shpirtërore dhe etike, dhe ta kenë një zemërgjerësi ndaj atyre që i therrasin në Islam. Ai duhet të jetë fort i pregaditur psiçikisht dhe shpirtërisht kur është në pyetje predikimi i fesë Islame. Padyshim se njohja e historisë së pejgamberëve në përgjithësi dhe të Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin gjithnjë mbi të!) në veçanti dhe të shokëve të tij sahabeve, të tab'iinëve të mëdhenj si Imam Ebu Hanifja, Sa'id ibn Jubejr, të dijetarëve të mëdhenj si Ahmed ibn Hanbeli, Imam Maliku, Imam ibn Tejmije, Imam ibn Badijs, Shejh Said el Hav-va, Imam Muhamed el Gazali, Imam el Kardavi, Imam Hasen el Benna, Ebu el E'ala el Mevdudi, prof. Sejid Kutubi, ish presidenti i Bosnjes Ali Izet Begoviç, Hfz. Ali Korça, Hfz. Ibrahim Dalliu, Hfz. Sabri Koçi, Hfz. Jakup Myqeziu, Shejh Selman el Audeh e shumë dijetarë dhe hoxhallarë tjerë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, bota Arabe, Turqia etj etj; sdo mend se edhe njohja e historisë së këtyre burrave të mëdhenj na jep kurajo dhe stimulim për durim, përqëndrim në rrugën e Da'vetit.

4). Respektimi i urdhërave të fesë dhe largimi nga ndalesat e saj

Edhe kjo çështje është e rëndësishme njësoj si çështjet tjera të sipërpërmendura, ngase njerëzit si zakonisht thirrësit i shikojnë sikur me qenë engjëj të Zotit që ecin në sipërfaqe të tokës, të cilët nuk guxojnë të bëjnë mëkate ndaj urdhërave të Tij dhe veprojnë vetëm ashtu siç urdhërohen. Në sy të disa njerëzve, edhe mëkatet e vogla konsiderohen si mëkate të mëdhaja. Sipas mendimit tim, ky është një fenomen shumë i vjetër dhe në historinë islame ekzistojnë plotë shembuj të tillë. Shumë punë të ndonjë personi konsiderojmë si shembëlltyrë të tyre në çdo aspekt.

Thirrësit në Zotin e Madhërishëm duhet të largohen nga amoraliteti dhe veprat e shëmtuara, qofshin ato të dukshme apo të fshehta, posaçërisht para njerëzve dhe dëgjuesëve që të mos bëhen shkak këto vepra dhe njerëzit më pas t'i refuzojnë fjalët e tyre. Nëse gabojmë diçka dhe e bëjmë pa qëllim, patjetër duhet të shepejtojmë e të bëjmë pendim (teube) para Zotit fshehurazi dhe haptazi. Pra, së pari ne duhet ta përmirësojmë vetveten nga morali i fëlliqur

dhe nga gjërat e pahijshme, kuptohet, jo për hir të njerëzve, por për hir të Zotit të Madhërisëm dhe për aplikimin e Sunnetit të Pejgamberit të Tij Muhammedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin gjithnjë mbi të!)

Profesor Sejjid Kutubi e konfirmon këtë domethënie në librin e tij **“Hasaisut-tesavuril-Islami”** kur e komenton ajetin kur’anor: **“Dhe ashtu, Ne u bëmë juve një popull të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në Ditën e Gjykimit) ndaj njerëzve, dhe për të qenë i Dërguari dëshmitar ndaj jush.”** (El-Bekare, 143).

“Kush është më mizor se ai, që e ka dëshminë e Allahut pranë veti dhe e fshehtë?” (El-Bekare, 140).

Profesor Sejjid Kutubi thotë:

“Këtë dëshmi, ai më së pari duhet ta aplikojë në vetvete duke e sendërtuar realisht në jetën e tij personale si dhe në çdo imtësi të aktiviteteve të tij sipas konceptit në të cilin mbështet besimi i tij. Në çdo lëvizje të jetës së tij kërkohet që të dëshmojë këtë fê me dëshmi praktike e jo vetëm me fjalë e me zemër. Dëshmia praktike konfirmon besimin dhe e materializon atë para njerëzve si dhe ndikon në botën reale dhe në botën e njerëzve.”²⁴⁴

Ajeti Kur’anor i interpretuar më lartë edhe pse nuk është në suren el En’amë, kjo nuk do të thotë se ne jemi larguar nga metodologjia jonë shkencore. Ne kemi theksuar që në fillim të kesaj vepre se kryesisht do të përqëndrohemi sures el En’amë, por ndonjëherë edhe detyrohemi që të referohemi veprave tjera dhe tefsirit të ajeteve tjera në suret tjera të prof.Sejjid Kutubit për ta kristalizuar mendimin e tij ma mirë.

II. Përbërja intelektuale e thirrësit

1. Të dijë atë në të cilën thirret dhe ta kuptojë në mënyrë të drejtë

²⁴⁴ Sejjid Kutub, **“Hasaisut-tesavuril-Islami”**; fq. 184-185.

Kjo njësi ka lidhje të ngushta me atë që u theksua më parë ngase ka të bëjë me cilësitë me të cilat duhet të pajiset thirrësi, qofshin ato intelektuale apo bihevisoriste, dhe këtu kam për qëllim njohuritë e thirrësit rreth shkencave të ndryshme që ta kuptojë mirë këtë fê të pastër islame dhe të njeh detyrën e vet ashtu siç thuhet në ajetin kur'anor: ***“Thuaj: “Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras te Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është Allahu, e unë nuk jam nga idhujtarët.”*** (Jusuf, 108).²⁴⁵

Të shohim se çka thotë profesor Sejjid Kutubi në tefsirin që i bën këtij ajeti fisnik, që të kuptojmë këtë të vërtetë të madhe shkencore si dhe të dijmë se çka duhet të dijë thirrësi e ta kuptojë në formë të drejtë.

Në tefsirin e ajetit kur'anor: ***“Thuaj: “Kjo është rruga ime e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras te Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është Allahu, e unë nuk jam nga idhujtarët”.*** (Jusuf, 108) - profesor Kutubi thotë:

“Thuaj: “Kjo është rruga ime”- është një tërësi që nuk ka asnjë të metë, asnjë dyshim dhe asnjë skepsë. “Unë thërras te Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje”- pra, ne jemi nën udhëzimin dhe dritën e Zotit, ne e njohim mirë rrugën tonë, ecim të vetëdijshëm, syçelë dhe vigjilentë, nuk dështojmë, nuk jemi emocional dhe nuk mbështetemi në hamendje. Kjo është bindje e qartë dhe e ndritshme! Ne e pastrojmë Zotin nga ajo që nuk i takon hyjnisë së Tij dhe largohemi e distancohemi nga ata që i bëjnë shok Atij. “E unë nuk jam nga idhujtarët”- as haptazi e as fshehurazi! Kjo është rruga ime, kush dëshiron le ta ndjek, e kush nuk dëshiron, unë do të vazhdoj të eci në rrugën time të drejtë.

Thirrësit në Zot duhet të bëjnë këtë dallim dhe duhet të proklamojnë se ne jemi një Ummet. Ne distancohemi nga ata që nuk besojnë në këtë besim, nuk ecin në rrugën e tyre dhe nuk respekton udhëheqësinë e tyre.

²⁴⁵ Rreth tefsirit të këtij ajeti po përmendim mendimin e disa mufessirëve klasik si p.sh. Te Imam el Kurtubiut, vëll. 9, fq:374, Imam Raziut Mefatihul Gajb, vëll.9, fq: 229, të Imam Sujutiut, el Dur'ru el Menthur vëll.4, fq: 75, të Imam Iz'zu el Din Abdul Aziz ibn Abdus Selam në tefsirin e tij: Tefsirul Kur'an, vëll.2, fq: 142 e te tjerë, të gjithë ata janë shprehur se ajeti i mësipër dmth: Thuaj o Muhamed se kjo është rruga ime, metoda ime dhe thirja ime; thërras në Allahun xh.sh. me plot bindje në këtë fe, me plot të drejtë, me fakte dhe argumente.

Pra dallohen dhe nuk përzihen! Nuk lejohet që ithatërt e kësaj feje të thirrin në këtë fê, ndërsa vetë të jetojnë në shoqërinë xhahilite! Ata duhet që në fillim të tregojnë se dallohen nga xhahilijeti, se i takojnë shoqërisë që ka besim specifik dhe që për adresë ka udhëheqësinë islame. Ata duhet të dallohen nga shoqëria xhahilite si dhe të dallojnë udhëheqësinë e tyre nga udhëheqësia xhahilite.

Xhahilijeti i shek. XX, në bazë të elementeve themelore dhe karakteristikave esenciale, nuk dallohet shumë nga xhahilijeti i parë me të cilin u ballafaqua da'veti i Islamit në histori. A nuk janë vallë vetë ithtarët e doktrinave atesite, ata të cilët nuk ngurrojnë të zbulojnë adresën, sfidën dhe mendimin e tyre! ashtu edhe ithtarët e da'vetit islam duhet të deklarojnë adresën, mënyrën dhe rrugën e tyre specifike, rrugë kjo, e cila tërësisht dallohet nga ajo e xhahilijetit?”²⁴⁶

Nga metoda e profesorit vërehet qartë se të kuptuarit e tij të Kur'anit ishte udhërrëfyes për thirrësit në Zot si dhe kërkonte prej tyre që të ndahen e të distancohen nga shoqëria xhahilite (inJORante) e cila në asnjë mënyrë nuk beson në Islam. Ithtarët e doktrinave të tjera nuk ngurojnë të tregojnë për da'vetin në të cilën thirrin dhe besojnë.

Që të bëhet më e qartë kjo çështje duhet të theksojmë disa mendime të profesor Sejjid Kutubit, me qëllim që sa më mirë të qartësohet metoda e tij, ngjashëm siç duket aq Dielli i cili ndriçon...

Ai në metodën e tij inspirohej nga Kur'ani Fisnik dhe kjo vërehet fare qartë në metodën e tefsirit të tij të Kur'anit në të kuptuarit e ajeteve të da'vetit. Këtë inspirim nuk mund ta përjetojnë dijetarët e rëndomtë, por vetëm ata që janë të thelluar në shkencë dhe të cilët tërë jetën e vet, deri kur të vdesin dhe ta takojnë Allahun e Madhërishëm, e kalojnë në shoqëri me libra dhe dijetarë.

Unë e llogaris Sejjid Kutubin si një nga dijetarët e tillë të thelluar, ngase ai është marrë me shkencë sheriatore që kur ka filluar të shkruajë shkrimet

²⁴⁶ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâliil-Kur'an**”; vëll. 5, fq. 1034-2035.

letrare e kritike. Them me bindje të plotë se ai i ka ofruar Ummetit islam shumë më tepër se sa që na ka ofruar neve...

Gjatë nxjerrjes së këshillave dhe udhëzimeve nga ajetet kur'anore, ai thoshte:

“Intelekti kur shoqërohet me shpalljen dhe udhëzimin e Zotit sheh, ndërsa kur largohet nga shpallja dhe udhëzimi i Tij, atëherë verbohet. Për sa i përket të verbërit dhe atij që sheh si dhe insistimit në persiatje, theksoj ajetin kur'anor: “Unë vetëm e ndjek atë që më shpallet mua. A është i barabartë i verbëri me atë që sheh? A nuk mendoni?” Afrimi i shenjave në këtë mënyrë, tregon mënyrën e rrëfimit kur'anor. Persiatja kërkohet, ndërsa insistimi në të është metodë kur'anore.

Persiatja duhet të jetë në suaza të shpalljes dhe kështu do të jetë në rrugë të dritës, ndërsa nëse është pa kurrfarë disipline do të endet nëpër errësirën e verbër, pa udhërrëfytes e pa udhëzim dhe pa libër ndriçues. Kur intelektin njerëzor lëviz brenda suazave të shpalljes,²⁴⁷ ai nuk ecë në rrugë të ngushtë, por në rrugë të gjerë, ngase ecë në rrugën e tërë ekzistencës që duket e që nuk duket, në shpirtë e në ngjarje si dhe në të gjitha sferat e jetës.

²⁴⁷ Intelekti dhe shpallja janë dy çështje që janë diskutuar qysh nga e kaluara e deri në ditët e sotme, gjegjësisht se a përputhet intelektin me shpalljen apo jo? Kjo çështje është shqyrtuar edhe në qarqet e ***“islamizimit të diturisë”***, ***“islamit të shkencave”***, ***“origjinaliteti islamik i shkencave”*** etj. Unë rreth kësaj çështje kam shkruar një punim që e kam titulluar: ***“Tekamulul-akli vel-vahji vel-havasi fil-islamijetil-ma’rifeti”*** dhe si rezyme e gjithë kësaj mund të them se Islami ka caktuar disa rrugë për të përfitur dituri dhe sipas meje dituria definohet ashtu siç e definon Shejh Abdurahman Habenneke El-Mejdani (Zoti e mëshiroftë!): ***“Dituria është veprim në të cilin marrin pjesë kooperative shqisat e dukshme e të padukshme, mjetet dhe veglat që i përdorin shqisat dhe parimet instiktive e të përfituara të intelektit si dhe njohuritë që i ka përfitur vet më parë dhe nga të tjerët që kanë përfitur nga njohuritë. Këtu hyn edhe ajo që Zoti nga Dituria e Vet, ua ka shpallur peygamberëve të Tij, që të kenë njohuri të vërteta dhe njohuri gjysëm të vërteta, të cilat i përfitojnë njerëzit e rëndomtë.”*** Këtë definicion mund ta gjesh në librin e tij ***“Devabitul-ma’rifeti ve usulil-istidlal vel-munadhareti”***; fq. 126-127, Darul-Kalem, Damask, bot. 1, 1993. Kjo gjë vërehet në faktin se Islami ekzistencën në botë e ndanë, në të dukshme dhe të padukshme, dhe se secila botë ka mënyra të posaçme për t’i njohur. Është gabim që të përdoren mjetet e botës së dukshme për atë të padukshmen dhe anasjelltas. Më gjerësisht shih i brat: ***“Er-ru’jetul-islamijetu li mesadril-ma’rifeti”***; dr. Rijad Salih Xhenzerli, Darul-Bexhairil-Islamijeti, 1994; ***“Islamijetul-ma’rifeti, El-Mebadi’u el-Ammetu”***; Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam, 1986; ***“El-Islam vel-aklu”***; Muhamed Xhevad Mugnije, Darul-Xhevad, Liban, 1984; ***“El-Te’arut vet-terxhah ve etheruhuma fil-fikhul-Islami”***; dr. Muhamed Ibrahim Hafnavi, Darul-Vefa’i, Measure, bot. 2, 1987; ***“Haule teshkilil-aklil-muslimi”***; dr. Imaduddin Halil; ***“Ezmetul aklil-muslimi”***; dr. Abdul-Hamid Ebu Sulejman, Darul-alemijje lil-kitabi’l-Islami, bot. 2, Rijad, 1992, etj.

Shpallja e mbron intelektin nga devijimi i metodës, shikimi i keq, mbështetja në epshe e dëfrime dhe pastaj e lëvizë dhe e bën atë aktiv. Këtë mjet të rëndësishëm që ia ka dhënë Zoti njeriut (intelekti), në realitet ia ka dhënë që të veprojë e punojë në mbrojtjen e shpalljes dhe udhëzimit hyjnor. “Dhe kështu, nuk humbë dhe nuk devijon.”²⁴⁸

Pas kësaj që u tha rreth mendimeve të Sejjid Kutubit, kuptojmë edhe një aspekt tjetër të metodës së tij në të kuptuarit e tij të ajeteve të da’vetit, dhe kjo nënkupton që shpallja të konsiderohet burim i çdo gjëje dhe mbrojtës i intelektit nga devijimi e humbja.

Përqëndrimi i profesorit në shpallje na tregon që ne duhet t’i nxjerrim njohuritë tonë dhe të kuptuarit tonë nga Kur’ani Fisnik dhe nga Sunneti i pastër pejgamberik. Ne nuk mund të largohemi e të distancohemi prej këtyre dy burimeve gjatë da’vetit tonë në Zotin e Madhërishëm, ngase këto dy burime janë e vërteta dhe aty ndodhet drita për ne, për atë që dëshirojmë ta thërrasim dhe për atë që duam ta udhëzojmë. Nga metoda e profesorit vërejmë se ai ka kujdes të madh ndaj Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe ndaj të kuptuarit të urdhërit për të urdhëruar në të mirë dhe për të ndaluar nga e keqja.

Më duket se problemi kryesor i pjesës dërmuese të thirrësve, hoxhallarëve qëndron në faktin se aspekti kulturor i njohurive dhe i shkencave të shpalljes (njohja e mirë e gjuhës arabe, shkencave të Kur’anit, sunnetit pejgamberik, fikhut, usulit dhe shkencave tjera fetare në përgjithësi) është sipërfaqësor dhe i cekët, përkundër asaj se njerëzit e tillë bartin diploma akademike!

Profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) thërret, udhëzon dhe konfirmon nëpërmes deklaratave të tij duke thënë: *“Thirrësit duhet të kuptojnë këtë gjë mirë”*, apo *“Thirrësit në Zot obligohen që të mos shpejtojnë”* apo *“Thirrësit në Zot patjetër të dijnë...”* se thirrësit duhet ta mësojnë dhe ta kuptojnë këtë fê dhe natyrën e saj në mënyrë korrekte, që t’ua transmetojnë njerëzve pa ndonjë ndryshim, devijim apo keqinterpretim.

²⁴⁸ Sejjid Kutub, “*Fi dhilâlil-Kur’an*”, vëll. 2, fq. 1099.

Kjo pjesë ka të bëjë edhe me urdhërin për të urdhëruar në të mirë dhe për të ndaluar nga e keqja... Këtë çështje Imam Gazaliu (Zoti e mëshiroftë!) e ka ndarë në një kapitull në librin e tij: **“Ihjau Ulumiddin”**, ku thotë:

“Dije se parimet e “El-hisbetu”, e cila nënkupton urdhërin për të mirë dhe ndalesën nga e keqja, janë katër: “El-Muhtesib” (thirrësi ose urdhëruesit, “El-Muhteseb alejhi” (i thirruri ose i urdhëruari), “El-Muhteseb fihî” (parimi apo ideja për të cilin thërrasim në të) dhe “Nefsul-ih̄tisab” (procesi i urdhërit në të mirë dhe i ndalimit nga e keqja). Për të gjitha këto parime ka kushte:

- Parimi i parë: “El-Muhtesib”:

Kushtet e këtij parimi janë: “Të jetë musliman, i moshërritur dhe i aftë. Këtu përjashtohet i marri, femiu, jobesimtari dhe i pa-afti. Këtu hyjnë individë konkretë edhe nëse nuk janë të autorizuar: mëkatari, skllavi dhe gruaja...”²⁴⁹ Me të vërtetë këto janë kushte shumë me rëndësi të madhe.

Në pjesën e edukatës së “muhtesibit” Imam Gazaliu vazhdon e thotë: “Dhe ne themi se burimi i edukatës së “muhtesibit” rrjedh nga tre cilësi të “muhtesibit”: Dituria, devotshmëria dhe sjellja e mirë.”

Çështja e diturisë ka të bëjë me njohuritë dhe shkencat rreth vendeve, kufijve, rrjedhave dhe ndalesave që të përqendrohet Sheriati në të.

Devotshmëria të mbron që të mos ndodhi e kundërta nga ajo që dihet, ngase secili vepron sipas asaj që di...

Sjellja mirë nënkupton të jetë i butë dhe i shoqërueshëm...

Dituria dhe devotshmëria nuk mjaftojnë për të. Në rast të hidhërimit, nëse nuk ka sjellje të mirë, nuk mjafton dituria dhe devotshmëria për t’u kontrolluar. Devotshmëria vlen nëse ka sjellje të mirë dhe fuqi për kontrollimin e epshit dhe hidhërimit. Këto tre cilësi e bëjnë “Has’be-në” të jetë afër veprave të mira dhe e largojnë veprat e këqija, e nëse zhduken,

²⁴⁹ Imam Ebu Hamid Muhamed ibn Muhamed El-Gazali, **“Ihjau-Ulumiddin”**; (vdiq në vitin 505 hixhri), recenziu Ebu Hafs Sejjid ibn Ibrahim ibn Sadik ibn Imran; botoi: Darul-Hadith, bot.1.Kajro, vëll. 2, fq. 487.

atëherë nuk mund të evitohet e keqja, bile edhe “hisbe” mund të jetë vepër e keqe nëse e tejkalon kufirin e Sheriatit.

Rreth këtyre sjelljeve Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë:

“Nuk urdhëron në të mirë dhe nuk ndalon nga e keqja përpos nëse e njeh atë që urdhëron dhe atë që ndalon.”²⁵⁰

Kjo argumenton se ai nuk duhet të jetë fakih i përgjithshëm por mjafton ta dijë atë që e thërret dhe atë që e ndalon...²⁵¹

2. Thirrësi duhet ta njohë kulturën e kohës në të cilën jeton

Kjo nënkupton që thirrësi t’i njeh disa shkenca bashkëkohore moderne që të ketë mundësi të zbërthejë dhe shqyrtojë probleme shoqërore dhe të arrijë të sqaroj me urtësi vendimet e Zotit të Madhërishëm dhe Sunnetit të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Dijetarët e definojnë këtë obligim si ***“të kuptuarit e realitetit”*** dhe e obligojnë thirrësin, myftiun dhe gjykatësin (kadiun) që ta njohin këtë çështje nëse dëshirojnë të kenë sukses në da’vet, vendim dhe gjykim. Si pikënisje e kësaj çështjeje është hadithi i Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), të cilin Imam Ahmedi e transmeton në **“Musnedin”** e tij:

“Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kur e dërgoi Mu’adh ibn Xhebelin në Jemen, i tha: “O Mu’adh! Ti do të shkosh te një populli që janë Ithtarë të Librit, thirri ata në dëshminë se “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se unë jam Pejgamberi i Zotit!” Nëse pranojnë këtë, informoi se Zoti i Madhërishëm i obligon të falin pesë kohë namaz ditën dhe natën. Nëse pranojnë këtë, atëherë informoi ata se Zoti i obligon me sadaka që u merret nga pasuria e të pasurve dhe iu jepet të varfërve; Nëse

²⁵⁰ Recenzuesi thotë: ***“Nuk e kam gjetur kështu!”***; Edhe Bejhkeiu transmeton në **“Shu’ab”** nga Amër ibn Shuajb, ky nga babai i tij, e ky nga gjyshi i tij : ***“Kush urdhëron në të drejtë le të jetë vetë i drejtë!”***

²⁵¹ Po aty, vëll. 2, fq. 519-520.

këtë e pranojnë, ki kujdes nga thesari i tyre(ryshfeti) dhe kujdes ndaj ankesës së të dëmtuarit, ngase nuk ka pengesë në mes saj dhe Zotit!”²⁵²

Nisur nga hadithi i sipërpërmendur, të kuptuarit e realitetit në të cilin jeton thirrësi si dhe njohja e rrethit ku jeton, duhet të jenë primare në da'vet pas përgatitjes së thirrësit dhe pas edukimit të tij me edukatë të vërtetë islame. Besoj bindshëm se është gabim autorizimi i thirrësve(hoxhallarëve që shkojnë në Perëndim, apo studentat e posadiplomuar nëpër vende Arabe dhe vijnë në Kosove, Maqedoni, Shqipëri, Bosnje, Mal të Zi dhe anembanë viseve Ballkanike, Evropiane, Amerikë, Australi...etj, them se ata nuk bën me ia aktivizue në teren, qytete, fshatëra me da'vet derisa nuk vërehet qartë se ata janë pjekur dhe kultivuar në këtë aspekt. Organeve zyrtare fetare nëpër ato troje të lartëpërmendura u sygjeroj që ata të organizojnë seminare, kurse trajnuese të ngjeshura, e pastaj atyre t'u lëshohet vendimi i punës. Nëse realizohet ky kusht, u themi: **“Urdhëroni e dilni në skenë të da'vetit sepse tash jeni të aftë të merreni me da'vet!”** E them këtë realitet për shkak se viteve te fundit në viset tona ne Ballkan dhe gjetiu, janë raportuar shumë probleme dhe janë paraqitur në skenë të da'vetit shumë djelmoha, studentë, hoxhallarë, kolegë të rinjë dhe kanë shkaktuar shumë probleme dhe përçarje në mesin e xhematit dhe në disa çarçe publike, nëpër media elektronike dhe vizuele si rrjedhojë e mos eksperiencës së mjafteshme në da'vet si dhe nga mosinformimi (xhehli) i tyre të këtij realiteti shkencor dhe fetar që jemi duke elaboruar tani. Islami (Kur'ani dhe Synneti) akuzohen nga armiqtë e fesë Islame për veprat dhe sjelljet e tyre të paskrupullta. Allahu na udhëzoftë të gjithëve.

Në cilat gjëra duhet përqendruar që të plotësohet ky aspekt i thirrësit dhe që ta kuptojë realitetin në të cilin jeton dhe me të cilin ballafaqohet?

Ekzistojnë disa gjëra të cilat do t'ia mundësojnë thirrësit që ta kuptojë realitetin ashtu siç duhet. Nuk ka dyshim se këto gjëra i nxorrëm nga metoda

²⁵² Transmeton Imam Ahmedi në **“Musnedin”** e tij. Hadithi nr. 1968 nga Abdullah ibn Safi; Imam Buhariu në **“Kitabuz-zekat”**; 1308, 1365, 1401; El-Medhalim, 226; El-Megazi, 4000; Et-Teuhid 6824; Imam Muslimi në **“Kitabul-iman”**; 27; Imam Tirmidhiu në **“Sunenin”** e tij, kapitulli **“Zeqati”**; 567. Imam Nesefiu në **“Sunenin”** e tij, kapitulli **“Zeqati”**; 2392; Ebu Davudi, **“Kitabuz-zekat”**; 1251; Ibn Maxhe në **“Kitabuz-zekat”**. 1773; Darimiu, 1563.

e vyer e profesor Sejjid Kutubit në tefsirin e ajeteve të da'vetit, dhe kjo metodë vihet në pah qartë kur profesori i çmuar shqyrtoi çështjen më të madhe që u përhap në kohën dhe në ambientin e tij, dhe ai aty u paraqit tamam si kampion dhe hero i vërtetë. Ai dyshimet e armiçëve të Islamit i refuzoi me argumente e fakte.

Pra, cilat gjëra duhet të ekzistojnë?

Duhet përgatitje e plotë në lëmitë fetare (sheriatores)

Ajo që këtu mund të thuhet është se thirrësi duhet të ketë diplomuar në ndonjë fakultet islamik. Nuk ka ndonjë pengesë që edhe ata që nuk janë të specializuar në shkencat islame të merren me da'vet, kuptohet nëse i posedojnë kushtet fetare, islame e kulturore, të cilat u japin kredibilitet për të bërë da'vet.

a). Të ketë njohuri rreth disa çështjeve intelektuale filosofike të kohës, si p.sh.: çështja e metafizikës, ekzistencializimit, evolucionit, çështja e ekzistimit të Zotit etj. Ai poashtu duhet t'i njeh sistemet njerëzore pozitive të kohës, si p.sh.: komunizmin, socializmin, demokracinë, laicizmin etj.

b). T'i njeh elitat dhe shkallët e njerëzve që janë rreth tij, ngase dav'eti nuk ka për të pasur sukses, nëse thirrësi të gjithë i shikon me një sy dhe të gjithëve u flet me një gjuhë...²⁵³

c). Të njeh një nga gjuhët e rëndësishme botërore, e cila ka përdorim të gjerë sot në botë, si p.sh.: gjuhën frënge, italiane, gjermane, e veçanërisht gjuhën angleze. Nuk shoh se thirrësi do të jetë i suksesshëm në shtetet perëndimore pa njohur një nga gjuhët që i theksova pak më parë, apo më së paku ta njeh gjuhën angleze, ngase kjo mosnjohja e gjuhës së popullit ku ligjëron e humbë shumë vlerën e da'vetit dhe pakëson rëndësinë e ligjëratës apo të hytbes së zhvilluar. Pra, kush dëshiron të merret me da'vet jashtë vendit të tij, patjetër duhet ta njeh gjuhën e vendit apo të shtetit ku është dërguar.

Unë nuk pajtohem me veprimtarinë dhe sjelljet e disa institucioneve fetare humanitare të shteteve arabe dhe shteteve tjera, ngase, thirrësit që ata i dërgojnë në vendet e ndryshme perëndimore dhe aziatike e njohin vetëm gjuhën arabe. Unë atyre u propozoj që të mos dërgojnë thirrës në asnjë vend

²⁵³ Muhamed ibn Sejjid El-Habib, "Ed'davetu ilal-Ilah, fi sureti Ibrahim El-Halil"; kapitulli mbi da'vetin e peygamberit Nuh. fq. 291-295.

të botës, përveç nëse thirrësi kryen kursin intensiv të gjuhës së vendit ku do të dërgohet, i cili kurs zgjatë gjashtë muaj ose një vit dhe kështu thirrësi ka për ta mësuar gjuhën e popullit ku do të veproj.

Për fat të mirë, ky propozim buron nga metoda hyjnore e dërgimit të pejgamberëve dhe të dërguarëve që flasin gjuhën e popullit të tyre... Në këtë kontekst, Zoti i Madhërishtëm thotë:

“Ne asnjë nga të dërguarit nuk e dërguam ndryshe vetëm në gjuhën e popullit të vet, ashtu që ai t’u shpjegojë atyre (në atë gjuhë)”. (Ibrahim, 3).

Pikërisht për shkak të kësaj neglizhence dështuan shumë aksione të institucioneve humanitare fetare, të cilat mendojnë dhe janë të bindura se veprojnë mirë. Zoti nuk dërgon pejgamber e as të dërguar në ndonjë popull nëse nuk e di gjuhën e atij populli. Pra, të kemi kujdes ndaj këtij parimi të rëndësishëm të da’vetit dhe të mos mbështetemi vetëm në nijet e në qëllim të mirë e as në aspektin sipërfaqësor. Nuk kishim nevojë që të paraqesim këtë hyrje të rëndësishme para se t’i shohim këto të vërteta nga profesor Sejjid Kutubit (Zoti e mëshiroftë!), ngase ai është shembulli më i mirë dhe konkret i asaj që themi se thirrësi duhet të njeh kulturën e kohës në të cilën jeton dhe vepron.

Profesor Sejjid Kutubi kishte njohuri dhe dituri të gjera rreth kulturës²⁵⁴ së kohës në të cilën jetonte. Koha e tij ishte kohë e konfliktit në mes të letrarëve, poetëve e prozatorëve ateistë e laikë. Ai poashtu i njihte edhe ligjet pozitive dhe doktrinën destruktive komuniste, socialiste, demokratike dhe afetare si dhe konfliktin e Islamit me këto doktrina dhe me sistemet tjera.

Në vijim le të shohim idetë e Sejjid Kutubit nga tefsiri i tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”** dhe të bindemi në vlerën dhe njohuritë e thella të këtij njeriu në shkencat tjera, për të parë se sa është realizuar ky aspekt intelektual tek ai, me qëllim që të shërbej si dritë dhe udhëzues për thirrësit tjerë si dhe njëherit të

²⁵⁴ Më gjerësisht rreth burimeve të kulturës arabe dhe perëndimore të Sejjid Kutubit, shih në librin: **“Sejjid Kutub, Esh-shehid el-hajj”**; fq. 161...

kuptojmë edhe metodën e tij në të kuptuarit e da'vetit dhe në dimensionet e tij edukative.

Profesor Sejjid Kutubi thotë:

“Dhe kjo na udhëzon në një aspekt më të gjerë të këtij udhëzimi kur'anor. Kjo nuk është e kufizuar për një kohë, as për ngjarje apo për një propozim konkret. Epshet e njerëzve paraqiten në propozime tjera. Thirrësit në fenë e Zotit nuk duhet të frikësohen nga epshet e njerëzve. Dëshira për t'iu përgjigjur provokimeve të propozuesëve ndikon që disa thirrës muslimanë sot të përpiqen që ta zbardhojnë, gjegjësisht zbërthejnë besimin islam në formë të “teorisë doktrimore” në letër, ashtu siç ndodhë në “teoritë e doktrinave të vogla” tokësore që i formojnë njerëzit në një kohë të caktuar dhe të cilat pas një kohe shndërrohen në ide, mendime e hipoteza kontradiktore.

Për këtë shkak gjejmë disa thirrës që përpiqen të sqarojnë sistemin islam me sisteme (në letër) ose me forma të ligjeve të ndara (poashtu në letër) që janë afër xhahilijetit, pa pasur kurrfarë lidhje me Islamin burimor. Ithtarët e këtij xhahilijeti thonë: “Islami është besim dhe nuk ka kurrfarë lidhje me sistemin e përgjithshëm dhe të realtë të jetës!” Këta dhe më tej vazhdojnë të qëndrojnë në xhahilijetin e tyre, në ligjet e djallit dhe nuk mbështeten në sheriatin e Zotit. Të gjitha këto janë orvatje të këqija dhe muslimani nuk ka nevojë të mbështetet në mendimin e ndryshueshëm njerëzor, i cili formohet në emër të progresit të mjeteve të da'vetit në Zot!

Një ndër orvatjet më të këqija është ajo e atyre që Islamit dëshirojnë t'i japin forma të tjera, ndaj dhe e emërtojnë atë me emëtime nga më të ndryshmet, që kalkulojnë mes njerëzve në një periudhë të caktuar kohore, si p.sh.: socializmi, demokracia etj. Këta mendojnë se i shërbejnë Islamit me progres të tillë negativ. “Socializmi” është sistem shoqëror, politik-ekonomik i formuar nga njerëzit dhe mund të jetë i saktë dhe i gabuar. “Demokracia” është sistem i jetës apo pushtetit, poashtu i formuar nga njerëzit dhe kështu, mund të jetë i saktë ose i gabuar. Islami është metodë e jetës që përmban koncept të besimit, të sistemit shoqëror, ekonomik, të sistemit ekzekutiv formal... Këtë e ka formuar Vetë Zoti i Madhërishëm dhe

nuk ka kurrfarë mangësie e lajthitje. Idhujtarët e xhahilijetit arab i luteshin Zotit përmes disa krijesave të Tij dhe i konsideronin si të parë, të afër, ura lidhëse te Allahu xh.sh.:

“Ne nuk i adhurojmë ata për tjetër, vetëm që të na afrojnë sa më afër Allahut” (el Zumer, 3).

Kjo është idhujtari(Shirk)! Pra, si të përshkruhet ai që i lutet Zotit përmes robërve të Tij ose përmes ndonjë doktrine apo metode të robërve?! Ç'marrëzi e madhe!!!

Islami është Islam, socializmi-socializëm dhe demokracia - demokraci! Islami është metodë e Zotit dhe ka vetëm adresën dhe cilësitë që ia ka caktuar Zoti. Socializmi dhe demokracia janë metoda dhe përvoja njerëzore. Nëse i zgjedhim këto, atëherë le t'i zgjedhin ashtu siç janë! Thirrësit në fenë e Zotit nuk duhet të bijnë në kurthin e epsheve të ndryshueshme njerëzore dhe të mendojnë se kështu i ndihmojnë fesë së Zotit!

Ju drejtohem atyre që kanë fê të dobët dhe nuk e madhërojnë Zotin ashtu siç duhet dhe u them: “A ua paraqitni njerëzve Islamin në emër të socializmit apo të demokracisë, ngase këto dy doktrina sot janë dy drejtimet bashkëkohore?” Kapitalizmi në një periudhë kohore ishte sistemi absolut, doktrina kapitaliste përqafohej me të madhe në periudhën e bashkimit kombëtar të shteteve të ndara si p.sh. të Gjermanisë dhe Italisë në kohën e Bizmarkut dhe Macinit, ndaj dhe nesër nuk dihet se çfarë do të thonë për Islamin, gjegjësisht çfarë sistemi shoqëror, tokësor e pushteti do ta parqesin Islamin? A do ta paraqesin atë ashtu siç u pëlqen njerëzve?! Udhëzimi kur'anor e sqaron këtë gjë në përgjithësi. Ai dëshiron që thirrësi ta lartësojë fenë e tij e të mos bie viktimë e propozimeve që vijnë nga njerëzit dhe të mos e zbukurojnë këtë fê me ndonjë emër tjetër si dhe t'ju flet njerëzve vetëm me metodën dhe mënyrën e tij. Zoti është i pastër dhe i pamvarur nga krijesat e Tij! Kjo nuk i përgjigjet adhurimit fetar dhe atij që nuk koncentrohet vetëm në këtë adhurim. Kjo fê nuk ka nevojë për njerëz të tillë në këtë adhurim,

*ashtu siç nuk ka nevojë Zoti i Madhërishëm për ndonjë adhurues ose mëkatar.*²⁵⁵

Kjo analizë e mrekullueshme është një studim, krahasim dhe rezultat i kulturës dhe njohurive të gjera të autorit që i ka rreth shkencave tjera. Ky potencial vërehet gjatë tefsirit të tij të Librit të Zotit të Madhërishëm dhe gjatë zberthimit të çështjeve të da'vetit. Kjo është metoda e tij në të kuptuarit e ajeteve të da'vetit.

Të dëgjojmë edhe njëherë shehid Sejjid Kutubin i cili na flet rreth asaj se çfarë ka parë në Amerikë në vitet e pesëdhjeta të Shek. 20, gjatë kohës që ndodhej atje për studime posdiplomike, gjegjësisht devijimin e moralit, vlerave dhe gjendjes si dhe mënyrën se si i ka kuptuar ligjet hyjnore nga realiteti kur dënohen popujt. Sikur të mos e kuptonte këtë realitet në bazë të konceptit të Islamit, nuk do të kishte pasur mundësi që t'ua paraqesë njerëzve madhërinë e metodës kur'anore.

Në tefsirin që i bën ajetit të **44** të sures **“El En'amë”** thotë:

“Gjatë qëndrimit tim në SHBA, e pashë me sytë e mi Fjalën e Zotit të Madhërishëm: “Meqë lanë pas dore atë me çka u këshilluan (urdhërin që t'i drejtohen Zotit), Ne ua hapëm dyert e çdo gjëje (begatie...)” (el En'amë, 44). Kjo skenë që del nga ajeti tregon begatitë dhe furnizimet e pakufizuara të cilët vetëm aty mund të bëhen ashtu siç bëhen. E shihja krenarinë e njerëzve për shkak të kësaj pasurie dhe ndjenjat e tyre se ajo është e caktuar vetëm për “njeriun e bardhë.” Bashkëpunimi i tyre me njerëzit me ngjyrë (zezakët) ishte në nivel shumë të ulët dhe të vrazhdë.

E shihja tërë këtë skenë dhe e kujtoja ajetin kur'anor dhe parashihja hapat që vijojnë pas për atë që janë në gjumë: “Derisa kur u gëzuan për atë që ju kishte dhënë, i kapëm befas, e ata mbetën të zhgënjyer. Ndaj u zhduk mbeturina e fundit e popullit mizor, pra falënderimi i qoftë Zotit të botëve!” (el En'amë, 44-45).

²⁵⁵ Sejjid Kutub, **“Fi dhilâlil-Kur'an”**, vëll. 2, fq. 1083-1084.

Nëse Zoti i Madhërishëm pas dërgimit të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e ka ngritur (deroguar) dënimin me ç'rrënjosje, natyrisht që ekzistojnë dënime tjera dhe njerëzit, posaçërisht atyre të cilëve u janë hapur dyert e të gjitha begative, shijojnë shumë dënime, përkundër asaj që kanë prodhime dhe furnizime të shumta...

Dënimi psikik, vuajtja shpirtërore, devijimi seksual dhe shkatërrimi i moralit janë disa fenomene që i përjetojnë sot këta popuj dhe e gjithë kjo ia tejkalon prodhimin, dëfrimit dhe kënaqësisë. E tërë jeta e tyre është e mbushur përplotë mjerim, mërzi e vuajtje. Përveç kësaj, aty ka edhe devijim të moralit politik nga ku shiten fshehtësitë e shtetit dhe tradhëtohet populli për hirë të kënaqësisë dhe devijimeve... S'do mend se këto gjëra kanë përfundim negativ!

Ky është fillim i rrugës dhe në këtë kontekst Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: “Kur të shohish se Zoti i jep njeriut në këtë botë atë që dëshiron (edhe pse bën mëkate), (dije) se kjo është proces (gradualitet)”; pastaj e lexoi ajetin: “Meqë lanë pas dore atë me çka u këshilluan (t'i drejtohen Zotit), Ne ua hapëm dyert e çdo gjëje (begatie) derisa kur u gëzuan për atë që kishte dhënë, i kapim befas, e ata mbetën të zhgënjyer” (el En'amë, 44).

Përveç kësaj, duhet theksuar se është sunnet (ligj) i Zotit në shkatërrimin e të keqes, në popull të ekzistojë e vërteta e pastaj Zoti e gjuan të keqin me të vërtetën dhe e shkatërron. Ithtarët e të vërtetës nuk janë përtacë dhe nuk presin që ligji i Zotit të realizohet pa punë dhe pa angazhim, ngase në të kundërtën nuk do ta përfaqësonin të vërtetën dhe nuk do ta meritonin një gjë të tillë skur të rinin ulur dhe sikur të ishin përtacë. E vërteta qëndron vetëm te populli i cili përpiqet që të sundojë pushteti i Zotit në tokë dhe i largojnë të tjerët që thërrasin në grabitjen e karakteristikave hyjnore (pushtetit të Allahut xh.sh.)”²⁵⁶

²⁵⁶ Sejjid Kutub, “Fi dhilâlil-Kur'an”; vëll. 2, fq.1091-1092.

Unë bindshëm besoj se materializmi dhe komunizmi i gjysmës së parë të shek. XX,²⁵⁷ në këtë kohë përjetuan kulmin dhe pedestalin e tyre. Të gjitha universitetet ndërkombëtare në përgjithësi dhe ato ruse (sovjetike) në veçanti, studentë e profesorë, mësonin dhe ua mësonin të tjerëve parimet e marksizmit, leninizmit dhe frojdizmit, si dhe parimet tjera destruktive e të devijuara që bien ndesh me Islamin dhe e kundërshtojnë besimin islam.

Për fat të keq, kjo metodë filloi të përhapet në mesin e muslimanëve në përgjithësi, dhe në disa shtete islame dhe arabe në veçanti, atëherë kur filloi ideja e ndryshimit të kurikulave dhe metodave studimore apo mësimore nëpër shkolla e universitete. Pra, duhej të kundërshtohet kjo rrymë destruktive dhe e hidhët si dhe të sqarohet dekadencia e saj. Njëri nga kundërshtarët e tillë ishte profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!), i cili shenjtërinë e Islamit e mbrojti me laps, me ide dhe me gjak.

Ende jemi duke folur për kulturën²⁵⁸ e kohës që duhet ta posedojë thirrësi, dhe ky është një aspekt i metodës së profesor Sejjid Kutubit në të kuptuarit e tij të ajeteve të da'vetit, gjë kjo që argumenton njohuritë e tij të gjëra rreth shkencave të kohës së tij...

Në këtë kontekst, Sejjid Kutubi thotë:

“Besimi në të padukshmen e dalloi njeriun nga bota e kafshës, mirëpo shoqëria materialiste e kësaj kohe, ngjashëm si shoqëria e materialistëve e të gjitha kohëve, dëshiron që ta kthejnë njeriun në botën e kafshës, e cila beson vetëm në atë që sheh dhe këtë e quajnë: “progres”. Jo, ky është regres, prej të cilit Zoti i mbron besimtarët duke i cilësuar si: “Të cilët besojnë në të padukshmen.”

²⁵⁷ Më gjerësisht rreth jetës politike që mbretëronte Egjipt në kohën e Sejjid Kutubit, shih librin e prof. Halidit: **“Sejjid Kutub, Esh-Shehid El-Hajj”**; fq.18-30.

²⁵⁸ Dijetari i njohur bashkëkohor dr. Shejh Jusuf Kardavi ka shkruar një libër shumë të rëndësishëm me titull: **“Thekafetud-da’jeti”**. Edhe dijetari i njohur egjiptian, i ndjeri dr. Shejh Muhamed El-Gazali ka libra të rëndësishëm për thirrësit në Zot, prej tyre veçojmë: **“Es-sunnetu en-nebevijetu bejne ehliil-fikhi vel-hadithi”**; **“Hulukul-muslimi”**; **“El-hakku el-mur-ru”**; **“Me’All-llah”**; **“Dirasat fid-da’veti Ved-du’at”**; etj. Lexuesit duhet t’i lexojnë librat e dijetarëve të tillë të njohur, ngase janë ata mjaft të arrirë dhe të përgatitur shkencërisht. Ata poashtu kanë merita për shkak të përvijës së tyre te gjatë në da’vet.

Ata që flasin rreth “metafizikës” dhe “scientizmit” poashtu flasin edhe për “determinizmin historik” që nënkupton se e tërë ardhmëria është e përcaktuar. “Shkenca” sot thotë: “Ekzistojnë hipoteza” por jo edhe “teza”. Marksi pranonte “determinizmin” por ku janë sot parashikimet e Marksit? Ai parashihte formimin e komunizmit në Angli për shkak të zhvillimit të lartë industrial, të kulminacionit të kapitalizmit në njërën anë, dhe të varfërisë së punëtorëve në anën tjetër, megjithatë, komunizmi u përhap në mesin e popujve që janë më të varfër industrialisht... Në Rusi, Kinë dhe asnjëherë në shtetet e zhvilluara industriale. Marksi dhe Lenini parashihnin domosdoshmërinë e luftës në mes botës kapitaliste dhe asaj komuniste, mirëpo ja, pasardhësi i tyre Hrushçovi mban flamurin e “jetës së përbashkët paqësore.” Nuk dua të flas më gjatë rreth “domosdoshmërive” të tilla të parapara, ngase nuk meritojnë shqyrtim serioz.

Ekziston një e vërtetë që quhet e vërteta e të padukshmes dhe çdo gjë tjetër konsiderohet hipotezë. Poashtu ekziston një determinizëm në ngjarjet që ndodhin në bazë të caktimit dhe të kaderit të Zotit. Caktimi i Zotit është i fshehtë dhe atë e di Vetëm Ai, megjithatë, ekzistojnë ligje konstante të Universit, të cilat mund t’i zbulojë njeriu e të mbështetet në to si mëkëmbës në tokë, duke e lënë hapur derën e Caktimit të Zotit. Fshehtësitë e Zotit janë të panjohura dhe kjo është shtyllë e të gjitha gjërave: “Vërtetë ky Kur’an udhëzon në ate që është më e fortë.”²⁵⁹

Me përfundimin e kësaj pjese arijmë në fund të ekspeditës intelektuale dhe të da’vetit me profesor Sejjid Kutubin (Zoti e mëshiroftë!) pasi që jetuam një kohë goxha të bukur me librin e tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”** ashtu siç jetoi autori i tij me të, dhe gjatë kësaj ekspedite pamë se si ai e ka ndërlidhur tefsirin e tij të Kur’anit Fisnik, posaçërisht të ajeteve të da’vetit me kritikën kundër teorive dhe sistemeve pozitive destruktive të kohës së tij.

Me këtë metodë shkencore të cilën e përdori gjatë tefsirit të Kur’anit Fisnik për t’i ndërlidhur ajetet kur’anore me realitetin e jetës, ai njëherit ka ofruar edhe mësim të da’vetit islam. Ai ka plotësisht të drejtë kur thotë:

²⁵⁹ Sejjid Kutub, **“Fi dhilâlil-Kur’an”**; vëll. 2, fq. 1120-1121.

“Jeta nën hijen e Kur’anit është begati, gjegjësisht begati që e njeh vetëm ai që e shijon atë... Begati kjo, e cila ta zgjatë jetën, ta bekon dhe ta pastron atë.”²⁶⁰

²⁶⁰ Sejjid Kutub, “**Fi dhilâil-Kur’an**”; vëll. 2, fq. 1, 2.

III: Kritikë, epilog dhe sugjerime

1. Disa vështrime mbi metodën e profesor Sejjid Kutubit

Pas këtij rrugëtimi të këndshëm me profesor Sejjid Kutubin nëpërmes tefsirit të ajetit të da'vetit në Zotin e Madhërishëm them se shumë kemi përfituar nga përvoja e tij e gjërë dhe e hidhur, për sa u përket çështjeve të da'vetit, filosofisë dhe strategjisë së tij, mirëpo, ky përfitim nuk më pengon që të jap disa vështrime që janë rezultat i studimit tim të metodës së profesor Sejjid Kutubit në të kuptuarit e ajeteve të da'vetit.

Askush nuk guxon të mendojë se kjo ndikon në zvogëlimin e vlerës dhe meritave të këtij komentatori, përkundrazi... E kundërta e kësaj është e vërtetë, ngase vështrimet e tilla e lartësojnë vlerën e këtij dijetari dhe e shtojnë dashurinë, respektin dhe nderin ndaj tij. Kjo duhet trajtuar si fakt se mëngësia është cilësi e rëndomtë njerëzore.

Këto vështrime mund të jenë të panjohura për disa të tjerë bile ndoshta as që i trajtojnë si vështrime, por për mua, kjo çështje është relative dhe këto mund t'i ndodhin çdokujt:

Vështrimet e tilla mund t'i ndajmë në dy grupe:

A). Vështrime të posaçme. Këto vështrime i kam përfituar si hulumtues, kërkues i diturisë dhe studiues i metodës së tij të da'vetit në këtë disertacion shkencor; dhe:

B). Vështrime të përgjithshme. Këto vështrime janë të studiuesve dhe hulumtuesëve të tjerë, të cilët e kanë studiuar mendimin, metodën dhe jetën e profesor Sejjid Kutubit.

A). Vështrimet e posaçme

1. Përsëritja e shumë çështjeve akadiologjike dhe intelektuale, si p.sh.: koncepti islamik, karakteristikat e konceptit islamik, pushteti, karakteristikat hyjnore, çështja e ndarjes dhe shoqërimit, ligjet pozitiviste që janë produkt i njerëzve, çështja e Kur'anit të periudhës mekase, periudha e gjatë për edukimin e gjeneratës së parë etj. Autori ka pasur mundësi të flet për këto çështje vetëm njëherë në mënyrë të gjatë në tefsir. Kur konteksti ndikon që të ripërsëritë atë që e thotë më herët, do të ishte më mirë sikur ta udhëzonte lexuesin në faqen konkrete që janë diskutuar më herët dhe të mos lodhet në ripërsëritjen e fjalëve apo çështjeve të njejta.

2. Ishte vështirë për mua ta tuboj këtë tematikë të përhapur në shumë vende, gjegjësisht nxjerrjen e metodës së tij në tefsirin e ajeteve të da'vetit, ngase ai (Zoti e mëshiroftë!) nuk e ka sqaruar metodën e tij në tefsir dhe nuk ka përdorur një metodë të vetme prej fillimit e deri në fund të tefsirit si dhe mënyrën e shqyrtimit të ajeteve të posaçme dhe të ajeteve të tjera të përgjithshme. Ai nuk e informon lexuesin për një gjë të tillë. Profesori flet në mënyrë të shpërndarë në librat dhe në shkrimet e tij rreth çështjeve racionale në këtë aspekt.

3. Sa i përket përdorimit të termit “*xhahilijet*” dhe “*shoqëria xhahilite*” që profesor Sejjid Kutubi ia atribuon shoqërive në të cilat jetojmë dhe për të cilat terme, gjegjësisht ide, mjaft është akuzuar se me këtë po i akuzon për kufër të gjitha shoqëritë islame... Pas shqyrtimit dhe studimit tim të veprave të tij në përgjithësi dhe tefsirit të tij “*Fi dhilâlil-Kur'an*” në veçanti, them se termi “*xhahilijet*” të Sejjid Kutubi ka kuptim të përgjithshëm dhe të posaçëm.

a). Kuptimi i përgjithshëm:

Sipas kuptimit të përgjithshëm ai e përdorë këtë term për të gjitha sistemet pozitiviste njerëzore, sociale, politike, ekonomike bashkëkohore që nuk mbështeten në kushtetutën e Kur'anit Fisnik dhe Sunnetin e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) Njerëzit veprojnë dhe gjykojnë sipas sistemeve të tilla pa u mbështetur burimisht në Kur'anin Fisnik e as në Sunnetin e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), siç është p.sh. sot gjendja në disa shtete arabe, të cilat mbështeten në Ministrinë e Drejtësisë apo në Ministrinë e Informatave si dhe gjendja e muslimanëve në shtetet e Lindjes dhe të Perëndimit që mbështeten në ligjin socialist, komunist dhe atë demokratik të shtetit, e që këto ligje janë nxjerrë nga ligjet Romake.

Të tillët, sipas profesor Sejjid Kutubit, janë muslimanë nën presion dhe janë të dominuar nga ligjet e tilla xhahilite që janë larg Islamit, qofshin në shtetet arabe ose ato perëndimore. Ky është kuptimi i përgjithshëm i termit **“xhahilijeti”** sipas profesor Sejjid Kutubit, dhe unë plotësisht dakordohem me këtë kuptim dhe domethënie. Pra, ai nuk i ka akuzuar shoqëritë islame apo Muslimanët për kufër, por sqaron gjendjen dhe jetën e tyre sipas ligjeve e sistemeve xhahilite, gjegjësisht sipas ligjeve që nuk e aplikojnë Sheriatin e Zotin në asnjë mënyrë.

b). Kuptimi i posaçëm

Për sa i përket kuptimit të posaçëm të këtij termi, ai (Zoti e mëshiroftë!) e përdorë shumë shpesh në veprat e tij. Jam i mendimit se ai këtu e përdorë për të treguar shoqërinë xhahilite me të gjitha parimet, vlerat dhe domethëniet e saj, ashtu siç kanë qenë njerëzit në shoqërinë e parë xhahilite para ardhjes së Islamit dhe se ata vërtetë janë jobesimtarë dhe jomuslimanë, edhe pse sot, ithtarët e këtij xhahilijeti bartin emra muslimanësh dhe paraqiten si muslimanë.

Nuk ka dyshim se unë distancohem tërësisht nga ky kuptim i profesor Sejjid Kutubit, dhe nuk besoj që edhe vet profesori Sejjid Kutubi ka për qëllim këtë. Ngase nuk mund të paramendoj se profesori i çmuar i akuzon për kufër të gjithë muslimanët dhe të gjitha shoqëritë islame. Nëse profesori kishte për

qëllim këtë kuptim, atëherë asnjëherë nuk e pranoj këtë gjë dhe as që pajtohem me të në asnjë mënyrë, dhe kjo do të ishte një kritikë shumë e madhe ndaj tij...

Unë mendoj se profesor Sejjid Kutubi nuk mund të mendojë kështu dhe t'i akuzojë të gjithë njerëzit për kufër dhe për xhahilijetin e parë, ngase rregullat e kufrit dhe ato të Islamit janë shumë të qarta tek ai. Ai, gjatë tefsirit të tij në **“Fi dhilâlil-Kur’an”** dëshmon të kundërtën kur flet për thirjen e jobesimtarëve në Islam.

Këto ishin disa vështirime dhe kritika të mia, dhe nuk ka kurrfarë dyshim se kjo nuk e ulë aspak autoritetin e komentatorit dhe profesor Sejjid Kutubit në tefsirin e tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”**. Përkundrazi, ai do të vazhdojë të jetë udhëheqës i mendimit islam bashkëkohorë dhe i da’vetit islamik.

Lus Zotin e Madhërishëm që ta shpërblejë për mundin dhe sakrificën që bëri për Ummetin islam si dhe ta pozicionojë në xhennetet e Tij të gjera me pejgamberët, të sinqertët, shehidët dhe të devotshmit! Amin!

B). Vështirimet e përgjithshme

Vështirimet e përgjithshme ndaj profesor Sejjid Kutubit dallohen me dallimin e njerëzve dhe specializimeve. Fukahatë e kritikojnë nga aspekti i fikhut për shkak të ndonjë mendimi të tij në tefsir nga lënda e fikhut. Muhadithët e kritikojnë ndonjëherë për shkak të ndonjë hadithi që e ka përdorur në Dhilal-in e tij etj. Ndoshta profesori ka pasur për qëllim diçka tjetër, mirëpo njerëzit kanë kuptuar diçka tjetër, dhe kjo është më e kapshmjia në këto çështje.

Pjesa dërmuese që e kritikonin ishin të kësaj lëmie. Ata, mbase duke mos i lexuar fjalët e Sejjid Kutubit prej fillimit deri në mbarim, ndoshta për këtë shkak devijojnë, rrëshqasin e bijnë në kurthin e mendimeve të këqija e pargjyquese për të.

Feja jonë e pastër na mëson që të verifikojmë dhe të argumentojmë çdo gjë. Nëse lexojmë një vepër apo një disertacion të ndonjë dijetari dhe të njëjtin e kritikojmë pozitivisht apo negativisht pas leximit sipërfaqësor dhe të pjesëshëm, pa e lexuar pjesën dërmuese të asaj që ka paraqitur dhe shkruar dijetari

apo autori, sipas mendimit tim, ne bëjmë një padrejtësi të madhe, pa marrë parasysh se çfarë pozite apo profesioni ka lexuesi.

Dijetarët e sinqertë e pranojnë këtë fakt si të pamohueshëm ngase nuk mund të gjykojmë për një çështje nëse nuk i lexojnë të gjitha argumentet që kanë të bëjnë me këtë çështje e pastaj të sjellim gjykimin tonë. E njëjta gjë duhet të vlejë edhe për personat edhe për idetë e tyre. Lexuesi obligohet që t'i përcjellë mendimet në një kronologji historike dhe me një precizitet të madh e pastaj të gjykojë për të.

Në skenën islame u paraqitën disa mendimtarë të mëdhenjë (kolosë) që mbrojnë të vërtetën dhe ithtarët e saj si p.sh.: prof. dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidi, i cili studioi me precizitet dhe objektivitet Sejjid Kutubin në veprat e tij, dhe i cili konsiderohet bazë shkencore për mendimin dhe aktivitetin e Sejjid Kutubit. Prof. Salah el Halidi shkroi shumë vepra dhe monografi letrare dhe kritike rreth mendimit të prof. Sejjid Kutubit, e ndër ta veçojmë: **“Sejjid Kutub, Esh-shehid el-hajj”**, **“Sejjid Kutub min el Mijladi ila el Istish’had”** **“ Fi Dhilal el Kur’an fi el Mizan”** etj. Poashtu vlenë të përmendim edhe prof. dr. Muhamed Teufik Berekat, i cili është autor i veprës: **“Sejjid Kutub, hulasatu hajatihi, menhexhu fil-hareke ven-nekdu el muvexh-xhehu ilejhi.”** Gjithashtu edhe profesori dhe këshilltari Salim el Behensavi ka punime të shkëlqyeshme shkencore në të cilat e mbron shkencërishtë dhe metodologjikisht profesor Sejjid Kutubin në librin e tij: **“Adva’un ala me’alim fit-tarik”**, **“El-Hukmu ve kadijjetu tekfir El-muslim”**, etj. Kohëve të fundit janë publikue edhe disa monografi me rëndësi të madhe për mendimin dhe kontributin e prof. Sejjid Kutubit si p.sh: **Reva’iu edh-Dhilal**, të autorit Rami Omer Ba Atiyeh, 2012, Rijad, Arabia Saudite; **Sejjid Kutub Ba’de 43 A’men min Istish-hadihi**, grup autorësh, 2010, Aman, Jordan; **Mekasidu el-Sheriati el Islamijeti fi Fikri el Imam Sejjid Kutub**, 2009, Hurtum, Sudan.

Profesor Salim El-Behensavi në mënyrë të mrekullueshme i thekson parimet shkencore sheriore rreth mënyrës së të kuptuarit të fjalëve të të tjerëve në librin e tij: **“Adva’u ala me’alim fit-tarik”**, për shkak se shumë njerëz i keq-komentojnë fjalët e profesor Sejjid Kutubit dhe padrejtësisht e akuzojnë atë me akuza të shumta. Ata që e akuzojnë atë, nuk mbështeten në metodën shkencore burimore e të shëndoshë juridike, ndaj dhe për këtë shkak

kanë rënë në kurthe të tilla. Prandaj Salim el Behensavi sygjeron disa parime që duhet të respektohen dhe të ndiqen për të mirkuptuar medimet e tjetrit

Parimet e këshilltarit Salim El-Behensavi mund t'i përmbledhim në pikat vijuese:

1. Mos akuzimi i muslimanit për kufër me gjëra të dyshimta:

Nëse ka mendime e thënie, nuk duhet të marrim vetëm një mendim që shkakton fitne e t'i lëmë mendimet tjera duke mos i analizuar rreth ndonjë çështjeje, ngase në këtë mënyrë nuk mund të përfitojnë gjykim të vërtetë sipas Sheriatit.²⁶¹

Nëse ndokush zgjedh mendim që përputhet me drejtimit e ndonjë shoqërie, apo të ndonjë individi dhe e akuzon tjetrin pikërisht në këtë mendim që nuk përputhet me mendimin e tij; ky gjest nuk është objektiv dhe kjo ka të bëjë me atë që quhet gjë e dyshimtë dhe një gjë të tillë e ka ndaluar Zoti i Madhërishtëm: *“E ata që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar huti, e kinse kërkojnë komentin e tyre”*. (Ali-Imran, 7).

2. Mbështetja në Kur'an dhe Sunnet:

Rregulla islame na urdhëron që, në rast të grindjeve dhe mosmarrëveshjeve rreth ndonjë çështjeje, të mbështetemi në Kur'an dhe në Sunnet që të gjejmë zgjidhje të shëndoshë.

Në këtë kontekst, Zoti i Madhërishtëm thotë:

“Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtronie atë te Allahu (te Libri i Tij) dhe te i Dërguari, po qe se i besoni Allahut dhe Ditës së Fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë”. (en Nisaë, 59).

Profesor Salim El-Behensavi thotë se kështu duhet të kuptohet edhe hadithi i Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!):

²⁶¹ Salim El-Behensavi, *“Adva'u ala me'alim fit-tarik”*; botoi: Darul-buhuthil-ilmijeti lin-neshri vet-teuzi'ë, Kuvajt, bot. 1, 1985, fq. 27.

“Fyerja e muslimanit është mëkatë dhe vrasja e tij është kufër!”

Në ajetin kur’anor thuhet:

“Nëse dy grupe besimtarësh tentojnë të luftojnë ndërmjet vete, ju pajtoni ata!” (el Huxhuratë, 9).

Nga kjo nënkuptohet se luftimi në mes besimtarëve nuk është kufër dhe hadithi i Pejgamberit ***“vrasja e tij është kufër!”*** - nënkupton kufrin në begatinë e Islamit e jo kufrin në dalje nga shoqëria islame.²⁶²

3. Dallimi në mes gjykatësve dhe thirrësve:

Në këtë kontekst, profesor El-Behensavi thekson se ata që i lexojnë librat e disa thirrësve të cilët shkruajnë për pushtetin e Sheriatit të Zotit në jetën tonë, si p.sh.: veprat e profesor Sejjid Kutubit: ***“Me’alim fit-tarik”***, ***“Fi dhilâlil-Kur’an”***, si dhe librin: ***“El-Mustalehat El-Er’be’atu”*** të autorit Ebu A’ëla El-Meududi, mendojnë se mendimtarët e tillë janë gjykatës që japin fetva e gjykime dhe se fjala e tyre patjetër të realizohet!!!

Ky është gabim i madh i lexuesëve, ngase në realitet vetë thirrësit e tillë deklarojnë se nuk kanë për qëllim të japin vendime e fetva por thjeshtë janë mendime të tyre. Këtë e vërteton edhe vetë profesor Sejjid Kutubi kur thotë: ***“Ne jemi thirrës dhe nuk jemi gjykatës!”***²⁶³

Pastaj profesor Salim El-Behensavi jep disa shembuj nga rezultatet negative që kanë dalë si rrjedhojë nga mos aplikimi i parimeve burimore nga ana e thirrësve dhe e dijetarëve. Ai poashtu thekson çështjen e akuzimit të

²⁶² ***“Adva’u ala me’alim fit-tarik”***; fq. 34.

²⁶³ Salim El-Behensavi, ***“Adva’un ala me’alim fit-tarik”***; botoi: Darul-buhuthil-ilmijeti lin-neshri vet-teuzi’ë, Kuvajt, bot. 1, 1985, fq. 36. Këtu është me rëndësi të potencohet se kjo që është e mos njohjes së dallimit në mes të këtyre tre terminologjive(***El Mufti, El Kadij, El Da’ij***) dmth: ***Muftiu, Gjykatësi, dhe Thirrësi***, është shumë problem dhe fenomen aktual i hoxhallarëve, studentëve, thirrësve në Islam pothuajse në tërë ruzullin tokësor. Po japim një sqarim të thuktë. Muftiu është ai i cili flet zyrtarisht në emër të Allahut xh.sh. dhe lëshon verdikte, fetva dhe jep nënshkrime në emër të Islamit, dhe se këto mendime dhe fetva; sipas dijetarëve nuk konsiderohen obligative, por janë udhezuese. A ndërsa Kadriu, është ai person, xhykatës zyrtar i cili mer vendime decizive në bazë të argumenteve që posedon, dhe pastaj lëshon vendime të prera rreth ndonjë çështjeje Islame(*martesa, divorci, trashigimia etj*) pranë Gjykatës Islame. Këto vendime janë obligative dhe ekzekutuese. A ndërsa Da’iu, thirrësi në Islam, hoxha, studenti, ai i që flet në emër të Islamit sipas mendimit të tij personal, sipas kuptimit të tij personal të Kur’anit dhe të Synnetit, apo të Sheriatit në përgjithësi, kështu që mendimet e tija nuk janë as obligative e as ekzekutuese. Sot çka po shohim nëpër mediat elektronike në internet, në YouTube, etj, me të vërtetë është mjerim dhe katastrofë për Ymmetin Islam! Allahu na ndihmoftë dhe na i qeltë sytë e zemrave tona, dhe i udhezoftë ata shokë, hoxhallarë në mirkuptimin e drejtë të këtyre terminologjive fetare, Amin.

muslimanëve që i adresohet profesor Sejjid Kutubit, ndërsa ata të cilët ia mveshin këtë gjë, çuditërisht janë nxënësit e tij...²⁶⁴

Prof. dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidi shqyrton shumë çështje në librin e tij **“Fi dhilâlil-Kur’an fil-Mizan”**, të cilat u aktualizuan rreth ideve të prof. Sejjid Kutubit, përfshirë akuzimin për kufër ndaj muslimanëve, qëndrimi i Sejjid Kutubit rreth fikhut islamik etj.

Ç’është e vërteta, studimi i prof. dr. Salah Abdul-Fetah Halidit mbi Sejjid Kutubin meriton çdo fjalë miradije e respekti nga ana e dijetarëve dhe studentëve të shkencave të Sheriatit! Zoti e shpërbleftë prof. Halidin për këtë vepër madhështore!

Sipas prof. dr. Salah Abdul-Fetah El-Halidit, shkak i akuzës së parë qëndron në keqkuptimin e fjalëve të shprehura nga ana e prof. Sejjid Kutubit në librat e tij: **“Fi dhilâlil-Kur’an”** dhe **“Me’alim fit-tarik”**. Akuzuesit kanë njohuri të kufizuara shkencore, kulturore e sheriatoe dhe nuk i njohin rregullat burimore të të menduarit.²⁶⁵

Prof. El-Halidi thekson se ekzistojnë dy grupe njerëzish që kanë përfituar rezultate negative nga fjalët e profesor Sejjid Kutubit:

Grupi i parë që mendon se të gjithë muslimanët sot janë jobesimtarë përveç atyre që janë anëtarë të grupit të tyre. Ky grup u formua në Egjipt gjatë viteve të shtatëdhjeta dhe njihet me emrin: **“Xhema’atul-muslimin”** apo **“Xhema’atut-tekfir vel-hixhreti”**. Ky grup deklaronte se beson në idetë dhe në fjalët e profesor Sejjid Kutubit, dhe kështu, kërkonin në librat e tij **“Fi dhilâlil-Kur’an”** dhe **“El-Mealim”** tekste të cilat i nxirrnin jashtë kontekstit të fjalisë. Më i zëshëm kundër ideve të tyre është prof. Salim El-Behensavi në librin e tij **“El-Hukmu ve Kadijjetu tekfir el-muslim.”**

Grupi i dytë që e akuzon besimin dhe mendimin e Sejjid Kutubit, për shkak se ai i akuzon muslimanët për kufër. Këtë grup e udhëhiqte inxhinjeri A. Ebu Izzet, i cili shkroi disa artikuj në revistën libaneze **“Esh-Shihab”**. Ai në shkrimet e tij thotë se njerëzit e vendeve islame janë injorantë,(xhahil) jobesimtarë dhe jashtë Islamit edhe pse falin namaz, agjërojnë dhe kryejnë haxhin!!!

²⁶⁴ Po aty; fq 39. Këtu nuk mund ta përcjellim gjithë atë që prof. El-Behensavi e thotë rreth kësaj çështjeje, ngase natyra e këtij disertacioni shkencor nuk na lejon një zgjerim të tillë.

²⁶⁵ Salah Abdul-Fetah El-Halidi, **“Fi dhilâlil-Kur’an fil-mizan”**; fq. 205.

Prof. El-Halidi thekson disa shembuj rreth kësaj çështjeje duke i argumentuar ato me vetë fjalët e profesor Sejjid Kutubit. Ai thekson se në fillim ndoshta nga fjalët e tij mund të kuptohet akuzimi për kufër, mirëpo në realitet, kjo nuk është ashtu dhe këtë arrijmë ta kuptojmë vetëm nëse i studiojmë thellësisht dhe komplet fjalët e Sejjid Kutubit dhe nëse i krahasojmë me dijetarët tjerë, dhe kështu, në këtë mënyrë del në pah gabimi i bërë.²⁶⁶

Unë i shoh si korrekte dhe të vërteta dhe pajtohem plotësisht me vështrimet dhe kritikën e Salim El-Behensavit dhe Salah Abdul-Fetah El-Halidit ndaj **“Fi dhilâlil-Kur’an”** dhe ndaj autorit të tij.²⁶⁷

Pas këtyre çështjeve të rëndësishme, do ti shtojmë edhe disa fjalë të tjera në vijim:

1. Profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) është njeri sikur ne, ndaj dhe për rrjedhojë ndodh që t’ia qëllon, ashtu sikur edhe të gabon, ngase ai megjithatë nuk është i mbrojtur, ashtu siç janë të mbrojtur pejgamberët dhe të dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ta!)

2. Profesor Sejjid Kutubi në librin e tij **“El-adaletul-ixhtimaijjetu”** e shqyrton çështjen e mosmarrëveshjeve dhe polemikat në mes Aliut dhe Muavijut. Ç’është e vërteta, ai nuk është dashur që të thellohet në këtë problem, ngase të gjithë sahabët (Zoti qoftë i kënaqur me ta!) janë të drejtë dhe muxhtehidë, dhe ai që e qëllon fiton dy shpërblime, ndërsa ai që gabon vetëm një.

Sa i përket kësaj çështjeje dhe profesor Sejjid Kutubit, mund të themi se libri i tij **“El-adaletul-ixhtimaijje”** është shkruar në fillim të veprimtarisë së tij islame, gjegjësisht në kohën kur nuk ka pasur shumë njohuri dhe kulturë islame, përkatësisht ai asokohe ishte largë shoqërisë së **Vëllezërve Muslimanë** dhe akoma nuk kishte vajtur në Amerikë.

Dijetarët dhe analistët të cilët mirren me këto çështje thonë se mund të harmonizohet ajo periudhë e prof. Sejjid Kutubit me këtë periudhë dhe se libri i tij **“Me’alim fit-tarik”** është i fundit që i përmbledh idetë e tij. Në këtë libër ai i lavdëron të gjithë sahabët (Zoti qoftë i kënaqur me ta!) pa përjashtim,

²⁶⁶ Salah Abdul-Fetah El-Halidi, **“Fi dhilâlil-Kur’an fil-mizan”**; Po aty, fq. 206-207.

²⁶⁷ Po aty, fq. 278-304. Prof. Halidi këtu thekson njëzetë vështrime mbi **“Dhilâl-in”**. Shih gjithashtu edhe librin **“Edva’un ala me’alim fit-tarik”**.

madje për ta ndanë edhe një kapitull që e titullon: “**Xhijlun kur’anijun ferid**” ku thotë:

“Ekziston një fenomen historik në të cilin duhet të ndalen thirrësit muslimanë në çdo tokë dhe në çdo kohë, madje duhet të ndalen aty një kohë bukur të gjatë, ngase ky fenomen ka ndikim kategorik në metodën e da’vetit dhe në drejtimin e tij. Ky da’vet ka nxjerrë një gjeneratë njerëzish - gjeneratën e sahabëve (Zoti qoftë i kënaqur me ta!)- e cila dallohet në tërë historinë e Islamit dhe në historinë njerëzore dhe ky kapacitet nuk doli më...”²⁶⁸

Këto fjalë rreth sahabëve janë të qarta ndërsa fjalët që thuhet në librin “**El-adeletul-ixhtimaijje**” janë të dyshimta. Në rast të dyshimit, pranojmë vetëm të qartën dhe distancohemi nga e dyshimta, dhe siç dihet, njëherit ky është kriter dhe rregull shkencor burimor në Sheriatin Islam, në lëndën e Usuli Fikhut (*Juhmelu el Mutleku ala el Mukajjed, ve Juhmelu el Muteshabihu ala el Muhkem*, etj).

Përfundim dhe sugjerime

Falë Zotit të Madhërishëm, pas një mundi të madh dhe një pune të vazhdueshme, arrita ta përfundoj këtë disertacion. Për këtë i jam mjaft mirënjohës Zotit tim, ashtu siç i falënderohem edhe për shëndetin që ma dha gjatë shkrimit në vitin 2000, dhe pas 13 viteve me 2013 të recensohet nga unë, përkthimi i punimit në gjuhën shqipe dhe në anglishte, dhe të shtohen ca informata dhe sygjjerime me rëndësi të madhe për lexuesit tanë, dhe që më bekoj ta përfundoj në kohën e duhur, bile në një kohë të shkurtër dhe racionale përkundër fluksit të angazhimeve akademike dhe familjare. Allahut i takon falënderimi dhe lavdata.

Këtu vlenë të theksoj se pas ekspeditës time në jetën, veprimtarinë, rrugët dhe zemërgjerësinë e botës së da’vetit me profesor Sejjid Kutubin, pas kalimit të çasteve të këndshme nën hijen e Tefsirit të tij, pas kënaqësisë sonë me ujin e tij të freskët dhe me ajrin e tij të pastër dhe pas lartësimit të shpirtërave dhe mendimeve tona mbi materializmin e jetës së kësaj bote mbi

²⁶⁸ Sejjid Kutub, “**Me’alim fit-tarik**”; fq. 14.

dekadencën dhe mbi regresin e saj, do t'i theksoj edhe disa rezultatet më të rëndësishme të cilat s'do mend se i përfitova gjatë këtij studimi.

Në vijim, ja disa rezultate dhe dobi që përfitova nga ky studim:

- Studimi im zbuloi gjendjen fetare në botën Islame e cila përjetonte trazira, fitne dhe konflikte doktrimore me komunizmin dhe ateizmin;

- Gjatë njohjes së personalitetit të profesor Sejjid Kutubit brenda rrethanave të ambientit të tij, vërejtëm një personalitet shkencor të pakrahasueshëm dhe një shembull të gjallë nga dijetarët e da'vetit. Arsyeja më kryesore që ndikoi në suksesin e madh të da'vetit të Sejjid Kutubit dhe të tefsirit të tij, pa dyshim është të jetuarit e tij në kohën e problemeve dhe të sfidave qytetëruese perëndimore dhe atyre amerikane, ngase ai, si një letrar e dijetar Islam, mufessir brilant që ishte me një eksperiencë të begatshme në çështjen e da'vetit, i përjetoi me tërë qenien e tij dhimbjet e Ummetit dhe bëri analiza e ixhtihade të sakta;

- Në bazë të metodës së tij, ky studim zbuloi se profesor Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) e shqyrtoi da'vetin në bazë të metodës së saktë e të plotë kur'anore dhe shkencore, metodë kjo që në të kuptuarit e ajeteve të da'vetit ishte konform rregullave të Sheriatit, usulit dhe gjuhës arabe;

- Këtu doli në pah personaliteti i Sejjid Kutubit si Imam, dijetar në da'vet në bazë të qëndrimeve të tij shkencore, ngase ai nuk kishte qëndrim pasiv dhe nuk qëndronte në distancë apo larg, përkundrazi, ai zbriste poshtë në fushë, gjegjësisht në mejdanin e da'vetit;

- Ky hulumtim zbuloi qëndrimin e Sejjid Kutubit ndaj sistemeve dhe situatave nga më të ndryshmet, ngase ai kurrë nuk lëshonte pë, gjithnjë fliste haptazi për të vërtetën dhe nuk frikohej prej dëmtimit të askujt, përpos prej Zotit të Madhërishëm;

- Ky studim, poashtu zbuloi unitetin e metodës së Sejjid Kutubit dhe Imam Hasan El-Bennasë në të kuptuarit dhe në filosofinë e da'vetit në Zot;

- Sejjid Kutubi, në bazë të metodës së tij, përfitoi njohuri të bujshme rreth doktrinave dhe sekteve destruktive të asaj kohe, dhe çdonjëri që e shihte, menjëherë fitonte përshtypjen se ai e njeh mjaft mirë situatën e botës. Sejjid Kutubi tregoi interes të posaçëm në tefsirin e tij ndaj çështjes së pushtetit Islam dhe hyjnisë së Allahut xh.sh.;

- Ky studim poashtu konfirmoi njohuritë e thella dhe të gjera në lëmin e da'vetit, gjegjësishtë në zberthimin e çështjeve precize të da'vetit që kishin të bënin me të kuptuarit e tekstit kur'anor dhe në udhëzimet e tij, duke e ndërlidhur situatën e xhahilijetit të parë(injorancën para Islame) me situatën e ngjashme sot. Ai bënte një krahasim preciz dhe të shkëlqyer në mes të dy periudhave, dhe në këtë lëmë, ai doli si Imam dhe dijetar që i diskuton çështjet fetare thelbësore, duke i argumentuar mendimet e tij me ajete nga Kur'ani Fisnik;

- Sejjid Kutubi përdori metodën dinamike në da'vetin e tij dhe kjo çështje ishte unike dhe ekskluzivitet i tij, ngase askush më herët para tij nuk e kishte përdorë këtë metodë. Sejjid Kutubi përmes tefsirit të tij, gjithashtu ndihmoi që të zbardhë personalitetet e sures el-En'am, parimet e da'vetit në periudhën mekase dhe rëndësinë e tyre në hapat e da'vetit, ku erdhi në përfundim se së pari duhet të fillojmë t'i ftojme njerëzit në përmirësimin e parimit esencial, gjegjësisht besimit në hyjni(*el Akijdetu vel U'budijetu*) dhe në adhurim të vërtetë, dhe se çdo da'vet që ka të bëjë me diçka tjetër, do të dështojë dhe fare nuk do t'i ndihmojë të vërtetës;

- Ky hulumtim poashtu zbuloi se Sejjid Kutubi i kupton disa gjëra të da'vetit ndryshe nga të tjerët, si p.sh.: hyjninë,(*El rububijetu*), pushtetin,(*El hakimijetu*), injorancën (*El-xhahilijetu*), idhujtarinë,(*El-Shirku*), mosbesimin(*El-Kufriu*) etj.;

- Ky hulumtim poashtu konfirmoi disa ide e parime të da'vetit të Sejjid Kutubit për personalitetin, parimet intelektuale, shpirtërore e biheavioriste të thirrësit si dhe për çështjen e da'vetit, si p.sh.: gradualiteti, suksesiviteti, kujdesi ndaj situatës së njerëzve, metodat e da'vetit etj.;

- Hulumtimi gjithashtu zbuloi autoritetin e madh që e gëzonte Sejjid Kutubi në shoqëri si komentator i Kur'anit dhe thirrës në krahasim me moshatarët dhe bashkëkohanikët e tij. Ky hulumtim zbuloi pozitën e Sejjid Kutubit edhe përmes mendimeve të bashkëkohanikëve të tij dhe atyre të dijetarëve që shkruan për të;

- Në fund, në radhë të parë e porosis veten time, e më pas edhe vëllezërit e mi thirrës, që të bëjnë edhe studime të tjera rreth këtij dijetari dhe të zbardhin edhe aspekte të tjera nga jeta e tij, të cilat vërtet duhet studiuar me një vëmendje të veçantë, ngase ai vërtetë e meriton një gjë të tillë. Ne kemi

nevojë të madhe për studime të tilla, posaçërisht studimin e aspektit dhe pastërtisë së tij nga tekfiri (akuzimi i të tjerëve për kufër) dhe ekstremizëm; dhe:

- Poashtu i porosis organet e universiteteve dhe shkollave që ta përjetësojnë (amshojnë) emrin dhe veprën e këtij njeriu dhe tefsirin i tij, apo pjesë të zgjedhura nga ky tefsir që të jetë metodë studimore shkollore obligative në fazat e ndryshme studimore.

Dhe krejt në fund, falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve!

Hfz. Hajredin Hoxha

Universiteti Ndërkombëtar Islamik në Malajzi,

më 1 janar 2000,

në Kuala Lumpur, Malajzi.

O korrngjua përkthimi i gjuhes shqipe dhe u be recensimi i tij nga un
personalisht me:

04.05.2013

Doha-Qatar

dhe me datën:

26.06.2013

Prizren-Kosove

قائمة المصادر و المراجع

1. القرآن الكريم.
2. الأساس في التفسير، حوى، سعيد، ط1-1985، دار السلام للطباعة والنشر .
3. الإسلام و العقل، مغنية، محمد جواد، 1984، دار الجواد -لبنان .
4. احياء علوم الدين، الغزالي، أبي حامد محمد بن محمد، المتوفى 505 هجرية، تحقيق أبي حفص سيد بن إبراهيم بن صادق بن عمران، ط1-دار الحديث -القاهرة .
5. إسلامية المعرفة، المبادئ العامة، المعهد العالمي للفكر الإسلامي، 1986.
6. أزمة العقل المسلم، أبو سليمان، عبد الحميد، ط2-1992، دار العالمية للكتاب الإسلامي.
7. أسلوب الدعوة في القرآن، فضل الله، محمد حسين، ط4-1982، دار الزهراء للطباعة و النشر، بيروت، لبنان .
8. أصول الدعوة، زيدان، عبد الكريم، ط3-دار عمر بن الخطاب للنشر و التوزيع الاسكندرية .
9. أصول الدعوة الإسلامية، علي، محمد جريشة، الناشر: مكتبة دار الوفاء للنشر و التوزيع، جدة، المملكة العربية السعودية .
10. أدع إلى سبيل ربك بالحكمة و الموعظة الحسنة و جادلهم بالتي هي أحسن، بيومي مصلح سيد، ط4-دار القلم للنشر و التوزيع، الكويت .
11. أضواء على معالم في الطريق، البهنساوي، سالم، ط1-1985، دار البحوث العلمية للنشر و التوزيع -الكويت .
12. التعارض و الترجيح عند الأصوليين و أثرهما في الفقه الإسلامي، الحفناوي، محمد إبراهيم، ط2-1987، دار الوفاء، المنصورة .
13. التفسير المنير في العقيدة و الشريعة و المنهج، الزحيلي، وهبة، ط1-1991-دار الفكر المعاصر، بيروت -لبنان
14. تذكرة الحفاظ، للإمام أبي عبد الله شمس الدين محمد الذهبي، المتوفى 748 هجرية، من الطبقة الحادية عشرة إلى الطبقة الرابعة عشرة، صحح عن النسخة القديمة المحفوظة في مكتبة العثمانية، دار احياء التراث العربي، بلا تاريخ .

15. تذكرة الدعاة، الحولي، البهي، الاتحاد الإسلامي العالمي للمنظمات الطلابية، ط2-1983، دار القرآن الكريم، بيروت، لبنان .
16. تفسير المنار للإمام رضا، محمد رشيد، ط3-1367 هجرية .
17. تفسير الطبري، المسمى: جامع البيان عن تأويل آي القرآن، لأبي جعفر محمد بن جرير الطبري، ط224-310 هجرية، حققه و خرج أحاديثه الشيخ: محمود محمد شاكر، و راجع أحاديثه: أحمد محمد شاكر، دار المعارف بمصر، بلا تاريخ .
18. تفسير الفخر الرازي، المشتهر بالتفسير الكبير و مفاتيح الغيب للإمام، محمد الرازي فخر الدين بن العلامة ضياء الدين عمر المشتهر بخطيب الري، ط3-دار الفكر للطباعة و النشر، بيروت، لبنان .
19. تفسير الشيخ محمد متولي الشعراوي، دار أخبار اليوم، بلا تاريخ .
20. تفسير القرآن للشيخ الإمام سلطان العلماء عز الدين عبد العزيز بن عبد السلام الدمشقي الشافعي، ط578-660 هجرية، اختصار النكت للماوردي، ط364-450 هجرية، قدم و حقق و علق عليه د /عبد الله بن إبراهيم بن عبد الله الوهبي، ط1-1991، دار ابن حزم -بيروت .
21. تفسير المراغي، تأليف صاحب الفضيلة الأستاذ: المراغي، مصطفى أحمد، ط11-1974، دار الفكر .
22. تفسير في ظلال القرآن، بقلم سيد قطب، ط-1985، 11، دار الشروق، القاهرة.
23. تفسير فتح القدير الجامع بين الرواية و الدراية، في علم التفسير، الشوكاني محمد بن علي بن محمد، المتوفى يصنعاء 1250 هجرية، حقق و خرج أحاديثه د.عبد الرحمن عميرة، وضع فهرسه و شارك في تخريج أحاديثه لجنة التحقيق و البحث العلمي بدار الوفاء، ط1-1994.
24. تفسير القرآن العظيم، للإمام الحافظ أبي الفداء اسماعيل بن كثير القرشي الدمشقي، المتوفى 774 هجرية، صُحِّح بإشراف فضيلة الشيخ خليل الميس، مدير أزهر لبنان ط2-دار القلم، بيروت -لبنان .
25. الجامع لأحكام القرآن، القرطبي، أبو عبد الله محمد بن أحمد الأنصاري، دار الكتاب العربي، بيروت -لبنان .
26. حول تشكيل العقل المسلم، خليل، عماد الدين، المعهد العالمي للفكر الإسلامي
27. خصائص التصور الإسلامي، قطب، سيد، ط8-1983، دار الشروق، بيروت
28. خلافة الإنسان بين الوحي و العقل، النجار، عبد المجيد، المعهد العالمي للفكر الإسلامي
29. الدعوة إلى الإسلام، مفاهيم و منهاج و واجبات، حسني، أدهم جرار، ط1-1984، دار الضياء للنشر و التوزيع.
30. الدعوة إلى الله في سورة إبراهيم الخليل، بن الحبيب، محمد بن سيدي، ط2، الناشر عبد الله بابا الشنقيطي .
31. الدر المنثور في التفسير بالمأثور و هو مختصر تفسير ترجمان القرآن، للإمام السيوطي، جلال الدين بن عبد الرحمن بن أبي بكر، المتوفى: سنة 911 هجرية، دار الكتب العلمية -بيروت .
32. الدعوات الإسلامية، البنا، جمال، شقيق الشهيد. ط1-1991، دار الفكر الإسلامي، القاهرة
33. دراسات إسلامية، قطب، سيد، ط9-1993، دار الشروق، بيروت .
34. رشيد رضا و دعوة الشيخ محمد بن عبد الوهاب، السلطان، محمد بن عبد الله، ط1-1988، مكتبة المعلا، الكويت .

35. روائع البيان في علوم القرآن، صابر، حسن محمد أبو سليمان، ط1-1988، المكتب الإسلامي، بيروت .
36. روح المعاني في تفسير القرآن العظيم و السبع المثاني، للعلامة الألويسي، المتوفى 1270هجرية، أبي الفضل شهاب الدين السيد محمود، ط4-1985، دار احياء التراث العربي، بيروت -لبنان .
37. الرؤية الإسلامية لمصادر المعرفة، جنزربي، رياض صالح، ط4-1994، دار البشائر الإسلامية .
38. رسالة من أقوال سماحة الشيخ عبد العزيز عبد الله بن باز في الدعوة، ط1-1413هجرية، دار الوطن للنشر .
39. سيد قطب الشهيد الحي، الخالدي، صلاح عبد الفتاح، ط2-1985، مكتبة الأقصى، عمان -الأردن .
40. سيد قطب المفترى عليه، القحطاني، محمد بن دليم آل دليم، ط1-1413 هجرية دار الطيبة -الرياض .
41. سيد قطب سيرة ذاتية، عبد الفتاح، علي، ط1-1996-شركة الربيعان للنشر و التوزيع، الكويت .
42. سيد قطب، خلاصة حياته، منهجه في الحركة، النقد الموجه إليه، بركات، محمد توفيق، بلا تاريخ .
43. سيد قطب، حياته و أدبه، عبد الباقي، محمد حسين، ط1-1986، دار الوفاء للطباعة و النشر، المنصورة .
44. سنن النسائي بشرح الحافظ جلال الدين السيوطي وحاشية الإمام السندي، اعتنى به و رقمه و وضع فهارسه: الشيخ عبد الفتاح أبو غدة، ط3-1988، دار البشائر الإسلامية، بيروت، لبنان .
45. صحيح أبي عبد الله البخاري، بشرح الكرمانى، ط2-1981، دار إحياء التراث العربي، بيروت -لبنان .
46. صحيح مسلم بشرح النووي، دار احياء التراث العربي، ط1-1987 يطلب من الديان، القاهرة، شارع الهرم .
47. صحيح سنن بن ماجه، تأليف محمد ناصر الدين الألباني بتكليف من مكتبة التربية العربي لدول الخليج-الرياض، أشرف على طباعه و التعليق عليه و فهرسته: زهير شاويش، ط3-1988، المكتب الإسلامي -بيروت .
48. صحيح سنن أبي داود باختصار السند، صحح أحاديثه ناصر الدين الألباني بتكليف من مكتبة التربية العربي لدول الخليج-الرياض، ط1-1989، توزيع المكتب الإسلامي في بيروت .
49. ضوابط المعرفة و أصول الاستدلال و المناظرة، الميداني، عبد الرحمن حسن حبنكة ط4-1993، دار القلم -دمشق .
50. الظاهرة القرآنية، بن نبي، مالك، ترجمة عبد الصبور شاهين، تقديم محمد عبد الله دراز و محمود محمد شاكر، مكتبة الحضارة، دار الفكر المعاصر، بيروت، لبنان، ط4-1987
51. العدالة الاجتماعية، قطب، سيد، دار الإخوان للصحافة و الطباعة، الناشر: مطبعة دار الكتاب العربي، 1952 .
52. في ظلال القرآن-في الميزان- دراسة و تقويم- عبد الفتاح صلاح الخالدي، ط1-1986، دار المنارة للنشر.
53. في ظلال القرآن - رؤية استشراقية، تأليف أوليفيه كاريه، ترجمة محمد رضا عجاج، ط1-1993، الزهراء للإعلام العربي .
54. الفرقان بين أولياء الرحمن و أولياء الشيطان، بن تيمية، شيخ الإسلام أبو العباس أحمد بن عبدالحليم الحراني، بلا تاريخ.
55. الفكر الإسلامي المعاصر، دراسات و شخصيات، سيد قطب، بحث مقارن لمبادئ الأصوليين و الإصلاحيين، الموصللي، د.أحمد صلاح الدين، دار خضر للطباعة و النشر، ط1-1990، بيروت.

56. القدوة، مبادئ و نماذج، صالح بن عبد الله بن حميد، ط1-1993، دار الوطن، الندوة العالمية للشباب الإسلامي، الرياض .
57. الأعلام، قاموس التراجم، الزركلي، خير الدين، دار العلم للملايين، بيروت، لبنان، ط7، 1987
58. القرآن الكريم و بالهامش زبدة التفسير من فتح القدير، الأشقر، محمد سليمان عبد الله، ط1-1985، وزارة الأوقاف الكويتية .
59. لماذا أعدموني، قطب، سيد، كتاب الشرق الأوسط، الناشر الشركة السعودية للأبحاث و التسويق
60. مذكرات الدعوة و الداعية، البنا، حسن، ط (دون) 1990، الزهراء للإعلام العربي، القاهرة مصر .
61. المستقبل لهذا الدين، قطب، سيد، الاتحاد الإسلامي العالمي للمنظمات الطلابية، 1988، مطبعة الفيصل .
62. المسند للإمام أحمد بن حنبل، شرحه و وضعه فهارسه أحمد محمد شاکر، ط2-1949، دار المعارف للطباعة و النشر .
63. المهذب من إحياء علوم الدين، الشامي، صالح أحمد، ط1-1993، دار القلم الدار الشامية بيروت .
64. مجموعة رسائل الإمام البنا، دار الشهاب، بلا تاريخ .
65. مشاهد القيامة في القرآن، قطب، سيد، ط1-1947 .
66. مفاتيح للتعامل مع القرآن، الخالدي، صلاح عبد الفتاح، ط2-1994-دمشق دار القلم.
67. معالم في الطريق، قطب، سيد، 1980 - دار الشروق بيروت .
68. مع الله - دراسة في الدعوة و الدعاة، الغزالي، محمد، مكتبة أخبار اليوم الإسلامية، بلا تاريخ
69. مقومات التصور الإسلامي، قطب، سيد، ط8، دار الشروق، 1983، بيروت.
70. مدخل إلى التفسير و علومه، زرزور، محمد عدنان، ط1-1995، دار القلم دمشق
71. مفتاح كنوز في ظلال القرآن، (فهارس في ظلال القرآن)، محمد يوسف عباس، دار الطيبة للنشر و التوزيع، ط1987، 1.
72. مباحث في علوم القرآن، القطان، مناع، ط5-1981، دار غريب للطباعة و النشر، القاهرة .
73. مناهج المفسرين، للمؤلفين: مسلم آل جعفر و محي هلال السرحان، ط1-1980 دار المعرفة
74. مناهج الداعية، أبو زيد، أحمد، كتاب شهري يصدر عن رابطة العالم الإسلامي السنة 12، ربيع الأول 1414، العدد 135:
75. مجلة: الدعوة، العدد، 82، شوال 1419 هجرية .
76. مجموعة الرسائل للإمام البنا، دار الشهاب، بلا تاريخ.
77. مجموع الفتاوى، لشيخ الإسلام أبي العباس أحمد بن تيمية الحارثي، طبع بأمر صاحب السمو الملكي ولي العهد المعظم فهد بن عبد العزيز آل سعود، ط1-1389 هجرية.
78. النبأ العظيم، نظرات جديدة في القرآن، دراز، محمد عبد الله، ط2-1970، دار القلم، دمشق .
79. نحو مجتمع إسلامي، قطب، سيد، ط8-1988، دار الشروق .

80. وفيات الأعيان و أبناء أبناء الزمان، أبو العباس شمس الدين أحمد بن محمد بن أبي بكر بن خلكان، حققه د/إحسان

عباس، دار صادر، بيروت .

81. الولاء والبراء في الإسلام من مفاهيم عقيدة السلف، رسالة ماجستير، القحطاني، محمد بن سعيد بن سالم، ط1-

1993، دار طيبة، الرياض، المملكة العربية السعودية

82. هذا الدين، قطب، سيد، بلا تاريخ.

- Imam Husain Rashid, *Quranology, The Practical Solutions To The Worlds Problems And Crisis*, Ta-Ha Publishers LTD. London, 1987 .
- Dr :Abdul Kader Maten ,*Ethics in Islam* :1988 .
- :Shaikh Muhammad As-Saleh AL-Uthaimin, *The Muslims Belief* Translated by :Dr :Maneh Hammad Al – Johani .Cooperation Office of Invocation and Virtue in Diriyah-Saudi Arabia.
- Ali Muhsin ,*Let The Bible Speak* : Islamic Da'wah & Guidance Centre , Dammam .Saudi Arabia .
- Emad El Din Shahin, *Muhammad Rashid Rida And The West* , International Institute Of Islamic Thought ,Herdon –Virginia –U.S.A, First edition :1993 .